Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi

D I J A

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 12/2014, viti XII, Ulqin
Numri 1 doli më 2003

Kryeredaktor
Hajro Ulqinaku

Anëtarë të redaksisë:
Dr. Gani Karamanaga
Dr. Simë Gj. Dobreci
Dr. Shefkije Islamaj
Dr. Maksut Haxhibrahimi
Inxh. arch. Mentor Llunji
Dr. Zhilbert Tafa
Dr. Bahri Brisku
Hajro Ulqinaku

E boton:
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.
Është themeluar më 12 nëntor 2002, në Ulqin.
U riregjistrua: Ministria e Punëve të Brendshme,
Podgoricë, Vendimi nr. 6308, më 13.02.2013.

Ky numër u botua me financimin e Fondit për Mbrojtjen
dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave në Mal të Zi

Vetëm dritë e diturisë përpara do të na shpjerë
(Naim Frashëri)

Çdo hap drejt kulturës është hap drejt lirisë
(Fjalë e urtë shqiptare)

Sa më shumë dije e kulturë, aq më shumë liri
(Sentencë)

PËRMBAJTJA

LETRARE

TRADITË

Gavril DARA – I RIU

Kënga e sprasme e Balës..... 11

POEZI

Milianov KALLUPI 13

Brinjazi më shkon ky lumë (miniatura) .....

Musa VYSHKA

Shkumbinit 14

Abdullah KONUSHEVCI

Vdekja e dytë e Gjergjit..... 14

Vjersha lamtumirëse 15

Petraq RISTO

Vija e jetës 15

Agron TUFA

Për fare u zhduke 16

Klara KODRA

Ujëvarë dhimbjeje 17

Agim VINCA

Danse macabre..... 18

Herezi 20

Visar ZHITI

Krahu i vdekur 21

Eqrem BASHA

Balada kalldrëme 21

Adem GASHI

Puçërrpolitika 22

Remzi LIMANI

Nën tendën ‘395D’ 23

Mexhid MEHMETI

Baladë shqiptare 25

Sulejman MATO

Të mësohesh 26

Esad MEKULI

Në Liqenin e Zanave 26

Kalosh ÇELIKU

Ulqini me dy varre në bregdet 27

Hajredin KOVAÇI
Mos m'i ha germat 29

Radovan ZOGOVIQ
Ardhësit (Kangët e Ali Binakut), Kanga e parë 30
Risto RATKOVIQ
Ikona 31
Jovan NIKOLAIDIS
Kalaja 32
Abdullah SIDRAN
Ankth 33

Eugenijus MATUZEVICIUS
Më duhet deti 34
Roman KISSIOV
Itaka 35
Bertolt BRECHT
Pasardhësve 36
Peter ROSEGGER
Dëshira për Vitin e Ri 38
Adolf GLASSBRENNER
Dy dëshira 39
Tomas TRANSTROMER
Për miqtë matanë kufirit 39
Juan GELMAN
Qetësi 40

PROZË
Ndoc NIKAJ
Fejesa n' djep a se Ulqini i marrun 41
Mirsada BIBIQ – SHABOVIQ
Nënë, pse? 55
Adil OLLURI
Kthimi i babait 60
Asllan BISHA
Kali 63
Andrej NIKOLAIDIS
Ardhja 69

EX-LIBRIS

Zija ÇELA
Shkrimtar i autenticitetit shpirtëror 74
Ballsor HOXHA
Kufiri mizor i tragjikes 81
Jaho KOLLARI
Ulqini, një histori 2500 librash të pashkruara 89
Ag APOLLONI
Ardhja e Apokalipsit 91
Mirash MARTINOVIQI
Kujtime për R. Zogoviqin - poezi e porosive të mëdha.. 92

PËRURIME

Promovimi i revistës "Dija"11, Mustafa Canka 100
"Dielli, deti, shëndeti" – libër me vlerë, Ismet Kallaba.. 101

DRAMË

Mexhid MEHMETI
Vdekje e hijshme..... 103

STUDIMORE

Maksud HAXHIBRAHIMI
Servantesi dhe Fransua Pukëvili ishin robër të piratit ulqinak, Uruç Aliut (Ulluzh Aliut) 141
Jahja DRANÇOLLI
Të dhëna pak të njohura për historinë e familjes Begolli 145
Prof. Dr Aleksandar Stipčević
Shqiptarët për arbëneshët e Zarës 151
Romeo GURAKUQI
Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës I Botërore... 168
Emilio BERTOTTI
"Ekspedita jonë në Shqipëri" 185
Emin KABASHI
Jeronim de Rada dhe hapësira evropiane e veprës së tij 191
Agim Vinca
Tivariada shqiptare: një histori e përgjakshme 203
Shefkije ISLAMAJ
Kongresi i Drejtshkrimit dhe çështje të leksikut 226
Fahri XHARRA
Barkat e qepura ilire dëshmojnë se ishim të hershëm ... 233

Dilaver KRYEZIU
Këngët nga Malësia e Madhe 236
Kujtim RRAHMANI
Miti, histori e oralitet në letrat shqipe 238
Dritan ABAZOVIQ
Ideologjija antiglobaliste 245
Dr. Moikom ZEQO
Flamuri shqiptar (zyrtar) është mbartur në Hënë
në trupin e anijes kozmike "Apollo 14" 250

MJEKËSI
Dr. Lukë GJOKAJ
Kiss sindroma – të qiturit e qafës në konventën e mjeksisë..... 253
Prim. dr Gani KARAMANAGA
Sëmundjet e mushkërive në shtatzënësi 258

ITINERAR
Jozef Jan SVATEK
Ulqini 265

PËRVJETOR
Prof. Bedri Dedja - akademik: krijues, studiues e botues shumëplanësh, autor i shquar i shekullit XX, nga: prof. Murat Gecaj 281
Jup Kastrati, një nga viganët e Albanologjisë, nga:
Isa Halilaj 286

SHTOJCË
Kronikë kulturore - Veprimtaria në Tiranë 293

LETRARE

TRADITË

Gavril DARA – I RIU

KËNGA E SPRASME E BALËS

I
BALA

Mori bijë, bija e Lalës,
Mori e bukur e trishtuar,
Pse më kthen në motnë e shkuar?

Shiko, mjegulla e errët
Rrokulliste mal më mal;
Djellit lerë malit të Gropës
Tundet, qesh shpati i humbet;
Po, si ti, e bardhë, e kthjellët
Copëza e qiellit shtrihet
Me një rreth të pasosur,
E rimtë si ninëza jote.

Dhe zjarrit të paraverës
Çelen gjithë rrahzat,
Edhe tymi hifytyrë
Vete dhe shkrihet me retë,
Posi kënga e meruar,
Që sjell era për së largu;
Kurse vashëzat pa breza
Të zëna orë më dorë,
Të thërrasinë në valle.
Pa kujdes këmba e djemve
Hidhet rëndë ndër kangjele,
Se kan zemërën tek ti
.
O ti lule e hollë malesh,
O ti e para e vashërisë,
Ec atje ku, tek hareja,
Derdhet ari i motit parë
Dhe zbavite zemërën
N'ëndërr t'ëmbël të mëngjesit!

Lerja plakut, lerja Balës
T'errtat lisa, zhurm'n e lumit
Që, rrëzaar malit t'egër
Gryen shpatin me përrenjtë,
Si mendimi im i shkretë
Më lëndon e përvëlon
Me të moçëmet kujtime.

Dyzet herë krahu i dimrit
Ra mbi Honin e mbi Brinjën,
E i theu e i zbardhoi;
Dhe aq herë bleruan arat
Tek ugarëzat e Fushës,
Që kur i mblodh dheu i huaj
Të ikuit, të pafatmit;
E që ahere gëzim
Më nuk shkrepi kësaj nate,
Që mbi trutë më ësht kumbisur.

Ndër sy kam e fluturojnë
Vjetë, trima e pun' të shkuara,
Sikur era që ndrron retë,
Ed përveshur, e zvarrisur
I përze me frymë e gji.
Moti kalon i pandier
Mbi të shkretinë dhënar
Po mbi ballin e ushtarit
Bien si plumb këto ditë,
Sepse me duar të ftohta
Brënda m'u në varr e shtijnë.
Këto ditë kotësie
Të helmëta janë, vashë,
Posi vdekja për Balën;
Se ky krah, tani i flashkët

Shumë herë sëlloi ushtën
Ndëra ushtarë, e bëmat tona
Shumë herë me lëvdime
U kënduanë nga vashat.
Tani q'ecij shkretëtirës
Edhe mbeta gjallë e zi,
Forca e t'rinjve më le
Të harruar në një skaj.
Po veç ti (si rremb i qiellit,
Lehtë e lehtë dimrit t'egër
Zgjuan të mjerin dhenar,
Tretur tek lugina e llazit
Dhe e gëzon me afsh e dritë)
Përdëllim i brengës sime,
Me mua vjen në errësirë
Dhe, sakaq, përpara syve
Kam bujarëtë, të fortët,
Të vrenjtur e të helmuar
Si m'u dukën për së largu
Çukat maleve shpërndarë,

Kur nga deti iu përfala
Për së fundi e më s'i pashë!

O ju bij të motit t'madh,
Hapër një udhë të ndritur,
Në thellësitë e vitrave;
Zulma juaj ishte diell
Përmbi botën e përmbysur;
Ajo eshtrat ju shkëlqen,
Posi djell, q'edhe pernduar
Gjithë me zjarr e me shkëndijë
Mbulon valët në trazim.

Po ushtarët s'duan helme,
S'duan qarë... Por, po deshe,
Emri yt tani më ndezi
Një përallëzë plot lot.

Kthyer në gjuhën e sotme nga:
Razi Brahimi

.....

Gavril DARA – I RIU *(për dallim nga ungji i tij, Plaku), lindi në Palaco Adriano të Sicilisë, më 1826. Ishte pasardhës i Jeronim de Radës, për poezinë artistike arbëreshe. "Kënga e sprasme e Balës" (u botua pas vdekjes së autorit) është kryevepra e autorit dhe njëra ndër veprat më të njohura të poezisë shqiptare. Ka vdekur më 1885.*

POEZI

Milianov KALLUPI*

BRINJAZI MË SHKON KY LUMË

(Në shtëpinë e shpirtit)

Në shtëpinë e shpirtit
Çdokush e ka nga një Itakë
Për të përgjërohet
Drithërohet në flakë.

(Amaneti i Faik Konicës)

Eshtrat po m'i latë, këtu, në dhe të huaj
Prej tyre do të mbijnë veç gjemba e shpata.
M'i shpini në tokën time, të mos vuaj,
Në çast do të shndërrohen në lule të bardha!

(***Porosi***)

Si deng hidhërimi
Në zbrazëtirën e varrit,
Nëse s'jam përgjëruar
Dhe për fijen e barit...

(***Hapësirë***)

Rrugët u bënë marramendëse
Hapësirat ndehën krahët e ajrit.
Ndjej të jem trupëzim i shtërgjeve,
Pulëbardhave, Zogjve.
Gjaku më klithmon
Eshtrat më muzikojnë
Himnin e fluturimtë.
Hapësira e mospërfill
Gurëzimin e statujave...

****Milianov Kallupi***, lindi në Elbasan, më 1948 dhe u shua, po në vendlindje, më 2013. Njëri nga talentet më të mëdhenj të haikut në shqipe. Ndër veprat poetike më të dalluara: *Çelin lulet, Kali i bardhë i ujëvarës, Haiku, Bohem, Pulëbardhat e Ulqinit* etj.

Musa VYSHKA

SHKUMBINIT

Se ç'kam harruar të të them një gjë,
Se ç'kam harruar diçka
Aty, në brigjet tua.
Jam plakur, i dashur dhe s'vij dot më,
Megjithëse s'harroj përherë njësoj të të dua,
Por ti tani ke aty pranë
Milianovin e dashur që po fle
Përqafoje dhe thuaji atij
Gjithçka ke për të më thënë
Vjen ai çdo natë fluturim
M'i sjell të gjitha nëpër ëndrra mua...

Tiranë - Elbasan, nëntor 2013

Abdullah KONUSHEVCI
(1958 – 2013)

VDEKJA E DYTË E GJERGJIT*

Kur derdhet atdheu në det
Shkulet shkëmbi fusha mali
Terri derdhet me shtamba
Dhe thikat vezullojnë

Vlorën e zënë ethet e dridhet
(Babi, do t'i kenë tretur
Gjergjit eshtrat
Se Atdheu po derdhet
Përsëri në det)
Drilonit s'mund t'i them
Ji i fortë
Driloni është bërë dhe

Dhe ata po e shohin
Se s'është kjo më
Lojë me qen e mace

VJERSHA LAMTUMIRËSE

E shtrenjta e shenjta ime Dardani
Që kur miqtë më ranë vertikalisht
Në ty më nuk gjej njeri
T'i rrok dorën të përfalem me të
Më fal nëse një ditë iki
Nëse nuk kthehem kurrë më

Janë mullizezat
Dhe mullibardhat janë
Që sot të këndojnë
Dhe të ledhatojnë shtatin

E shtrenjta e shenjta ime Shqipëri
Më fal nëse një ditë iki
Nëse nuk kthehem kurrë më
S'kam zemër t'i shoh
Ata që lyhen me mellan
As mëllenjat që u këndojnë ranë

Më fal nëse një ditë iki
Nëse nuk kthehem kurë më
Jam ai që të shoh që të dua
Vetëm në ëndërr

Petraq RISTO

VIJA E JETËS

Loti i Parë dhe Loti i Fundit janë binjakë
Ose: dy pika krijojnë Vijën e Jetës

Në këtë vijë kam ecur
Në fillim këmba-doras
Duke kuptuar zvarritjet e luftës...

Pastaj gjunjazi
Duke nuhatur të ardhmen
Si rob duke u lutur

Kur u ngrita në këmbë
Qe tepër vonë
Përplasa kokën te Hëna e Plotë
Dhe mbeta i gjymtuar.

Më gjeni në Pavijonin e Poetëve
Gjithnjë midis dy lotësh
Nga miq rrethuar.

Manhattan, 30 shtator 2013

Agron TUFA

PËR FARE U ZHDUKE

Me qëllim që natë e ditë të më rrije para syve,
Me qëllim që të bëhesh gjithë më e dukshme.
Me qëllim që pazgjidhshëm t'na lidhje të dyve
Për fare u zhduke...

Me qëllim që mundja të marrë arratinë,
Me qëllim që prej teje mos mbetet një shenjë,
Me qëllim që kërkimin ta bëj me tahminë –
Si i verbëri prenë.

Ty dheu të piu saora në katër drejtime:
Katër anët shushatur në shpresë, dëshpërim,
Kryqëzuar udhëkryqesh dashuria ime
Bën rrethrrotullimin –

Dhe ngryset bujtinash bajate, periferish,
E kredhur në gjumë të terrtë e harrim
Që nesër, pas eje të vihet në udhë sërish –
Ma bën me qëllim.

Klara KODRA

UJËVARË DHIMBJEJE

(*Për të gjallët dhe të vdekurit në Sardenjën e përmbytur*)

Vërshon një ujëvarë... nga qielli, vallë?
Më mirë do të thosha "nga skëterra"
Gjersa përpin njerëz të gjallë.
Vërshon një ujëvarë skëterrore,
Një tjetër ujëvarë nga sytë njerëzorë,
Ç'është ajo vajzë që s'ka as dy vjet
E do të mbetet aq përjetë?
Ç'është ai baba që fut në xhup
Katërvjeçarin vogëlush
Që me përpjekje mbinjerëzore
Qëndron i varur për një orë?
Kush është ai që rend për ndihmë
Dhe ata që s'tunden asnjë grimë
Gjersa përbindëshi ujor
Si gojë hap gjirin e vet mizor
Dhe nuk ngurron që të përpijë
Artë baba, atë fëmijë?
- Je lodhur, Lukë?
- Bëj pushim!
- Po ata që presin për shpëtim?
Në shtëpi grua e fëmijë me ankth
Të presin... Pritja s'ka mbarim.
Përbindëshi ujëvarë gëlltit vetë
Pemë, shtëpi... po edhe jetë.

Po shkruaj, po shkruaj dhe s'jam e zonja
Prej uji mos qofshin këto shkronja.
Prej zjarri qofshin, të pashuar.
Për ju, për ju, për t'ju kujtuar,
Është një përbindësh... Jo si në përrallë.
Në jetë përpin njerëz të gjallë.
Po kush për këtë fajin e ka, vallë?

Agim VINCA

DANSE MACABRE

(*Epitaf për të rënët në Tivar, 1945*)

Toka poshtë. Qielli lart. Deti në mes.
Dhe ne që vemë kurorë lulesh
Te kjo godinë e vjetër, e gurtë
Me emrin Monopol!
Lule të kuqe, lule të bardha
Të freskëta si gjaku, si shpresa.
Ende vret njerëz në botë Urrejtja
Me tyta, thika, granata, helm e kokarda,
Mijëra, miliarda...
Njeriu vret!
Jemi në Tivar Breg.
Ulqinakë, anamlas, kranjanë, shestanas,
Kosovarë, tiranas, shkupjanë, lumjanë,
Miq e shokë nga Drenica, Karadaku,
Dukagjini, Tropoja,
Këtu tek u bë ploja.
Binin si kallinj trupat e gjallë,
Klithnin, çmendeshin, rënkonin,
Kërkonin një pikë ujë para se të vdisnin!
Xhelatët shtinin pa pushim
Mbi *banditët shiftarë*
Nga të gjitha anët, me të gjitha armët
Dhe këndonin këngë për lirinë.
Madhëronin luftën, fitoren, Mareshalin
Dhe deheshin me gjak e shlivovicë!
Në këtë *danse macabre*
Gjashtëdhjetë e tetë vjet më parë!
E në Tivar Nalt nuk ra kambana për mort
Arqipeshkvi Guilielm Adam nuk shkroi raport,
As u lut kush për shpirtin e të vdekurve.
Veç qielli lart i pa të gjitha
Qielli i hirtë dhe retë në horizont!
Trupat që binin si bari nën kosë
Gjakun që rridhte lumë
Plagët që kullonin gjak
Plisat e bardhë që notonin mbi det.
Vajmedet!

Veç qielli i hirtë dhe retë e kuqërremta.
Jemi në Tivar Breg.
Në këtë muranë pa shenjë, pa lapidar!
Ende vret njerëz në botë urrejtja
Si këtu e gjashtëdhjetë vjet më parë,
Si këtu e gjashtëqind vjet,
Si këtu e gjashtë mijë vjet!
Si në Trojë, Vaterlo e Hiroshimë,
Në Prekaz, Sarajevë e Reçak!
Gjak! Gjak! Gjak njeriu has!
Këtu ranë për një ditë mijëra plisabardhë
Korrur nga breshëritë e mitralozit,
Djegur nga flakët e barotit.
Toka poshtë. Qielli lart. Deti në mes.
Dhe ne që vemë një kurorë lulesh
Lulesh të kuqe si gjaku, të bardha si harresa
Në Tivar Poshtë.
E në Tivar Nalt prapë hesht Kambana e Sahatkulla
Askush nuk lutet për shpirtin e të rënëve.
Veç baca Ramush, plaku qibar 93-vjeç nga Prishtina e Vjetër,
Tregon me dorë si orakull, sypërlotur,
Një përrua, një shpellë, një guvë, një hon, një pellg
Dhe detin përballë detin
Tek flenë hijet e atyre që ranë këtu
Në pikë të ditës
Në agun e lirisë së popujve,
Të lirisë së larë me gjak
Te ky shesh kalvar, te kjo godinë Golgotë
Me emrin profan Monopol i Duhanit,
Atëbotë e sot,
Atëbotë e sot,
O Zot!

(*Tivar, Monopoli i Duhanit, 31 mars 2013*)

HEREZI

(*Në vend të demarshit për aktin vandal të 24 majit 2013*)

Sulmi në Shtëpinë e Alfabetit në Manastir ndodhi në Ditën e Shën Kirilit dhe Metodit, që është festë zyrtare në shtetin fqinj me emrin FYROM.

Masazhi i tij është i qartë: këtu s'ka vend për shkronjat shqipe!

Alfabeti cirilik s'i duruaka ato! Shkronjat shqipe! Mbase as latine.

Urrejtje, krim, barbari... Ç'është, vallë, kjo që ndodhi në Ditën e Shën Kirilit dhe Metodit në Manastir?

Në "qytetin e konsujve", si e quajnë ata; seli e Vilajetit dhe e Kongresit, për ne.

Aty ku burrat nga të katër anët e Arbërisë morën vendimin historik të ABE-së.

Si mund të jenë të shenjtë ata që s'i durojnë dot të tjerët vetëm e vetëm pse janë ndryshe? Hiqjauni Kirilit dhe Merodit nofkën "shën"! Hiqjani aureolën pasardhësve të tyre mesjetar e modernë! Mos e mashtroni botën! Ç'shenjtëri është ko?

Sulmi vandal në Shtëpinë e Alfabetit në Manastir ndodhi në valën e fushatë zgjedhore në Shqipëri. Në Shqipërinë shtetërore... Nuk pati reagime nga Tirana zyrtare. Atje bëhet garë për vota; garë e ethshme. Në të vërtetë luftë për pushtet. Tash njëzet e tre vjet, e tash njëqind vjet!

Lëngon alfabeti shqip. Alfabetin shqip s'ka kush mbron! Shkronjat shqipe po përgjaken edhe në shekullin e 21-të! Si në kohën e turkut; si në kohën e Kralit; si në kohën e "Vozhdit"... Dhe të shërbyesit të tij namqorr nga qyteti buzë Vardarit; mbushur deng me kuaj, luaj e luftëtarë legjendarë.

Sheshe, hotele e stadiume me emra të bujshëm: Leka i Madh, Filipi i Dytë, Buqefal... Hip këtu e shih Stambollin!

Në shtetin me emrin FYROM çelin si akaciet iluzionet. Dhe paradokset si kërpudhat pas shiut!

Sondazhet thonë se shqiptarët janë populli më i urryer; Shqipëria shteti më armiqësor!

Sa të marrë që janë, o Zot! Ç'heretikë!

Herezi është me siguri edhe kjo që bëj unë!

Demarsh në vargje a p(r)oemë postmoderne?!

(*Prishtinë, më 29.5.2013*)

Visar ZHITI

KRAHU I VDEKUR

Si vdes njeriu kur nuk duhej të vdiste, a ke parë?
Si i bie koka në një rrugë të Tetovës
Dhe yjet e fundit shkrepin mbi gurët e përgjakur
Nga plagët gurgullon jeta

Dhe Zoti s'e bën dot më baltën njeri.

Dora që preku armën?! Cung të kishte qenë më mirë,
Thundër a putër... Na vrasin këtu në fillime ndodhish
Të egra, në mbarimet e tyre, të shuara pas ekranit
Të kompjuterit të djegur të policisë. Krahu
I vdekur i jetës zgjatet dhe zgjatet, i kalon kufijtë,
Të gjitha kufijtë, të dhembjeve dhe durimit,
Të frikës dhe epokave
Hapen mbi rrugë gishtat e dorës së vdekur
Si harta e Ballkanit. Rënkon krahu
Dhe ftohet mbi pellgun e gjakut të vet. Befas
Ngrihet dhe troket i padukshëm si ankthi
Në ndërgjegjen e gjithkundshme. Troket
Larg dhe afër Tetovës, me datë të vrarë...

Eqrem BASHA

BALADA KALLDRËME

Se çka thoshte një njeri në trotuar
Tek pinim birrë në tarracën e kafenesë
Dhe ngrysnim me nge një pasdite vere

Derisa
Ai fliste se çka fliste fliste fliste
S'pushonte të gërthiste
Me duar me gjeste bërtiste

Askush nuk e dëgjonte
Ne merreshim me vetveten

Ai pastaj thërriste thërriste thërriste
S'pushonte të gjëmonte
Me gjithë fulqinjtë shkumonte shkumonte

Ne këpusnim dëngla
Gjëra të parëndësishme – të ftohta
I tundnim dollitë së koti
Tredhshim miza bjerrshim kohë

E ai çirrej çirrej çirrej
Digjej shquhej ngjirej
Shkëpurdhej

Ishte një zagushi e rëndë
Ne pinim birrë e tjerrshim rërë
Në tarracën e kafenesë
Në një ditë të mërzitshme vere

Në të ngrysur çdo gjë u qetësua
Ne u kthjellëm u shkundëm nga heshtja
Kthyem kokën dhe pamë

- bah
tha njëri prej nesh
- një kufomë në trotuar!

Adem GASHI

PUÇËRRPOLITIKA

Ndërtesa e lartë e Qeverisë
Lartësohet sa mandati i saj
Në strukturën e leshtë të shtetit
Me xhepa shumë

Që andej me sy e mërzi perëndish
Në perspektivë zogu
Ata, shohin thnegla përposh

Këta, që jemi Ne,
Në perspektivë bretkose
Shohim pasqyrim shtëllungash të reve
Në një qiell të xhamtë reflektimi

Në luftën e pashpallur
Mes Tyre e Shkrimtarëve,
që s' blihen as shiten,
Gëlojnë motivet e pabëra dramë,
Më kot
Pret skena e Teatrit Kombëtar
Matanë

Një kokërr vote
S'është veçse një puçërrpolitikë
Në teorinë e demokracisë.

Remzi LIMANI

NËN TENDËN '395D'

(*Fragment*)

Tashmë në numra të shndërruar
Familja ime mban emrin '395D'
Çdo ditë para agmisë
Para këngës së gjelit të kuq
Më zgjonte melankolia e nënës
Të tjerët të mbuluar me batanija kuajsh
Të shtrirë përtokë flinin
Përreth qetësi relative
Dikush dikujt i thërriste me axhele
Ecni të mos vonohemi
Para agmisë nxitonin për të kur...
Një zë thekshëm thërriste gjakun e tij
Mos e harroni Kosovën
Ishte dikush që i përcillte i përlotur.
Pa frymë nëpër tendën e ngushtë
Symbyllazi mbi kartonët e ambalazheve
Mbi tokën e ftohtë

Shtriheshim të mardhur e të jeshilët mbi të
Nën tendën ‘395D’
Ecnim të kërrusur
Në gjunjë pinim ujë
Në gjunjë luteshim për Kosovën.
Meqë ra fjala
Gjithmonë merrja shtatë pjata të gjelbra
Shtatë gota plastmase
Shtatë pirunë
Shtatë lugë
Një pjatë plastmase
Një gotë
Një lugë
Një pirun më shumë
Sepse unë kisha pesë fëmijë
Kurse nën tendë vetëm katër
Vajza ime Venera
S’ishte me ne
Pa e pyetur e humbën në Anadoll
Duke kujtuar imazhin e humbur
Nuk doja ta ndaja nga sofra
Andaj merrja edhe për të.
Një ditë në sy të mëngjesit
Para gjunjëve
Shtrova një cohë beze amerikane
Hapa kutinë e bojës së këpucëve
Fillova ta bëja konstruktin e pikturës mbi bez
Qëkur më zgjoi nëna nga gjumi
Motivi i pikturës më flinte në kokë
Doja ta vizatoja *Kosovën.*
Të mbështjellë në plagë
Ishte dita e njëzetepestë
Rreshtat për bukë rriteshin për çdo ditë
Lumi i njerëzve s’kishte të ndalur...
Nga Drenasi, Theranda, Ulpiana, Besiana,
Manana, Brezana, Viktoriana,
E gjithë Dardania
Të pafrymë zbrazeshin mbi tokën neutrale

Në gjunjë e gisht në kokë
Vendosa ta pikturoja *Tokën e Djegur*...

15 maj 1999, Kampi Stankovec, Maqedoni

Mexhid MEHMETI

BALADË SHQIPTARE

Shumë gjak të shqiptarëve
O Tivar, ti ke pi'
I vrave pas shpine
E me pabesi

(Popullore)

1
As Deti i Kuq nuk është i kuq
I kuq është Deti i Tivarit
As Deti i Zi nuk është i zi
I zi është Deti i Tivarit

2
Lulëkuqet e Kosovës
Rrënjët në Tivar i kanë
Ditë e natë atje
Historia qan
Gjeografinë e shpirtit
Me lot shpërlan

3
Vetëm në Tivar
Det të kuq e të zi ka
Vetëm në Tivar
Deti s'i ngjan detit
Qielli s'i ngjan qiellit
Rëra rërës guri gurit
Dheu dheut dielli diellit
Ujëloti i shndërruar në gjak

(1993)

Sulejman MATO

TË MËSOHESH

Të mësohesh fillimisht me dritën e diellit,
Me fytyrën e nënës dhe me fytyrat e njerëzve të dashur.
Të mësohesh me këpuckën e këmbëzën e zbathur,
Me urdhrat e mësuesve të eprorëve të tu.
Të mësohesh për t'i pritur fatkeqësitë qetësisht
Dhe çastet e lumturisë t'i vlerësosh si çlirim.

Të mësohesh me fytyrën tënde në pasqyrë,
Dhe me udhëtimet, si të gjendesh në një tren pa kthim.
Të mësohesh me vdekjen e të dashurve të tu,
Me pakohësinë e kohës, të sendeve dhe njerëzve.

Të mësohesh me dështimet dhe fitoret e përkohshme.
Të mësohesh me gjithçka dhe kur zemra të dhemb
Dhe kur ndihesh i vetmuar, i poshtërua dhe i braktisur.
Të mësohesh me frikën gjersa ta mposhtësh atë.

Të mësohesh me lirinë që s'i duhet askujt
E që njëkohësisht na duhet të gjithëve.
Të mësohesh të jetosh pa kujtime dhe shpresë,
Si gurët dhe drurët që s'ndjejnë asgjë.

Të mësohesh që edhe në çastet e vështira të qëndrosh si burrë,
Se ai që s'ka frikë nga vdekja nuk vdes kurrë.

Esad MEKULI

NË LIQENIN E ZANAVE

Po ju rikthehem, liqe i dashur, syve tu malorë –
zanave tua shërimtare,
të lidh, për shëndet, në rremzen e njomë pishe pejzën e kuqe
që zanat e mbara të na ndihmojnë
të mos frigohemi nga vrasjet, nga zor-zullumi, nga kryqimi...

(Prindërit e mplakur, vra në pakun e shtëpisë, nëna i ka qarë
dhe motrën me kërthi, të therur, i ka vajtuar
me një prush fëmijësh në rrugë nga shtëpia e vet e dashur...)
dhe paren e metaltë, në mirënjohje, të hudh në ujërat tuaja;
këmbët fëmijërore i zhyt në ujin e kulluar dhe të akullt
që në guralecët bardhoshë të mbahen me fuqi,
dhe lag ballin e njomë – të kthjellohet si thellësitë tuaja
në këtë ditë verore...

Ju rikthehem shkëmbinjve tu, bimëve tuaja, qetësive –
shërimtare tuaja:
të puth syrin kaltërosh, t'i përkëdhelë pishat dhe barin
të përshëndes shqiponjë – krenare e lartësive... –
pse asgjë më të dashur – sot si dikur – se ti –
fëmijënia ime bonjake edhe në këto brigje!

Liqeni i Hridit – Plavë, 1973

Kalosh ÇELIKU

ULQINI ME DY VARRE NË BREGDET

Ulqini me Kalanë mbi shpinë
E Detin në gji. Tjerr një legjendë.
Nëpër mote: Për dy vëllezërit trima
Që, e shpëtuan nga armiqtë Qytetin.
Dhe, ranë dëshmorë rrëzë Kalasë.
Qyteti me Kalanë mbi shpinë
E Detin në gji. Tjerrë një legjendë:
Për dy vëllezërit që shpëtuan Ulqinin…

(***Asgjë nuk kishte ndryshuar në këtë Qytet***)

Pas njëzetë viteve i bëj pushimet në Ulqin
Erdha në mëngjes. Nuk e gjeta në gjumë.
Vetëm se, shumë pak kishte ndryshuar qyteti
Ende i mbante stolitë e vjetra komuniste.
"Olimpikun", që dikur e vizitonin gjermanët

Tashti e vizitonin çekosllovakët. Shqiptarët.
E ky, edhe tashti si dikur moti në komunizëm
I priste krahëhapur me bukë. Kripë e zemër…
Asgjë nuk kishte ndryshuar në këtë Qytet.
Ende flitej gjuha e "vëllazërim-bashkimit".
Dhe, nuk e di kush çka është në demokraci…

(***Malësia e Madhe vështirë e ka ta pushtojë Ulqinin***)

Malësia e Madhe, vështirë e ka nesër
Ta pushtojë Ulqinin. E t'ia mësojë gjuhën.
Legjendën e dy vëllezërve kreshnikë
Që, e dhanë jetën ta shpëtojnë Ulqinin.
Dhe, rrëzë Kalasë t'i presin turistët
Ballëlartë me bukë. Kripë. E, zemër…

(***Lamtumirë, Qyteti Dy Vëllezërve - ika në Shkup***)

Dhe, lamtumirë, Qytet i Dy Vëllezërve,
Po ik për Shkup. Bërllokun tim të vjetër
Që, ende nuk e ka zënë Dimri. Dëbora
Vardari ta vërshojë, t'ia pastrojë rrugët.
Skënderbeu ku pret të kalojë matanë
Hipur në kalë. E me shpatën në brez.
Dhe, lamtumirë, Qytet i Dy Vëllezërve,
Ika në Shkup. Bërllokun tim të vjetër…

(***Rruga nëpër Kosovë - një rrugë tjetër***)

Verë për verë të kisha vizituar vetë i dyti
Kalanë. Bregun. Dhe, Plazhin e Madh.
Dhe, gjithmonë kisha ardhur një rruge
Rruga nëpër Kosovë një rrugë tjetër.
Herën e fundit të erdha nga Shqipëria
Dhe, të ika një rruge tjetër nga Kosova.
Maleve: Nëpër Çakorr. Pejë. Dhe, Prishtinë…

Hajredin KOVAÇI

MOS M'I HA GERMAT

Kurrë s' ngihesh, he, të plastë pika
Në bark plaç
Të shkoi jeta duke më urrejtur
Duke më përbuzur
He, u shofsh
Edhe germat do t'm'i hash
He, kurrë mos u ngopsh
Ç'faj kam unë
Që kam germa më shumë se ti

Dh dh dh
Dhashtë Zoti
Mbi ty të shkrepë moti

Ë ë ë
Ëndrra të këqija gjithmonë shikofsh
E nga gjumi kurrë mos u zgjofsh

Rr rr rr
He, rrenashe shkreta
Gjithmonë me rrena të shkoi jeta

Th th th
Thika me të cilën
Do t'ma presësh gjuhën
Dhe që gjithmonë ma ngule pas shpine
Moj katile

X x x
He, xanxare
E poshtër e mëkatare

Y y y
He, t'u shoftë fara
E payrnek
Më bëre t'ia filloi nga e para
Po ti as s'më zhduk dot, jo, s'je e zonja
Se unë të mbys me shkronja.

Radovan ZOGOVIQ

ARDHËSIT (KANGËT E ALI BINAKUT)

I Iku gjumi Ali Binakut si zogu i trembun dhe netët u banë të randa e të pambarim. Orë e orë të gjata të natës ai rrin zgjuet, i shtrimë në postahen e vjetër t'ogiçit, ndërsa netëve të shurdhta e heret para se të zbardhë drita rrin pranë oxhakut ku, simbas zakonit të stërgjyshëve, e ndez vetë zjarrin: rrin, mendon dhe numron tespihe – mjekra e bardhë e krehun i skuqet në flakë si tufa e misrit të Dukagjinit. Pëshpërisin fletët e thata të buzëve, kërcasin tespihet – kohë të vështira kanë ardhë, don me iu zhdukë gjurma fisit t'Ali Binakut të Dukagjinit.

Ma lehtë e kanë pasë stërgjyshët e tij në moshën e tij: lejshin parmendën e kosën, lejshin pushkën dhe rrijshin në kulla; ndizshin zjarrin në oxhak t'odës së madhe, u tregojshin bijve dhe nipave çka duhej të punojshin, shkojshin në pleqni të Shëngjegjit, pajtojshin gverra shtëpiake, pritshin mysafirët, kujdeseshin për nuset dhe i faleshin perëndisë. Po çka të bajë, çka të bajë Ali Binaku plak, si të rrijë në kullë, qysh të dalë prej saj – ditë të vështira kanë shkelë, zotërinj të vështirë: duen t'i zhdukin gjurmën si atij ashtu edhe fisit të tij prej Dukagjinit.

KANGA E PARË

Unë Ali Binaku heq tespihet e mij të shurdhët
Dhe me çdo kokërr të rendoj mbi qafë vargun e gurëvet,
Unë Ali Binaku
Të mallkoj gjithë ç'ke deri farën e gjinisë sate.

Pse, pse
Në pullaz ma vrave të shejtin shpend, lejlekun?

N'oxhakun tim i falej allahut,
N'oxhakun tim puthte sqepat e bardhë
Që si bima prej bucës shpojnë lëvozhgën e vesë,
Prej oxhakut tim shtrinte në votrën time rrembat e bardhë,
Dhe kurr me krahë s'ma rrëxoi mollën prej rrembi,

Dhe kurr me sqep s'ma shpoi synin e kuq të qershisë
(që të kullojë ninza e kuqe!) –
Shpend i shejtë

Kur pushka e parë krisi n'te –
Me habi shikoi sy-hapun shpend shejti;
Kur pushka e dytë krisi n'te –
Vetëm qafën e përkuli si lulja e bardhë n'erë;
Kur pushka e tretë krisi në të –
Ra prej oxhakut tim, i përgjakun,
Në pullazin tim...

Ashtë natë. Hana pikllueshëm sodit shqiptarinë e Dukagjinin.
Rrij para oxhakut – mbi prush ka ra cipë e blertë e hinit;
Gjithçka flen – ndihet vetëm pikja e tespihëve.
Mbi mue, në shtrojën e zezë të myshkut në pullaz,
Shtrihet pa shpirt shpend'i shejtë.
I baddhë dhe i përgjakun – top bore me gjak stërpikun,
I bardhë dhe i përgjakun – top bore me gjak i ulun.

Po ndiej, po ndiej:
Prej strehës
Sime
Pikon
Gjak.

Risto RATKOVIQ
(1903 – 1954)

IKONA

Shoh ndonjë grua
Që ngjason me ty
Me mantel bojëhiri
E me kapele të bardhë
Qëllon që ta takoj në rrugë
Edhe pse e di

Se u bë kaq kohë që më s'je
Mendnoj: mbase je ti

Përndryshe, ti e di,
Te Zoti s'keni besuar
As unë, as ti,
Dhe përnjëmend kjo
S'ka lidhje me të
Që unë të ndez
Një kandil përpara fotos tënde

(Përkthyer: Mazafer Xhaxhiu)

Jovan NIKOLAIDIS

KALAJA

Të gjithë si ushtarë të verbër
Pranë bedenave tua kapërcejnë.
Dikush në det:
I varfri, Dashnori, Ose katili,
Dikush në male,
Që atje i vetëm të këndojë e ankojë.
Disa, Si një zog i lidhur,
Sa qëndron,
Rreth teje duke heshtur.
Ndërsa pluhuri i shekujve,
Nëpër sokakët e tua,
Sikur qetësia, Natën.
Zërin kurrkush s'ta dëgjon.
Ndoshta ndokush të pa,
Kur erdhën dyndje të mëdha,
Që të qeshësh si fëmija me ngulm.

Poezi boshnjake

Abdullah SIDRAN

ANKTH

Çfarë po bën, im bir?

Ëndërroj, nënë. Ëndërroj, nënë, sesi po këndoj.
E ti më pyet, në ëndrrën time, çfarë po bën, djalë.

Për çfarë këndon në ëndërr, im djalë?

Këndoj, nënë, sesi kam pasur shtëpi
E tash nuk kam shtëpi. Për këtë këndoj, nënë.
Sesi, nënë, kam pasur zë dhe kam pasur gjuhën time.

E tash nuk i kam, as zërin, as gjuhën.
Me zërin që nuk e kam, në gjuhën të cilën nuk e kam,
Për shtëpinë që nuk e kam e unë këndoj këngën, nënë.

E përktheu në gjuhën shqipe: Smajl Smakaj

Eugenijus MATUZEVICIUS
(Lituani)

MË DUHET DETI

Gjithnjë e më fuqishëm hetoj
Se më duhet deti,
Batica dhe zbatica e tij,
Afërsia e tij.
Më herët kjo ishte romantikë,
Lirikë e rinisë,
Gëzim i dalldisur i të njohurit.

Tash deti më duket organo e madhe
Ku çdo ditë është e mbushur me të.
Me tingujt dhe heshtjen e zhurmshme,
Thellësinë e dhembjes,
Ngulmëshmërinë e mençur
Mendimin e përsëritur
Të pandryshuar,
I cili mëson si të jetohet,
Mëson për fuqinë, dëshirën...

Deti dhe realiteti përzihen.
Kumbojnë organot e mëdha,
Presin dhe përcjellin
Ata që vijnë,
Ata që shkojnë.

Roman KISSIOV
(Bullgari)

ITAKA

"*... kam kuptuar me të vërtetë*
çfarë përfaqësojnë Itakat"
K. Kavafis

Edhe unë jam një Uliks,
Por i panjohur,
Për mua nuk ka dëgjuar askush,
Askush nuk e ka kuptuar dinakërinë time...

Sepse unë nuk e kam braktisur kurrë Itakën.

Asnjëherë të vetme në jetën time,
Nuk kam takuar Ciklopin, Lestingtonin, Sirenat,
Nuk kam ndërtuar Kalin e Trojës,
Nuk kam qenë i duartrokitur për asnjë virtyt...

Sepse unë nuk e kam braktisur kurrë Itakën.

Askush nuk ka ditur kurrë
Për forcën e harkut dhe kurajos time,
As Penelopa, dashuria e saj për mua
Është venitur krejt,

Sepse unë nuk e kam braktisur kurrë Itakën.

E solli në shqip: Dashamir MALO

Bertolt BRECHT
(Gjermani)

PASARDHËSVE

1

Me të vërtetë unë jetoj në kohëra të errëta!
Fjala e pasherr është qesharake. Balli pa rrudha
Tregon për pandjeshmëri. Ai që qesh
Vetëm nuk e ka marrë ende
Lajmin e tmerrshëm.

Çfarë kohërash janë këto, kur
Një bisedë për lisa është pothuaj krim
Sepse nënkupton heshtjen për aq shumë mizori!
Atë që qetësisht po kalon rrugën
Mbase shokët e tij që janë në hall
Nuk mund ta gjejnë më?

Është e vërtetë: unë ende i ftoj shpenzimet e jetës
Por, më besoni: kjo është vetëm rastësi. Asgjë
Nga ajo që bëj nuk më jep të drejtë të ngopem.
Rastësisht nuk më kanë prekur. (Nëse më braktis fati
Atëherë mbaroj).

Më thuhet: ha e pi ti! Ji i lumtur që ke!
Por, s mund të ha e të pi, kur
Ia grabis të uriturit atë që ai ha, dhe
Gota ime me ujë i mungon një të urituri!
Dhe unë ende ha e pi.

Unë me qejf do të isha i urtë
Në librat e vjetër shkruan se ç'është të jesh i urtë:
Rri larg grindjeve të botës dhe kohën e shkurtër
Kaloje pa frikë
Dilja mbanë pa dhunë
Të keqen ktheje me të mirë
Të mos ia plotësosh dëshirat vetes, por t'i harrosh
Thuhet se është urtësi.
Të gjitha këto unë nuk mundem:
Me të vërtetë unë jetoj në kohëra të arrta!

2
Në qytete erdha në kohën ne rrëmujës
Kur mbretëronte uria.
Mes njerëzve u gjenda në kohën e kryengritjes
Dhe unë u zemërova bashkë me ta.
Kështu shkoi koha ime
Që më ishte dhënë mbi këtë tokë.

Bukën time haja mes betejave
Shtrihesha të flej mes vrasësve
Dashurisë s'i kushtoja vëmendje
Dhe natyrën shikoja me padurim.
Kështu shkoi koha ime
Që më ishte dhënë mbi këtë tokë.

Në kohën time rrugët të çonin në moçal
Gjuha më tradhtoi para kasapit
Unë mund të bëja pak. Por, sundimtarët
Pa mua ishin më të sigurt, kështu ma merrte mendja.
Kështu shkoi koha ime
Që më ishte dhënë mbi këtë tokë.

Forcat ishin të pakta. Caku
Ishte shumë larg
Ishte qartë i dukshëm, ndonëse për mua
Pothuaj i paarritshëm.
Kështu shkoi koha ime
Që më ishte dhënë mbi këtë tokë.

3
Ju që do të dilni nga vërshimi
Në të cilin ne jemi fundosur
Kujtoni
Kur të flisni mbi dobësitë tona
Dhe kohërat e errëta
Prej të cilave keni shpëtuar.

Po ne, me shpesh se ç'kemi shkuar në shkollë,
Ndërruam vende,
Nëpërmjet të luftërave të klasave, të dëshpëruar
Kur këtu ishte vetëm padrejtësi dhe aspak zemërim.

Ne dimë:
Edhe urrejtja kundër poshtërsisë
Deformon tiparet.
Edhe zemërim kundër padrejtësisë
Të ngjirë zërin. Ah, ne
Që duam të bëjmë gati truallin për përzemërsi
Vetë nuk mund të jemi të përzemërt.

Ju, ndërkaq, kur të vijë koha
Që njeriu për njeriun të jetë ndihmës
Na kujtoni
Me zemërbutës.

Peter ROSEGGER
(Gjermani)

DËSHIRA PËR VITIN E RI

Një grimë më shumë paqe dhe më pak grindje, përsëri.
Një grimë më shumë mirësi dhe më pak xhelozi.
Një grimë më shumë dashuri dhe më pak armiqësi.
Pak më shumë të vërtetë – kjo do të ishte mirë, gjithsesi.

Në vend të gjithë këtij trazimi, një grimë më shumë qetësi.
Në vend që përherë vetëm Unë, një grimë edhe Ti.
Në vend të frikës dhe ngurrimit, një grimë më shumë guxim.

Në dëshpërim dhe errësirë, një grimë më shumë dritë.
Jo afsh me mundim, por pak asketizëm në këtë vit.
Dhe shumë më tepër lule, aq sa mundet, në jetën tonë.
Jo veç në varreza – atje ato lulëzojnë vonë.

Synim të jetë qetësia e zemrës.
Diçka më të mirë nuk di.

Adolf GLASSBRENNER
(Gjermani)

DY DËSHIRA

Ah, dy dëshira i kam pasur përherë
Për fat të keq kurrë s'u bënë e vërtetë
Janë dy dëshira të thella
Më të bukura përjetë!

Që të gjithë, të gjithë njerëzit
Me të njëjtën dashuri t'i përqafoj mbarë
Dhe disa prej tyre
Të nesërmen t'i var në litar.

(*Nga gjermanishtja: Enver ROBELLI*)

Tomas TRANSTROMER
(Suedi)

PËR MIQTË MATANË KUFIRIT

Nuk ju shkrova aq sa duhet. Të gjitha ato që nuk jua thashë
U frynë e u frynë si një balon i vjetrua
E u zhdukën ngadalë larg në qiellin e natës

Kjo letër tani është te censuruesi. Ai ndez llambën e tij.
Nën dritën e saj fjalët e mia hidhen si majmunët në kafaz,
Që tunden e shkunden, ndalen dhe tregojnë dhëmbët.

Lexoni mes rreshtave. Do të takohemi pas dyqind vjetësh,
Kur mikrofonat nëpër muret e hoteleve do t jenë të harruar
E më në fund të fjetur, do të jenë shndërruar në fosile.

**Poet suedez, fitues i çmimit Nobel për letërsi në vitin 2011. Poezinë e mësipërme e shkroi pas një vizite në Ballkan (ish-Jugosllavi) në vitin 1979*.

(Nga anglishtja: Doruntina VINCA)

Juan GELMAN

QETËSI

Kush do ta kishte marrë me mend se pëllumbi do të martohet me skifterin,
Dyshimi me mirësinë, i plaçkituri me plaçkitësin?
Dasma të rrejshme!
Hata të panumërta do të lindin nga këto dasma, grindje dhe pikëllim.

A do të qëndrojnë në këmbë vatra të këtyre dasmave? A do ta dridhë apo shkatërrojë
Era më e lehtë që vjen nga veriu dhe fryn atje? A do të mbarojë si gërmadhë, e shtypur nga qielli?

Ah, vend!
Ah, vendi im! i tërbuar! i pikëlluar! i vrarë! i bukur!
I njollosur me gjak revolucionar!

Papagaj ngjyrëvjollcë rrinë
Duke bërtitur në çdo lis,
Në çdo degë renditur.
Më shumë vetëm? Më pak vetëm? Vetëm? Pse?

Kush do ta kishte marrë me mend se viçi do të martohet me kasapin,
Butësia me kapitalizmin?
Dasma të rrejshme!
Hata të panumërta do të lindin nga këto dasma, grindje dhe pikëllim dhe qartësi
Si dita që po sillet në kupolën e saj të hekurt mbi këto vargje.

(Përktheu: Enver Robelli)

PROZË

Roman

Ndoc NIKAJ

FEJESA N' DJEP A SE ULQINI I MARRUN

(Fragmente)

LUFTA

Shpendi kishte rra n'Shkoder n'uzdajë m' u ndesh n' Bardhen. Ndeja e Bardhes n' shpii t' tii, sa ishte Sokoli i smuet prejë varret, e kishte rritë m' te dashtniin aq saa i dukei se s'mund rrite paë te.

Bardhia ishte puntore e gjallë, e dlirët e e paster aq saa gjithshkahia i ndritte n' shtat t' sajë. Kmishat e rubat, perparcat e xhubleta ndritshin n' t' bardhë t' laame e t' pastra e dukei m' shei për mii gjith shoqe tiera; kuer pat shkue n' Nergovan pat siellë marë shpiin e Shpendit, vue n' t' ndrequn e n' uidii rraqet e çaklat e shpiis e shpija e Shpendit nuk dukei ajo e parshmia. Shpendi kishte ndii nji t'knaqun t' plotë saa ndei Bardhia aty, por kuer ajo kie nisë, shpija kishte marrë nji hije randimit për te; nji dishka t' mangut kishte ndii n' vehte e n' shpii t' vet e tuk i kishin thanë se Bardhia aso vietet do t' bite me dimnue poshtë e dijt kohen qi ishin nisë karvanet kishte marrë me mend se per Zojë t' Shkodres do t' gjindej m' at t' kreme.

Kishte raa n' Dedai, marrë Sokolin e Tringen e me ta u ulë n' Shkoder. Nuk dite a kishte muitë m' u shmangë Bardhia per me hii n' Shkoder m' at ditë. I' a kishin perspietë t' dielen mrama, te e vona, e Sokoli, kishte ngrehë me shkue n' mik m' at natë, paë u shmangë kahë karvanet. Kshtu, naten e Zojës, bashkë me Sokolin e me Tringen t' shoqen e Sokolit kishin fietë n' shpië t' Gjok Iakut e n' e nesre per miesditë n' shpii t' Kol Gjokës per paë muitë m' u ndeshë m' Bardhen.

Shpendi u njit perpietë e pak mrapa raa n' Shtoi t' Ulqinit ku kishte pronet e dimnishtës vet.

Ishte vieta 1878 e Mali i Zii n' llaas t' Rusiis kishte nisë luften me Turkii per me muitë m' u shtrii kahë tokët e Shqypniis. Rusi ishte lshue me terbim t' fortë per me permysë Turkiin e Sllavt gjith marë ishin çue peshë.

Saa Rusija ishte tuej thye ushtriët Turkesha, Mali i Zii kishte msye Shqypniën tuej lshue fuqiën e vet ma s' parit n' Potgoricë ku gjet qindresë t' fortë.

Ushtriët malazeze at herë, tuej majtë gjithnji luften m' at krah, drodhne fuqië t' madhe n' Muriq ndermiet t' Virit e t' Tivarit e aty u ndeshne me ushtrië Shqyptare t' priime prejë Hodo Begut Dervishaj e mas nji lufte t' pergjakshme turri i tyne kie ndalue.

T' msymet e Malazezve n' Potgoricë e n' Muriq nuk ishin kenë veç se nji dredhië per me hutue fuqiët Shqyptare e saa me t' turrrme t' forta mundoheshin me habitë tubat e Shqyptarve m' at krah sollne gjith fuqiën e vet per mii Tivaar.

Kushtrimi mlodh aty Shqyptarët e Shkodranët e Ulqinakët u lshuene me t' madh gairet n' ndimë t' Tivarit.

Hodo Begu la me ushtrië t' Muriqit, n' kamë t' vet, Isuf Agen vetë u kthye n' Anë t' Malit ku pritte fuqii tiera prejë Shkodret e Malcijet per me ndalue guximin e anmiqve, por Malazezt nuk i lane kohë ndimve t' reja me i' a perspietë e me at t' shpeitë Tivari met i rrethuem per anë e Shqyptarët t' ndryem n' kshqel t' lidhun mos m' u dhanë per t' gjallë.

Kryesundimin ushtarak t' Tivarit e kishte Brahim Beg Mirallaji me nja dyqind ushtarë rojtarë kufijesh qi ishin kanë gjetë n' rojë t' kullave, e Shqyptarve i priite Selim Beg Tivari.

Dyqind Ulqinakë ishin ndrye me Shkodranë m' at Kshqel e qindresa ishte e fortë saa do qi rrethimi i kishte gjetë t' paë gatuem at anë e kishte nollë e paë pritun.

Rrethimi i Tivarit ndezi Shkodren n' kushtrim e tubat e Shqyptarve u mlodhne per rreth Hodo Begut per m' u lshue n' ndimë t' ndrymve.

Rrani Malciia, u mlodhne ushtriët qi gjindeshin n' gjytet, u lshuene mas kushtrimit rrethet e Shkodres e krahi i Lezhës e lami ushtarak i Shqyptarve u shumue me ushtarë qi, teper t' nguçem, nuk printe t' mlidhei gjith fuqija e Shkodres mer me raa nji herit e

me çaa Malazezt, por u ndeshne me ta n' Rezigaqe ku u ba nji luftë e mnershme.

Aty pushka i lshoi rend taganit e fyt a fyt u kapne n' dyy palët me huj terbimit. Gjaku shkoj rrkajë, qindresa kie e paë shoqe por shumica e Malazezve e pat fitimin e Malazezt fituesa dogjne Anen e Malit ku u derdh mnerimi.

Malazezt me gjith nduer shterngimesh u munduene me lodhë t' rrethuemt me u dhanë n' dorë por Kshqeli nuk u dha e Malazezt m' at huj dogjne Gjytetin e Pazarin e Tivarit.

Rrihte topi per anë, pushka kriste me ditë e me natë e mas saa javëve t' rrethimit mungesa e shuitës u ndi mrenda kshqelit. Masho Verbica e rrahte n' top kshqelin per me muitë me çilë ledhet e forta e me i baa shteg ushtrirëve m' u shtyy per mrenda, por burrat e gairetshëm s' e merrshin n' dorë e tuej u mshehë nder shpella t' çiluna n' gji t' malit, mrenda kshqelit, herë me buk e herë paa buk, ndreqshin prita t' reja e s' u epshin n' dorë.

N' krah t' Ulqinit, nuk kishte muitë m' at t' shpeitë me çue ndimë t' madhe per me e msye me hov pse s' kishte aq gjind saa me hapë m' kater anët nji herë, per me shtii n' dorë gjithë krahinen por edhe andei pushka ishte ndezzun, kushtrimi i dhanun e t' msyemet e qindresat t' forta.

Ishte gadi nandë javë qi Tivari gjindei i rrethuem e buka ishte n' t' sosun kaq saa t' ndryemve s' i kishte metë tieter veç se kaa nji kupac midhë n' ditë saa me shue unshimin.

Knjazi saa ishte tuej shterngue Tivarin çoi lajmit e vet n' Ulqin me e shtye m' u dhanë per paë u baa dam, por Ulqini i' a kthei me t' gjegjun se lypshin ma parë m' u shkrii se me u shtrue. Masi patne dhanë ket t' gjegjun u mlodhne t' parët e Ulqinit e bane kuvend ndermiet qysh do t' i bahei per qindresë me aq pak ushtarë qi kishin.

Gjindeshin n' Ulqin, gjithseit katerqind ushtarë rreshtak (talimi) Mustafazaa, nja keterqind Labë e s' baheshin per mii treqind vetë Ulqinakë, Shkodranë e Malcorë nder t' cillët gjindei Shpendi.

Ky aso kohet qi kie dhanë kushtrimi per ndimë t' Ulqinit gjindej n' Shtoj e nder ma t' parët ngau m' u gjetë me burra t' qindresës e gjith ku kie ma e madhe nevoja e ma i madh rreziku aty u gjet me t' madhe trimnii.

Kuvendi i Ulqinakve nisi laimit e vet te Knjazi n' Shushan ku ishte lami kryeparë i ushtriëve anmike, me fialë se veç masi t'

merrei Tivari muishin me hie me të nder fialë. Kshtu turri marrë i Malazezve u drodh n' Tivarë ku qindresa e t' ndryemve ishte qindrssë disprimi.

Shka s' muit me ba pushka e topi i Malazezve e bani uja e edia nder t' ndryem. Mas nandë javëve qi ndiati rrethimi, per posë buket qi ishte marue, edhe ama e ujit kie shperthye prejë topave t' anmikut e edia i' u shtue uus, e t' shternguem gjith kahit, t' ndryemt, raane n' godi m' u dhanë n' dorë por me ndeer t' armve, qi me erz i kishin bartë deri m' at kohë, e kshtu Tivari u muer prejë Malazezve!

Mas Tivarit turri i Malit Zii u lshue n' Ulqin ku kie pritë me qindresë t' fuqishme.

Stomijet e qindresës, ledhnajet (istikamet) pritat e sajueme, e bregjet per me ndeshë anmikun ishin kenë rreshtue e vue n' faqe t' Braticës per mii Kishë e Haxhi Mehmeti gjindej kryeparë tuej i dhanë gairet shokve per qindresë. Nji tubë Malsorë Shtojakë e Malabrijas gjindeshin nder ma t' parët e ata ishin qi do t' a ndalshin hovin e parë t' anmiqve. Shpendi ishte kryeparë nder ta e huta e tii flakote per mii gjith tiera. Dy rrypa fyshekës kishte njesh; njenin m' t' hollë e tietrin krah e qafë. Gaitanat e rrgjanët, qi prejë qafet i bishin m' teposhte, mashin livoren e ngriime n' rrgjand,

Mali i Zii kishte vue grykat e topave n' Krythë kundruell Ulqinit e Masho Verbica kryetari i topçive ishte mendimit me e marrë me top e me uu sikur ishte kenë marrë Tivari, por Pop Illija lypte me e marrë me yrysh e dy priisat e ushtrive nuk ishin kerkund nji mendimit.

Pop Illija kishte me vedi dymii e katerqind ushtarë e me ta, per t' zbardhun t' dritës, paë i vue vesh tierve, msyni kahë Bratica.

T' perpiekunit e parë, i rrebtë e i mnershëm, u baa nder ullishta t' Braticës, ku toka gjimoi n' ushtimë t' pushkve t' shuma, malet perkthyene andei e kndei krismen e paë daame e burrat t' vraam e t' varruem u rrxuen per miet tuej lanë rend tierve m' u shtyy aty ku t' parët kishin metë. E mnershme kie lufta m' at t' ndeshun ku njena anë per qindresë t' vendit vet qindronte e tietra n' uzdajë t' fitimit e t' plaçkimit.

Shpendi qi gjindei n' krye t' pritave t' para, n' e diathët, porsi bishë e unshme per gjak, me at tubë t' vogel malcorësh qi kishte me vedi, u baa rrfe e gjallë e tubat e anmiqve qi i kishin raa

m’ at krah i dhetoi n’ e parë e s’ lueti vendit deri saa i pat pergjysue shqimit.

Lufta qi kishte fillue n’ nade ishte tuej ngiatë me turr t’ paë daam e Shqyptarët, saa do ma n’ pakicë, s’ ishin kerkahë tuej lshue. Mas hoveve t’ para i ishin qasë ledhnajeve (istikameve), bregjeve e stomijeve ku qindresa ishte baa e rrebtë. Gjaku shkote tuej u derdhë m’ njenen anë e m’ tietren. Shum ushtarë rreshtakë kishin metë n’ ledhnaje ushtarët e Labriis ishin pergjysue, pesë Ulqinakë kishin metë e shum varrue, Shkodranë e Malcorë ishin dhetue e dita kishte nisë me u kthye, por Shqyptarët s’ kishin mene m’ u kthye.

Njaty m’ nandë e gjysë, masdite, Masho Verbica qi kishte ndejë n’ hutim e squet deri m’ at herë nder maje t’ Krythës, tuej paa se vetem me pushkë s’ muite Pop Illija me i’ a dalë sikur pat kuitue n’ at t’ parë, i vuni topat ledhnajeve e me t’ madhe duhii i rrahi per me muitë me i çilë shteg t’ vetve, tuej qitë zbluet n’ shesh ushtarët Shqyptarë.

Per nji sahat rresht gjimoi topi e pushka nji herit e toka u dridh per anë, por s’ dridhei zemra e luftarve qi vriteshin me i dalë zot dheut vet.

Njaty m’ dhetë e gjysë sahatin bromllet (gjylet) e topave i çilne ledhnajet n’ shumë vende. nji bromlle i raa Shpendit per afer me turr t’ fortë e rrxoi nji krah t’ ledhnajt qi ç’ parandei ishte kenë ligshtue. Nji shkndii bromllet i varroi nji shoq per brii e, per pak, copa ma e madhia e bromlles kie tuej ndeshë m’ te.

- Ndima e Zotit e ora e Shqypniis! – tha Shpendi e u shtrungue n’ hutë n’ Malazez qi kishin nisë m’ u afrue.

Ledhnajet ishin ligshtue e rrxoheshin per gjith anë. Masho Verbica kishte synue hollë e saa bromlle kishte lshue aq shpella kishte baa e ledhnaje rrxue e kshtu m’ dhetë e gjysë sahatin u dha yryshi i mram per t’ marrun t’ Ulqinit

Ushtoi pushka me krizem t’ paë daame; u ndeshne burrat tuej shtye shoqishoinë n’ zierm t’ pushkve e n’ breshnii t’ plumave qi bishin rrethaza e per miet por Shqyptarët, n’ pakicë e t’ zbluem faqe t’ anmikut qi me shumicë i kalote shumë heresh, nisne m’ u mnjenue n’ e parë e mrapa tuej u ligshtue shkuene tuej lshue vendet e veta. Malazezt, qi ishin n’ fitim dhane shkasin e mram e me turr t’ rrebshem i zmrapne m’ disaa ana t’ ledhnajeve.

Nji ledhnaje e vetme kishte metë paë u marrë e ajo ishte e Shpendit qi me shokë t’ vet s’ e lshote as masi e paë se tierat ishin

vue m' t' ikun. Shumica e anmiqve ishte lshue n' at vend e Shpendi e paa rrezikun por s' u topit as faret.

– Heu ndihma e Zotit e ora e Shqypniis! – briti edhe nji herë Shpendi e u shtrengue per m' qindresë t' fundshme.

M' shum ana pushka kishte praa e Malazezt kishin nisë me ndiekë t' ikunit por rreth Shpendit e t' Malcorve vlote ene pushka si n' e parë. Nji tieter pritë nji herit s' ishte dhanë ene e qindrote por tek ma letas se e Shpendit e m' te gjindej Haxhi Mehmeti qi i epte gairet t' vetve per qindresë. Shumica e anmiqve, qi n' e parë, ishte kenë e hapët nder shumë ana, u mlodh aty ku ma fort rrihte pushka e prejë shumicet s' bani ma dobii qindresa e ai grusht trima t' rrethuem gjith kahit, nuk i lshuene pritat deri saa s' meti ma kush me ba qindresë.

Shpendi ç' n' e parë, kishte marue shqimit rrypat e fyshekve e rishtas i kishte mushë me tjerë t' derdhun prejë arkve me grumlla per rreth ledhnajeve per shpeitim t' luftarve e masi i kishte sosë per t' dyten herë, s' i kishte metë ma kohë me shtii fyshekë tierë nder rrypa pse pushka ishte kenë shumue e anmiku afrue n' shei t' pushkës. Masi pat hjellë at herë rrypat m' anet shpeshtoj t' shtimet tuej mledhë me grushta fyshekë. Huta i kishte vue lmashkii barotit e s' i punote ma, por kishte marrë t' nji shoqit qi i kishte metë m' at t' parë e me hutë t' tii ishte tuej baa qindresë.

S' mramit i rrethuem per anë, me atë grusht trima brii vedit nuk u dhan deri saa t' gjith shokët i metne per afer e ai vetë u rrxue i varruem e kshtu met i rrethuem prejë Malazezve qi kahë kishin paa qindresen e madhe t' tinë io veç nuk e çartne por e nderuene porsi kreshnik t' fortë qi ishte.

Ledhnaja e Haxhi Mehmetit kishte raa para se t' rroxei Shpendi e kshtu me Shpendin u muer Ulqini.

Afer njimdhetësh sahatit pushka prani e Malazezt u derdhne ndeper Ulqin.

Shpendi i varuem me dy plume n' shtat, njenin n' koshë e tietrin n' krahnuer, kie çue me u miekue n' smuetore ushtarake e masi, per nji muej, pat miekimet n' Ulqin, kie nisë per Cetinë per miekime ma t' mira.

CETINA

Fryete nji murlaa i ftoftë e i hovshem. Baktiit gjindeshin nder vathnaje t' grashtueme e gjindja e shpiis ishin mledhë rreth tryezave e, tuej ba kryq n' ballë, ishin kah nisshin buken, kuer qetë e vathnaive filluene me lehë me nji t' lehun t' fortë e t' turrshem. Bardhia e tierët u ndreqne n' veshtrim por mas nji çasit qetë shutitne e disaa zagarë dhane nji t' kajun gzimit sikurë m' nji nieri t' njoftun. Dera troklloi e nji zaa burrit thirri me i çilë. Tuk e ndieu at zaa Bardhia flakroi n' lamë e turr' a vrep u lshue me e çilë deren e gzueshem tuej e rrokë permallshem:

- Mirë se erdhe Sokol! – i tha – Qysh, kshtu i paë pritun? Ndoshta s' asht gjaa t' lig?

- S' asht gjaa t' keq Bardhe! – tha Sokoli; - kam ardhë me u paaa e me gjue per pak dit. – E tuej thanë kshtu i lshoi huten motres n' dorë e u afrue nder tierë qi ishin çue t' gjith n' kamë me e pritë. U pershendet me t' gjith e u ul n' tryez me shokë.

Shpendi gjindei n' Cetinë i varruem e Bardhia s' dite tieter veç se ishte baa luftë n' Ulqin e se Ulqini ishte marrun prejë Malazezve. Mnija e sajë ishte e madhe per at rodë anmik t' Shqyptarve e saa do butë ishte zemra e sajë dote me i paa t' hupët! Kishte lee me at mnii n' zemer e me te ishte rritë e kuer pat ndii se ishte kenë marrë Tivaar e Ulqin:

- Heushoo!.. – kishte britë – Mali i Zi me shkelë tokët e Shqyptarve! Kuku per çika t' malciis!.. Se per dielm asht dam me i permendë!..

Por Bardhia s' dite kerkund se ai i vetem qi pershkohei ndeper mende t' sajë, mas nji qindreset kreshnike, i muitun prejë shumicet e me dy plume neper shtat gjindei n' Cetinë per mieksii!

Sokoli e dite se Shpendi kishte ngaa n' kushtrim t' Ulqinit e se ishte gjetë n' at luftë por nuk dite ma pertei, e ne nesret:

- Do t' shkoi m' u piekë n' probotinin – i tha Bardhes, e me hutë n' skiep t' krahit msyni bregun e Pulaive, ku ishin gjithseit trii dugajë tregtijet; hini m' nji lunder t' vogel qi e qiti n' Shenkollë e, tuej kapercye katundin u shtye n' Shtoi t' Ulqinit ku Shpendi kishte pronet e veta.

Aty muer vesht se Shpendi i varruem ishte kenë çue n' Cetinë. Nuk xuni vend aty, por tuk hangri miesditen, u nis per Ulqin e prejë andei n' Tivaar ku fiet nji natë e mrapa kapi Virin e prejë andej ndretë shkoj n' Cetinë m' u paa me probotinin e vet.

Sokoli s' ishte i vaditun me udhtue giatë e s' njifte vende tiera veç se saa merrte per s' giatit ç' n' bieshkë e deri n' Velipojë ku kishte dimnishtat. Ishte kenë n' Grudë, n' Hot e n' Kastrat e n' Rec e Lohe deri n' Riollë e, per pak kohë, kishte shkapercye Shtegun e Dhenve kuer kishte pasë raa n' gjak saa ishte kenë tetmdhetë vieç.

Kuitote se Cetina do t' ishte nji gjytet i madh fort por s' gjet m' te veç se pak shpija t' mdhaa nder t' cillat ishte nji qi e thirrshin Hotel e nji udhë t' vetme t' ndretë e me shpija m' rresht. Pak gjaa lerg Hotelit, para nji fushores, ishte shpija e Knjazit e hapët por e ultë e per ballë sojet ishte monasteri e Kisha Knjazore. Per posë dyy rrugave qi muishin m' u njehë me shpija, ma lerg ishin sikur ksollat e baktive, qi ai kishte n' Dedai e n' Velipojë, t' mlueme me kashtë theknet. Gjith Cetina gjindei m' nji fushore, a se lugajë t' rrethueme me male t' nelta okolle e Sokolit qi ishte i vaditun me paa Shkodren nuk i' u giaa ma e madhe se nji mahallë e Shkodres!

- Heu! kuku! – tha Sokoli n' zemer t' vet – a kio Cetinë n' a kaa marrë Tivaar e Ulqin!

Ulqini ishte marrë n' Kallnuer e Sokoli, n' Fruer, gjindei afer majeve t' Cetinës, ku rrethet e edhe gjytetin i gjet t' mushuna me boor e me akull.

Rrshitshin udhat e gjurmët luheshin vshtirshem; cegmi kishte ngrii heit ndeper ulluqe t' pullazeve aq saaa t' ngriimt e akullsinës tuej kullue rend mbi rend njeni m' tietren, mrrijshin skajet deri m' tokë: sqollet e lmashkuem dukeshin porsi mermere e akullin e trashuem fish m' fish nuk muite gjaa me e derptue; rrallas per udhë shifeshin Malazez t' strukun nder strunga t' leshta e Shkije e Shkina tuej folë n' giuh t' vetë kqyrshin t' seritun malcorin e veshun t' tirqë shajakut, n' opangë t' dredhme, n' xhamadan t' cohët e me gaitana e kuej t' rrgjanët t' lshuem krah e qafë qi mashin vierret livoren e ngriime, me ksulë t' bardhë Shqyptare e me shall qi tuej i rrethue kryet i virei per rreth qafet.

Sokoli per m' u shtye deri atie kishte marrë per shoq nji dashamirë t' venë e me te bashkë kishte hii n' Cetinë.

Shpendi qi gjindei m' t' shndoshun kishte nisë me lueit gjurmë ndeper oborr t' smuetores e tuk paa probatinin u lshue e e perqafoi me shum maall. E pyetuna ma e para e tii kie per Bardhen e mrapa per gjith tierë e kshtu Sokoli ndei per dhetë dit

n’ Cetinë deri saa Shpendi muit me baa rrugë e t’ dy bashkë kthyene n’ Shtoi t’ Ulqinit.

Sokoli s’ i kishte vue vesh kurrnji herë ziermit dashniis qi shkote tuej rritë m’ Shpendin e n’ Bardhen e me at ditë qi u probotinuen e njehte Shpendin si vlla t’ venë e t’ Bardhes, e kshtu tuk mrriine nder shpija t’ Shpendit, nisi nji barije t’ Shpendit, me marrë Bardhen. Shpendit i flakoi zemra n’ gzim: dote Sokolin si vlla e dote motren e probotimit porsi motren e vet, por, saa heresh ndiite emnin e Bardhes nji dishka e kandshme pershkohei n’ zemër t’ tii e saa ma fort parandei i epte t’ merzitun vetmimi aq ma shum t’ gjallët ndiite n’ vedi kuer muite me e pasë per afer. Bardhia tuk muer fialen e Sokolit per me dalë n’ Shtoi s’ eci por fluturoi aq saa baritoria s’ muite me e ndiekë per gjurmë. M’ at mrame, Shpendi i diftoi pershkimet e luftës e t’ marrmen e Ulqinit e Bardhes i shkote e i vite ftyra n’ permallim t’ rasave kalueme, herë i shtohei herë i pakohei t’ rrahunit e zemres sajë e shum heresh britte.

- Heu! kobi i mloftë gjith ç’ asht Malazijas! Heu dami i mloftë çikat e Shqypniis qi s’ lshohen s’ bashku me shqymë rodin e Malazezve!.

PLEQNIMI I BERLINËS

Mali i zii kishte shtii n’ dorë Tivarin e Ulqinin n’ Kallnuer n’ 1878; lufta s’ ishte kenë vetem m’ ket anë me Mal t’ Zii pse Mali i Zii veç n’ llaas t’ Rusiis guxote me ngucë anët t’ona e lufta e madhe e e pergjakshme qi do t’ daate fitimet e t’ dyy palve ishte ndermiet t’ Rusiis e t’ Turkiis, Rusija, fitim mas fitimit, ishte shtye deri n’ Stefanoz e aty i ishte dashtë me ngurrue pse mretnit e mdhaa i kishin dalë per ballë per mos me e lanë me çartë Turkiin.

U mlodh Pleqnimi n’ kryegjytet t’ Alemanjes, n’ Berlin, e aty u shestuene punët ma t’ mrapshtat per tokë t’ Shqypniis!

Austrija qi nuk dote me lanë m’ shtrii Malazezt kah bregu i detit, dha e muer me mretnii tiera deri saa e drodh punen qi me shtye Malin e Zii prej Ulqinit e me i dhanë krah kah Gucija.

Kshtu Mali i Zii duel, per at herë, prejë Ulqinit n’ uzdajë me marrë per vedi krahin e Guciis.

U dha zani ndeeper Shqypnii se Mali i Zii do t' i qasei Guciis, prejë se ashtu e kishte daa Europa e Ali Pasha i Guciis u lidh me besë me krenë t' maleve per me i baa qindresë nji pleqnimit aq t' paë rrugshem, e Shqyptarët u çuene n' kamë edhe nji herë.

Mkamsit e Turkiis t' tutun prejë kercnimeve qi i rrethoshin kishin vue dorë e i ishin kenë shtrue pleqnimit e Turkija me at nenshkrim do t' i' u perkrahte Malit Zii per me marrë vendet e veta!

Ahmet Muhtar Pasha me dhetë toborre kishte mrrijt n' Perzrend i çuem me shterngue Shqyptarët per me i lshue Malit Zii Guciin, e por saa kishte mrrijt aty i kishte dergue fialë Ali Pashës me i' u shtrue Malit t' Zii.

Ali Pasha i kthei t' gjegjun me leter tuej thanë:

- Masi Mreti n' a paska lshue, ju nuk keni ma sundim nder nee as na ndigjesë me juu. Ç' me atë ditë t' ktii laimit, na jena t' Malit Zii e per n' u afrosh ma kndei kena me t' vue pushken. Mali i Zii t' vinë e t' na marrin.

Dihei çiltas se veç dhueni e kishte shterngue Stamollen me lshue at piesë t' Shqypniës! e kshtu Ahmet Pasha e nisi letren per Stamollë: Stamolla Berlinës e Berlina paë marrë n' dorë faret kercenimin e Shqyptarve i dha fialë Malit Zii me shkue n' Gucii, por Ali Pasha por saa kishte dhanë at t' gjegjun kishte qitë kushtrimin ndeper Shqypnii e Gaash e Krasniqe, Nikaj e Mertuer e Shalë e Shosh i kishte gjegjë kushtrimit.

Pop Ilija me gjashtmdhetë tubsii, a se bataliona ushtarë, u nis per Gucii n' uzdajë me e marrë paë pushkë, por, saa ai ishte tuej hii n' Mushiq, afer Gucijet, kushtrimi ishte hapë per anë, e rrani malcija: kshu Pop Ilija, ku mendonte me gjetë vend t' shtruem, ndeshi n' ma t' madhen qindresë. Pushka nisi, n' e parë, per s' largut e toka u lkund, malet gjimuene e gjama shkoi tuej u pershkue shpat n' shpat e grykë m' grykë me t' madh mnerim t' atyne qi, s' lergut, muishin me e veshtrue, por s' ngiati lufta me pushkë pse Shqyptarët e rrebtë, qi luftoshin per qindresë t' vet, nuk ndiene n' hutim me mushë e me shprazë, por me tagana e kurtiela u lshune n' anmik e fytafyt u kapne deri saa e zmrapne, e e shtyene shqimit.

Ishin aso kohet tuej luftue Shqyptarët me at gairet qindreset qi ma vonë i kie njoftë prejë gjeneralave t' Turkiis kuer n' vietë 1911, t' çuem per me shtrue Shqypniin, kiene t'

shternguem me dishmue *ndeper fletore t' Stamollës*, se ishin tuej luftue me nji komë qi nuk lshote shpii, as stom, as shkrep, as guer t' vetem veç se *masi t' jtte vetë*!..

Mali i Zii gjet at qindresë qi s' mendonte e i lodhun e i poshtnuem m' at krah, i' u kiaa Europës!

Shqypnija ishte çue n' kaamë e *Lidhia e Pezrendit* qi kie perbaa n' Priill t' vietit 1880 kishte marrë t' shtriime per gjith anë t' Shqypniis e krenët e t' parët ishin lidhë me besë mos me lshue nji pllamë vend t' venë. E lidhmia n' e pafrë kishte pasë t' shtyemen prejë Stamollet qi mrapa tuej paa rrezikun ishte kenë mundue me gjith fuqië t' vet me e ndalue ziermin qi kishte marrë t' hapët por teper ishte ndezë zemrimi e Shqyptarët s' gjegjeshin ma m' u ndalë as s' doshin me lshue kurrfarë rrypinet, saa do t' vogel, anmikut t' komit vet.

Tuzi u ba qandra e qindresës e aty u mlodh Shkoder e Malcii t' lidhun t' gjith m' nji besë me dekë për vend t' vet. Mali i Zii s' i' a shifte fuqin vedit me u shtye ma ndei e m' nji luftë t' shtrueme ishte n' rrezik me bierrë edhe shka kishte pasë parandei.

Nuk u lshue nder armë, por nder tela e nder letra e me mkamës t' Europës u kap tuej britë se kishte metë i rrethuem. Rusi qi kishte pshtetë mii vedi roisiin e Malit Zii lypi t' maitunt e pleqniis e Mretniit tuej paa teper t' madhe qindresen n' Gucii, e zemrimin e madh t' Shqyptarve m' at anë, shestuene me e ndrue Guciin me Ulqinin e shternguene Turkiin me e lshue Malit Zii Ulqinin!

Kshtu per t' dyten herë Mali Zii do t' msyente Ulqinin; por kso heret s' desht me e marrë me gjak t' vet: lypte qi t' i lshohei prejë Turkijet mas t' lidhmeve t' baame!

Per me shterngue Turkiin e me tremë nji grusht Shqyptarë, Mretniët Europiane mrriine me dergue n' limaa t' Ulqinit danamet e veta!.. Kobë per Europë marë me çue gjith at daname per nji t' lshueme t' Ulqinit!!..

Nji herit me daname t' mretnive qi u çfaqne n' breg t' detit, edhe Dervish Pasha, prej Shkodret, u nis me tetë toborre per me rudhë hovin e Shqyptarve qi doshin me baa qindresë.

Dervish Pasha duel n' Zogai t' Ulqinit e aty ndeshi nder prita t' Shqyptarve qi i kishin dalë para me e ndalue.

Mas kushtrimit, Shqyptarët ishin mledhë e Ulqinakë e Malcorë e Shkodranë gjindeshin tubë per qindresë t' vendit vet, por kishin metë t' hutuem e t' habitun me tre anmiq per rreth.

Kishin m' njenen anë Malin e Zii qi porsi bishë e unshme rrite n' gatim me kaperthye me kthetra t' rrmyeshme ai vend masi t' a gjeete t' paë qindresë. Danamet e Mretniëve rrishin n' kercnim tuej siellë grykat e topave faqe gjytetit per me shterngue m' u dhanë e m' tietren anë toborret e turkiis, me Dervish Pashen per krye, afroheshin m' ta per me i baa me i' u shtrue anmiqve! Orë e ligë e e zezë per Shqyptarë e Mretnië! Pushka e Mretit vet e e vllazenve ishte dreedhë me shterngue vllaznit per me i' u shtrue anmiqve! E gjith Mretniët e Europës kishin çfaqë kaa nji danamë per shoq per mii nji grusht gjind qi doshin me qindrue per vend t' vet!...

Katerqind vetë gjindeshin t' mledhun bashkë per qindresë t' Ulqinit e kta katerqind i dolne per ballë tetë toborreve t' Dervish Pashës qi, t' çuem prejë Stamollet, per Malazez luftoshin!...

E Malazezt me nji gaz shpotimit vroshin per s' lergut luften e Turkoshakve me Shqyptarë qi t' parët, paë farë dhimet n' vedi doshin me e lshue vendin, e tierët me zemër t' pergjakun mundoheshin me e pshtue prejë thoive t' anmikut.

Tubat e ushtriëve t' Dervishit u ndeshne nder ma t' parat prita e pushka ushtoi per anë; qindresa kie e fortë e kreshnike por teper shumicë e madhe njena anë e tietra pakicë s' kishte giasë luftet por t' nji anmikut qi ndiek ke mundet me shtrue nen vedi.

N' prita ma t' fortat gjindei nji tubë malcorë e per krye t' tyne Sokoli e Shpendi t' cillët sikur bie n' tufë t' berreve bisha e malit ashtu kta raane permiet t' ushtarve rreshtakë t' Dervishit tuej permysë e tuej rrxue kaa dy tre nji herit.

Nuk bumullon rrfeja, kuer me krizem t' paë daame shkon tuej ndrrue krizmen herë n' ushtimë t' kadalshme herë me shkase t' turrshme, aq saa hutat e dy probotinave qi njena mas tietret epshin ushtimë gjamtore tuej qitë per grykash flakë e dehë nji herit.

Lufta ngiati dy sahat e paë daame por shumica e ushtriëve mretnore s' e la me xanë vend at pakicë ushtarësh qi me disprim t' mram qindroshin e Shkoder e Ulqin nisne m' u mnjenue.

Qindresa u baa e leet, pushka pakoi m' ket anë e nder ma t' mramt filloi me u dhanë ika.

Sokoli me Shpendin e me Malcorë tierë ishte tuej qindrue e tym e flakë delte prejë ledhnajeve tyne edhe masi u dha ika nder prejë, deri saa t' metun vetem shqimi e paane kote qindresen, e

gjith nji tuej luftue lshuene pritat e u zmrapne. Kshtu ika u dha per anë, pushka prani e veç hera herë, ku ndeshej ndonji qindresë e leet pertriheshin disaa pushkë qi leshin mrapa nji shutii t' giatë e ndermiet t' pushkve e t' shutiis ndiheshin brimë t' ndeshunash t' gjindve tuej ikë, zaa graash t' mnerueme, vaai fmiish t' tremun e ankimet e t' gjithve qi – Ah! medet!, britshin, - Ushtriët mretnore me luftue me nee per me n' a dhanë n' dorë t' Shkieeve!...

Sokoli e Shpendi nuk morne udhen me kthye kahë gjyteti sikurë gjith tierët por kapne rrugen qi shtyhei kah Shtoji. Kaluene ndeper ullishta, ti' u njitne nji kodres t' germuet me landë lisit t' shpeshta e zdrypne m' anë tieter, e andei kaluene n' udhë t' ndretë qi tuej raa ndeper nji qafë t' dy kodrinave shkote tuej u ulë m' teposhte. Gjith seit kishin metë dhetë vetë qi dredheshin kah shpijat.

Nata kishte nisë me raa e hana ene s' e kishte mlue faqen e vet per me lshue rend diellit me ndritë ndeper dhee e burrat Shqyptarë qi e dishin fort mirë se nuk kishin shkapercye shqimit frigen, e pritave t' ushtriëve ecshin dy kaa dy, tuej veshtrue per anë. Ishin gadi tuej kapërcye at qafë kuer nji batare pushkë u ndesh m' ta. T' ishin kenë ma t' paë vaditun nder armë, jo nji i vetem se mund pshtote m' at shteg, por t' shpeitë si vetima qi lshon prejë qillit, martinat e burrave i gjegjne batares gadi flakë per flakë. Dy ma t' parët n' pushkë por n' t' dytat, gjama e shum t' varruemve nuk vanoi m' u ndii m' anë tieter, edhe t' dekun per dhee ma t' idhtit lmuç kishin raaa.

Per nafakë t' Shqyptarve nji stom i neltë kishte nollë para tyne si t' ishte kenë i ndrequn per ta e m' at pritë qi ishte, m' at ças, ma e fortë se nji ledhnaje e ngrehun, pushka u perzii me nji gjamë qi dukei luftë e ndezun ndermiet t' saa toborreve e io ndermiet t' dhetë vetve t' ndalun per udhë prejë njiqind e pesdhetë vetve ushtarë.

Gryka e t' ndeshunit ishte shtegu per kahë Dervish Pasha kishte drashtë se i vien ndimë Ulqinit, mas kushtrimeve t' dhanuna e grykat e kodrinat ndeper at rreth i kishte mushë me ushtarë t' vuem nder prita.

T' ndeshunit kie i fortë. Ushtima e pushkve pershkohei koder m' koder e grykë m' grykë kalote: rrypat e fyshekve t' Shqyptarve ishin kahë veshin n' t' sosun, shum t' dekun kishin metë nder ushtarë rreshtakë mretnorë, e ene s' dihei fundi i maresës. Burija e ushtarve bite paë pushim tuej lypë ndimë prejë

pritave tiera e Shqyptarët e rrebtë ishin kahë jetshin t' rrethuem, por Sokoli e Shpendi t' merzitun:

- M' tani! dielm! – britne, t' dy nji herit e tuej dalë prej stomit, tetë martina morne zierm per nji herë, e batare krisne livoret n' dorë t' tyne.

Sikur nji duhii shtergatet reshë breshen me turr e gjaja e gjallë rrudhet e struket m' vedi friget, ashtu u rrudhne ushtarët nder prita t' hutuem e t' marrun meç prejë aso duhijet t' rrmyeshme. Pak kush nder ta mujt me qitë ma pushkë e ndonji rrallas qi u shpraz kerkund s' kishte t' perpiekun m' syy e n' ndreitim por kush me grykë per dhee kush njiqind pash ma n' perpietë e shprazi pushken.

Malcorët raane per miet t' tyne e kaluene e paë u kuitue ene ushtarët, pushka i krisi mas shpinet. I muer nji frigë e mnershme; u kuituene t' rrethuem m' dyy anët e i' u dha ika paë veshtrue ma burii as t' thirrun t' parësh. Luftarët e rrebtë, masi i vuene m' t' ikun, mlodhne disaa martina t' raame preië duerve t' dekunve e, para se t' i' a mrrite ndima anmiqve, u larguene andej tuej lanë vendin e shtruem me anmiq t' dekun e t' laam me gjak t' tyne.

Shpendi vetë i katerti muer udhen e Shtojit e kater tierët krahin e Malit Briis ku kishin ndejen e vet. Per t' varruemin qi kishte metë n' vend nuk muite me diit a kishte muitë me pshtue, a kishte marue jeten.

* Burimi: *Fejesa n' djep a se Ulqini i marrun*, (botimi i dytë), Shtypshkronja "*Nikaj*", Shkodër, 1918.

Roman

Mirsada BIBIQ – SHABOVIQ

NËNË, PSE?

- Ku e keni nënën dhe babanë ? – i pyeti Fahria.

Atëherë plaka ngriti kokën dhe me buzë që dridheshin nga dhimbja e brendshme shpjegoi se tërë natën kanë ecur në këmbë nga Radavci deri në Rozhajë përmes Kullës dhe se dikush kishte qëlluar mbi ta. Me atë rast iu vranë djali dhe e reja. Kufomat e tyre mbeten në Kullë, kurse, ajo me katër nipërit e saj arriti të ikte. Kulla ishte bërë varrezë e të pafajshmëve.

- Kanë shtënë tërë natën, kurse nuk kemi ditur nga po qëllonin – ka vazhduar rrëfimin plaka. – Ja, të gjitha i kishim këmbët e lagura, por, kuku për mua, kah, kund do të shkoja me fëmijët. E mjera unë, si më ndodhi kjo në këto vite! Të vdekurit më mbeten në bjeshkë. Zot i bekuar, çfarë më gjeti mua! – më zhgënjim bërtiti plaka duke i fshirë lotët me shaminë e zhubravitur dhe të zverdhur.

Në një moment me dorë godet betonin. Nipërit i rrinin shtrirë në kraharor dhe fillonin ta thirrnin nënën, kurse nipja më e vjetër, dikund 12-vjeçare, filloi t'ia ledhatojë fytyrën dhe duke klithur i flet:

- Mos gjyshe, mos gjyshe, edhe ti nëse do të na vdesësh, ku do të shkojmë ne?!

Pikërisht në atë çast u afruan dy njerëz. Pyeten se të kujt janë fëmijët. Derisa plaka edhe më tej ka klithur dhe me thonj gërrithte dheun e kapluar nga dhembja dhe vuajtja, Fahria shpjegoi atë që e dëgjoi. Njëra nga ato thotë se ata të Kryqit të Kuq të Rozhajës dhe se do t'i vendos në xhami pasi që vetëm atje kishte vend, meqë në shtëpitë e shumë familjeve ishin vendosur një numër i madh i të dëbuarve të pafat. Fahria priti derisa i larguan. Plaken mezi që e vendosen në automobil. Kurrë më nuk i pa as nuk u mor vesh çfarë ka ndodhë me te. Me hapa të rënduar u nis drejt qytetit. U kthye edhe një herë. E shikoi atë gruan flokëbardhë se si ishte përulur pranë një fëmije, që e kishte ngritur dhe përqafuar. Zemra filloi t'i rrihte më fortë. Një frikë e fishkur m'u kishte future në të gjitha poret e trupit. Kuptova se kishte

ardhur koha të iknim nga Bukeli dhe t'i boshatisnim shtëpitë tona. Atëbotë Bukeli ishte përplot të dëbuar nga Kosova, prandaj gjendja paraqitej edhe më e vështirë. Duhej njoftuar këta hallexhinj e fatkëqij se as të ne, në komunën e Rozhajës nuk mund të gjenin sigurinë. Pas gjysmë ore, kolona e automjeteve, e traktorëve, e kuajve të ngarkuara me të sëmurë e njerëz të rraskapitur, si dhe ata që ecnin këmbë ishte nisur drejt Rozhajës. Në një çast Sokoli sikur heshti. Sytë iu mbushen me lot, që shpejt i rrodhën nëpër faqe, para se me ofshamë të përshpëriste:

- Nuk kam ditur sesi nënën ta zbrisja deri në rrugë dhe t'i bashkëngjitesha kolonës. E mora karrocën me të cilën bartja drutë dhe aty disi e vendosa nënën. Kur isha pranë rrugës, me ndihmuan ashtu që edhe nëna ime se shpejti u vendos në traktor. Kolona ishte e gjatë me kujtonte kolonën e njëjtë të para dy muajve, kur njerëzit e njëjtë iknin nga Kosova, duke kërkuar shpëtim në Malin e Zi të lirë. Menjëherë u paraqit nga largësia kolona e ushtrisë. Një si përzierje e turpit dhe frikës sikur i mbushi të çarat në zemrën time. Shurdhër e shikoja dheun, tokën para vetes, duke e lutur Zotin që të mbërrinim të gjallë në qytet. Duke mediturar kështu, me përfshiu klithma dhe vaji i grave dhe i fëmijëve. Nga kolona i kishin ndarë dy djem të rinj, të cilët kriminelët filluan t'i rrihnin. Fatzinjtë bërtisnin nga dhimbja dhe frika. Kukama e tyre shpërndahej nëpër malet e Bukelit, me shpresë se dikush do t'i ndiej e do t'u ndihmonte. Dy djemtë fatzinj, duke u ngritur me vështirësi, së shpejti iu bashkëngjiten kolonës. Për një çast mora frymë pak më lirshëm se bëhej fjalë për një teke jonjerëzore të çastit dhe një çmenduri të çastit dhe se mundimeve tona do t'u vinte fundi. Mirëpo, hetova se drejt meje vinin dy ushtarë. Mendova se do të më maltretonin edhe mua. U frikësova dhe u bëra e shurdhër. Mirëpo, ata iu afruan Selim Kelmendit, një të riu, të bukur, të zhvilluar, që kishte flokë të dendura të zeza dhe me vetulla të bukura, i cili së bashku me Hajrien, bukuroshen tonë dhe me dy fëmijë, kishte kërkuar shpëtim duke ikur nga lufta, e i cili kishte kapluar Kosovën. E ndanë Selimin, duke e goditur me kondakun e pushkës në kokë. U rrëzua dhe gjaku që i dilte nga goja i derdhej nëpër fytyrë. Njëri nga ta, me sytë plot urrejtje, e shikoi ashpër Hajrien, iu afrua dhe e goditi në qafë. U rrëzua, kurse rreth saj qanin dy fëmijët e saj. Britma dhe kukama edhe më e madhe u bë në tërë kolonën. Selimi tashme i pafuqi dhe pavetëdije shikonte i shtangur nga dhimbja. Vajza e tij më e

madhe, duke mos e kuptuar seriozitetin e gjendjes, iu afrua dhe me duar ia shtriu këmbët. Krimineli i njëjtë, i cili e goditi Hajrien, e kapi vajzën për krahu dhe ashpër e shtyri anash. Më plot urrejtje në sy Selimi atëherë u tha:

- Më vrisni, unë drejt Rugovën nuk dua të shkoj, t'u shpie atje!

E dinte Selimi se çfarë kërkonin prej tij. Ata donin prapë gjakderdhje, vrasje. Rugova ishte përplot njerëz që ishin shmangur, fshehur duke shpresuar se ajo bjeshkë do t'i shpëtonte nga kriminelët, të cilët nuk heqin dorë që t'i ushqejnë mendjet e tyre kriminale me shpirtra të vdekur.

Dhe derisa i përballonte goditjet në kokë, Selimi arriti që bashkëshortes së tij t'ia thotë fjalët të cilat u mbuluan nga gjaku:

- Shko rrugës sate, ki kujdes për fëmijët, e unë shkoj rrugës sime.

- Derisa kolona u shkri në vaj, kukama, dhimbja e vuajtja - fliste Sokoli - Selimi me hapa të ngadalshëm shkonte në takim me vdekjen, kurse bashkëshortja dhe fëmijët e tij klithnin, duke shikuar për herë të fundit bashkëshortin dhe babain e tyre. Pas tri ditësh - vazhdoi Sokoli - Selimin e kam gjetur të vrarë tri metra nën rrugë. Ishte i shtrirë i vdekur në barin e gjelbër të sapodalë, por gjithnjë i bukur dhe djaloshar. E shikoja trupin e tij të vdekur. Një erë e lehtë pranverore ia krihte flokët e dendura, të përziera. Në anën e majtë të kraharorit të tij shiheshin katër plagë nga plumbat. Pastaj, në xhepin e tij u gjeten edhe të holla. E kuptova se jeta e tij atë ditë kobi ishte në duart e atyre të cilët ishin të gatshëm që t'i përmbushnin epshet e tyre kriminale, që të vrisnin duke harruar edhe Zotin edhe gjithë atë që është njerëzore, që ai na e ka dhuruar. Kam pyetur, duke e shikuar trupin e Selimit fatkeq, deri kur do të pësojnë njerëzit e pafajshëm, për shkak të instikteve nacionaliste dhe jonjerëzore të dikujt. Selimi kishte ikur nga lufta, kishte ikur nga urrejtja, duke u përpjekur të gjente shpëtim te miku i tij Qazim Daci, në fshatin Bukel të Rozhajës, në Malin e Zi të lirë, por fati i keq që sundonte mbi njeriun fatzi e gëlltiti, por edhe e mbillte frikën, urrejtjen dhe vdekjen – duke bërë me kokë sikur e përfundoi rrëfimin Sokoli.

- E kam humbur gishtin e vogël, disa persona të maskuar derisa shkonim në Jeleç, shtinë kundër nesh. Ecnim në kolonë. Ishim rreth 400, meshkuj të moshës së mesme, disa të vjetër dhe të rraskapitur, vajza të reja dhe djem, por më se shumti fëmijë.

Tmerr ishte, miku im, Kemo! Luanin me jetët tona. U shërbenim si lodra. Shkoja ngadalë shkaku i prindërve. Nënës sime i dhembnin këmbët. Në fakt, e gjithë kolona ecte ngadalë. Disa ndaleshin rrugës, të paaftë të shkonin më tutje. Kurrë nuk do ta harroj atë ditë. Para meje shkonte familja Prelvukaj nga Vitomirica. Ishin strehuar në Katund të Ri, duke shpresuar se do të shpëtonin. Dikund në vet lakoren e Jeleçit, nga mali doli një grup i armatosur. Ishin të tmerrshëm. Së pari zbrazen armët në ajër. U dëgjuan klithma dhe të gjithë u shtrimë në rrugë. Nuk na lejonin të vazhdojmë më tutje. Njeri nga ta i afrohet familjes Prelvukaj dhe me forcë e tërhoq vajzën 20-vjeçare për krahu.

- O Kema im, sa ishte e bukur ajo vajzë! - tha duke rrotulluar kokën Jakupi.

Nëna e saj Nuria, filloi të bërtasë, të klithë, kurse babai i saj Deliu dhe axhallarët Ganiu dhe Beqiri, duke mos kuptuar se çfarë po ndodhte, shikonin të hutuar herë ata, herë duke shikuar vajzën e frikësuare cila me tërë zërin bërtiste:

- Mos me lëshoni, mos më lëshoni! - duke kërkuar ndihmë nga familjarët, të afërmit e saj.

Rezistoi, kundërshtoi sa pati fuqi, luste dhe lutej që ta lironin, duke thënë se ajo askujt nuk i ka bërë keq dhe nëse kanë sadopak ndjenja njerëzore, ta lironin menjëherë. Një qeshje arrogante e kriminelëve sikur jehoi nëpër Jeleç. Në një çast axhallarët e saj, Beqiri dhe Ganiu kundërshtuan, duke kërkuar ta lironin vajzën, duke thënë se ajo askujt nuk i ka bërë të keqe dhe se duhet ta lironin. Qëndrimi i tyre i guximshëm në fillim sikur i befasoi ata, por edhe ndezi shpejt ndjenjën e tyre shtazarake dhe i bëri edhe më të vendosur në atë qëllimin e tyre të ferrit që ta rrëmbenin vajzën shumë të bukur. Duke kuptuar se fjalët njerëzore nuk ndihmojnë dhe se vajza nuk kishte të shpëtuat,Ganiu i vendosur plotësisht të luftonte për te, për dinjitetin e saj dhe ardhmërinë e saj, por u qëlluan nga rafali i një krimineli, pas hapit të tretë apo të katërt. Klithma e dhimbshme iu shkëput Beqirit nga kraharori dhe, i pushtuar nga shtangimi që ia paralizoi trupin, u nis drejt vëllait të vrarë, por nuk arriti larg - e qëlluan edhe atë ata luftëtarët “trima”, të mbledhur kush e di nga dhe të bërë bashkë në një turmë të kriminelëve të pacipë dhe vrasës. Të tërbuar, të prirur për vrasje, vazhduan me të shtëna, ashtu që gjithçka rreth vetes të shihnin viktima të cilat duhet vrarë dhe për çka nuk ka pse të ketë ndonjë arsye e as ndonjë rrezik për

ta dhe për jetët e tyre. Ato ditë u mor vesh edhe për vrasjen e Dafinës nëntëvjeçare. Vajza fatkeqe kishte pësuar nga ndonjë plumb të shkrepur nga ndonjë grup i tërbuar.

- E, si po e sheh, kam pësuar edhe unë. Por kjo që mua më ka ndodhur nuk është asgjë krahasuar me këtë që të dëftova. Nuk e di as vet se si plumbi kishte arritur deri te gishti im, të cilin në spitalin e Beranes ma hoqën, që për pak që të kishte marrë, sepse, sikur të kishte dashur Zoti, që atë ditë edhe unë të isha vrarë, Kema im. Kurrë nuk do ta harrojë kukamën e asaj vajze, të pafuqi dhe me fytyrën e frikësuar derisa e shpinin në pyll, kurrë! Një Zot e di se çka kishte ndodhë me Lenditën, ashtu quhej, dhe se a do të gjendej trupi i saj. Zoti, i vetmi e di! - e mbylli rrëfimin Jakupi.

* Fragment nga romani homonim. Nga gjuha malazeze e përktheu: *Smajl Smaka.*

Novelë e shkurtër

Adil OLLURI

KTHIMI I BABAIT

Sa i papeshë qenke bërë, baba! Asnjëherë nuk më ka vajtur mendja se do të mund të të bartja vetëm në njërin krah e vetëm me njërën dorë. Mbi këtë qese ngjyrë korbi qenka e varur një letër e bardhë, në të cilën i paskan shënuar disa numra që të takonin ty, të vetmet gjëra që tashmë të dallojnë nga të tjerët, që patën fatin tënd të ktheheshin kaq të lehtë në atdheun, që tashmë nuk u duhet gjë.

Fol, baba, fol! Ma thuaj të paktën një fjalë! Nxirre një zë dhe më trego ç't'u desh atdheu, për të cilin u bëre kaq i lehtë e i pamish?! Nuk të mjaftuam ne?! Nuk të mjaftoi nëna, që u përkujdes për ty, siç i rri gati murgesha një tempulli të shenjtë, që t'u bind sikurse më e devotshmja besimtare një profeti dhe t'u përul, sikurse më kokulura robëreshë një prijësi shpirtëror?! Nuk të mjaftova unë, që të kisha yrnek në çdo gjë që bëja, në çdo fjalë që flisja?! Nuk të mjaftoi qyteti që i hapi dyert për ty, rrugët e të cilit t'i puthnin hapat në çdo të lumin mëngjes e në çdo muzg vetullngrysur të mbrëmjeve?! A nuk ishim ne për ty atdheu apo ai gjendej diku në katet e epërme dhe të padukshme të qiellit, të cilat unë nuk mund t'i shihja dhe nuk mund t'i shoh dot?!

Gjersa të bart mbi supe, më vinë ndërmend kohët kur unë isha jo më shumë se dy vjeç dhe ti më mbaje në krah e më shëtisje rrugëve e parqeve të qytetit apo edhe fushave të blerta të fshatit tënd të lindjes apo rreth e rreth oborrit të shtëpisë së gjyshit. M'i fshije buzët dhe faqet sa herë që zhytesha nga ëmbëlsirat që m'i blije vazhdimisht, edhe atëherë kur unë nuk doja. Më ndiqje sa herë që unë arrija të të ikja nga dora. Ah, sa më pëlqente kur të shihja duke vrapuar pas meje. Ngazëllehesha, shkrihesha në gaz, kur nuk arrije të më zije, edhe pse më afrohesha aq afër sa me një zgjatje dore mund të më kapje. Unë hareshëm u gëzohesha fitoreve të mia, që krenarisht ia kumtoja nënës dhe gjyshit, që më donin po aq sa ti. E mbaj mend që, fill pas një viti, nuk më pëlqenin më ato ndjekje, meqë nisa të ndiej se ti mund të më zije

sa hap e mbyll sytë, por me kast bëje kinse nuk më arrije, vetëm e vetëm që ta nxirrje të qeshurën time. Më pëlqente të më mbaje në krah çdo kund që shkonim, pos në rrugën që dërgonte te mjeku, veçmas te ai syzemadhi, pamja e të cilit më ishte bërë si gogol nate. E urreja jo vetëm atë, por secilin mjek. Nuk mund ta duroja atë aromë ilaçesh që kishin ato vende. Nuk mund t'i duroja ato gjilpëra të pashpirta, që aq me gjakftohtësi ma shponin trupin. Më ishin bërë ëndërr tmerri ato shiringa dreqi, që më thernin thuajse për çdo ditë. Nëna më ka treguar se dy herë më kishe menduar për të vdekur në atë kthinë të ngushtë ambulante, që për mua ishte shndërruar në një kënd truptherës, që nuk doja ta shihja me sy, por ti vazhdimisht më dërgoje aty, sepse urreje të më kapte edhe më e vogla grimcë e ndonjë sëmundjeje.

Më pëlqenin ato çaste, kur unë i mbusha katër vjet dhe ti më merrje në kafene me miqtë e tu. Më nxisje t'ua tregoj emrin e ata më pyesnin se i kujt jam, e unë me mburrje ua thosha tëndin emër. Ua ktheja fjalët dhëmb për dhëmb kur ata thoshin se ti nuk ishe ashtu siç mendoja unë. Sa shumë qeshnin kur u thosha se të tillë ishin vetë, se e kishin hundën e shtrembër, se e kishin barkun e madh sa koshi i gjyshit në fshat, se djemtë e tyre ende shurronin në shtrat, ndërsa unë dilja vetë në tualet. Sa bukuri kishin e sa lumturi ngjallnin ato ditë me ty, që nuk mund të harrohen lehtë.

Çdo gjë u prish në një ditë kur ti u ktheve më herët se zakonisht në shtëpi dhe i the nënës se më nuk do të shkoje në punë, jo që më nuk doje, por nuk të linin më aty. I the që do të niseshe qysh në javën e ardhshme në një vend të largët, në të cilin askush nuk do të thoshte që të mos punoje. Unë nuk të pashë duke u nisur, sepse ti kishe marrë udhë në orët e vona të natës dhe nuk doje të ma prishje gjumin. Nëna nuk e mbante në mend në më kishe puthur në ballë, sepse miku yt me veturë nuk guxonte të priste gjatë, por i kujtohej se kishe hyrë në dhomë dhe më kishe mbuluar me të portokalltën e të trashen batanije mua, shpinëzbuluarin, dhe i ishe lutur asaj, edhe pse ishte natë fillimshtatori, të më ruante nga të ftohtit e mbrëmjes.

Na vinin shpeshherë letrat e tua me bukurshkrimin tënd, të cilin përpiqesha ta kopjoja me javë të tëra. Isha i fiksuar ta shkruaja secilën germë si ti. Na vinin kartolinat e zbukuruara, ngjyrëndezta, të cilat i ruaja pranë fletoreve kopertinëtrasha që m'i kishe dërguar, e që dallonin nga ato që bliheshin në qytetit tonë. Krekosesha me to para shokëve të mi të klasës së dytë. Na

vinte edhe zëri yt nga telefoni i bardhë i xhaxhait, me numra të gjysmëfshirë, që e mbante ngjitur në murin e korridorit të banesës së tij, që ishte dy herë më e madhe se e jona. Na vinte çdo gjë nga ti, por vetë nuk na erdhe asnjëherë, baba.

U bënë tetë vjet pa trokitur në derën e banesës tonë. Unë isha bërë katërmbëdhjetëvjeçar, pa më parë për asnjë çast duke u rritur. Na thanë se ishe kthyer në vendin tonë dhe rrije në një fshat të thellë malor, sepse nuk guxoje të vije në qytet. Na thanë se kishe vendosur të na sillje lirinë dhe të na hiqje frikën nga të uniformuarit që nuk flisnin si ne. Doje t'u hakmerreshe atyre që nuk të lanë të punoje, që të ndoqën e të larguan nga ne. Nëna nuk mund të besonte se ti, aq i qetë e zemërbutë, mund të kapje armë dhe t'ia drejtoje atë dikujt, ndërsa unë për çdo ditë e torturoja veten, duke thurur plane në mendjen time se si të vija në atë fshat e të të shihja ty tok me të gjithë lirisjellësit.

Lufta mbaroi. Unë dhe nëna kishim marrë rrugën e ikjes, që sillte më kollajshëm shpëtimin. Liria erdhi, por ti nuk u duke gjëkundi. Të pritëm rreth dy muaj pas lufte që të shfaqeshe në banesën tonë dhe të gëzoheshim për këto ditë ngadhënjimi, por ti nuk u bëre i gjallë, nuk na dhe asnjë shenjë, derisa e morëm vesh që ti ishe zënë rob dhe nuk dihej se në ç'burg ishe a se në ç'vend të kishin degdisur.

Për çdo natë të shihja në ëndërr të varur kokëposhtë në tavanin e një dhome të errtë, këmbë e duar lidhur me një litar të pazgjidhshëm, që e mbante një tra i vjetër, si dhe tre policë shëmtakë, surrategër, që të godisnin pamëshirë. Sa herë që t'i ofshaje dhimbshëm nga goditjet e tyre të fuqishme, ata binin në një ekstazë kënaqësie, duke qeshur me zë deri në kupë të qiellit. I gëzoheshin triumfit, meqenëse kishin robëruar dikë që kishte guxuar t'ua kthente plumbin. Ata për të bërë edhe më të kënaqshëm argëtimin e tyre, të zhvishnin të tërin dhe të godisnin edhe më vrazhdë, me tërë fuqinë që e kishin. Të ishte gjakosur tërë trupi dhe buzët e tua nuk kërkonin gjë tjetër pos ujit, por të pamëshirshmit as që donin të dëgjonin dhe etjen mund ta shuaje vetëm me pikat e gjakut tënd nga balli dhe vetullat e shqyera. Pikonte trupi yt në atë dhomë të errët, duke e mbuluar ngjyrën e saj të zezë me njolla të së kuqes. Ato net ishin të mbushura me përplot ëndrra makthi, që po të mos ishte nëna afër, do ta merrja malin.

Unë dhe nëna të kërkuam me vite. Nuk lamë njeri pa pyetur, nuk lamë gjurmë pa ndjekur. Donim ta dinim se në ç'vend të kishin zhdukur. Edhe pse kaluam një dhjetëvjeçar lirie, së cilës ti iu bëre fli, ne ende kishim shpresë se një ditë do të kthehesh i gjallë, se një ditë krejt papritmas do t'i bije ziles së banesës, ose pa bërë zhurmë do të hyje brenda në orët e vona, mu ashtu siç kishe dalë nga ajo, për të mos u kthyer më kurrë. Shpresonim dhe vetëm shpresonim, derisa një ditë morëm një lajm se e kishin gjetur trupin tënd, eshtrat e të cilit sot po i bart në shpinë, të mbledhura në këtë qese të zezë.

Asllan BISHA

KALI

Dielli i mëngjesit përskuqi pirgjet thikë të Mozhurit. Bashkat e mjegullës filluan të shpërndahen ngadalë, lëviznin kah pellgu i Barbanës, në drejtim të Gjeranave. Në det mjegulla bëhej edhe më e dendur. Në fushën e Zogajve, pllajave të ulëta, ajo ishte qepur dhe nuk lëvizte aspak.

Rrugës përdredhake të fshatit, ngarkuar me hejbe, nxitonte Rizai i Lisenës. Ai ngarendte, shkelte barin e njomë dhe vesa i shtrydhej nën këmbë. Ecte me hapa të shpejtë, për të mbërritur sa më parë në tregun e Ulqinit. Kur arriti në Dushkakuq, pa se dielli ishte ngritur një pash në qiell, prandaj murmuriti me vete: "U vonova! S'ishte dashur të prisja hënën, ajo të gënjen në pranverë, sepse mjegulla mbyt luginën. Peshku shitet në mëngjes, para piskut të vapës. Eh, pa kalë ec e mos u vono! Edhe pa kalë duhet të mbërrij" - i jepte zemër vetes Rizai dhe shpejtonte hapin.

Kur mbërriti në treg, dielli kishte arritur në kupë të qiellit dhe çante ajrin e kulluar. Një puhizë pranverore nga deti ia ledhatoi fytyrën e djersitur. Rizai uli hejbet që kundërmonin erë peshku. Atij iu afrua tagrambledhësi dhe si një maçok i pangopur, vështronte çiftet e kublave të lidhura me xunkth. Ai as s'përshëndeti, por foli ngadalë:

- Unë të kontrollova ty, ti mua, kuptohet më dhuron çiftin e parë. A kupton?

Faqet e kuqe si shegë iu skuqën edhe më Rizait, kurse gjuha iu tha në gojë. Rrudhat e ballit iu shtuan, deshi të kundërshtojë, por në çastin e fundit iu kujtuan fjalët e babait:

"Tregtia i do nëntë hile e një trimëri. Ti je i rrëmbyeshëm, biro. Nuk duron...".

Tagrambledhësi ecte ngadalë dhe priste përgjigjen, kurse Rizai u drodh, e mbajti veten dhe bërtiti me të madhe:

- Urdhëroni, peshq të lirë, peshq të mirë, kubla.

Blerësit u grumbulluan si pulëbardhat në Dri dhe filluan t'i blejnë çiftet e para të kublave. Ca të tjerë kënaqnin kureshtjen. Në piskun e vapës Rizai zbrazi hejbet dhe shiti peshqit e fundit.

Iku me nxitim nga tregu dhe në të dalë të qytetit, në furrën e Naumit, bleu dy bukë. Kthehej për në fshat livadheve dhe shkelte barin e trashë. Toka lëshonte avull, ndërsa dielli digjte si furrë. Kurorat e shelgjeve nuk fërfërinin, edhe pse ishte pranverë. Posa mbërriti në Dardhëz, në gjysmën e rrugës, Rizai u ul nën hijen e lisave. U shtri në barin e njomë, kurse tash maistrali i pasdites filloi t'i mënjanojë kurorat e dendura të lisit. Hija ishte e trashë. Rizai ndau bukën e grurit, kafshatat i përtypte ngadalë, si plak. Donte që shija e bukës dhe aroma ta kënaqnin sa më shumë. Ishin këto çaste të gëzimit dhe atij ia përtërinin energjitë. Duke e mbështjellë në hejbe gjysmën e bukës, Rizait i ranë nga xhepi ca para të holla. Filloi t'i numëronte dhe mijëshet gati i ledhatonte. Duke i paluar, murmuriste: “Sot fitova, peshku u shit mirë. Janë para, por pak për të blerë një kalë. Eh, t'i kisha edhe pesë të tjera, pranë meje do të hingëllinte kali dhe krifën do t'ia shpupuriste maistrali. Këtu, nën hije, do të pushoja, shpatullat do t'i kisha të lira. Por, do ta blej. Bota blen çifliqe, unë do të blej kalë. Për mua vlen sa një çiflig”.

Trokthi i kalit të një shtegtari ia shkëputi andrallën. Para tij u duk djali i Muharrem agait, Mustafai, i cili me mendjemadhësi zdrypi nga kali, edhe pse kishin qenë shokë fëmijërie. U ul me nxitim, kurse kaploshi i lyer me vaj arrash, iu çua përpjetë, si xhufkë kallami. Kali i urtë iu afrua barit të njomë buzë gardhit.

Kur iu afrua, Rizai i zgjati agait të ri kutinë me duhan Kraje:

- Urdhëro, Mustafa! - i tha.

- Jo, s'e pi nga këto, kam cigare fabrike, janë nga Napoli.

- Merre, provoje një, - foli Mustafai me salltanet.

- Jo, s'i dua! -refuzoi ai. - A e di si thoshte gjyshi im?

- Jo, ku ta di unë.

- S'ka me peshk deti, me ujë Rumie edhe me duhan Kraje. Është duhan burrash.

- Po, por ky është duhan zotërinjsh...

Rizait i rrodhi gjaku në damarë, me ngulm. U mërrol dhe foli me zë të lartë, saqë një tufë harabelash që ishin në kurorën e lisave, u frikësuan dhe fluturuan e ranë në ograjë.

Ai i përsëriste fjalët me nervozizëm të rrallë:

- Botë e marrë kjo, s'jemi të gjithë djem zotërinjsh, Mustafa.

Agai i ri dukej i përmbajtur, me zë të thekshëm shprehte pendim:

- Pse zemërohesh, Riza? Ti s'beson se unë të nderoj, me ty kaluam fëmijërinë. Tashti rri larg meje, por ta dish se ne e nderojmë babanë tënd. Është bujk i vyeshëm. Ti je peshkatar i zoti.

- Jo, s'u largova nga ti, o Mustafa. Edhe unë të nderoj, por në na ndau puna. Unë jam natën në peshkim, kurse ditën e shes atë, - shtoi peshkatari, të cilit s'i kishte ikur ende hidhërimi i refuzimit të duhanit.

- He, si u shit peshku sot? – e pyeti Mustafai duke ndërruar bisedën.

Vërejti se e kishte filluar gabim.

- Mirë, gati u vonova.

- Të duhet një kalë, Riza. Unë me gjokun tim arrij në shtëpi për dy orë, - tha ai sikur Rizai të mos e dinte se për sa kohë bëhej ajo rrugë në këmbë e sa në kalë.

U duk sikur dialogut mes tyre i kishte ardhur fundi, ndaj Rizai tha:

- Unë u çova Mustafa, duhet të shkoj në peshkim sonte.

- Shkojmë bashkë. S'kam pse të ngutem.

Dy shtegtarë mbërrijnë më parë në shtëpi. Mustafai në kalë, kurse Rizai në këmbë udhëtonin fushës buzë Barbanës. Flitnin rrallë, ndërsa zhegu i pasdites thante arat që rënkonin për një pikë shi dhe, pasi mbërritën në Vaun e Shën Gjergjit, Mustafai ndaloi kalin dhe tha:

- Të freskohemi pak, Riza. Shtegtuam në piskun e vapës.

Ata u freskuan me ujin e kthjellët dhe të ftohtë të lumit. Kali i etshëm s'ngopej me ujë. Mustafai u ul nën hije të plepit, ndezi cigaren dhe iu drejtua Rizait:

- U rritëm bashkë. Në fëmijëri brodhëm si pak moshatarët tanë pas lejlekëve dhe dallëndysheve.

- Po, u rrita në arën tuaj. I ndihmoja babait tim, - plotësoi Rizai.

- Më thuaj, pse i largoheni çifligut tonë? Ja, i lutem babait ta japë përgjysmë arën e kënetës. Nuk është aq e keqe sa ç'mund ta mendosh. Vërtetë s'është arë buzë lumit, por ti je i zellshëm, e punon dhe fiton. Të tjerët marrin të tretën.

Rizai e dëgjoi me vëmendje dhe, pasi u mendua, shtoi:

- Mustafa, a të kujtohet kur zumë qyrlekun?

- Posi, më kujtohet. Unë thosha "është imi", ti s'lëshoje pe dhe vendosëm: një ditë ta mbaja unë e një ditë ti. Por erdh një ditë dhe qyrleku ngordhi.

- Ti i qitshe qyrlekut më shumë grurë se unë, por ai ngordhi.

- Të kuptova Riza, - tha agai. - Ti dëshiron të jesh i lirë. T'u dhashtë e mbara!

- S'dua t'i përziej dherat e huaja.

Të dy ecnin si miq të vërtetë, si dikur në fëmijëri. Prapa tyre mbetej fusha e Barbanës. Era e pasdites fërfërinte kurorat e plepave, kurse shelgjet laheshin me gurnninë dhe syprinën e qetë. Qyrlekët në brigjet e pingultë gërmonin dheun për të ngrehur folenë, kurse zëri i tyre s'përzihej me ligjërimin e bilbilit, pa mbaruar shtëpinë. Valëzat e bardha si qumësht i ngiste era e pasdites, ndërsa pirajkat shungullonin në Vaun e Freskanjelit.

Kur iu afruan, Mustafai u step në vend dhe u zverdh si limoni. Trupi iu rrëqeth dhe me zë të ngjizur, foli si nëpër dhëmbë:

- Shiko, si lahet thëllëza në lumë! Ma këputi shpirtin.

- Po, e shoh faqekuqen.

- Unë ia shoh gjoksin e gufuar dhe flokët si penda e korbit, është vajza më e bukur në brigjet e Barbanës. Ka vithe të bukura, Riza...

Mustafai vështronte Sutën e bukur, dridhej si xhufkat e kallamit buzë lumit dhe thithte me ngulm cigaren.

- Po ta hap zemrën, Riza. Ti je i ndershëm. I dua njerëzit e tillë. I dërgova inxhi, nuk i qasi. I çova fustan, s'e mori. Nuk e

deshi as unazën e arit. Tash nuk më flet, u çmenda për faqet e saj si shegë, për belin e hollë, - ofshani djali i agait.

- Qenke dashuruar keq, - foli Rizai.

- Shëtita katunde e qytete, por zemra më mbeti të Suta.

Ajo s'përfill djemtë e katundeve, ndoshta ëndërron të martohet në qytet! Nuk zbutet thëllëza, nuk bie në lak.

- Thëllëza është e mençme, ke të drejtë Mustafa, por bie në lak dhe zbutet - fliste qetë peshkatari i ri.

- Jo, nuk zbutet. S'përfill askënd.

- Gabon. Unë e zbus, - shtoi Rizai me vendosmëri, ndërsa qerpikët i rrihnin si pirajkat e vajzave në lumë.

Mustafai qeshi me të madhe si i marrë, saqë kali tërfëlloi.

- Pse qeshesh, Mustafa?

- Si të mos qesh, ajo s'pranoi fustanin e inxhitë e ti thua se e zbutë. Mos, të lutem!

- Mua më pranon pa të gjitha këto, aga, - tha Rizai.

- Me bind e unë të jap kalin! – tha ai edhe me mburrje, edhe me dyshim, se ndryshe s'do ish aq i lirë në bast.

- Mos se do të pendohesh, do e humbësh kalin!

- Fjala-fjalë! – tha me krekosje. - Më bind e të qoftë kali falë! - tha Mustafai.

Rizai vuri dorën pas veshit, iu afrua vaut dhe ia mori këngës:

Tuj u ngjit' Buries përpjetë,
Në mendime tuj mendu,
Jalla shpirt, moj ku do t'jesh,
A t'ka ra ndërmend për mu?

Zëri i ëmbël i Rizait përhapej pellgut të lumit. Jehona kthehej nga mali i thatë i Fraskanjelit. Suta e bukur lëshoi pirajken e madhe dhe u skuq si gaforre deri në rrënjë të flokëve, u drodh si gurnia e lumit. E lëshoi larësen dhe me zë foli:

-Të lumtë goja e të këndoftë zemra, o bilbil!

E ëma iu gërmush, e qortonte e murmuriste:

- S'ka turp vajza, s'e le rehat djalin e botës. Korba unë, do të ma marrësh fytyrën, moj!?

Rizait iu turbullua vështrimi. Nga sytë i gufuan lotët. Kundronte Sutën dhe kalin. Ishte i gëzuar. Dielli ra pas kreshtave

të ashpra të malit të Krythës. Mbi pellgun e lumit u duken bashkat e reve.

Mustafai shtrëngonte dhëmbët, kafshonte buzën, kurse bulëza djerse i rrëshqitnin nga balli i vrenjtur dhe shpërndaheshin në mollëzat zeshkane. I pikëlluar, murmuriste:

- Humba Sutën dhe kalin...

U nisen për në shtëpi. Rizai në kalë, ndërsa agai pas tij, kokëvarur. Nata hapte velin e saj, kurse shpezët ligjëronin në flladin e mugëtirës në të ngrysur që gllabëronte ujërat e Barbanës. Rizait i dilte parasysh silueta e Sutës së Fraskanjelit. Buzëqeshte, i falënderohej vajzës njëzetvjeçe. Përfytyronte vjeshtën me diell e zërin e daulles dhe qerrin e nuses me qilim të kuq e këngën e dasmorëve, kurse brenda nusja si perri.

Atë natë, edhe pse Rizai ishte i lodhur, nuk e zinte gjumi. Herë pas here hapte dritaren dhe vështronte në kopsht kalin që përtypte barin e njomë.

- Kalin e fitova me kusht. E ëndërrova për shumë mot, por është i huaj. S'bën, është pa djersë. Ne s'e deshëm kurrë gjënë e huaj, - bluante me vete Rizai.

Në mëngjes Rizai me sy të skuqur dhe qepalla të lodhura, me kalë përdore, trokiti në derën e Mustafait. Dera u çel. Kali hingëlloi. Siç dukej e njohu të zotin. Mustafai ishte i zbehur dhe i befasuar.

- Ishte dhe mbetet yti, Mustafa! Është fituar pa djersë. S'më duhet...- i tha prerazi Rizai.

Qielli dhe bari lahej me vesën e mëngjesit. Në lindje horizonti skuqej.

Rizai po nxitonte në peshkim.

Roman

Andrej NIKOLAIDIS

ARDHJA

POR LARG ËSHTË AMERIKA

Por larg është Amerika dhe *dielli që shkëlqen*.

Problemi për njeriun i cili, të themi, ka vendosur të dehet në pyllin e pishave, ku e pret aroma e rrëshirës dhe e boçave, maistrali dhe hijesira, nuk janë vetëm shëtitësit, nuk janë vetëm mysafirët. Për hall i mjaftojnë bashkëvendësit. Më të këqijtë prej tyre janë ata që vozisin: kanë patentë shoferi, emra dhe mbiemra, madje edhe biografi. I kanë të gjitha, përveç konsideratës ndaj njerëzve të tjerë.

Njeriu i zvogëlon kërkesat, nga jeta pret vërtetë pak. Të themi, të hyjë në automobil dhe të shkojë deri te vendi ku kanë mjaft uiski dhe akull. Mirëpo, sado pak që të dëshironi, do të fitojmë edhe më pak. Qëndroj në një kolonë, me qindra metra të gjatë. Njerëzit kanë të nxehtë, njerëzit janë nervozë. U bien sirenave, disa kërcënohen dhe shajnë. Disa rrinë qetë, sepse klerikët i kanë mësuar që t'ia lenë fatit, që emër të dytë e ka për kaosin. Pas një minute – dy, që duken si një orë ose dy, kolona nis e lëviz me ngadalë, si ndonjë gjarpër gjigant. Përvoja më mëson: kur në Ulqin është bllokim, shkaktar gjithmonë është ndonjë i parod. Njëri është ndalë dhe bisedon me një tjetër në automobil në anën e kundërt. Dikush është parkuar më mes të rrugës dhe ka shkuar në bastore, ta plotësojë tiketën. Kalojmë pranë *shkaktarit* të tollovisë: një njeri i moshës së re, më një kokë si ndonjë babune dhe me një shikim taravoli, është ndalë pranë byrektores dhe e ka bllokuar rrugën për në Plazh të Vogël. Nga vetura ka porositur byrek dhe pret derisa ia përgatisin dhe sjellin. Pastaj, nuk ka pasur të imëta, prandaj ka pritur që ëmbëltori, kartëmonedhën prej 20 eurosh ta thyejë dhe t'ia kthejë kusurin. Të gjitha këto i bëri pa nguti, në një qetësi më të madhe filozofike, duke mos çarë kokën për të tjerët, automjete, nxehtësinë, sirenat... Sikur *lopa në zen*: vetëm te lopët e dallojmë atë gjakftohtësi ndaj rrethit, asaj qetësie

që të bëjë më parë atë që i bie në mend: zakonisht që baglat t'i lëshojë në vendin e ndodhjes.

Sasinë e primitivizmit te njeriu në qytet mund ta masim saktësisht me pakujdesinë e tij ndaj njerëzve të tjerë, qetësia e tyre dhe kërkesat; me vendosmërinë e tij që beson se është i vetëm në botë, me vendosmërinë e bindjes së tij që atë që ka qëllim ta bëjë, e ka të drejtë ta bëjë menjëherë dhe pikërisht aty, pa marrë parasysh telashet që do t'ua sjellë njerëzve të tjerëve. Vendi i tij është në *natyrë*, atje ai është mësuar që *të ekzistojë do të thotë të keqtrajtojë*; ai nuk ka iluzione të njeriut të qytetit – për të natyra nuk është baraspesha delikate, organizëm i ndjeshëm dhe i koklavitur; natyra atë dhe të tijtë gjatë historisë vetëm i ka keqtrajtuar, me thatësirat e veta, me stuhi, me vërshime, me acare; ata nga natyra mezi kanë kur, por që me vete kurrgjë përveç natyrës nuk kanë marrë, sepse ata janë *natyra*. Sasinë e primitivizmit te njeriu, them, saktë mund ta masim me pengesën që ai e paraqet për njerëzit e tjerë. Sepse njeriu primitiv nuk di të ekzistojë në qetësi dhe diskrecion: ai gjithmonë prodhon zhurmë, shëmti dhe kundërmim. Dhe i bën të gjitha që të jetë i vërejtur – ai ekzistimin e tij vazhdimisht e *emeton*, Ekzistenca e tij është sulm në të gjitha shqisat dhe trurin. Ai na keqtrajton me vetë ekzistimin e tij. Nëse ai gëzohet, një njeri me konsideratë dhe me shije, që e ka fatin e keq të jetojë afër tij, pashmangshëm do të vuajë. Ajo me të cilën njeriu primitiv kënaqet, te njeriu i qytetërua shkakton dhimbje.

Në Vjenë, kam lexuar në gazeta, një austriak, e ka vrarë fqinjin boshnjak. Siç është marrë vesh më vonë, boshnjaku me vite ia ka luajtur mendtë e kresë me muzikë popullore ballkanike, që çdo pasdreke e ka lëshuar në banesën e vet. Austriaku disa herë i është ankuar policisë që ka intervenuar në pajtim me ligjin, por që boshnjakun kjo nuk e ka penguar që edhe tutje ta shqetësojë austriakun. Kur e ka parë se të gjitha mundësit ligjore të mbrojtjes së paqes dhe të privatësisë janë shterë, austriaku ka shtënë në boshnjakun në kokë dhe qetë i është dorëzuar policisë.

Tregimin e mbaj në mend sepse flet për atë sesi ligji nuk ka sukses të na mbrojë nga njeriu primitiv, që nuk është tjetër veçse një fatkeqësi natyrore. Sado të jetë brutal, ligji nuk i arrin brutalitetet e natyrës. Kur ligji do të thotë hakmarrje, si në rastin e dënimit me vdekje, ai është më afër natyrës – e me këtë më i largëti ligjit.

Prandaj këtu është aq padurueshëm, sepse primitivizmi këtu nuk është eksces, por *thelbi* i kulturës së këtushme, prandaj në *esencë* nuk është kulturë. Nëse nuk jeni primitiv, ju këtu jeni një trup i huaj, dhe këtë do të keni raste ta ndieni çdo ditë në lëkurën tuaj. Me shumë përpjekje, fat dhe para mund ta konstruktoni fortifikatën tuaj dhe në të në të ruani renditjen e gjërave sipas teje – për një kohë. Për *një kohë* mund ta mbyllni botën e vet: të çoni mure të larta, ë hapni kanale të thella, të veni ura. Por ata do të gjejnë mënyrë të depërtojnë: si në *Maskën e vdekjes së kuqe* të Po-së, *natyra* e tyre do të përbirohet deri te ju dhe të fshijë *botën tuaj* nga faqja e *botës së vet*.

Njerëzit këtu mbeturinat i hedhin për udhë dhe peizazhin e shndërrojnë në deponi. Bagëtia e tyre, pa të cilën nuk mund të ekzistojnë në paralagjet e veta, ecën asfaltit dhe kullot nëpër parqet e dikurshme të shndërruar në kullosa. Fëmijët e tyre lozin kiç-fontana dhe para sysh të kalimtarëve lagin në xhardinierë me lule. Ata nevojën e vet e lenë nëpër plazhe, në lokalet e shkreta të qendrës për kulturë. Nga të gjitha format e arteve, më së shumti e pëlqejnë muzikën, meqë ajo nuk të detyron në interpretim, në mendime. Deri natën vonë, sikur kripa që do të mbulojë çkado që bie në të, e kriposin botën me zhurmë, me atë muzikë të vetën neveritëse të cilën e kanë të domosdoshme që të dëfrehen.

Nëpër mure dhe bilborde vendosin fotografi të grave të veta gjimëdha, me fytyra dhe grimasa tmerruese që, mund ta paramendojmë, duhet të sugjerojnë epshin, por që dëshmojnë vetëm marrëzinë dhe boshllëkun. Në atë zbrazësi ata fusin aletet gjithmonë të ngrehur dhe pikërisht nga ajo zbrazësi lindin fëmijët *e tyre*, të cilët botës *së tyre*, kombit, kulturës, sojit *të vet* do t'u sigurojnë vazhdimësinë.

Ka çaste, sikur atë ditë, në mes të gjithë atyre njerëzve nga të cilët, të gjithë, më kanë penguar, ka momente kur më kap zemërimi i atillë saqë asnjë fyerje që ta kujtoja, asnjë rafal sarkastik drejt civilëve të tyre, drejt *grave* dhe *çilimive* të tyre që do ta shkrepja, nuk do të më lehtësonte gjë. Ka momente kur mllefi më nxen aq fort saqë nuk mundem të luaj vendit – thuaj se monoliti i zi nga *Odiseja* ka rënë mu në gjoksin tim. Çaste kur *ka* vetëm zemërim, kur unë jam vetë *zemërimi*. Atëherë kujtoj: *vdekje*. Ajo që do të pasojë duhet të jetë vdekja. Nëse ka diçka më pas, diçka jashtë zemërimit, jo mund të jetë vetëm vdekja. Kështu

kam menduar edhe atë ditë: jam mbështetur fort në ulësen e makinës, e kam shtrënguar timonin dhe – kam pritur.

Është e çuditshme që diçka e sigurt, sikur vdekja, nëse marrim guxim të llogarisim në të si shpëtimtare, bëhet diçka jashtëzakonisht e pasigurt dhe, sipas rregullit, vjen shumë vonë. Rrethanë lehtësuese është ajo që shkaku i mosarritjes së saj, në të vërtetë, kurrë nuk jemi të dëshpëruar. Njeriu, thonë, është shtazë me dhunti arsyeje. Më parë do të jetë, përkundër arsyes, shtazë e dënuar me optimizëm. Posa ta largojnë grykën e pistoletës nga balli i tij, posa e heqin çizmen nga qafa e tij, posa e heqin thikën nga rropullitë e tija, njeriu do të kujtojë: do të bëhet më mirë. Edhe para se të arrijë të bëjë kryq edhe ndonjëherë, do të deklamojë: *besimi*, *shpresa*, *dashuria*, prapë do të gjenden me fytyrë në baltë, prandaj edhe vdekja s'do t'i duket aq trishtuese dhe e padrejtë.

Prapë asgjë, gjithçka prapë vazhdon, i thashë vetvetes dhe dallova që njerëzit rreth meje kanë nisur të dilnin nga makinat e tyre. Çdo çast kanë shikuar kah qielli. E kanë thirrur njëri-tjetrin, i kanë kapur kokat me duar, kanë hapur krahët nga çudia. Atëherë fjolla e parë ra në dritaren e parë: E hapa dritaren e derës dhe shikova përjashta: asaj dite të qershorit, qetazi dhe madhërishëm, sikur në filmat holivudianë për idilet e Kërshëndellave, bora po binte në Ulqin.

PASHA KOSOVARËT I QET NË ITALI

Në vitin 1999, kolonat e refugjatëve nga Kosova, kanë ikur sa përpara ushtrisë serbe, sa shkaku i bombardimeve të NATO-s, janë derdhur në Ulqin. Shumë nga ata njerëz kanë ëndërruar si ta kapin Evropën. Pasha u ka ofruar *ta realizojnë* atë ëndërr.

Kriminelët seriozë, në atë kohë nga limanet malazeze kanë lundruar për në Itali me anijet përplot me refugjatë. Disa nga ata vaporë kanë mbërritur në anën tjetër të Adriatikut, disa janë fundosur dhe me vete në fund të detit kanë çuar aq ëndrra për fitime të mira, për mercedesa të përdorur, dhe kursimet me të cilat

në rrethinat e Prizrenit e të Prishtinës do të ndërtonin shtëpi laramane me shumë kate dhe me luanë stolisë në ballkone.

Nga të gjithë *tregtarët me njerëz*, Pasha ka qenë më i liri. Kjo shkaku se punët i ka kryer me harxhime më të vogla. Kjo, prapë, pse njerëzit të cilët e kanë paguar që t'i qeste në Itali, *nuk* i ka bartur në Itali. Pasha klientët do t'i ngarkonte në kamion dhe gjithë natën e lume do t'i voziste nëpër Mal të Zi: Nga Ulqini deri në Kolashin, nga Kolashini deri në Nikshiq, nga Nikshiqi deri në Risan, pastaj gjatë bregut të Bokës, nëpër Budva, prapa në Ulqin. Të gjithë transportojnë detit – vetëm Pasha ecën rrugës së moçme, tokësore – lavdërohej. Në mëngjes njerëzit do t'i shkarkonte në plazhin ranor të Adës së Ulqinit. Refugjatët e hutuar janë sjellë rreth vetes, por që s'kanë mundur të shihnin asnjë ndërtesë, asgjë që do të mund t'u jepte përgjigje në pyetjen: a jemi me të vërtetë në Itali? Tash vetëm përpara – i mësonte Pasha para se do të hipte në kamion dhe me tërë gazin do të ikte, veç përpara, e kur do të takoni ndokënd, ju u thoni me mirësjellje *Buon giorno*!

Refugjatët, me valixhet në duar, do të endeshin nëpër plazh, gjithë kohën deri sa ta takonin një rojë i cili, në përshëndetjen *Buon giorno*, për çudi, do t'ua kthente me sharje në shqipe të çalë.

Plani i Pashës ka pasur vetëm një mangësi: s'e ka paraparë se të ikurit, si të kuptojnë se janë të mashtruar, në jetë nuk do të kenë dëshirë tjetër pos ta vrisnin. Unë jam një njeri i informuar mirë. Sapo kam dëgjuar se vinin për të, Pashën e nis te miku në Tivar, ku është fshehur gjithë kohën derisa refugjatët nuk janë kthyer në Kosovë.

(Fragmente nga romani homonim *Ardhja*. Këtë vepër pritet që së shpejti ta botojë SHB "OM" nga Prishtina).

EX-LIBRIS

Vështrimi kritik

Zija ÇELA

SHKRIMTAR I AUTENTICITETIT SHPIRTËROR

Rreth katër romaneve të Mehmet Krajës: *"Edhe të çmendurit fluturojnë"*(2004), *"Im atë donte Adolfin"* (2005), *"Selvitë e Tivarit"* ("2007) *dhe "Hotel Arbëria"* (2010)

1.

Do të doja t'i bëja disa pyetje Mehmet Krajës për katër romanet e ribotuara nga Onufri: "Edhe të çmendurit fluturojnë" (2004), "Im atë donte Adolfin" (2005), "Selvitë e Tivarit" ("2007) dhe "Hotel Arbëria" (2010). Do të doja ta pyesja, për shëmbull, si dreqin arrite t'i shkruaje vetëm në gjashtë vjet katër romane të këtij niveli?! Mirëpo i përmbahem mendimit të njohur, atij që thotë se vështrimi kritik i një vepre nuk mund të arrihet duke u konsultuar me orakullin, autorin e saj. E po ashtu, me gjithë diversitetin që sjellin leximet vetjake, besoj se asnjë përfundim objektiv nuk mund të arrihet duke dalë jashtë sferës që sugjeron vetë autoriteti i veprës dhe ku mrekullisht, e përsëris – mrekullisht, gjallon *pseudo-objektiviteti* i shkrimtarit të fiksionit. Kraja është i llahtarshëm në këtë objektivitet të gënjeshtërt. (Mund të thoja *kopil*.) Gjasmues, iluziv, i pafytyrë dhe gjithsesi i pafajshëm si gjithë vëllazëria e tij e përbotshme, ai mashtron pa pikën e drojës, sepse trillon në mënyrën më të besueshme e më të shëndetshme, duke kaluar përmes asaj fijes së hollë që ndan irealen me realen dhe, në një fqinjësi kaq të afruar, lexuesi i gëlltit pa ujë edhe mëdyshjet që i lindin. Në sfondin e zhvillimeve bashkëkohore, kjo është nga shprehjet më domethënëse të përgjegjësisë krijuese për "mospërgjegjësinë" e trillit në letërsi. E kështu, pa e pyetur autorin, po jap një përgjigje se çfarë shkrimtari është Mehmet Kraja. E di se tek ne mjaft autorë e presin si mujsharë çastin që krijimtarinë e tyre dikush ta cilësojë

postmoderne, thua se postmodernizmi është më shumë lavdi sesa kalendar. Thjesht, sipas meje, ndoshta Kraja është një postrealist. Me një fjalë, shkrimtar i integruar plotësisht në nivelin më të përparuar europian. Nëse katër romanet do t'i përfytyroja si një kuartet me katër instrumente, atëherë "Im atë donte Adolfin" do të ishte pianoja, "Edhe të çmendurit fluturojnë" violinçeli, "Hotel Arbëria" fagoti dhe "Selvitë e Tivarit" violina. Por sido që t'i renditësh dhe pavarësisht nga ndryshimi i partiturave, gjithë së bashku luajnë muzikë dhome, ku nuk mungon balada për të gjallët, një requiem për të vdekurit dhe një skerco për të gjallët e të vdekurit bashkë. E këto rrinë me njëra-tjetrën, sepse në prozën e Krajës mbisundojnë gjendjet paraverbale të personazheve, kryesisht trazimet e pazëshme me sy hapur dhe jermet e ëndrrave me sy mbyllur. Janë gjendje që mund të kenë qenë jashtë e janë bërë të brendshme, si dhe të brendshme që mëtojnë të artikulohen për të dalë jashtë. Kjo dëshmi pohon se në krijimtarinë e Mehmet Krajës, para se një zanat që mësohet, letërsia është autenticitet shpirtëror. Dhe në intonimin estetik të këtij autenticiteti, si veçori autoriale ka edhe ngjyra, edhe ndërthurje. Bie fjala dramatikja, tipari më spikatës i shkrimtarit, bashkëjeton me humorin e buzagazit, por shfaqet edhe më rëndshëm kur pikëllimi helmues tretet me sarkazmën përmbytëse.

2.

Çfarë i është dashur autorit, para se t'ia niste punës për secilin nga romanet?

Disa troje të njohura, Prishtina, Shkodra, Tivari, Tirana etj. Fabula dhe shumë personazhe të panjohura, çka i fantazon me lehtësi. Pastaj kritika ndonjë *dokument historik*, apokrif në të vërtetë, bllok a fletore me shënime që dikush i paska mbajtur dikur, por që vetëm sa përmenden, pasi nuk luajnë rolin e faktit. Çfarë tjetër më pas? Më pas asgjë, kaq i kanë mjaftuar. Si prozator i racës, të gjitha të tjerat Kraja i ka vetë. Duke e pasur karburantin përbrenda, ai është ndodhur i gatshëm për shkëndijat që i kanë rënë nga jashtë. Dhe rezultati? Te mjeshtri nuk gjejmë pantallona të kuqe të qepura me fill të bardhë, si shfajësim i ekstravagancës së artistit. Por as në duart e artistit nuk shihen shenja të prangave prej despotizmit të mjeshtrit. Mehmet Kraja, në radhë të parë, është prozator i leteralitetit të dhuntishëm, atij të lindurit, genuin-it. Prandaj nuk është e rastit që, duke pasur

vetëmjaftueshmërinë e zhvillimit, ka ardhur duke e pasuruar romanin shqiptar jo në statistikë, por atje ku sot është balli më cilësor i këtij zhanri. Natyrisht, gjithkush përjeton rrethanat e veta, ndoshta edhe autori u ndihmua nga rrethanat e jashtme. Por më tepër se kombinim rrethanash, është rasti kur përparimi arrihet duke u shfaqur thekshëm fuqia vetjake. Kraja i ka lexuar dhe i lexon në vijimësi prozatorët shqiptarë, por në këto romane nuk ndihet hija e asnjë pararendësi. Prandaj është kaq neto vlera që sjell në letërsinë tonë, çka e bën po aq të epërm edhe respektin e autorit për individualitetet e tjera.

3.

Nëse do ta ndaja kuartetin duke i përafruar sipas meje tiparet, njëfarë binjakëzimi do të ishte: "Im atë donte Adolfin" me "Selvitë e Tivarit" si një koncert për piano e violinë; "Edhe të çmendurit fluturojnë" dhe "Hotel Arbëria" si një koncert për violinçel dhe fagot. Binjakët e fundit kanë shumë dhimbje, jo vetëm për dramat që sjellin, por edhe për thikat që shqiptarët ia ngulin njëri-tjetrit. Ndërsa dy të parët, romane që i kam më për zemër, krahas dhimbjes dhe ravgimeve njerëzore, kanë aq kapriçio të narrativës, sa mbërrijnë edhe kulme. Në këndvështrimin e ligjërimit të rrëfyesit dhe botës së brendshme të personazhit, Lindita Tahiri i ka kushtuar një studim të mprehtë stilistik romanit "Im atë donte Adolfin". Ajo pohon se me mënyrën e paraqitjes së realitetit historik, Kraja krijon metafiksionin historiografik, të cilin lexuesi nuk e pranon me skepticizmin që do t'i ishte qasur historisë, sepse domethënënia e rrëfimit nuk mbështetet në dokumentimin faktik të të dhënave të imagjinuara, por në ndërlidhjen e këtyre të dhënave me ligjërimin e rrëfimit. (Libri "Monolugu", fq. 133). Siç shihet, është një depërtim në thelbin e specifikës së fiksionit të Mehmet Krajës. Po kujtoj kalimthi se, kur ekzistojnë studime të qelizës letrare si ky që përmenda, një autor ka shansin për ta njohur më gjakftohtë vetveten, pasi në procesin e studimit ka ndodhur një transformim i çuditshëm, nënvetëdija e shkrimtarit është bërë vetëdija e kritikut. Por unë po ndalem te "Selvitë". Në letërsi ka mjaft romane që i bashkon një arketip: shkrimtari zbret në fëmijërinë e tij dhe, nga pozitat
naiviste të asaj moshe, rrëfen botën përreth. Mirëpo nën ndikimin e një rezultati sundues, mjaft autorë përfundojnë pa dashje ose në

letërsi imituese, ose në letërsi bastarde si epigonë të pandreqshëm. Për nga origjinaliteti i mbrojtur (i konservuar), befasimet artistike dhe kënaqësia e leximit, "Selvitë e Tivarit" i vihet përkrah modelit më të fortë që kanë dhënë në këtë rast letrat tona, "Kronikës në gur" të Kadaresë. Tek "Adolfi" paragrafi i parë i rrëfimit nis me: "Im atë...". Krijohet kështu iluzioni i menjëhershëm se gjithçka që do të rrëfehet është reale, përvojë fort mirë e njohur nga autori, pasi këtë e përcakton lidhja e gjakut, plus të famshmet shënime (sic!) që na qenkan mbajtur dikur me hollësi. Mirëpo çfarë ndodh letrarisht? Mbasi ka trilluar të atin (ngjarjet zhvillohen në sfondin e Luftës së Dytë Botërore), autori trillon edhe të birin, pra fëmijërinë e vet. Por fëmijërinë e dytë ama, sepse ai nuk do të ndalet, dota trillojë edhe tjetrën. Për nga kronologjia kohore, fëmijërinë e parë dota gjejmë te romani pasues "Selvitë e Tivarit", me ngjarje që zhvillohen shumë më herët, rreth vitit 1878. Dhe pak vëmendje për paradoksin tani, sepse këtu kemi të bëjmë me një trill të pazakontë, kur për nga mosha i biri çertifikohet më i madh se i ati. Nëse autori ka qenë dhjetë veç kur bëhet pjesëmarrës në ato ngjarje, rezulton se librin (sipas shënimit në fund: *Prishtinë, janar-nëntor 2010*) e ka shkruar kur ka qenë 123, ndërsa sot, megjithëse i ditëlindjes 1952, shkrimtarit i bie të jetë 136 vjeç. (!) Çudia është se, sado tepër fantaste dhe e guximshme kjo lojë trefish e fshehtë me kohën, letrarisht mbetet prapëseprapë e pranueshme. Rrëfyesit i kanë thyer prej së hershmi rregullat e kohës duke informuar në distancë, madje duke ditur edhe çfarë ka ndodhur para lindjes së tyre. Por zakonisht kjo bëhet duke e respektuar honin ndarës nëpërmjet neutralitetit të vetes së tretë. Kurse te "Selvitë" lexojmë: "Edhe tani, kur e sjell në përfytyrim pamjen e atij vendi, më duket sikur sjell në kujtesë kritika një gravurë të vjetër... Nuk është se kjo pamje vetëm tani më duket e tillë. Gjatë atyre ditëve të largëta dilnim shpesh mbi muret e kalasë dhe nuk bënim asgjë, ngjiteshim mbi kullën e princit..." (Fq. 112) Shihni si guxon autori të rrëfejë në vetën e parë, si e kalon vështirësinë e saj dhe çfarë rrengu na ngre "qafiri", duke aktivizuar njëherazi kohën e ngjarjes, kohën kur shkruan dhe atë relativen kur do të na drejtohet ne, si përputhje me kohën e leximit. Veçse kjo lojë nuk do të mund të mbahej gjatë më këmbë, nëse nuk do të harmonizohej në mënyrë simultane gjatë tërë romanit me mjete të tjera të stilistikës, duke treguar të njëjtin guxim dhe të njëjtën

mjeshtëri unifikuese. Asnjë mbret në faqe të dheut, me gjithë fuqinë që i pati dhënë froni, nuk mundet që prej një distance kohore një shekull e gjysmë ta shohë vetennë mënyrë aktive në kalanë e tij, si lëviz, çfarë sheh e çfarë përjeton. Por shkrimtari edhe të pamundurën e bën të mundur, duke dëshmuar se çfarë fuqie krijuese kanë princat e letrave në mbretërinë e përjetshme të artit.

4.

Për nga kompozicioni romanet e Krajës kanë disi formën e shtjellës. Është kapur më parë një nukël potencial, diçka si syri i ciklonit, pastaj ka filluar përhapja e rrathëve duke e rritur diametrin. Këto rrathë herë priten kushtëzueshëm njëri me tjetrin, herë vetëm takohen nëpër lakore ose ruajnë pavarësi, por gjithë së bashku harmonizohen në një mozaik. Tek "Im atë donte Adolfin" këtë rol e luan babai, tek "Edhe të çmendurit fluturojnë" – Kukumi, te "Hotel Arbëria" – Skënder Berisha. Ndërsa te "Selvitë" fugën fillestare e nis kurva profesioniste Zuke Kalimani, për të përfshirë pastaj në shtjellë tërë Tivarin e përtej Tivarit, ushtrinë e Dovletit, atë të Krajlit të Cetinjës dhe flotën angleze të Stjuartit të çalë. Por çfarë tabloje e paharrueshme krijohet, çfarë personazhesh të larmishme gëlojnë. Ato jo vetëm e pasurojnë njëri-tjetrin, por kontrastet theksojnë edhe profilet brenda veprës: Samiu dhe Sani Kanduri, Ilham Shaqir Suma, Cuf Idrizi, Beqir Demi, Shuaib Damoni, Jehud Doraci, Xhemilja e Habib Katanës, Ymer Efendia, gjakoni Dedë Zarishti, Padër Shtjefni, Nikë Pjetër Jungu, Lami i Kasëm Demirit, Johan fon Bergmani, Nel Gjeshku me mushkën e tij, boshnjakja e Hetem Hoxhës, Lami i Kasë Demirit, Selim Çerkezi, Sebernazja e Beqir Demit dhe deri te gjashtë burrat e Tivarit, Kabili e Rahili, Sabiti e Hamiti, Aliu e Veliu, që hyjnë në bisedime për kufijtë me ushtritë e huaja. Dhe ndonëse me këta gjashtë burra veprës po i afrohet fundi, krerët 34- 36 vazhdojnë të ngrihen, ato kthehen në dramë për nga tensioni, në grotesk universal për nga përmbajtja dhe në poemë për nga stili. Në kuptimin e mirëfilltë, te "Selvitë" nuk ka ndonjë temë që mund të formulohet, gati-gati as subjekt që mund të tregohet në mënyrë lineare. Veçse nuk ka aty situata ku të ndihet shtërzimi i kërkimit, por burime të bollshme ku imagjinata buis vetvetishëm. Autori është ndodhur mu në amën e lëndës së pastër letrare (*les lettres pures*), çka i ka dhënë krejt romanit atë që quhet

frymë, dhe pikërisht fryma ka qenë përcaktuese në kahjen e kësaj letërsie luminishente. Në këtë roman, bashkë me "Im atë donte Adolfin", Kraja ngrihet në nivelin e asaj krijimtarie ku realja s'i përket aq realitetit, sesa fantazmagorisë së tij. Me një fjalë, çfarë ka në përditshmërinë e vdekshme të një kohe mund të mos gjendet në vepër, por gjendet aty çfarë përfaqëson shpirtin e pavdekshëm të kohës. Duket sikur autori i ka fshirë nga mendja romanet e tjera që ka shkruar, për t'i krijuar vetvetes një kondensim të ri, por edhe shenjën më konkurruese për vazhdimësinë e tij në të ardhshmen.

5.

Në pasurinë, lirinë dhe elegancën e përdorimit, Kraja është një nga kampionët e gjuhës letrare. Në të gjithë historinë e letrave tona, prej fillimit e deri më sot, haset rrallë ndonjë shkrimtar që ekspresionizmin e mjedisit dhe natyrës ta ketë në nivelin e këtij autori. Ai nuk e ka për gjë të trashëgojë nga romantikët (që sot shumëkush i shpall krejtësisht anakronikë) afeksionin për gjithësinë, për qiellin e horizontet e tij, për diellin, hënën, yjet, etj. dhe t'i risjellë në modernitet me shijen e kohës. Kur skenat i kanë të pranishme këta trupa qiellorë, në tekst farfurin drita. Sapo shtrihen hijet, përshkrimi bëhet therës. Edhe pse nga njëri roman te tjetri shkrimtari sikur e ka hangër disi natyrën, çdo rimarrje sjell ca rrëqethje dhe ca ndjesi që mbesin flu. Kjo flu, kjo mjegull aq e shpeshtë në romanet e tij, nuk është thjesht lagështira e motit. Por kryesisht nebuloza prej së cilës është krijuar universi i katër romaneve, një tis vibrues që as e ka lënë autorin të shohë gjithçka qartë qysh prej fillimit, siç shohin skematikët, as të ecë qorrazi jashtë hullive të veprave, siç ecin profanët. Ndoshta s'është e rastit që edhe leximi i Krajës të lë njëfarë mjegulle në kokë. Ajo nis të zhdavaritet pasi mbaron libri, sepse pikërisht atëherë, i persekutuar nga dilemat e aktualitetit, qytetari i kritika sotëm çon gishtin në tëmth dhe, siç ka shtruar vargan pyetjesh autori, nis të pyesë edhe vetë: A thua kështu gjithmonë paska qenë jeta, e lakmueshme, ndjellëse, e brishtë, absurde, marramendëse, sureale dhe shpesh idiote njëkohësisht?!

6.

Nuk mund të thuhet se vetë thelbi i artit ka ndryshuar shumë përgjatë historisë. Ka substanca që sikur ngrijnë, sepse për

paprekshmërinë e tyre koha i trajton disi në mënyrë frigoriferike. E tillë është letërsia e antikitetit, e cila edhe pas shumë shekujsh ka mbetur sa klasike, aq moderne njëkohësisht. Çfarë ka ndryshuar më tepër ndoshta është tipografia dhe leximi i letërsisë. S'jam kundër, le ta respektojmë sovranitetin dhe lirinë e

lexuesit në këtë epokë të multikulturalizmit. Por nëse kultura është bërë konsum, fenomen që ka prirje vërshuese, atëherë pjesës më të denjë të letërsisë i duhet të bëjë rezistencë për të qëndruar në kulturën e fisme, kulturën e lartë siç thuhet sot. Këto romane të Krajës i kundërvihen konfuzionit kulturor dhe ushqejnë mendim, ndjeshmëri e spiritualitet te lexuesi. Por pa i varur shpresat te çdo lloj lexuesi, pasi rrenat populiste kanë filluar të na dalin për hundësh. Letërsia e Krajës, duke i kthyer shpinën mediokritetit, letërsisë së shurupit dhe të mediatizimit stinor, bëhet më e pëlqyeshme vetëm për ata që ngrihen në nivelin e saj. Ka njerëz të letrave të tjera që shkruajnë edhe romane, pa qenë romancierë të mirëfilltë. Por ka edhe romanancierë safi që, kur ua do puna, nuk u lënë kurrgjë mangut njerëzve të atyre letrave. I tillë është Mehmet Kraja. Shkrimtar plot kërkime, vëzhgime inteligjente dhe qortime të hidhura përballë ndërgjegjes kombëtare. Eseist në letërsi. Analist në politikë. I flaktë në publicistikë. Ai është vërtet mizor dhe i pamëshirshëm nganjëherë. Por i pamëshirshëm sidomos ndaj vetes, sepse marazi kundër konformizmit dhe nervi i mospajtimit me padrejtësitë s'e lejojnë të përdorë për gojën shtupën e heshtjes. Sidoqoftë, nga jeta plot travaja e shkrimtarëve mbeten librat më të mirë. E kam thënë, këto janë diamantet që lënë pas vdekjes, por që në të gjallë na janë dhuruar modestisht. Dhe të mendosh pastaj se çfarë heq edhe vetë toka, ama e tyre, për t'i krijuar. I krijon aq thellë, sa prej kufijve të zjarrit nganjëherë i nxjerr në sipërfaqe bashkë me llavën e vullkaneve.

Vështrim analitik

Ballsor HOXHA

KUFIRI MIZOR I TRAGJIKES

(Ridvan Dibra*: Legjenda e vetmisë*, roman)

Më kujtohet si fëmijë në moshën 4-5 vjeçare, duke dëgjuar këngën *Çou Rexho,* gjendesha në një qark të kufizuar nga dhembja, qark mizor. Radioja rrinte tërë ditën lëshuar nga nëna, dhe unë herë e dëgjoja e herë luaja – thurja botën edipiane me babain në punë. Ishte mizore ajo këngë, djali në ditën më të madhe të tij vritej mu nga kali i tij. Kjo tragjedi (zbuloja këtë fenomen të shoqërisë njerëzore) trondiste psiken time të asaj moshe, ishte e pashpirt, sa herë që e dëgjoja krijonte pamundësinë e njeriut. Ishte e pashpirt edhe në atë se krijonte një rreth të pandryshueshëm dhe disi duke reflektuar (ashtu më dukej në atë moshë, duke mos ditur ç'është simbolika dhe shenjimi i saj) përhershmërisë. E pyesja nënën si ishte e mundur një gjë e tillë "të vritej njeriu në atë ditë", dhe as ajo nuk kishte përgjigje. Kështu, duke e intensifikuar imagjinatën time, intensifikohej dhe një gjë tjetër, një gjë që e thithja nga kjo këngë brenda psikes sime dhe nga e cila isha bërë i varur. Ishte njëlloj gjendje e të qenit i pandihmë, gjë që krijonte mundësinë ta ndjeja më shumë dashurinë për nënën time. Sa herë dëgjoja këtë këngë, krijohej një liqe ndjenje aq i thellë që shpërbënte botën aktuale, dhe humbesha duke thurur (luajtur) aspiratën time të kësaj moshe. Ishte kufij i krijuar nga pamundësia e logjikes dhe përvojës për ta ndryshuar.

Mizoria e autorit – përkufizimi i Legjendës së Vetmisë.

Në paratekstin e romanit "*Legjenda e vetmisë",* autori Ridvan Dibra po ashtu na mbyll brenda një qarku (e që do të bëhet qerthull), i cili do të na zhvesh tërë emocionet e ngritura/aktive të aktualitetit për të na mbyllur në një gjendje transi e tragjedie.

"Nana djalin ka qorrue / Me gjaks t'burrit m'u martue."

Mu sikur në baladat e legjendave të eposit popullor, krijohet, definohet linja e tragjedisë, e cila na shfaq diçka jo të përditshme, jo të prekshme në realitet, por që si Guri i Zi pranë të cilit Bala kalon ditët, është e pranishme. Por ky qark - që shndërrohet në qerthull - nuk do të pasojë rregullat e tragjedisë, ashtu si na tregon përvoja e leximeve letrare. Në fakt, lexuesi është i ndodhur në një univers letrar, të cilit asnjëherë nuk i definohet as koha e ngjarjes dhe as vendi. Më shumë se gjysma e veprës *Legjenda e vetmisë* kalohet nëpër këtë asnjanësi kohore dhe të vendit. Vetëm një shenjë dhe vetëm një herë ceket mësuesja, si shenjë e mundshme e identifikimit të kohës së ngjarjes, por dhe kjo është e brishtë dhe e paqëndrueshme nga qëndrimi, apo thënë më saktësisht qeniesimi i kësaj ndodhie brenda "legjendës" së saj. Shenjat e aktualitetit (policia, topi, "prostituta", etj.) shfaqen vetëm pas gjysmës së veprës, kështu duke shenjuar një kufizim mjeshtëror të lexuesit brenda kufirit të tragjikes, me qëllim për t'ia mjegulluar atij lidhjen me diçka reale. Për më shumë, autori luan me vëmendjen e lexuesit duke e shtyrë atë të pranojë një realitet (artistik brenda veprës) në të cilin ai vetë vendos çka do të shohim dhe çka do të përjetojmë, p.sh. pa përcjellur logjiken e skemave të njohura të letërsisë. Të gjendur si lexues dhe të ndërlidhur me ngjarjen e veprës, në disa momente pyetemi (apo së paku jam pyetur) të kapërthyer brenda: ku është TV, ku është radio, interneti (simbole pa të cilat nuk ka familje)? Apo ku është mënyra e jetës, sipas asaj që kritika na mëson historia, ku janë zakonet dhe doket e historisë? Me një fjalë, të vjen të pyetesh: ku jam? Syzheu në këtë vepër është i ndërtuar duke "manipuluar" syrin e lexuesit drejt një rrjedhe, brenda një për-kufizimi të universit. Tërë vepra është e rrethuar me kufirin e tragjikes si një vend krimi i rrethuar me shiritin e verdhë të policisë, "do not cross", dhe ne jemi të mbyllur brenda. Por, autori nuk mjaftohet me këtë, ky kufi është herë i përshkuar nga eternalja njerëzore, herë të tjera nga aktualiteti, dhe sidomos nga mizoria, që buron si shenjim nga marrëdhënia njerëzore. Autori thyen rregullat, si të tragjedisë, si të ironisë, duke shndërruar këta kufij, apo duke bartur lexuesin prej njërit fund në tjetrin. Është më shumë një lojë e krijuar me qëllim në mes të lexuesit dhe të autorit, ku sapo fillojmë të lundrojmë brenda njërës rrjedhë të fatit, ashtu si njihet nga përvojat e leximit, bartemi në një tjetër për t'u humbur në dorën e autorit. Kjo është një lojë që më shumë

ngjan në një "luftë" të autorit me shtjellat e marrëdhënieve dhe fateve njerëzore aktuale dhe historike, duke kërkuar një rrafsh ku mund të mbijë një tragjedi. Tragjedia sot më nuk është në mesin tonë – të shpërbërë fuqie për të ndikuar në jetët tona, humbim për çdo ditë në kaosin e (le të themi) informatave, dhe arrijmë vetëm atë që na mundëson mbijetesën – ndodhemi tej tragjedisë, ajo ka kaluar në ironi mizore që shuan çdo përpjekje për të ndjerë fisniken – "majen" e tragjedisë". Andaj, dhe autori i dorëzohet (me intencë artistike të arrirë) kërkimit nëpër marrëdhënien njerëzore përmes një bartjeje nëpër vërshimet e asaj që ndodh sot dhe në ne dhe përballë nesh – fundi i fisnikërisë së njeriut. Kjo sa u tha më lart, shpërfaq Mizorinë (artistike) të autorit si mekanizëm interpretimi dhe shenjimi në këtë novelë. Për ta shquar shënjimin e saj, ndoshta do të ishte e udhës të përkujtohet tipi narrativ "shpresëdhënës" (i romancës). Në këtë të fundit, tragjedia e ndodhur brenda veprës shtrihet në harmonizimin e tërë asaj që bëjnë personazhet dhe të rrjedhave të fatit drejt gjetjes së drejtësisë, drejt përmbushjes së drejtësisë në këtë botë, gjë që arrin kulmin zakonisht në fund të veprave të këtij lloji. Në veprën *Legjenda e vetmisë*, kjo skemë përmbyset; çdo gjë duke u shtrirë, formësuar në të kundërtën e romancës dhe duke krijuar një fat (keqësi) njeriu (atë të Balës) të pakufi, apo ndoshta më saktësisht: të pandalshëm mizor.

Shtresat e mizorisë

Kërkimi i autorit shenjohet më së miri nga shtresat e rrethit ku ndodh kjo tragjedi e shndërruar në ironi "gjatë rrugës". Dhe kjo rrugë përbëhet/ strukturohet nga rrethi, rrethet shoqërore. Por krejt në mënyrë origjinale dhe duke tronditur lexuesin, marrëdhënia shoqërore është e shuar kërkesash dhe nevojash të natyrshme si të kureshtjes dhe përmbushjes së lexuesit, si dhe të personazheve që komunikojnë brenda kësaj mizorie. Ta lëmë Balën adoleshent pranë Gurit të Zi (ashtu siç bënë autori në të vërtetë), dhe të zhytemi në hullinë e mizorisë së tij, deri tek fëmijëria. Në moshën tetë vjeçare, sipas tekstit, Bala humb babain e tij, udhërrëfyesin, ndërmjetësuesin dhe prehjen e pamundësisë fëmijërore (kjo pamundësi është shumë e theksuar sidomos në vendet si këto të Ballkanit, ku jeta është diçka që varet prej fatit më shumë se prej aftësive njerëzore). Është i paimagjinueshëm fati i Balës, dhe tërë rrjedha narrative e kësaj novele, sikur valë

aksidentesh, me rrëmbim përhapet në vëmendjen tonë si lexues. Është posaçërisht e pamundshme (dhe e paimagjinueshme) e besueshme dhe mu për këtë na kapërthen brenda këtij qerthulli. Universi i qeniesimit të Balës themelon atë kufirin tragjik, që shndërron gjendjen e shijuesit të veprës, që nuk mund ta ndryshojë as logjika dhe as përvoja. Të krijojmë disa nivele simbolike, jo të ndara, që do të thotë se nuk janë të kategorizuara sipas nevojës së personazhit dhe as sipas rëndësisë, por që, megjithatë, shenjojnë secila në vete tragjedinë e Balës. Nëna (pas vdekjes së babait) si niveli i parë dhe më i afërti, pastaj fqinji i bukur si ndërmjetësim në mes të nivelit të parë, atij të familjes dhe rrethit, niveli i tretë, Maria, shoqja e klasës, niveli i katërt mësuesja, dhe niveli i fundit klasa. Duke qenë se Bala është një person normal para tragjedisë së vdekjes së babait, ai është suksesshëm i manifestuar deri në moshën që e ka (tetë vjeç) kur edhe i vdes babai, në të gjitha këto rrethe/nivele shënjimi brenda novelës. Dhe ç'ndodh? Vdekja e babait përnjëherë, si damkosje, lidhja e tij me të gjitha këto nivele, ndodhi pas ndodhie, marrëdhënie pas marrëdhënie, shkëputet, nga ky univers: Bala damkoset nga rrethi, gjë që e bën të ndahet nga shkolla, ndahet nga mësuesja për të cilën ka simpati postedipiane, pastaj shkëputet nga shoqja e klasës, e kupton apo më saktësisht e ndjen intuitivisht ligësinë e fqinjit dhe si shkëputje e fundit nga ky univers kupton tradhtinë e nënës (ajo duke tradhtuar dashurinë e babait). Me këtë kritika reaksion zingjiror të këtyre shkëputjeve të lidhjes së Balës me universin fizik, krijohet kufiri/qarku tragjik i cekur më lart. Dhe lexuesi mbetet mbyllur brenda, si brenda një kurthi, duke pas kërkuar të zakonshmen. Krijohet hapësira shpirtërore për të përjetuar tragjedinë. Krijohet ajo ndarja - e pandryshueshme as nga logjika dhe as nga përvoja - e tragjedisë me Balën, personazhin e izoluar brenda kësaj gjendjeje. Ky izolim tragjedie fillon të shenjojë për personazhin kryesor pikë së pari atmosferën familjare ku ai ka jetuar "paraprakisht". Me vdekjen e babait, përmes marrëdhënies së nënës së Balës me fqinjin (e bukur) shpërfaqet konstrukti i familjes së tij, në të vërtetë marrëdhënia e prindërve të tij (bashkë me fqinjin), kështu duke kuptuar se babain ia ka vrarë vetë fqinji, shoku i tij më i ngushtë, me qëllim të zotërimit të nënës së personazhit kryesor. Ndërmjet këtyre personazheve, vepruesve (aktantëve të mizorisë së njeriut) brenda këtij universi, ka dhe marrëdhënie njerëzore (përkundër

mizorisë të niveleve të tjera)në mes të Balës dhe shoqes së tij të klasës, apo dhe mësueses e cila e lutë të kthehet në shkollë. Në të vërtetë, këto dy personazhe janë lidhja e fundit e Balës me universin fizik të kësaj novele, pas vdekjes së babait të tij, para ndarjes së tij prej universit që e njohim.

Përballja e Balës me mizorinë

Kështu, Bala duhet të dali një personazh tragjedie i eposit popullor, duke i ndodhur shkëputja fatale tragjike nga tërë bota që e ka rrethuar para damkosjes nga fati, ajo e marrëdhënieve shoqërore. Në përvojën e letërsisë, në tragjedi, personazhi kryesor është i mbrujtur nga ideali për të çuar në fund drejtësinë (për lexuesin i cili përjeton veprën letrare) dhe me këtë është mbijetues dhe mbizotërues i rrethit, megjithë tragjedinë që e përball. Por, mu në pikat kur lexuesi shpreson të gjejë fijen e rilidhjes së Balës me botën dhe me këtë mbijetimin dhe mbizotërimin e saj nga Bala, personazhi kryesor i veprës *Legjenda e vetmisë*, autori lejon (apo ndoshta ajo është prezente dhe me këtë nuk është nevoja të lejohet apo ndalohet) mizorinë të ndërfutet nëpër jetën e personazhit kryesor. Ai, p.sh., humb dhe të vetmen lidhje reale me babain e tij, duke pas krahasuar fotot e tij me pamjen e vet dhe duke u bërë pre e mizorisë së rrethit, shkëputet nga kujtimi i babait. Në momentin kur ai duhet të rikrijojë marrëdhënien me rrethin përmes shoqes së tij, Maria, hallati i tij e përmbys këtë mundësi dhe ai shkëputet nga kjo mundësi; po ashtu edhe kur i vie mundësia e hakmarrjes, mizoria shfaqet brenda mundësisë dhe shpërndërron tërë gjendjen tonë, aspirimin tonë të vënies së drejtësisë (jo vetëm të Balës), besimi ynë në fatmirësinë shndërrohet në fatkeqësi, gjë që është edhe një shkëputje e radhës. Është, siç u cek më lart, njëlloj vërshime e ngadalshme dhe gjithëpërfshirëse mizorie, e pandalshme, që shtrihet në tërë tekstin. Mendoj, duke i bërë vend imagjinatës, lexuesi dhe autori shndërrohen në kundërshtues të njëri- tjetrit, apo thënë më mirë autori e "keqtrajton" lexuesin me mjeshtëri artistike, duke e vënë në këtë univers mizorie të pandalshme. Për dallim prej veprave tjera të këtij zhanri, posaçërisht në epet popullore, mizoria e fatit (dora e autorit) është gjithnjë e zotëruar nga brenda prej frymës së idealit të arritjes së drejtësisë, fitores së saj, por në këtë vepër, autori me sukses, e përmbys këtë forcë të shpërfaqur vazhdimisht

në historinë e letërsisë, duke e kurthuar lexuesin të pandihmë, mu si edhe Balën.

Bala, a thua i kujt është ky bir?

Ky kufi tragjedie, mizorie, e krijon, skalit një Balë-personazh kryesor, që shenjon një dashuri të sinqertë fëmijërore dhe të prindit të tij. Kjo, intuitivisht, inicion jetën subjektive. Izoluar nga prania e babait, izoluar nga nëna, izoluar nga rrethi, me një fjalë izoluar nga çdo lidhje shoqërore fizike me rrethin, mizoria nuk ndalet, kufiri ngushtohet edhe më, bëhet edhe më i ngushtë (mendoj se është evidente njëlloj klasustrofobie artistike, që ndjen lexuesi nëpër faqet e *Legjendës së vetmisë*), Bala izolon veten (vetëmbrojtje psikologjike) në jetën para vdekjes së babait të tij. Krijon marrëdhënie vetëm me pyllin dhe aty manifestohet, aty rikrijohet babai i tij, duke shenjuar jo vetëm dashurinë për babain e tij, por dhe luftën instiktive të njeriut me fatin dhe përmbysjen e gjërave. Koha bëhet e parëndësishme dhe dhe Bala del si një prej personazheve më të ai rritet. Por kjo zgjat shkurt, qarku tragjik shndërrohet shpejt në qerthull çuditshme të letërsisë shqiptare. Është shenjim i kufirit të njeriut brenda dy forcave – dashurisë dhe urrejtjes. Derisa në moshën fëmijërore, e bart nëpër vërshimin e mizorisë dashuria, e ndërtuar brenda psikes së tij nga marrëdhënia me babain e tij , kjo në momentin kur ai arrin të kalojë pragun e fëmijërisë në adoleshencë (apo më saktësisht ku "hallati" i tij fillon kërkimin vetanak të kritika përmbushjes) ajo shndërrohet në urrejtje. Është fatalitet të cilin autori e lë të zdeshur nga minimialistika e rrëfimit. "Maja e jetës është dashuria, përsëriste ati shpesh dikur. Edhe urrejtja, përsërit tash Bala". Por siç ndodh në përvojën letrare të personazhit, me qëllim të jetës së tij hakmarrjen, vënien në vend të drejtësisë, sy për sy e dhëmb për dhëmb, fisnikërinë e këtij qëllimi, Bala është krejt i "bartshëm" nga ato që i ndodhin. Duke humbur, siç u cek më lart, së pari shoqen e tij, të vetmen lidhje me botën si pasojë e mbizotrimit të instinktit të tij mashkullor, gjë e cila do t'ishte qesharake po të mos ishim brenda kufijve të tragjikes. Bala, meqenëse është i shuar lidhjeje me botën, i traumatizuar deri në shkëputjen e lidhjes me nënën e tij, nuk mbisundon universin, as nuk mbijeton, dhe as nuk gjen prehje. Bala është ndërtuar prej traumës së izolimit dhe ashtu edhe sillet. Megjithëse, në novelë, ai ushqen qëllimin e jetës së tij me shndërrimin e dashurisë ndaj

babait në urrejtje ndaj fqinjit, dhe krijon e jeton në episodet e thurura të hakmarrjes, ai edhe pranon dhuratën femër nga fqinji, bile dhe lidhet me atë, qoftë dhe për pak kohë. Dhe, krejt në fund, duke pas zgjedhur njërin prej të gjitha planeve të panumërta, ai tenton të hakmerret ndaj fqinjit, vrasësit të babait të tij. Por ajo që ndodh është se autori bashkëdyzon, apo thënë më saktësisht, përballë fatin me vullnetin, ndërtuar nga fisnikëria, të Balës. Njëra përballë tjetrës, aty shenjohet ironia dhe jo tragjedia, pamundësia e të qenit fisnik në këtë univers. Nuk shkrep pushka. Pasi që çdo gjë të ketë shkuar sipas planit të Balës për hakmarrje ndaj fqinjit. Fati, apo shtjella e ngjarjeve ndodhin të vetvetishme dhe asnjë prej tyre nuk ndodh në lidhje me qëllimet tona, përkundrazi ato ndodhin përballë asaj që i duhet të bëjë/arrijë Bala. Edhe më tej, siç e cekëm më herët, është një mizori e pandalshme, izolohet Bala. Këtë herë në verbëri të plotë nga, sipas të gjitha shenjave, fqinji i tij. E tëra merr fund pa pas mundur heroi i veprës të hakmerret, pa u vënë drejtësia në vend.

Kurthi artistik i autorit

Në parathënien e librit, autori deklaron se kjo novelë është një përpjekje e tij që t'i jepet tërësisht rrëfimit dhe bukurisë së të rrëfyerit, duke pasur për qëllim shmangien nga trendet globale letrare të nihilizmit, ironisë dhe lojës postmoderne; ndër të tjera, kjo novelë është pikërisht kjo. (Për më shumë, mendoj se është gabim të mendohet se kjo novelë është një rrëfim psikologjik, siç 'udhëzohet' në botimin e librit). Novela *Legjenda e vetmisë* është lojë, konotim i pandalshëm tragjedie me ironinë, si dy skema rrëfimi të përvojës njerëzore, njëra me tjetrën, duke mohuar njeriun me vullnetin e tij dhe me këtë duke mohuar fisnikërinë dhe çka do që ka themeluar njeriun deri më sot. Është nihilizëm total: në mungesën e të mbinatyrshmes, qoftë si zot në religjion, apo moral në mizorinë e universit, që nuk përfillë njeriun, dhe për më shumë ndërfutet nëpër marrëdhënien e njeriut me njëri tjetrin, duke dekonstruktuar çdo qeniesim të mbrujtur nga motivimi prej dashurisë. Dashuria vdes në fillim të rrjedhës së jetës së Balës, dhe tërë ajo që mbetet është përpjekja e njeriut nëpër mungesën e shpirtit, të universit, qoftë atij njerëzor qoftë atij të rrjedhës së asaj që e quajmë fat. Dhe, nuk është përpjekje e mbrujtur nga fisnikëria e njeriut, megjithëse Bala është i izoluar nga kjo mungesë shpirti me dashurinë e babait të vdekur kur edhe fillon

ngjarja e novelës, është instinktive, e pashpirtë dhe automatike, çdo "bartje" e Balës nëpër shtjellat e kësaj që e quajmë fat është dëshmi për këtë, "hallati" (me vrimë në kokë, thënie popullore) endet nëpër ironinë e këtij universi. Dhe prej këtu, universi i thurur artistik i *Legjendës së vetmisë* si një botë - traumë për dhe e lexuesit (po e marr guximin ta quaj). Kurthim i tij brenda mizorisë për të përjetuar një tragjedi postmoderne, ku loja me për-kufizimin e tragjikes shmang çdo shenjë të lidhjes së lexuesit me dëshminë që do të mund të ishte dalje e tij prej këtu. Dalje si dorëzim para vëmendësimit me atë që është, mizorinë e njeriut të papërfillshëm nga universi ku jeton. Është një pyetje që mund t'ia shtrojë vetes lexuesi i bartur nga kjo vërshimë mizorie artistike si lojë: a është njeriu sot formësim i kësaj mospërfillje? Shokët e Balës, më në fund, e pranojnë Balën, edhe të damkosur, apo ndoshta vetëm kështu mund ta pranojnë, të verbtë, të pamundësuar për të parë fytyrën e njeriut sot; por ndoshta, lexuesit të durimshëm, mu errësira e verbërisë së Balës do t'i shënjojë fytyrën e njeriut sot. Derisa dëgjoja *Çou Rexho*, dhe bartesha brenda burimit të një ndjenje, të harruar tashmë, e të ringjallur nga kjo novelë, derisa izolohesha me kritika vetëdëshirë, krijuar varësi nga kjo këngë, në për-kufizimin e shkëputjes nga bota, në transin e kësaj që buronte si melankoli e të kuptuari të fatit, pikërisht në fazën edipiane, ndjeja, luftoja duke ndjerë, si luftë për t'u lidhur – që prej nënës duke larë enët në kuzhinë e deri tek babai (armiku edipian), prej aty në dervishët e shpuar që shfaqeshin në TV – me botën.

Ese

Jaho KOLLARI

ULQINI, NJË HISTORI 2500 LIBRASH TË PASHKRUARA

(Dy fjalë të shkurtra për librat mbi detarët, peshkatarët dhe Glosarin *e Hajro Ulqinakut)*

Këtu nuk do të ndalem në detaje të asnjë vepre të Ulqinakut. Qëllimi i kësaj shkrese është profetizimi eventual imi mbi vlerën kapitale të tyre në të ardhmen e largët (ndonëse vlera e tyre është edhe në ditën e sotit e padiskutueshme).

Pikërisht për këtë, të bëhej një paralele midis *Hafis Aliut* dhe *Hajro Ulqinakut* nuk është aspak një gjë e tepruar. Si njëri, sikundër edhe tjetri, kanë jetuar e punuar një kohë të gjatë jashtë Ulqinit.

Dihej mirëfilli se Hafiz Ali Ulqinaku na ka lënë një *Fjalor turqisht-shqip*, nga ku mund të nxirrej (nga studiuesit e gjuhës dhe të tjerë) se si është folur shqipja në Ulqin, dhe më gjerë, këtu e më se njëqind vjet më parë.

Një thesar ky me një vlerë të pakontestueshme.

Në kohën kur *Fjalori* i Hafiz Alisë e pa dritën e diellit, dokumente të shkruara mbi Ulqinin dhe të folmen e popullatës së tij, ka pasur fare pak.

Por ky fakt (se kishte, pra, pak dokumente të shkruara mbi Ulqinin në atë kohë) nuk e bëri atë Fjalor aq të (pa)njohur në kohën e tij.

Ndonëse, pra, i rrallë, ai sigurisht nuk ka tërhequr kërshërinë e opinionit asokohe, sa e tërhoqi (dhe gjithnjë e tërheq) një shekull e ca më vonë (në lidhje me këtë konstatim timin, ndonëse spekulativ, mbi popullaritetin e veprës së Hafiz Alisë në kohën kur ajo u shkrua dhe u publikua, mund të shtoj vetëm se këtu nuk e kam qëllimin ta vë vlerën e asaj vepre nën teh të briskut, fjala është për diçka tjetër, gjë që do të shihet më vonë.

Kur isha ende i vogël (mbase 10-12-vjeç) e pata pyetur babanë se, kush e ka ndërtuar një virane që ndodhej jo larg shtëpisë sonë!?

Ai vetëm rrudhi krahët.

Disa vjet më vonë, tashmë në moshën madhore, ia pata bërë po të njëjtën pyetje, duke i thënë që, po ta kishte pyetur ai babanë e vet dhe, babai i tij (pra, gjyshi im), ta kishte pyetur babanë e vet, sot i kisha treguar birit tim se kush e kishte (dhe kur ishte) ndërtuar ajo ndërtesë që sot është gërmadhë.

Në këtë bashkëdyzim, duke mos u përqëndruar, pra, në detaje të asnjërës prej atyre veprave, mund të thuhet se *shkrimet e Ulqinakut mbi detarët dhe detarinë, peshkatarët dhe peshkatarinë*, sikurse edhe *Glosari* i tij, do t´u rritet vlera me kalimin e kohës. Vlera e këtyre veprave, në të ardhmen e largët, për studiuesit e ardhshëm, do të ketë vlera kapitale.

Ata (studiuesit e ardhshëm, pra), në saje të faktit se në të kaluarën e largët ka ekzistuar njëherë Hajro Ulqinaku dhe i ka mbledhur këto dokumente, duke i sistemuar dhe publikuar në libra respektivë, do ta kenë shumë më lehtë, seç e kemi ne sot, të publikojnë studime mbi të kaluarën e këtij mjedisi (Ulqinit).

Vetëm ky konstatim (që kësaj radhe nuk është një spekulim, por një fakt që sigurisht do të vërtetohej në të ardhmen) i bën këto vepra të mëdha.

Ata që ndajnë mendimin se veprat e përmendura kanë një vlerë të vogël, apo mesatare, duhet të lindin sërish për njëqind apo dyqind vjet, që ta shohin sa gabim e kishin pasur!

Ag APOLLONI

ARDHJA E APOKALIPSIT

(Andrej Nikolaidis me romanin Ardhja)

Andrej Nikolaidis me romanin *Ardhja* ka mbaruar trilogjinë tragjikomike, të cilën e përbëjnë edhe dy romane tjera të përkthyera në shqip nga shkrimtari dhe përkthyesi ynë i njohur, Hajro Ulqinaku, sipas rendit kronologjik të botimit: *Mimesis, I biri* dhe *Ardhja*.

Ardhja, duke qenë vazhdim konceptual i dy romaneve të tjera, trashëgon ide e trajta të tyre, por këtu bëhet një thellim tematik falë dimensionit biblik, i cili shfaqet që në titull dhe shtrihet gjithandej në nëntekstin e romanit, në një pjesë të të cilit rrëfehet *ati*, e një pjesën tjetër *i biri* i braktisur dhe I çmendur.

Apokalipsi në të cilin aludohet shpesh gjatë rrëfimit, mund të kuptohet si zbulesë hyjnore dhe si fund i botës së rrejshme, e cila mund të shkatërrohet sapo të zbulohen autorët e krimit, apo sapo të zbulohet e vërteta, e cila, siç thuhet në kapitullin e fundit, duhet t'i thuhet vetëm priftit, sepse nëse bëhet publike, do të jetë shkatërrimtare: "*E vërteta është një kometë që bie në Tokë, tallaz që përmbyt brigje, bombë që rrezikon pirgun. Vetëm një grimë e së vërtetës dhe kjo botë do të bëhet e pamundshme*".

Kjo ide për gënjeshtrën si shpëtimtare mund të jetë si jehonë nga *Zemra e errësirës* e Conrad-it, mirëpo në romanin e Nikolaidisit ajo rikontekstualizohet dhe aktualizohet duke e përfolur në mënyrë parodizuese Ardhjen e Dytë që e paralajmëron Gjoni në Zbulesën e tij. Në fakt, romani *Ardhja* ka në njërën anë krimin (vrasjen e Vukotiqve), në anën tjetër ndëshkimin (pritja e Apokalipsit). Ndërmjet krimit dhe ndëshkimit janë edhe hajnitë, mashtrimet, dhuna, tradhtitë, homoseksualizmi etj., të cilat së bashku thurin intertekstualitetin biblik, herë si ironizim i profecive të rrejshme dhe akteve të ndaluara nga feja, herë si torturë psikologjike që vjen si pasojë e përfytyrimt të botës si thertore.

Me romanin *Ardhja* Nikolaidisi ka vazhduar preokupimin tematik me vorbullën ballkanike, të cilën e trajton me teknikë mozaiku, me artikulim monologues që edhe dialogun e asimilon sipas dëshirës së narratorit homodiegjetik, me qëndrim ironizues dhe me mendje të hapur.

Mirash MARTINOVIQI

KUJTIME PËR RADOVAN ZOGOVIQIN, POEZI E POROSIVE TË MËDHA

Radovan Zogoviqi është klasik malazez. Shkrimtar, i cili e ka pasuruar letërsinë malazeze me vepra të cilat e vendosin në majat e saja. Është lindur në fshatin Mashicë, në Polimjen e Epërme, te Andrijevica, në Mal të Zi, në vitin 1907. Gjimnazin e ultë e ka kryer në Berane dhe gjatë shkollimit katërvjeçar çdo pesëmbëdhjetë ditë i ka kaluar nga 32 kilometra duke ecur këmbë deri në Mashnicë, ashtu që nëna e tij ta arnonte e ta pastronte dhe të merrte ushqimin për dy javët e ardhshme. Në klasën e tretë të gjimnazit të ultë, ka filluar të shkruajë tregime të shkurtra kundër alkoolit, kundër alkoolistëve dhe tregtarëve të alkoolit, kurse në klasën e katërt boton këngë popullore, shortare dhe shpoti dhe përshkrime të lojërave popullore në Kiq, javoren beogradase për humor, zbavitje dhe për mbledhjen e krijimtarisë popullore. Dy vite e gjysmë të Gjimnazit i ka kryer në Pejë, pasiqë familja e tij ishte vendosur në Dukagjin, në një fshat të Deçanit.

Kolonist në Dukagjin, pjesëtar i lëvizjes komuniste që nga ditët e para, luftëtar për drejtësi dhe për të vërtetën edhe vet deri në përkushtim dhe, i saktë dhe i drejtë. Njeri që gjithmonë ka pasur qëndrim, edhe në kohërat kur të mbajturit qëndrim vetanak paguhej edhe me kokë. Ndonëse pjesëtar i një lëvizje ideologjike, tek ai ideologjia nuk e ka vrarë poetin. Ai i ka dhënë asaj aq sa ajo ideologji ka përmbajtur në vete postulate të përhershme, që kanë vlerë për të gjitha kohërat. Më vonë, ithtari i saj më besnik do të shpallet për renegat të saj. Do të jetë edhe dyshues, mohues dhe kritikues i saj, më saktësisht i atyre. Të atyre mbi të cilët, pa fije dyshimi, ishte shumëfishë më lartë. Mirëpo, se çdo e keqe nuk është e keqe, tregon edhe rasti i tij. Pikërisht gjatë viteve të izolimit, lindin veprat e tij të mëdha, të shkruara me gjuhën e Ezopit. Të mbështjella me metafora. Ajo gjuhë, gjuha e tillë e kanë bërë të madh, të patejkalueshëm, të paqasshëm, të

pakapshëm nga censorët dhe të afërt me lexuesit dhe me adhuruesit e shumtë të tij. Edhe vet i izoluar, i hedhur nga shokët, i harruar nga miqtë, Zogoviqi bëhet përkushtimtar i Poezisë. Pikërisht në fazën e parë të atij izolimi, Isidora Sekuliq është i vetmi person që e viziton. Për shkak të keqtrajtimit dhe bastisjes së shpeshtë nga UDBA, edhe ajo se shpejti do të heqë dorë, por do ta zëvendësojë poetja Desanka Maksimoviqi. Kur për këtë kishte dëgjuar Gjilasi, familjar i afërmë dhe bashkëpartiak i Zogoviqit, e kishte qortuar Desanken pse ajo e vizitonte, ajo i ishte përgjigjur: Edhe ju do t'u vizitoj kur do t'u gjej, godasë fati i njëjtë. Ishte kjo një shaka spontane e cila se shpejti u bë realitet. Kishte rënë edhe Gjilasi. Shkollës së renegatëve iu shtua edhe një nxenës. Në shkollën e tillë, që të dy do të merrnin dhe vazhdonin kursin tjetërfare, nga ai që e kishin vijuar më parë. Zogoviqi kishte heshtur dhe kishte shkruar, kurse Gjilasi kishte shkruar, por edhe kishte vepruar politikisht. Në periudhën e paraluftës, Zogoviqi ishte poet i njohur. Në fillimin e studimeve e kishte humbur bursën për shkak të një kritike të pavolitshme të një shfaqje të dobët teatrore. Në përfundim të vitit të parë shkollor, së bashku me një shok, e boton revistën *„1939 në jug“.* Në vitin e tretë të studimeve e ka shkruar novelën *Shtëpia e bardhë*. Me urdhërin e pushtetit të atëhershëm, shqiptarët e Dukagjinit ishin të detyruar t'i lyenin shtëpitë e tyre, "të cilat nga jashtë lojalisht ishin të bardha, por nga brenda ishte çdo gjë e errët dhe e papastër, çdo gjëje i zihej fryma nga varfëria, papastërtia, prapambeturia e trishtuar e i çdo lloji sëmundjesh të rënda dhe zullumeve të trishta". Novela ishte botuar në revistën *Stozher*. Censura e ndaloi këtë numër. Si përgjigje për padrejtësitë kundër shqiptarëve, që iu bënin në Mbretërinë Serbo-Kroato-Sllovene shqiptarëve në Kosovë, në vittin 1936, në sanatoriumin Klenovik në Zagorjen e Kroacisë, Zogoviqi e shkroi poemën *Ardhësit - Këngët e Ali Binakut*, zë i revoltës, i kryengritjes kundër asaj padrejtësie e kundër padrejtësive në botë. Para kësaj, Zogoviqi në Zagreb e kishte vizituar bardin e poezisë *August Cesarecin*. Këtë rrëfim ma ka dëftuar në banesën e tij në Beograd, që në vitet e hershme të tetëdhjeta të shekullit të kaluar. Ishte ftohtë, Cesarec ishte mbështjellë me një batanie të trashë, kurse Zogoviqi, poet i ri, me një dozë droje para bardit të madh. Si është gjendja në Kosovë? - e kishte pyetur Cesareci kolegun e ri. Zogoviqi i kishte folur detajisht për maltretimet ndaj shqiptarëve, nga ana e xhandarmëve

të atëhershëm dhe të disa kolonistëve malazezë, ndër të cilët dallohej veçanërisht *Sava Lazareviq*, komandant i xhandarmërisë malazeze (i „krilashëve“) në atë pjesë të Dukagjinit, e cila, në periudhën 1912-1915 ishte nën Malin e Zi, i pagëzuar *Savë–batarja*. Cesareci i kishte dëgjuar me vëmendje këto detaje të trishta dhe ndodhi tragjike për jetën e atëhershme të shqiptarëve të Kosovës dhe, pas bisedës dy orë e gjysmë kishte klithur: *Zogoviq, nëse nuk keni letër, këtë duhet ta gdhendni në gurë* . Së shpejti këto fjalë të Cesarecit e kishin nxitur shkëndinë e cila qëmoti ishte ndezur, Zogoviqi e shkruan poemen „*Ardhësit – Këngët e Ali Binakut“*, që e përbëjnë dymbëdhjetë tërësi poetike.

Para luftës së Dytë Botërore, Zogoviqi ka jetuar në Beograd, në Zagreb dhe në Shkup, ku në Fakultetin Filofifik e ka kryer Grupin për Letërsi dhe ka fituar titullin profesor. Në vitin 1937 në Zagreb e ka botuar librin *Zogjtë e zjarrtë* që ishte ndaluar, kurse kritiku Eli Finci ishte dënuar me tri vjet burg, pasiqë policia e kishte zënë duke e dërguar tirazhin e fshehur nga Zagrebi për në Beograd. Në vitet 1937 deri në vitin 1939 ishte anëtar i redaksisë beogradase *Nasha stvarnost*, kurse në vitin 1939, sëbashku me Velibor Gligoriqin, e nis dhe e redakton revistën *Umetnost i kritika*. Lufta e zë në Beograd, ku pasë bombardimit të gjashtë prillit shkon në Mal të Zi. Në ditët e para kryengritjes bëhet anëtar i komandës kryengritëse për rrethin e Andrijevicës, nga së bashku me Veselin Masleshën dhe ne bashkëshortën Vjera, në bjeshkën Konjsko te Berane botohet gazeta e hektografuar *Sloboda* traditë e botimit, që me shkëputje të kohëpaskohshme vazhdon deri në ditët tona. Në Manastirin Moraça punon në Shtabin e njësitit të Komit, kur e shkruan poezinë për nder të fitores sovjetike të Moskës. Gjatë luftës dhe në luftë ka ushtruar detyrat më të përgjegjshme; ishte anëtar i agjitpropit të Komitetit Krahinor dhe i Sesionit të Propagandës të Shtabit Suprem të njësive partizane të Malit të Zi. Në vjeshtën të vitit 1943 trasferohet në sesionin Propagandues të Shtabit Suprem. Ishte anëtar i redaksisë, bashkëpunëtor dhe redaktor i dorëshkrimeve në revistën *Nova Jugoslavija*. Pas desantit në Dërvar, transferohet në ishullin Vis, e pastaj në Beogradin e çliruar. „Nga atëherë“- shkruan Zogoviqi në Biografinë që e tij dhe „pothuaj deri në fund të vitit 1948 kam kryer aq shumë dhe aq detyra të ndryshme, kështu që, sidomos në fillim, duhej zgjatur ditën deri në 30 orë. Gjatë tërë asaj kohe „kam qenë anëtar i

Komisionit për Agjitacion dhe Propagandë pranë KQ të PKJ, konkretisht e kam nxjerrë fletushkën 20 *oktobar* (që është dita e çlirimit të Beogradit), kam marrë pjesë në organizimin dhe nxjerrjen e gazetës *Borba;* kam marrë pjesë në organizimin e shoqatave kulturore e arsimore, në organizimin dhe në punën e shoqatave kulturore, të ndërmarrjeve botuese, të kurseve arsimore, në nismën e botimin e revistave, në organizimin dhe punën e shoqatave kulturore, të ndërmarrjeve botuese, në themelimin e filmit jugosllav, në organizimin e Kongresit të Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë, disa muaj ishte redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën *Borba,* nënkryetar i Shoqërisë për bashkëpunim kulturor të Jugosllavisë me BRSS, të Jugosllavisë dhe Bullgarisë dhe të Jugosllavisë e Shqipërisë. Anëtar i redaksisë së revistës *Jugoslavija* ka shkruar artikuj politik e ushtarak, kritika letrare e artistike në Borba *Knjizhevne novine* dhe në gazeta e revista tjera. Ka botuar fragmente nga kritika letrare, ka shkruar poezi, ka redaktuar botime të ndryshme, kam mbajtur ligjërata, fjalime parazgjedhore e fjalime të tjera, kam marrë pjesë në përkthimin e biografisë së Leninit, në redaktimin e Historisë së PKJ, e kam përgatitur botimin e përpunuar të Matveja Kozhemjakinit dhe Fome Godijevit; isha referues kryesor në Kongresin Themelues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe në kremtimin e 100-vjetorit të *Kurorës së Maleve,* kam udhëtuar me delegacionin qeveritar të shkrimtarëve në BRSS (1946 dhe 1947), kam udhëtuar me delegacionin e luftëtarëve të rezistencës në Paris, kam udhëtuar me delegacionin e PKJ në Kongresin e Partisë Komuniste të Indisë në Kalkutë (shkurt 1948) në delegacionin e punëtorëve të kulturës në hapjen e ekspozitës së piktorëve dhe të skulptorëve jugosllavë në Pragë".

Në vitin e luftës 1943 e shkruan poemën e njohur - *Vjershë për biografinë e Titos,* si një përgjigje ndaj propagandës perëndimore. Atij „fisi të poshtër të biografëve të Titos. Kundër atyre „që genjejnë dhe spiunojnë rreth emrit dhe rrugës së Titos" iu përgjigjet me rafale të ashpra të vargjeve dhe të barotit, të vërtetën dhe ndaj pyetjes së tyre: kush është Tito? Zogoviqi përgjigjet: "*Po pyesni për Titon kush është/ ti pushkë, pushka ime, shkruaj /Tito, jemi të gjithë ne/ edhe toka edhe ushtria edhe malet sulmet tona trime, të pandala / të shtruarat nëpoër shinjelat e tyre dhe të shatorëve të tyre.../* Poema është shumëzuar në vendluftime, u është ndarë luftëtarëve, të cilët me të në gojë dhe

me vargjet e saj, kanë rënë përgjatë tërë vendit të pushtuar. Nëpër vorbullat e luftës, poema i ka përjetuar gjashtë botime zyrtare. Gjatë kohës së izolimit të tij, Zogoviqi e ka përkthyer poemën *Mir* të Majakovskit. Me honorarin e përkthimit të kësaj poeme ai do ta botojë në një botim privat, në vitin 1958 librin e vogël, por të madh dhe shumë me efekte *„Ardhësit - Këngët e Ali Binakut“*. Nëpër librarítë e Beogradit e kishte shpërndarë poetja Desanka Maksimoviqi. Librarítë e kishin marrë librin, por pas disa ditësh libri ishte tërhequr nga shitja. U ndalua shitja e tij. Ky libër jo i trashë i pengonte regjimit të kaluar mbretëror, por edhe atij që zëvëndësoi, regjimit komunist. Por kaluan caret dhe mbretërit, të cilët i mbijetoi poezia, që Zogoviqi më se miri e dëshmon me vargjet e Këngës së nëntë, në librin *Ardhësit - Këngë të Ali Binakut*.

Mbi ne në mua, sa kap kosa e një jete,
kanë qenë tre krala, që vijshin për mos me shkue,
që ngrehshin topat në shtatë rrugë dhe kufij
dhe na goditshin me zjarrë, dhe na qëllonin me fjalë
të mëdha me na ngri,
dhe na shkundshin si pemët, dhe na qethnin si delen,
dhe na thurshin në lese, hujtë e të cilave zblidhen në nyje,-
tre krala, që vijshin për mos me shkue,
dhe shkuen,
si vegshat u thyen.
Mbi ne në mua, sa kap kosa e një jete,
kanë qenë tre krala, që vinin për të mos shkuar,
që ngrehnin topat në shtatë rrugë dhe kufi
dhe na godisnin me zjarrë, dhe na qëllonin me fjalë
të mëdha për të na grirë,
dhe na shkundnin si pemët, dhe na qethnin si delen,
dhe na thurnin në lese, hunjtë e të cilave zbliodhen në nyje,-
dhe shkuan
si vegshat u thyen

Poezia e Radovan Zogoviqit i ka mbijetuar tre carë, tre mbretër dhe mbretëritë e tyre, duke u shndërruar në një simfoni të madhe, zërat dhe jehonat e së cilës dëgjohen dhe jehojnë, jashta mbretërive kalimtare, duke u bërë mesazh i përhershëm për të gjitha gjeneratat dhe popujt dhe vërejtje për pushtuesit dhe

tiranët. Në përfundim të heshtjes shtatëmbëdhjetëvjeçare izoluese, nga e cila shndërriti të folurit e përhershëm, Zogoviqin në Beograd e kishte vizituar shkrimtari *Mirosllav Kërlezha*, me të cilin në perioudhën e paraluftës kishte pasur polemika të rrepta dhe jo aq të këndshme, të njohura si: *lufta në të majtën letrare.* I befasuar nga vizita e tillë, Zogoviqi ishte gëzuar se dikush po e viziutonte, aq më tepër Kërlezha, i cili ka ardhë nga vet Titoja, kur izolimi i poetit edhe zyrtarisht ishe vënë *ad acta*. Në fund të vizitës, Kërlezha ia kishte kërkuar poezitë për *Republikën zagrebase*, revistë në krye të së cilës ishte vet Kërlezha. Zogoviqi ia kishte dhënë një tufë poezishë, ndërkaq Kërlezha do t'i botonte në numrin e parë vijues të revistës. Në këtë mënyrë edhe kishte filluar rehabilitimi i Radovan Zogoviqit, dalja nga izolimi shtatëmbëdhjetëvjeçar. Pason vizita e Zogoviqit te Kërlezha në Zagreb, kur ai ia dha për ta lexuar botimin në shumë vëllime të romanit *Zastave (Flamujt).* Zogoviqi, një kexues i vëmendshëm e suptil, i cili pa asnjë dyshim dhe pa konkurrencë, mund ta hetonte tërë atë që ishte e tepërt, kishte fshirë bukur shumë pjesë nga romani, kurse Kërlezha i padurueshëm, thërriste shpesh dhe pyeste: Deri kund ke arritur? Kur kishte arritur deri në fund, Kërlezha e kishte pyetur se a i pëlqente romani. Zogoviqi ishte përgjegjur: Unë nga gjashtë libra do t'i kisha shkruar, botuar dy. Kjo Kërlezhës nuk i kishte pëlkqyer. Këtë rrëfim ma ka treguar Zogoviqi që në vitet e tetëdhjeta kur e kisha vizituar disa herë në Beograd. Atëbotë e pata zhvilluar edhe një intervistë të gjatë me te. E përjavshmja zagrebase *Oko* (Syri) kishte autoritetin e një reviste të hapur në të cilën mund të botohej çdo gjë. Një pjesë e madhe e intervistës ishte fokusuar në luftën brenda të majtës letrare. Atëbotë, ajo ende ishte temë e ndaluar. Për këtë apo për ndonjë arsye tjetër, intervista nuk u botua. Pas një kohe të caktuar, vendosa ta thërras kryeredaktorin se a do të botohet intervista dhe kur. Pa ndonjë shpjegim m'u përgjigj se intervista me Zogoviqin nuk do të botohej. Këtë intervistë pas një kohe e botoi revista beogradase *Knjizhevnost (Letërsia)*, me një distancim të redaktorit i cili, në fund të bisedës: mendimet, idetë, opinionet e Zogoviqit i quan *retrograde*, kurse e kishte fshirë hyrjen time inspirative. Redaktor ishte *Vuk Kërnjeviq* me të cilin vet Zogoviqi kishte polemizuar më parë, të cilën e ka botuar me titull *Knjizhenva sudanija* (botim privat, 1974), për të cilën unë unë dija asgjë. Nga koha kur e kam zhvilluar këtë intervistë, unë i kam disa letra nga

Zogoviqi, të cilat i ruaj si një thesar në arkivin tim, si dhe vet intervistën e shkruar nga dora e Zogoviqit. Pas daljen nga prangimi ose nga burgu shtëpiak, siç thuhej atëbotë, Zogoviqi ka botuar: *Fjala e artikuluar* (1965), përmbledhjen e tregimeve *Pejsazhe dhe diçka po ndodhë* (1968), përzgjedhje poezish me titullin *Damarëve për gurë*, botim i Entit Grafik (1969). Pasojnë librat me poezi*: Personalisht, krejtësisht personalisht* (1971), *Kancelaria e knjazit* (1976), *Përkohësisht, përgjithmonë* (1985), *Supret për nesër* (1985), librin e tregimeve *Natë dhe gjysmë shekulli* (1978), tregime të zgjedhura (1985), romanin *Gëzofi me gjysmë mëngësh* (1985), libri me ese dhe trajtesa për Njegoshin, S.M. Ljubishen dhe për këndimin gojnore: *Kalimthi për të patejkaluaren* (1983). Krahas studimit të gjatë e ka përpiluar antologjinë e *Këngës epike malazeze të kohërave të ndryshme*, në Beograd, në vitin 1970, nga Enti Grafik i Titogradit. Gjatë një vizitës sime që i bëra më pati thënë se është duke e përgatitur antologjine e këngëve lirike malazeze, me verejtjen se kënga lirike më e mirë malazeze është *Nëpër fusha valo o trim i shquar*. Se deri ku ka arritur në këtë punë, tash për tash nuk di asgjë. Ndoshta mund të ketë qenë vetëm një dëshirë, plan i tij. Pasi që nga trashëgimia e tij, e cila është publikuar pas vdekjes së tij, libri i tillë nuk është prezentuar, ndaj as ndonjë shenjë për te, ka të ngjarë se ai nuk ka arritur ta përfundojë, ndoshta as mos ta nisë seriozisht atë projekt të rëndësishëm - *përzgjedhje të lirikës popullore.*

Radovan Zogoviqi ka vdekur më 5 janar të vitit 1986. Mbetjet mortore, urna, sipas dëshirës së tij është varrosur në varrezën familjare në Deçan, ku kanë jetuar, si kolonistë prindërit e tij, ku edhe ai e ka kaluar një pjesë të rinisë së tij të hershme.

Pas vdekjes është botuar libri *Rikëndime* (1989), në të cilën janë përmbledhur përkthimet e tij të poezisë shumë nga të cilat, gjatë izolimit të poetit Zogoviq janë botuar me emrin e poetes Desanka Maksimoviq, si dhe libri i prozave autobiografike, memoaristike, udhëpërshkruese, kronikane *Postajanje i postojanje*.

Në vitin 2009 në Prishtinë është botuar në tri gjuhë libri *Ardhësit - Këngët e Ali Binakut*, si botim i Shtëpisë Botuese *Publisher - Ars Albanica*, edicion i *Kepit të Shpresës së Mirë - Fahredin Gunga.* Poezitë në gjuhën shqipe i ka përkthyer *Esad Mekuli*, kurse në gjuhën angleze Avni Spahiu. Librin e ka

përgatitur jashtëzakonisht bukur piktori Shyqri Nimani, kurse parathënie speciale për këtë botim e ka shkruar *Jevrem Bërkoviqi*, i cili pos tjerash ka thënë: "*Ekzistojnë popuj, shkarjet historike të të cilëve, herëherë edhe fytyrën e zezë popullore ua shërojnë, ua përmirësojnë dhe ua lajnë vjershëtarët e tyre të mëdhenj. Dhe ekzistojnë popuj krimet e të cilëve, apo njollat e përgjakshme historike, i përlavdërojnë dhe i zmadhojnë vjershëtarët e tyre parësorë, e mandej ata dytësorë e tretësorë. Populli malazias e ka pasur fatin të kishte vjershëtorin e madh, që nga Njegoshi e deri më sot më të madhin, Radovan Zogoviqin, ardhacakun dukagjinas, kosovarin sipas fëmijërisë dhe rritjes, i cili si malazias ardhacak, ndjeu qenien dhe shpirtin e tokës dukagjinase dhe rrënjët shqiptare të ngulitura thellë në atë tokë kosovare. Radovan Zogoviqi, si askush tjetër e ndjeu, e përjetoi dhe e jetoi dramën shqiptare kosovare, të shkaktuar nga ardhja e kolonistëve dhe vendosja e tyre në Kosovë e Dukagjin! Njeriu dhe vjershëtari Radovan Zogoviq e përjetoi dramën kosovare edhe si dramë të vërtetë malaziase*." - shkruan Bërkoviqi .

(Nga gjuha malazeze e përktheu: Smajl SMAKA)

PËRURIME

PROMOVIMI I REVISTËS "DIJA"11

Mustafa Canka

Zonja dhe zotërinj, të nderuar miq, të dashur bashkëqytetar!
11 numra të revistës DIJA tashmë janë bërë enciklopedi e llojit të vet të Shqiptarëve në Mal të Zi, por edhe të komunës së Ulqinit.
Sepse, duke marrë parasysh strukturën, mënyrën dhe llojin e teksteve dhe autorët të cilët janë të përfaqësuar aty, është lehtë të konkludojmë që bëhet fjalë për revistë serioze. Së bashku me Lemben, kjo është revista e vetme e këtij lloji e cila botohet në Ulqin. Kjo është hapësirë e atyre që mendojnë dhe krijojnë, që, për ato që vijnë, do të jenë dëshmi për ne dhe kohën tonë në këtë botë të përkohshme.
E të gjithë ne lëmë gjurmë. Lum ato që, me meritat e veta dhe mëshirën e Zotit, për të mirë do të njihen. A duhet të theksohet: dija, shkenca, libri, ajo që është e shkruar, janë e mirë e përhershme.
Duhet me të vërtet shumë punë, sakrificë dhe vendosmëri në mënyrë që të kihet vazhdueshmëri në botimin e një reviste të tillë. Kurrsesi nuk është lehtë që në një komunitet të vogël siç është i yni të iniciohen fuqitë e përgjumura letrare, të mblidhen në një vend të gjithë ato që merren me fjalën e shkruar, ti ofrohen lexuesve temat aktuale dhe të balancohet me mungesën e përhershme të përkrahjes financiare. Vet inicimi i një reviste të tillë është ngjarje kulturore, ndërsa 11 numra është arritje e vërtet.
Si do që ta sillni, në DIJE gjithmonë hasni ndonjë segment të rëndësishëm, i cili është interesant për lexuesin. Për mua është më e rëndësishme që DIJA afirmon dhe promovon dialogun në mes nesh, që në të lajmërohen njerëz të rinj, ato që kanë çfarë të thonë në krijimtarinë e prozës dhe poezisë, në eseistik, në shkencë.
Ne, përndryshe, kemi qejf të lavdërohemi që kemi traditë të mrekullueshme. Dhe kjo është e vërtet, por Elioti prej kohësh ka thënë: Zotërinj, nëse keni nevojë për traditë, atëherë duhet ta fitoni me shumë mund!

Për këtë arsye detyrimi ynë i parë është që vazhdimisht të mësojmë, të arsimohemi, të kërkojmë këshillën më të mirë nga ato që dinë, në mënyrë që të marrim mësimet më të mira dhe të provojmë të kuptojmë shenjat e përhershme të kohës. E nëse ndërkohë edhe vetë mund të shënojmë ndonjë gjë, atëherë me të vërtet jemi të shpërblyer me thesarin e çmuar. Dhe nëse atë e përdorim në të mirë të komunitetit, atëherë suksesi është i garantuar, siç është rasti me këto 11 numrat e DIJES. E përgëzoj për këtë gjë kryeredaktorin dhe anëtarët e tjerë të redaksisë.
Faleminderit.

"DIELLI, DETI, SHËNDETI" – LIBËR ME VLERË

Libri i tretë i prim. dr. Gani Karamanagës.

Ismet Kallaba

Në sallën e Qendrës Kulturore të Ulqinit, më 2.10.2013 u përurua libri "Dielli, deti, shëndeti" i prim. Dr. Gani Karamanagës. Libri, i botuar në dy botime të veçanta, në gjuhën shqipe dhe malazeze, është përmbledhje e punimeve kërkimore-shkencore të autorit, të mbajtura në konferenca shkencore, takime mjekësore apo të botuara në gazeta e revista të ndryshme që nga viti 1977 e deri në ditët e sotme. Ai është vlerësuar lart nga folësit në përurim, specialistë të mjekësisë dhe të fushave të tjera, të cilët kanë vënë në pah aspekte të ndryshme pozitive të këtij libri. Redaktori shkencor i botimit në gjuhën shqipe, Prof. Dr. Elez Selimi nga Tirana, ka thënë se në punimet e botuara në libër bëhet fjalë për sëmundjet më problematike në rajonin e Ulqinit. Sias Selimit, autori ka meritë që ka ditur të shkruaj qartë dhe kuptueshëm, për masën e gjerë të njerëzve, duke arritur në mënyrën më të mirë të mundshme të dërgojë afër lexuesve dijet e duhura shkencore për këto sëmundje. Recensenti i botimit në gjuhën shqipe, Prof. Dr. Simë Dobreci, ka thënë se Prim. Dr. Gani Karamanaga, i dashuruar në Ulqinin e vendlindjen, gjatë punës së tij profesionale

është marrë posaçërisht me ndikimin e klimës së bregdetit në shëndetin e njeriut, duke i studiuar dhe vërejtur veprimet pozitive të detit, aerosolit, klimës, diellit. Në këtë libër, ai i grumbulloi, i sistemoi vëzhgimet e veta mbi ndikimin e klimës bregdetare në shëndetin e njeriut. Dr. Karamanaga konstatoi që resurset natyrore të Ulqinit ndikojnë mirë në përmirësimin e shëndetit", theksoi ai. Dr. Mirosllav Mariq nga Igalloja e ka quajtur autorin e librit vizionar që sheh përtej. "Në libër vërejmë përgjegjësinë e atij që sheh më tepër se tjetri. Po ashtu autori, vizionar, në një mënyrë origjinale nxit idetë e zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve njerëzore dhe natyrore të biodiversitetit unik të Ulqinit. Autori nuk pret projekte të mëdha nga lart. Ai e fillon aksionin, propozon dhe krijon projekte të mëdha, për disa prej të cilëve jemi sot dëshmitarë", ka thënë ai. Për të "libri është bashkëkohor dhe i dobishëm për lexim, tekst jo vetëm mbi të arriturat shkencore bashkëkohore, por edhe i raportit të përgjegjshëm të autorit ndaj profesionit, identitetit, mjedisit të tij". Në fjalën e vet, autori Prim. Dr. Gani Karamanaga ka thënë se libri paraqet rrugën e tij jetësore në fushën e mjekësisë. Ai ka folur ndër të tjera për strukturën e librit, që në bazë të tematikës që trajton është i ndarë në katër kapituj: Shëndetësi, Klima dhe shëndeti, Infektologji, Pulmologji. Për librin kanë folur edhe Prim. Mr. Scc. Milan Roloviq, recensent i botimit në gjuhën malazeze, Ardita Rama, lektore e librit në gjuhën shqipe, Liljana Rabrenoviq, lektore e librit në gjuhën malazeze, dr. Nail Draga, drejtor i Qendrës Kulturore Ulqin dhe Safet Kurtagiq, drejtor i Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave. Prim. Dr. Gani Karamanaga ka qenë drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Ulqin në tre mandate. Është organizator i tetë simpoziumeve shkencore të mjekëve Ulqin – Shkodër. Ai është kryetar i Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi. Deri tani ka botuar monografinë në gjuhën shqipe dhe malazeze "Mjekimi me faktorë natyrorë në regjionin e Ulqinit" dhe "Historiku i shërbimit shëndetësor në Ulqin". Botimin e librit "Dielli, deti, shëndeti" në gjuhën shqipe e ka financuar Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, kurse në gjuhën malazeze Shtëpia e Shëndetit në Ulqin. Përurimi i librit, i cili është moderuar nga shkrimtari Hajro Ulqinaku, është organizuar nga Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi dhe Biblioteka e Ulqinit – Qendra Kulturore.

DRAMË

Mexhid MEHMETI

VDEKJE E HIJSHME

(Dramë me temë nga balada Hasan Aga dhe Çika Potureshë).

PERSONAT:

Narratori
Kalimtar Rasti
Kalimtar Tjetri
Hasan Aga - 9 dhe 15 vjeç
Çika Potureshë - 9 dhe 15 vjeç
Nëna Hasan Agës
Hyzmeqare Parja
Hyzmeqare Dyta
Haxhuska Plakë
Shoku I
Shoku II
Fantazmë Gruaja
Burra, gra, djem e vajza, dasmorë e xhematë, muzicientë etj.

Shpjegim: *Ngjarja që ndodh gjatë paraqitjes së Narratorit, Kalimtar Rastit e Kalimtar Tjetrit, në fillim e në fund të shfaqjes, është paramenduar të zhvillohet në plan të parë si një (i)realitet i (pa)mundshëm, ndërkaq ngjarja tjetër që ka të bëjë me baladën, duhet të paraqitet në plan të dytë, përkatësisht në retrospektivë skenike, ngase përkundër tematikës bazë baladore, ajo më shumë i ngjason një ëndrre dhe çuditërisht shembëllen me një idil romantik, kështu që edhe lumturia e personazheve, po edhe tragjika e tyre duhet të përjetohen si të tilla! Njëlloj duhet të ndodhë edhe me Fantazmë Gruan...*

TABLO E PARË

(...Skena është e errësuar gati në tërësi. Nga thellësi e territ dëgjohet muzikë e pikëlluar e cila duke u qartësuar dalëngadalë kuptohet se është kënga e Hasan Agës dhe Çikës Potureshë. Në një kënd të skenës ndizet një dritë e vogël sa e një qiriri e cila mezi ndriçon fytyrën e zbehtë dhe mjekërbardhë të Narratorit i cili posa zbrazë një kupë e lë mbi tavolinë. I bie tavolinës me dorë dhe bërtet me zë si të shterur "edhe një". Meqë nuk e dëgjon askush, kap kupën me të dy duart dhe e mbushë vetë atë).

"Hë... edhe një, po kujt i çirrem kështu? Askush në botë nuk më dëgjon. Askush! Vetëm unë rroj në këtë botë. Të gjithë kanë vdekur. Të gjithë! Hë... vetë i kanë fajet... nuk kanë pirë sa duhet... Hëk...

(Hyn Kalimtar Rasti)

Narratori
(Me habi) Po ti kush je?

Kalimtar Rasti
(E shikon vëngër dhe me përbuzje pa i kthyer fare përgjigje) ?!

Narratori
Pse s`flet. Mos t`u kanë mbytur anijet në det?

Kalimtar Rasti
(Ulet në karrigen përkarshi, ndez një cigare dhe sërish nuk i kthen përgjigje).

Narratori
(I afrohet me fytyrë te hunda, e shikon si me habi dhe mu në vesh i bërtet sa mundet) Bam!

Kalimtar Rasti
(I trembur) Hej, mos ke luajtur nga mendja?!?

Narratori

(Triumfalisht) Hë, gjallë qenke? Pse s`flet, pra? E sheh se jam i vetëm në këtë botë jallane. Vetëm unë jam gjallë. Të gjithë të tjerët janë të vdekur. Të gjithë... *(e shikon frikshëm Kalimtar Rastin),* ndoshta..., ndoshta edhe ti je i vdekur... Apo, apo... ndoshta ne të dy jemi të vdekur e të tjerët që nuk duken janë të gjallë.

Kalimtar Rasti

Ndeze një cigare. *(Ia shtrin pakon me cigare).*

Narratori

(Zgjatë dorën po nuk merr cigare) ?!

Kalimtar Rasti

Merre!

Narratori

Jo, jo,... *(trembet nga pakoja e cigares).*

Kalimtar Rasti

Merre, hej, se nuk bëhet kiameti. Çka po trembesh si nga lugati?! Të gjallët pinë duhan. Të vdekurit, besa, jo!

Narratori

E kam lënë.

Kalimtar Rasti

Mos do të thuash se ke vdekur! Ë?!

Narratori

Jo, jo... ka ca ditë që e kam lënë atë të shkretë. Më bën dëm shumë... Më...

Kalimtar Rasti

Të paska lënë ai ty besa, ashtu si t`paska lënë edhe mendja.

Narratori

(E ndërpret) Jo, jo... gjallë jam. Nuk kam vdekur. Përndryshe, e sheh se si e pi rakinë!? I vdekuri nuk pi raki, apo jo?

Kalimtar Rasti

Po ti nuk je duke pirë rakinë!

Narratori

Si, si? Si the, unë nuk e pikam rakinë? E ç`është kjo? *(Merr gotën e mbushur, ia cakrron për hunde "hajt gëzuar")* A nuk është kjo raki? *(Çon gotën me një hurb).*

Kalimtar Rasti

Hajvan! Ti s`e kupton se rakia të paska pirë ty e jo ti rakinë!

Narratori

Megjithatë, jam gjallë. Edhe kjo është dëshmi se jam gjallë!

Kalimtar Rasti

Shkova.

Narratori

Ku?

Kalimtar Rasti

Sa më larg nga këtu!

Narratori

Pse?

Kalimtar Rasti

Nuk rrihet në varre!

Narratori

Çfarë varresh, more?

Kalimtar Rasti

Ja këto. Këto...

(Sillet rreth e rreth duke treguar me dorë. Në çast ndizen dritat dhe skena mbushet fund e krye me varre. Njëri nga ta është i zbuluar. Tre të tjerë i ka përkarshi. Më tutje vetëm një. Pastaj nëntë...).

Narratori
Bah...

Kalimtar Rasti
Ika...

Narratori
Shko në t`samës, po mua ku po më lë? I vdekur nuk jam! Nëse kam pirë pak kjo nuk do të thotë se kam vdekur. Edhe duhanin s`e pi, ja, për inat, po gjallë, gjallë jam. Si kujtove ti?...

Kalimtar Rasti
(Merr një kryq varri, i hipën sikur kalit dhe ikën...) - Ihaaa...

(Trokëllima e hapave të kalit të shpon veshët. Pastaj çohet një frymë e madhe. Stuhia me fishkëllimë shkund gjethet nga drunjtë...).

Narratori
(Mbyll veshët me dy duar) Po ky, kush ishte ky?

Kalimtar Rasti
Ihaaa... shkovaaa... Ja kam dhënë besën Doruntinës... Ihaaa...

Narratori
Besën, Doruntinës?! Bah... Ky të ishte Konstantini?! Mos jam ëndërr, apo m`ka zënë tepri rakia!?

(Larg në fund të skenës shihet një grua fantazmë. Ecën ngadalë me duar përpara. Era ja shpupurish leshrat e gjata dhe fustanin me vello të bardhë).

Fantazma Grua
Konstandin! Kooonstadiiin...

Narratori

Konstandini e Doruntina! Jo, jo... Nuk dua ta shtjelloj këtë temë. Nuk dua. As Rexhën jo. Rexhën e Nonës... As Aga Ymerin... As Halit Gashin, as Halilin e Hajrinë... as... as... Çfarë shkrimtari do të jem unë nëse përsëris temat e shtjelluara më parë?... Nëse përsëris të tjerët, apo, fundja edhe vetveten? Vetveten, po unë, cili jam unë...? Kush më njeh mua? Askush! Nuk bëhet emër me tema të huazuara. Me balada, tragjedi, këngë popullore... Nuk bëhet emër nëse nuk je i sigurt se a je gjallë apo jo?! Përndryshe, pse, atëherë, të merrem me të vdekurit?...

Kalimtar Tjetri

(I afrohet me kujdes Narratorit dhe i flet aq ngadalë thua se ka frikë që të mos ia prishë gjumin) Hë, po ç`qenke bërë tapë! Hajt, bir, hajt... Ani, ti më thua se do të krijosh emër..., se do të bëhesh shkrimtar. Mut! Mut, do të bëhesh!

Narratori

(Sikur trandet nga kllapia) Jo mut, po raki. Raki... Po kush je ti? Pse më shqetëson në këtë kohë të pakohë?

Kalimtar Tjetri

E kemi lënë të takohemi sot!

Narratori

Sot? Pse?

Kalimtar Tjetri

Po, po, sot. Edhe atë mu në këtë vend, por shpresova se nuk do të të gjej kështu tapë të dehur! Ti nuk e mbajte fjalën...

Narratori

Fjalën!? Cilën fjalë? Besën... Cilën besë? E pa Konstandinin se si e shaloi kryqin e varrit në vend të kalit! E pe? Pak më parë bisedoi me mua! Madje më ofroi cigare. I thashë se nuk e pi. Hë... iku! Iku pa pirë asnjë gotë raki! Iha, i bërtiti kalit Konstandini dhe iku bashkë me erën. Pastaj... Pastaj po me atë erë erdhi Doruntina... Duart i mbante përpara dhe thërriste Konstandin, Kooonstandiiinnn... po ai nuk e dëgjoi! Për besë po. Ja këtupari kaloi Doruntina e bukur e cila e verbuar pas besës së

Konstandinit nuk më pa mua fare... Por edhe unë, mbase, gabova që nuk i bëra zë. Së paku do t`i kisha treguar anën se kah iku Konstandini me kryqin e varrit të shaluar si kalë...

Kalimtar Tjetri

Ç`flet ore përçart? Aq shumë të paska rënduar rakia sa që ke ndërruar edhe temën.

Narratori

(E shikon me përbuzje) Temën, cilën temë? Unë të flas për të vërteta, kurse ti sërish me të vjetrën "temën, ta temën", po cilën temë, ore?

Kalimtar Tjetri

Atë për të cilën jemi marrë vesh?!

Narratori

Ti nuk i sheh ato që jam duke i parë unë. Ti vetëm kërkon. Kërkon dhe kërkon. Ti vetëm kërkon... Kërkon të mbajmë besë. Besë kërkon! Nuk je ti në lëkurën tonë. Nuk di ti ç`është shkrimtari e ç`është shkrimtaria. Ajo farë punëtorie ku shkruhen veprat. Aty ku shkruhen "veprat" me porosi. Me pare e pa pare... Me raki e pa raki... Nuk e din ti...

Kalimtar Tjetri

Po unë shpresoj që brenda muajit të inskenoj dramën për të cilën u morëm vesh. Mirëpo, ti rakinë e ke bërë dramë e dramën raki!?!

Narratori

A kam qenë i dehur atëherë kur u morëm vësh?

Kalimtar Tjetri

Ç`flet, ore?

Narratori

Të pyes a kam qenë i dehur atëherë kur u morëm vesh?

Kalimtar Tjetri

Jo, po përse pyet?

Narratori
E, atëherë eja kur nuk jam i dehur!

Kalimtar Tjetri
Po ti, tashti po flet sikur të mos jesh fare i dehur.

Narratori
Ka kohë që më mundon një temë, të cilën deri sot nuk e ka shtjelluar askush. Kuptohet, pos rapsodit popullor. Baladën për Hasan Agën e Çikën Potureshë. Qysh si student, mbaj mend, se si profesori plak i letërsisë popullore, kur na pat folur për baladat, në mënyrë të veçantë u pat ndalur në atë të Hasan Agës ..., për të cilën pat thënë se kishte ndodhur duku në fshatin tim të lindjes, meqë vetëm aty ekzistuaka ende Mahalla e Poturve. Më vonë mësova se Potur kishte pasur edhe në shumë lokalitete të tjera, por mua që nga atëherë kjo baladë më është ngulitur në mendje dhe vazhdimisht e konsideroja si diçka timen. Si diçka të veçantë, të cilën duhej ta përjetësoja në ndonjë krijim letrar timin.

Kalimtar Tjetri
Do të thotë se nuk ke bërë dramë për Konstandinin e Doruntinën, ashtu sikundër jemi marrë vesh, por për Hasan Agën e Çikën Poturesh?

Narratori
Jo, as për Konstandinin e Doruntinën, as për Rexhën e Nonës, as për Aga Ymerin, as për Luto Fukaranë, as për Lugun e Xhemiles, as...

Kalimtar Tjetri
Mjaft, mjaft... më thuaj, pra, çka ke bërë?

Narratori
Po cili je ti që më pyet?

Kalimtar Tjetri
Unë jam Regjisori.

Narratori

Regjisori?! E unë, pra, jam shkrimtaaaariiiiii... Shkrimtari! *(I bie tavolinës me grusht).*

Kalimtar Tjetri

Tash sërish po flet si i dehur!

Narratori

Ani çka? Të gjithë shkrimtarët janë të dehur. Të gjithë. Edhe kur pinë edhe kur nuk pinë! Po, ama, edhe të gjallë janë, të gjallë edhe kur rrojnë edhe kur nuk rrojnë. Dua të them, janë të gjallë edhe pas vdekjes...

Kalimtar Tjetri

U mor vesh. Ma jep, pra, dorëshkrimin...

Narratori

Ju nuk mund t`i shihni ato që i shohim ne. Ti, pra, nuk mund t`i shohësh ato që i shoh unë. Ha, ha, ha... Unë jam shkrimtar... Ha, ha, ha... Jam mut... E ti je... ti je... edhe ti je... mmm... mmmuuu... ttt...

(Errësohet skena dhe njëkohësisht bie edhe perdja).

TABLO E DYTË

(Ambient tërësisht baritor. Aty-këtu shihet ndonjë kafshë duke kullotur. Lëndina me barë e lule si dhe lisat e pemët që e rrethojnë, paraqesin një bukuri të rrallë natyrore. Tek-tuk shihet ndonjë bari duke ruajtur bagëtinë. Që nga larg, me nga një shkop në dorë, duken një djalë e një vajzë, të cilët qeshin e bisedojnë hareshëm. Shihet qartë se janë shumë të lumtur. Në ndërkohë dëgjohet kënga " O, bari...", dy të rinjtë, Hasan Aga e Çika Potureshë, pasi gjejnë një vend më të përshtatshëm për lojë, herë ulen luajnë bishtash, e herë ngrihen e vrapojnë pas njëri-tjetrit duke lozur symbyllazi. Në ndërkohë muzika ngadalësohet kështu që djali dhe vajza tashti dëgjohen mirë kah bisedojnë).

Hasan Aga

Ai, sa e parahatshme qenka ajo mështjerrë e larme. Nuk kullotka aty ku duhet, po yrysh e në misër të huaj.

Çika Potureshë

Mështjerrat gjithnjë janë kështu të parahatshme. A nuk e ke ditur ti këtë?

Hasan Aga

Po ku ta di unë kur nuk jam bari i vërtetë?!

Çika Potureshë

Shihesh edhe nga rrobat *(ia lëmon ato),* i ke të reja, të pastra, të bukura...

Hasan Aga

Çobani i shtëpisë dje mori leje nga nëna ime për të shkuar për një kohë te familja e vet, që e ka diku larg pas këtyre bjeshkëve.

Çika Potureshë

Larg, ku?...

Hasan Aga

Të thashë, pas bjeshkëve..., pas shtatë malesh..., kodrash... Ha, ha, ha...

Çika Potureshë

Po flet sikur kur rrëfen ndonjë përrallë!

Hasan Aga

Pse nuk të duket ty e tërë kjo punë si në përrallë?

Çika Potureshë

Cila punë?

Hasan Aga

Ja, kjo që papandehur u bëra bari, pastaj njohja me ty, pastaj... Ah, kjo mështjerrë lazdrane.

Çika Potureshë
Po pse, ç`i paska ndodhur çobanit tuaj?

Hasan Aga
Kushedi, me siguri do t`i ketë ngjarë diçka e madhe. Ndonjë vdekje në familje, apo... Përndryshe, nuk do t`i kishte dhënë leje nëna ime. Ani mu tash, në këtë kohë, në vlugun më të madh të punëve.

Çika Potureshë
Pse për dasmë a nuk do t`i kishte dhënë leje, a?

Hasan Aga
Ku ta di, ndoshta...

Çika Potureshë
Ndoshta?!

Hasan Aga
Ti nuk e di sa është e rreptë nëna ime!

Çika Potureshë
Ha, ha, ha...

Hasan Aga
Përse qeshesh?

Çika Potureshë
Nëna e rreptë?!

Hasan Aga
Po, pra.

Çika Potureshë
Po babai?

Hasan Aga
(Ulë sytë përtokë dhe hesht).

Çika Potureshë

Po babai... *(e prek me gishtin tregues në hundë),* po babai?...

Hasan Aga

(Kthen kokën në anën tjetër dhe i bishtëron përgjigjes).

Çika Potureshë

Unë për vete nuk kam fare frikë nga nëna, por nga babai. Madje me nënën qëndroj si me ndonjë shoqe të mirë. Gjithçka i tregojmë njëra-tjetrës. Edhe sekretet më të mëdha. Më këshillon për çdo send. Kurse babai?! Hë, ai është tepër i rreptë si për mua ashtu edhe për nënën...

Hasan Aga

(E shikon në sy. Ja përkëdhel me dashuri flokët e gjata që ja kishin pushtuar tërë shpinën Çikës Potureshë).

Çika Potureshë

Ç`i shikon flokët? Të duken të pakrehura? Nuk kam ç`të bëj, sepse e humba diku krehrin.

Hasan Aga

E kërkojmë dhe do ta gjejmë diku bashkë.

Çika Potureshë

Po ti, pse nuk më the a ke frikë nga babai?

Hasan Aga

(Hesht).

Çika Potureshë

Pse nuk flet, o Hasan Agë, përse nuk flet? Pse t`është mbyllur goja me dry?

Hasan Aga

Unë nënën e kam edhe nënë edhe baba!

Çika Potureshë

Pse, të sëmurë e ke babain?

Hasan Aga

Jo të sëmurë, po nuk e kam fare. Ka nëntë vjet që nëna më ruan jetim. Kujdeset për mua e për pasurinë tonë...

Çika Potureshë

Si të ka vdekur babai?

Hasan Aga

Nuk e di?!

Çika Potureshë

Si nuk e di a është i vdekur apo i gjallë?

Hasan Aga

Nëna më ka rrëfyer se në një luftë të madhe e shumë të rreptë, me një ushtri bishash të egra që zbritën nga Karpatet, për t`i pushtuar sarajet tona të larta e tokat tona pjellore, e kishte pësuar edhe babai im Ymeri...

Çika Potureshë

Aga Ymeri?!?

Hasan Aga

Po, por jo ai i këngës...

Çika Potureshë

Pse të mos jetë mu ai?

Hasan Aga

Sepse Aga Ymeri i këngës ka pasur të bëjë me një tjetër mbret e mbretëri e jo me ushtri bishash karpatiane.

Çika Potureshë

Sa të bukura i ke rrobat...

Hasan Aga

Flokët e tua ia kalojnë çdo bukurie.

Çika Potureshë

Krehrin...ah, krehin, nuk e gjetëm krehin...

Hasan Aga
Ç`të duhet krehri? Ty të rrinë më bukur leshrat e pakrehura!

Çika Potureshë
Hajt, pra, të luajmë... *(e shikon si e magjepsur dhe ulet në bar).*

Hasan Aga
Prapë dëshiron të lozim?

Çika Potureshë
Ëhë...

Hasan Aga
Ç`të luajmë?

Çika Potureshë
Ç`të duash!

Hasan Aga
Ç`të dua?

Çika Potureshë
Ëhë...

Hasan Aga
A je e sigurt?

Çika Potureshë
Pse të mos jem?!

Hasan Aga
A nuk je akoma e vogël?

Çika Potureshë
Unë e vogël?!

Hasan Aga
Hem ti, hem unë...

Çika Potureshë
Çfarë të vegjël, ore, për lojë nuk jemi të vegjël!

Hasan Aga
Luajmë, pra...

Çika Potureshë
Çfarë të luajmë?

Hasan Aga
Të luajmë, të luajmë... Të luajmë... Hajt të luajmë: burrë e grua ?!?

Çika Potureshë
Phu, i pafytyrë, po ne jemi të vegjël!

Hasan Aga
The se nuk jemi të vegjël për lojë!

Çika Potureshë
Po ajo që thua ti nuk është lojë?!

Hasan Aga
Si nuk është lojë?

Çika Potureshë
Është, por për të mëdhenjtë, nuk është për të vegjlit...

Hasan Aga
The se nuk jemi të vegjël?!

Çika Potureshë
E çka nëse nuk jemi?

Hasan Aga
Të luajmë atëherë.

Çika Potureshë
Mos është herët?

Hasan Aga
Herët për lojë?

Çika Potureshë
Po kjo nuk është lojë!

Hasan Aga
Si nuk është lojë?

Çika Potureshë
Është lojë e rrezikshme.

Hasan Aga
Pse atëherë e luajnë të rriturit?

Çika Potureshë
Ata dinë të luajnë.

Hasan Aga
Pse të mos dimë të lozim edhe ne?

Çika Potureshë
Sepse jemi të vegjël.

Hasan Aga
Nuk jemi të vegjël.

Çika Potureshë
Si nuk jemi të vegjël?

Hasan Aga
Lozim e shohim.

Çika Potureshë
Çka të shohim?

Hasan Aga
Shohim se jemi të rritur.

Çika Potureshë
Luajmë po sa të luajmë?

Hasan Aga
Sa të shohim se nuk jemi të vegjël.

Çika Potureshë
Sa të shohim se nuk jemi të vegjël?

Hasan Aga
Po!

Çika Potureshë
Si?

Hasan Aga
Ja kështu... *(shtrin duart ta përqafojë).*

Çika Potureshë
Ik... Mos... Ah...

Hasan Aga
Nuk jemi të vegjël...

Çika Potureshë
Ah, shtrëngomë, shtrëngomë fort, fort, sa të mundesh...

Hasan Aga
Nuk jemi të vegjël...

Çika Potureshë
Ah,...

(Në prapaskenë, pas një kaçube, shihet Haxhuska Plakë. Të gjithë e kanë të qartë se ajo tërë kohën e kishte përcjellë lojën e dy të rinjve, madje ndoshta i kishte dëgjuar edhe fjalët e tyre...).

Hasan Aga
Sa e bukur je, ia kalon edhe hënës pesëmbëdhjetëshe ...

Çika Potureshë
E ti? Ti i përngjet Yllit, Ylberit...

Hasan Aga
Do të luajmë edhe ditëve tjera...

Çika Potureshë
Po nëse rastësisht të vdes çobani! Ha, ha, ha...

Hasan Aga
Mos fol mbrapsht.

Çika Potureshë
Unë vetëm u shegara, por vërtet nëse kthehet çobani juaj, atëherë ku do të shihemi?

Hasan Aga
Buzë lumit, atje, *(tregon me dorë)* tek burimi...

Çika Potureshë
Përditë?

Hasan Aga
Përditë!

Çika Potureshë
Tërë jetën?

Hasan Aga
Po, derisa të martohemi.

Çika Potureshë
Kur, pra, do të martohemi?

Hasan Aga
Kur t`i mbushim nga pesëmbëdhjetë vjet.

Çika Potureshë
Besën?

Hasan Aga

Besën! *(Përqafohen. Shtrëngohen fort njëri për tjetrin. Pas pak një zhurmë në formë të shushurimës së gjetheve i tremb të dy).*

Çika Potureshë

M´u duk se dikush ishte pas kaçube?!

Hasan Aga

Edhe mua m`u duk ashtu, por nuk duhet t`ketë qenë tjetër pos ndonjë gjarpër...

Çika Potureshë

Gjarpër?...

(Errësohet skena dhe njëkohësisht bie edhe perdja).

TABLO E TRETË

(Skena paraqet një dhomë të rregulluar mirë me orendi të stilit oriental. Në një qoshe të minderes, mu skaj dritares, pi me naze kafenë dhe vështron jashtë me sy të përhumbur hanëmja, Nëna e Hasan Agës. Atë e shoqërojnë edhe dy hyzmeqare të shtëpisë, të cilat nuk janë të ulura në minder si zoja e shtëpisë, por janë vendosur mëgjunjazi midis dhomës mbi një qilim të bukur ngjyrë kuqezi. Presin t`i urdhërojë diç, t`i qortojë apo t`u japë ndonjë detyrë të re. Që nga larg dëgjohen këmborët e bagëtisë...)

S k e n a e p a r ë

Nëna Hasan Agës

Jam bërë merak për Hasanin, rrallë e lëshoj në mal për të ruajtur bagëtinë, mirëpo ai dreq çobani iku dje dhe nuk di se kur do të kthehet. Nuk di a të zë tjetër bari për pak kohë, apo ta lë Hasanin ta kryej atë punë...

Hyzmeqarja Parë
Bën si të duash, Hanëm!

Hyzmeqarja Dytë
Ti di më së miri, Zojë!

Nëna Hasan Agës
(Me hidhërim) Bën si të duash hanëm, ti di më së miri Zojë..., hanëm... hanëm..., zojë... zojë..., po ju nuk dini çfarë do të thotë të keni tërë shtëpinë mbi krye.

(Të dy hyzmeqaret dalin me ngadalë jashtë duke drojtur që mos t`i godasë më shumë rrebeshi i fjalëve të Nënës së Hasan Agës e cila pa e vërejtur fare daljen e tyre nga dhoma, vazhdon monologune saj).

Ah,Ymer,Ymer... Ike pa më thënë lamtumirën e fundit dhe u trete pa shenjë e pa dokë. Nuk e di a je i vdekur apo i gjallë po dergjesh diku i lidhur me zinxhirë shkau... Po të kishe vdekur, mbase do të ishte marrë vesh. Lajmi për vdekjen e dikujt saora merr dhenë dhe dëgjohet në të katër anët e botës... Të ishe gjallë, ani, do të gjeje mënyrën për t`më lajmëruar... E mjera unë e mjera, ka nëntë vjet të plota që jam duke u kujdesur vetë për sarajet, tokat, pasurinë tonë... Për nderin tënd dhe për fytyrën time Ymer! Ja, Hasani është rritur. Burrë është bërë! Vërtet ka vetëm nëntë vjet, po sa shumë të ngjet ty Ymer! Edhe pak e do t`i veshë rrobat tua Ymer. Do t`i mbathë çorapet e këpucët e tua Ymer. Pastaj, do t`ia jap shpatën tënde Ymer. Do ta martoj... E inshalla edhe shtëpinë do të ma mbushi përplot me fëmijë...

(Për një kohë hesht. Që nga larg, sërish dëgjohen këmborët e bagëtisë, të cilave iu bashkëngjitet zëri melankolik i një fyelli dhe zërat e çobanëve).

Ja, erdhën barinjtë e tjerë, por Hasani im nuk u kthye ende. E mjera unë, po ma gjen djalin diçka! *(I afrohet sërish dritares dhe shikon përjashta).* Po ma ha ndonjë bishë e egër... Po ma kafshon ndonjë gjarpër... Po e humb rrugën diku dhe po tretet si Ymeri... Po ma rrëmben dikush, apo po ma vret ndonjë shka i pabesë... E mjera unë e mjera... Pse e lëshova vetëm në mal... Pse?

(Në dhomë hyn Hyzmeqarja e Parë)

Hyzmeqarja Parë
Zojë...

Nëna Hasan Agës
A u kthye Hasani?

Hyzmeqarja Parë
Jo Zojë, por...

Nëna Hasan Agës
E mjera unë...

Hyzmeqarja Parë
Zojë...

Nëna Hasan Agës
Dil jashtë!

Hyzmeqarja Parë
Po Zojë... një fallxheshë...

Nëna Hasan Agës
Në dreq të mallkuar edhe ti edhe fallxhesha... Dil jashtë!

Hyzmeqarja Parë
Mirë zonjë... *(Niset të del jashtë për dere, mirëpo pak pa dalë përjashta...).*

Nëna Hasan Agës
Ndal! *(Hyzmeqarja ndalet në prag të derës dhe si e ngrirë qëndron me shpinë të kthyer kah Nëna Hasan Agës)* Fallxheshë, the? Cila fallxheshë? Ka qenë ndonjëherë këtu, apo jo?

Hyzmeqarja Parë
Jo, Zonjë, për herë të parë është në shtëpinë tonë *(i bie gojës me dorë)* pardon, në sarajet tua zonjë...

Nëna Hasan Agës
Le të hyjë.

S k e n a e d y t ë

Hyzmeqarja Parë

(Del jashtë dhe kthehet bashkë me Hyzmeqaren e dytë dhe me Haxhuskën Plakë, e cila e kërrusur dhe me një shkop në dorë mezi ecën).

Haxhuska Plakë

Mirë se të gjej, Zonjë e shtëpisë. Inshalla janë për hajër fjalët e mia dhe... *(I jep shenjë me sy se nuk është në gjendje të flasë në prani të hyzmeqareve)* dhe...

Nëna Hasan Agës

Dilni ju dyja jashtë! *(Të dy hyzmeqaret me përulje dalin jashtë, kurse Haxhuska Plakë ulet në minder karshi zojës së shtëpisë).*

Haxhuska Plakë

Kam të të them një sekret. Një haber për ty Hanëm...

Nëna Hasan Agës

Kështu më kanë thënë të gjitha fallxheshat që më kanë qitur fall deri më tash, por asnjëra prej tyre nuk ja ka qëlluar... Askush deri tash nuk diti të më rrëfejë diç për Ymerin tim e të më ngushëllojë...

Haxhuska Plakë

Por unë me të vërtetë kam të të tregoj diç që do të të interesojë shumë...

Nëna Hasan Agës

Di diçka për burrin tim? Për Aga Ymerin, apo...

Haxhuska Plakë

Jo, Zonjë, por...

Nëna Hasan Agës

Atëherë, pse erdhe?! Të gjitha fallxheshat janë një yrnek. Gënjeni sa mundeni vetëm sa për të marrë bakshishet dhe pastaj

ikni kah sytë këmbët. Ikni atje ku me rrenat tuaja ua zgjatni jetën gënjeshtrave duke përfituar po ashtu nga gënjeshtrat. Dil jashtë...

Haxhuska Plakë
Po unë nuk jam fallxheshë. Unë vetëm se erdha të të jap lajmin dhe të shkoj.

Nëna Hasan Agës
Nuk je fallxheshë, thua?

Haxhuska Plakë
Jo, a nuk më sheh?

Nëna Hasan Agës
Ç`të shoh? Si fallxheshë më dukesh?!

Haxhuska Plakë
Gaboheni Hanëm, unë nuk jam fallxheshë. Dua të të rrëfej vetëm atë që kam parë me këta dy sytë e mi dhe atë që kam dëgjuar me këta dy veshët e mi. E sa për bakshish, ajo është punë e jote...

Nëna Hasan Agës
Fol, pra! Më thuaj çka di për Ymerin?

Haxhuska Plakë
Asgjë!

Nëna Hasan Agës
Asgjë?! Pse erdhe pra tek unë? Çka do të më thuash tjetër? Asgjë tjetër mua nuk më intereson! Asgjë... Ik, ik...

Haxhuska Plakë
E kam fjalën për Hasan Agën.

Nëna Hasan Agës
Për birin tim?

Haxhuska Plakë
Po, Hanëm.

Nëna Hasan Agës
E mjera unë. Ende nuk është kthyer nga mali...

Haxhuska Plakë
?!

Nëna Hasan Agës
Mos e ka ngrënë ndonjë bishë mali? Apo...

Haxhuska Plakë
Jo, jo...

Nëna Hasan Agës
Mos e ka rrëmbyer dikush, mos e ka vrarë...?

Haxhuska Plakë
Jo, jo...

Nëna Hasan Agës
Mos e ka kafshuar ndonjë gjarpër?

Haxhuska Plakë
Jo gjarpër, por gjarpërushe... Ha, ha, ha... Hi, hi, hi...

Nëna Hasan Agës
Pse qeshesh? Ç`i ka ndodhur djalit tim? Hasanit tim të vogël...

Haxhuska Plakë
Ty të duket i vogël, por unë me sytë e mi e pash se ai di të bëjë punë të mëdha... Hi, hi, hi...

Nëna Hasan Agës
Çfar punësh? Me kë?

Haxhuska Plakë
Me Çikën Potureshë!

Nëna Hasan Agës

Çikën Potureshë? Cila është ajo? E kujt është? Çfarë është?...

Haxhuska Plakë

Besa e hijshme është sa s`ka. E zoja si flutur, edhe trime, por...

Nëna Hasan Agës

Por çka?

Haxhuska Plakë

Është e poturëve. Vërtet tash së voni kanë marrë fenë tonë dhe deri diku edhe me idare janë mirë, por thënë të drejtën, zojë, nuk është për Hasan Agën. Dera juaj meriton nuse agallarësh e bejlerësh. Megjithatë, ashtu sikundër e ka shkruar Zoti!

Nëna Hasan Agës

Zoti e ka shkruar atë që do të them unë. Hasani është imi dhe unë do të vendos për të. E kam rritur e vejë, me aq mundime dhe sakrifica, nuk lejoj, jo, që dikush tjetër të ma rrëmbejë nga duart...

Haxhuska Plakë

Megjithatë, Zonjë, mos u ngut...

Nëna Hasan Agës

S`kam çka të mos ngutem! Po ti si i pe, më thuaj?

Haxhuska Plakë

Me këta dy sy i pashë. *(Prekë sytë me gishtat tregues)* Tërë ditën e lume luajtën bashkë.

Nëna Hasan Agës

Luajtën?! Po ç`pritje ti të bëjnë tjetër çamarrokët, pos që të luajnë? A nuk i pe se ende janë fëmijë? Dhe për këtë ke ardhur tek unë të më japësh sihariqin?

Haxhuska Plakë

Po, zojë, por unë i pashë edhe duke u...

Nëna Hasan Agës

Mbylle! Në atë moshë gjithçka është lojë. Gjithçka... *(Kthen kryet nga dritarja).*

Haxhuska Plakë

Po, zojë, por...

Nëna Hasan Agës

Mëshile, të thashë!

Haxhuska Plakë

Zonjë...

Nëna Hasan Agës

Fol!

Haxhuska Plakë

Unë i ndjeva, për besë, i ndjeva ç`flisnin...

Nëna Hasan Agës

Ç`kanë për të folur fëmija?

Haxhuska Plakë

Ata lidhën besën me njëri-tjetrin.

Nëna Hasan Agës

Besën?! Çfarë bese lidhin fëmija, oj?...

Haxhuska Plakë

Ata, Zonjë, lidhën besën që kur t`i mbushin nga pesëmbëdhjetë vjet, të martohen me njëri-tjetrin dhe nga kjo besë nuk mund t`i ndajë askush përveç vdekjes...

Nëna Hasan Agës

Askush?! Hë, dreq o punë! E unë kisha frikë mos ma ka gjetur diçka e keqe djalin, kurse shejtani i vogël u merrka me dashuriçka! Madje lidhka edhe besë! Hajt se do ta shohim punën e "besës". *(Dëgjohet rrapëllimë e dyerve të oborrit, zhurma e këmborëve të mështjerrave dhe zëri i Hasan Agës)*. Po vjen

"dylberi", "jarani", "ashiku" i vogël... *(Kthehet kah Haxhuska Plakë).* Ti dil jashtë sa nuk të ka parë...

Haxhuska Plakë

(Shtrin dorën me të shpejtë për të marrë bakshishin dhe ikën me të shpejtë duke i fërkuar paratë për mjekre) Mirupafshim, Hanëm!

S k e n a e t r e t ë

Nëna Hasan Agës

Ik tash... *(Ia bënë me dorë Haxhuskës Plakë dhe ulet në minder si e pasherr, thua se nuk di asgjë dhe porositë një kafe nga hyzmeqaret)*

Hyzmeqarja Dytë

Urdhëro kafen, Zonjë... *(Kthehet pak më shpejtë se zakonisht për të dalë jashtë).*

Nëna Hasan Agës

Hej, Ti!

Hyzmeqarja Dytë

Urdhëro, Zonjë.

Nëna Hasan Agës

Ma thirr Hasan Agën këtu.

Hyzmeqarja Dytë

Mirë.

Hasan Aga

(Hyn i gëzuar në dhomë, përqafon të ëmën) Çka ke nënë që je kaq mazun?

Nëna Hasan Agës

Si çka kam o djali jem, pa izë temen ti do m`u martue!

Hasan Aga

Hajt, bre nënë, ti merak mos u bënë, kur të vijë koha edhe ty t`kisha kallxue, se me Çikën Potureshë jam besatue...

Nëna Hasan Agës

(Me qortim) S`e du, djalë, more, Çikën Potureshë! Ta nxa nana nusen prej oxhaku, ta nxa mikun, loke, prej konaku. S`ka ditë nana për martesë qi je ba, moti nana ty t`kisha martue.

Hasan Aga

Hala, nanë, për martesë unë nuk jam, veç mu m`pret, nanë, Çika Potureshë, tjetër grue, lum nana, nuk due.

Nëna Hasan Agës

Ah, qen, qeni... *(I vërsulet me shkop Hasan Agës i cili me të shpejtë del jashtë. Errësohet skena dhe bie perdja)*

TABLO E KATËRT

(Atmosferë dasme. Skena është e rregulluar ashtu që përnjëherë shihen dhoma e mysafirëve, ajo e nuses si dhe korridori me një pjesë të ballkonit dhe të oborrit. Hasan Aga i veshur solemnisht me rroba dhëndërie, bashkë me dy shokë, mocanikë të tij, ecën i habitur si i pakokë herë në njërin kënd të skenës e herë në këndin tjetër. Nganjëherë e takojnë ndonjë grua apo vajzë e cila ngutet pas ndonjë pune... Edhe pse dasmë, në njëfarë mënyre, konaku duket i zbrazët, meqë shumica e dasmorëve, gra e burra, kanë shkuar për të marrë nusen).

S k e n a e p a r ë

(Hasan Aga dhe dy shokët moshatarë të tij)

Shoku I

Mirë kaloi dasma, tash po e presim nusen.

Shoku II
Thonë se është e bukur si hëna pesëmbëdhjetëshe!

Shoku I
Dhe nga derë bejlerësh.

Shoku II
Lumi ti, o Hasan Agë!

Shoku I
Lum, besa!

Hasan Aga
Lum si unë mos bëfshi kurrë o, shokët e mi!?!

Shoku I
Pse?

Shoku II
Ç`po flet kështu jerëm o, Hasan Agë!?

Hasan Aga
Nuk po dyshoj se a është nusja e bukur e as se është nga derë e mirë, po unë besën, bre shokë të mi, tjetër kujt ia kam dhënë..

Shoku I
Çka?

Shoku II
Besën?!

Hasan Aga
Ka shtatë vjet që jam besatue me Çikën Potureshë, o shokët e mi, ka shtatë vjet që për martesë, njëri tjetrit besën ja kemi dhënë. Veç të vdekur...

Shoku I
Po vijnë..., po vijnë krushqit... *(Që nga larg dëgjohet muzikë e gëzuar dasme).*

Shoku II

Eja, Hasan, t`i presim te dyert e oborrit. Ashtu zakoni e lyp ndër ne!

Shoku I

Leji, Hasan, pallavrat e fëmijërisë, po çfarë "bese" mund t`lidhin fëmija!? Nusen që të kanë zënë nuk e ka kush, Po edhe Çika Potureshë, diku e ka kësmetin...

Hasan Aga

Ah, bre shokë!.. *(Të dy shokët e kapin për krahësh dhe nisen kah dyert e oborrit).*

S k e n a e d y t ë

(Hasan Aga, Shoku I, Shoku II, dasmorët, nusja, Nëna Hasan Agës, djemtë e çikat e mëhallës...)

(Ndihet muzikë dasme, gëzimi ka arritur kulmin tek të gjithë dasmorët. Shumica prej tyre ndjehen si në delirium dhe tashmë nuk dihej se cili udhëhiqte vallen e cili shkonte pas kryevallëzuesit. Për një çast në krye të valles gjendet Nëna e Hasan Agës. E gëzuar tejmase ajo heq vallen kurse të tjerët i shkojnë pas... Vetëm Hasan Aga është i mvrenjtur dhe shumë i pikëlluar. Më kot përpiqen të tjerët ta fusin edhe atë në valle. Ai kërkon mënyrën se si t`i shmanget pranisë së të tjerëve... Dëshiron të struket diku në mbretërinë e vetmisë së vet...)

Shoku I

Eja, Hasan, futu në valle!

Shoku II

E sheh sa gëzim të madh kemi për ty.

Shoku I

S`ke nga kush të turpërohesh më... Nuk është kohë e moçme kur dhëndurët janë fshehur nga dasmorët...

Hasan Aga
?!

Shoku I
Ti nuk je Rexha i Nonës...

Shoku II
Ke marr nuse si hëna pesëmbëdhjetëshe.

Shoku I
Në shtatë krajli s`i gjendet shoqja.

(Hasan Aga del krejt nga dhoma, kurse të tjerët edhe për një kohë vazhdojnë ahengun. Më pastaj, muzika heshtet. Në dhomën e dhëndërisë shihen vashat se si e vendosin nusen në qoshe. Nusja, së cilës tashmë ia kanë hequr duvakun nga fytyra, duket shumë e bukur. Pak më vonë, në korridor shihen grumbuj dasmorësh të tjerë, moshash e gjinishë të ndryshme, të cilët e sjellin Hasan Agën tek nusja për ta futur dhëndër).

Shoku I
Prej natës sontit, Hasan, po bëhesh burrë.

Shoku II
Lumi ti për vete.

Shoku I
Ke marr nuse të bukur. Në shtatë krajli s`i gjendet shoqja.

Shoku II
Nga derë bejlerësh më.

Shoku I
E ke pasur mësitin e fortë. Po besa edhe nëna jote ia ka nxehur xhepin mirë!

Shoku II
Për Hasanin s`ka qenë nevoja. Po kush nuk do të kishte dëshiruar të ketë një dhëndër si ky, nga derë e madhe e të...

(Grumbulli dasmorëve, para se ta fusin dhëndërin në dhomë të nuses, në prag të derës i vënë një filxhan të cilin ai e then me një të mëshuar me këmbë, kurse të tjerët, e fusin brendë Hasan Agën, duke i rënë shpinës me dorë e kush si mundet, ashtu sipas zakonit. Në dritaren që lidhë dhomën e dhëndrit me korridorin, shihen mirë se si bisedojnë Nusja e Hasan Aga, kurse tek dera e dhomës kanë vënë veshin dhe përgjojnë disa të rinj e të reja. Në mesin e tyre shihet edhe Haxhuska Plakë...

Në ndërkohë dëgjohet kënga: " ... - Ç`ki, bre djalë, marak shum qi je ba, a po t`doket nusja fort e keqe, a po t`doket çeiz qi s`t`kam prue, a po t`dhimet harxhi ty për darsëm? Dogri due, djalë bre, me m`kallxue! As e keqe, bre bijë, nuk po m`dokesh, për çeiz n`mendje nuk po m`bjen, as për darsëm harxhi nuk po m`dhimet - (ja) kam dhanë besën Çikës Potureshë ..."

Lëshohet perdja e dritares së dhomës së dhëndërit. Kënga dëgjohet edhe më... Skena errësohet ngadalë në tërësi. Mbretëron një heshtje totale...

Përnjëherë ndriçohet skena e shoqëruar nga një piskamë trishtuese... Të rrahura daullesh jo të zakonshme, paralajmërojnë kobin që ka ndodhur! Shihet tollovi e jashtëzakonshme. Pështjellim i shoqëruar edhe me efekte dritash të reflektorëve, edhe me muzikë.

Nusja Hasan Agës shihet e ngrirë në prag të derës së dhomës. Letrën e Hasan Agës, të shkruar me gjakun e tij, e mbante në dorë... Errësim i sërishëm i skenës...).

S k e n a e t r e t ë

(Të gjithë dasmorët, tash shihen të rreshtuar duke e bartur kufomën e Hasan Agës. Daullet bien pa pushuar, ashtu siç e kishte lënë amanet Hasan Aga. Kortezhi zvarritej ngadalë me një dhembje të madhe...

Sërish ndjehet jehona e këngës: " ... Ori nane, kurr s`kam pa kshtu namë - hem se darsëm, nane, hem xhenaze, hem se krushqi, nane, hem xhematë!... Amanet, bre krushq edhe xhematë, qit xhenaze qitu me ma ndalë, po kam qef, more, sall ni herë m`e pa! ...").

Çika Potureshë

(I del para xhematit) Ndalni krushq, se një fjalë Hasanit du t`ja them!.. *(Kortezhi ndalet. Kufomën e Hasan Agës e lëshojnë ngadalë në tokë. Çika Potureshë ia zbulon fytyrën. E lëmon me dorë. E puthë në ballë...)* E, Hasan, more Hasan Agë, po sa mirë ti besën e mbajte! Vetëm vdekja, pate thënë, ne mund të na ndajë, po as vdekja Hasan s`do t`na ndajë... *(Nxjerr thikën nga brezi dhe i bie vetit mu në zemër. Pranë kufomës së Hasan Agës shtrihet edhe një kufomë tjetër, ajo e Çikës Potureshë. Tërë ngjarjen e përcjell një muzikë e dhembshme dhe trishtuese... Skena errësohet gati në tërësi. Pas pak zë e zdritet pak. Krushqit shihen si të ngrirë. Të palëvizshëm... Gjithçka është në gjendje të mëparshme vetëm se janë zhdukur që të dy kufomat...)*

S k e n a e k a t ë r t

Kalimtar Rasti

(Me zë të lartë) Stop, stop!.. Nuk bënë, nuk është mirë kështu... Me daulle, me muzikë në varrim...

Narratori

Ashtu e thotë balada, hej...

Kalimtar Rasti

Balada!? Cila baladë, ore, kush është autor i saj?

Narratori

Krijuesi Popullor...

Kalimtar Rasti

Do të ketë qenë ndonjë shkrimtar muti si ti...

Narratori

Mbylle të thashë!

Kalimtar Rasti

Po ku ke parë ti të varrosen njerëzit me tupana e me zurle?

Narratori
Amaneti...

Kalimtar Rasti
Ë...

Narratori
Ashtu e kishte lënë me gojë Hasan Aga...

Kalimtar Rasti
Ku e din ti ore kokëbosh?

Narratori
Letrën që e shkroi Hasan Aga me gjakun e vet...

Kalimtar Rasti
Cilën letër? Ku e ke parë ti?

Narratori
Ashtu e thotë kënga, hej...

Kalimtar Rasti
Kënga?! Po ti veç këngë di të këndosh dhe... Raki të pish di... Asgjë tjetër nuk di ti... Asgjë... As tekstin që ta kërkova nuk dite t`ma bësh...

Narratori
Fajet i ke ti. Ti nuk je kurrfarë regjisori. Mut je ti. Nuk di ta vësh në skenë një dramë të thjeshtë e cila ka për temë tragjiken e një balade popullore...

Kalimtar Rasti
Dramë i thua ti kësaj? Unë jam regjisor i vlerave, hej... jo i...

Narratori
(Kthehet në anën e kundërt te narratorit dhe ecën si i shtanguar me dorën e ngritur përpara duke treguar diç me gishtin tregues) Ja, varret... Varret... Aty pushon Sulejman Brahimi, atje Avdia i Motrës, Rexha i Nonës... Konstandini... Hasan Aga e Çika

Potureshë... I shihni trëndafilat që kanë luluar mbi varret e tyre... Po kaçën me thera që iu është futur midis?...

(*Skena errësohet ngadalë, kurse muzikën e lehtë dhe të dhembshme e përcjell zëri i një qyqeje që këndon diku afër dhe krrokamat e ca korbave diku në largësi... Kur ndriçohet skena, dëgjohet vetëm kënga e Hasan Agës dhe Çikës Potureshë, ndërkaq skena është krejtësisht e zbrazët. Edhe pasi bie perdja, dëgjohet kënga. Ajo vazhdon edhe gjatë kohës kur aktorët dalin para publikut për t`u përshëndetur...).*

F u n d

Preshevë,
më 4 - 9 korrik 1996

STUDIMORE

DETARI

Maksud HAXHIBRAHIMI

SERVANTESI DHE FRANSUA PUKËVILI ISHIN ROBË TË PIRATIT ULQINAK, URUÇ ALIUT (ULLUZH ALIUT)

Beteja detare të Lepantit u zhvillua më 7 tetor 1871. Kjo ishte beteja më e madhe detare e cila u zhvillua në detin Mesdhe midis botes së krishtere dhe asaj osmane, ku morën pjesë 438 anije ndërluftuese. Për shkak të paftësisë së admiralit osman, Myezzinzade Ali Pashës, 200 anije osmane u fundosen, më ç'rast 20000 ushtarë osmanë u mbyten. Kjo, në të vërtetë, ishte disfata e parë dhe më e rende e flotës osmane. Kësaj radhe edhe vetë admirali i flotës u mbyt. Vetëm flota e Uruç Ali Reisit, e përbërë prej 40 anijesh, shpëtoi dhe iku për në Stamboll. Ndërkaq, të krishterët kishin humbje më të vogla. Në këtë betejë të shquar, si pjesëmarrës i luftës, plagoset edhe shkrimtari spanjoll Servantesi, autori i veprës së mirënjohur "Don Kishoti". Kjo humbje e madhe e flotës osmane, megjithatë, nuk e then moralisht sadriazemin, Sokollu Mehmet Pashën. Ai admiral të ri (*kaptan* – i *derya*) e emëroi Uruç Aliun, i cili pat sukses t'i shpëtojë anijet e veta. Sadriazemi ia ndërroi emrin Uruç Aliut, duke e pagëzuar me emrin - KILIC (shpatë) ALI.

Prej vitit 1571, Ulqini, i cili më herët (viti 1533) përmendet si vendstrehim i detarëve nga kusarët, bëhet vatër e fuqishme e kusarëve dhe të gjitha anijet tregtare lundronin larg ujërave të tij. Në Ulqin fillon edhe tregu i robërve dhe, sipas disa gojëdhënave a legjendave, këtu u shit si rob shkrimtari i njohur spanjoll Servantesi i cili, në Betejën e Lepantit, e pat humbur njërën dorë.

Më 25 shtator 1575, derisa Servantesi më vëllanë Rodrigon, kthehej nga Napoli në Spanjë, anija u sulmua nga disa galera kusarësh që ishin nën urdhër të një renegati shqiptar, të quajtur Memi (Arnaut Memi) dhe u zunë robër. Ka gjasa, pra, që Servantesi të jetë zënë rob nga ndonjë kusar shqiptar ulqinak dhe, gojëdhëna e legjenda mbi robin Servantes në Ulqin, mos të jetë e

pabazë. Kështu, në traditën gojore të Ulqinit, bëhet fjalë për një njeri të ditur, që dikur moti kishte jetuar në Ulqin, pra për dashurinë idilike mes ashtuquajturit *Servetit* me kalaleshën e bukur ulqinake. Ka mendime se gojëdhëna mbi dashurinë e Servetit me kalaleshën është një modifikim dhe adaptim i mëvonshëm i ndonjë legjende më të hershme për Servantesin e famshëm.

KUSARËT DHE DETARËT ULQINAKË KANË SJELLË ZEZAKË SI ROBËR

Edhe pse kusaria e Ulqinit përmendet që nga shekulli XIV, legjendat kryesisht flasin për një kusari më tipike, me vendosjen në këtë qytet, siç thuhet, të 400 pirateve arabe, kryesisht algjerianë, që nga gjysma e dytë e shekullit XVII, apo prej vitit 1669 (pas Luftës Kandike). Nga koha e lulëzimit të kusarisë, Ulqini njihet edhe si treg i robërve dhe si vend i rrallë ku kusarët dhe detarët ulqinakë kanë sjellë zezakë si robër, për nevoja detare, si marinarë, peshkatarë, por edhe për punë të tjera në shtëpi. Familjet ulqinake detare, të cilat prestigjin e vetë e kanë pasur edhe për nga posedimi i zezakëve në shërbimin e tyre, kryesisht i kanë trajtuar zezakët si anëtarë të familjeve të veta, *si njerëz të lirë* e *jo si robër*. Atyre u kanë dhenë çifliqe, mbiemrat e familjes dhe u kanë mundësuar krijimin e familjeve. Në platonë e epërme të Kalasë së Ulqinit, menjëherë prapa Muzeut, gjendet Kulla e Balshajve. Përpara është një shesh i vogël, që dikur ishte Sheshi i Skllevërve apo Sheshi i Zezakëve skllevër (afrikanë), i rrethuar me kazamatet (burgjet) e revelinit. Në hyrje është *luara e revelinit*, kurse për ballë saj është muri i lartë Johani Bolani, nga koha e Venedikut. Zezakë skllevër (afrikanë) ka pasur gjithmonë në Ulqin. Ata vihen në dukje dhe në fund të shekullit XIX, si edhe në fillim të shekullit XX. Ata shërbenin nder tregtarë, deri para Luftës së Parë Botërore. Zezakët, skllevër zakonisht janë sjellë nga tregtarët ulqinakë, të cilët me anijet e tyre përshkojnë, në shekullin e kaluar, skelet e Adriatikut dhe të Mesdheut, duke bërë edhe tregtinë e skllevërve. Gojëdhënat thonë së skllevërit mblidheshin më tepër në Afrikën Veriore dhe në Arabinë Saudite. Preferoheshin më tepër fëmije të vegjël, të moshës 3–4-vjeç. Këta fëmijë rriteshin dhe trajtoheshin si njerëzit e shtëpisë

në Ulqin. Ata janë rritur si bijtë e shtëpisë dhe janë martuar rregullisht, femrat duke i pajisur edhe me pajë, njëlloj si vajzat e pronarit. Ne mundëm të hetojmë disa raste skllavesh ndër tregtarë e pasanikë të qytetit, të cilët mbahen mend dhe kanë jetuar deri në kohët e fundit. E njohur ka qenë mamia arapeshë, Zejnepe, që ishte skllave e Hafiz Abaz Golemit etj. Në kohën e kusarisë, piratët e Ulqinit merreshin edhe me tregti me skllevër të zezë. Tripolisi (Tarabulusi) ishte liman kryesor eksportues, në të cilin bliheshin skllevërit nga viset e ndryshme të Afrikës Veriore. Kusarët dhe tregtarët i shitnin skllevërit ose i linin që të punonin në pasuritë ose në anijet e tyre. Deri në vitin 1878, në Ulqin jetonin 100 familje zezake. Kishte edhe zezakë që vinin si të lirë në Ulqin. Zezakja Zahra, me prejardhje nga Sudani, u martua me ulqinakun, kapidanin detar, haxhi Halil Ficin, major i ushtrisë turke. Më vonë, zezakët gëzonin më shumë liri në Ulqin. Dy prej tyre, për shembull, ishin edhe kapitenë të anijeve. Në kodrën e Pinjeshit është edhe fusha që e mban emrin "*Fusha e Harapëve*". Aty tuboheshin zezakët dhe luanin lojëra të tyre rituale. Lidhur me këto lojëra është krijuar edhe loja temperamentë "*Sharaveli*", si kombinim i melosit dhe ritmit vendës të Ulqinit dhe melosit e ritmit afrikan, që luhet edhe sot në një formë të modifikuar. Në atë kohë ekzistonte edhe kafeneja "*Trumo*" që quhej edhe "*Kafja e harapeve"* (e zezakëve), sepse pronarë dhe shërbyes ishin vetëm zezakët. Çdo sulm të kryer me sukses në ndonjë anije, kusarët e kremtonin pas kthimit me festë të bujshme në gjirin në Ranë (Plazhi i Vogël). Në kazanë të mëdhenj zihej hallva, që përzihej me rrem. Me rrem kusarët e ndanin edhe thesarin e plaçkitur nga anijet e Venedikut, të Austro–Hungarisë, të Dubrovnikut, e ndonjëherë edhe të Turqisë, edhe pse lundronin nën flamurin e Turqisë. Haxhi Halil Fici, si kapidan (detar dhe tregtar) solli në Ulqin disa zezakë nga Sudani (Afrikë). Ai në vende të Afrikës shkonte për tregti. Prej këtyre zezakëve shumica ishin femra. Haxhi Halil Fici ishte gjysh prej nene i Tofik Bilalit, nga Ulqini. Si detarë të aftë, ulqinakët preknin me velanijet e tyre tërë Mesdheun, madje kalonin edhe përtej Gjibraltarit, kapnin brigjet perëndimore të Afrikës, prej nga sillnin edhe zezakë, që shërbenin si piratë në anijet e tyre, kurse më vonë më rënien e kësaj veprimtarie qenë shndërruar në shërbëtorë të tyre. Këtë e vërteton edhe tradita gojore e përcjellë brez pas brezi, si dhe dokumentacioni arkivor. Ulqinaku Ali Basha, në vitin 1770, ka

sjellë nga Egjipti dy robër, kurse një grup ulqinakësh, që ishte kthyer më 1775, solli më vete 13 robër zezakë. Fransua Pukëvili ishte mjek dhe nëntë vjet rresht (1806 – 1815) qëndroi si konsull i Francës në Janinë, pranë Ali Pashë Tepelenës. Pasi u kthye në atdhe (Francë), ky botoi dy vepra të rëndësishme: "Udhëtimi nëpër Greqi" dhe "Historia e Rilindjes së Greqisë", të cilat së bashku përbënin gjithsej 10 vëllime. Veprat e Pukëvilit s'ka dyshim se kanë vlere edhe për në, për studimin e mjaft problemeve të albanologjisë, si ato të historisë së lashtë dhe të re, të gjeografisë, të çështjeve të historisë qytetare dhe agrare, të toponomastikës dhe të disiplinave të tjera shoqërore të përafërta.

Për veprat heroike, trimëri apo punët heroike që benë kusarët ulqinakë, u trashëguan shumë gojëdhëna a legjenda e anekdota. Një rast i tillë, por interesant, lidhet me shkrimtarin dhe mjekun francez – Pukëvilin. Pukëvili ishte zënë rob në një rast të lundrimit të tij, nga ana e piratit të njohur ulqinake – Uruç (Ulluzh) Alisë. Pukëvili ngjitet, në fillim të vitit 1798, në velanijen të tipit "tartanë" nga Livornoja, e quajtur "*Madonna di Monte Negro*". Ai niset me anije prej Aleksandrisë për në Itali. Ata arritën pranë brigjeve të Kalabrisë, natës së datës 25. XI. 1798, të cilët në gjirin *Squillace*, i sulmoi anija kusare, në të cilën ishte kapidani ulqinak - Uruç (Ulluzh) Alija. Pasi që anija ulqinake, në krye me kapidan Uruç Aliun, Pukëvilin dhe të tjerët i drejtuan në burg të Tripolit, prej të cilit, në vitin 1799, ishte transferuar në Stamboll, ku lypset të jetë i dëbuar dy vjet, në një kështjellë – *Sette Torri*. Me intervenimin e Qeverise Franceze, Fransua Pukëvili u lirua nga burgu dhe dëbimi, dhe u kthye në Paris, në vitin 1801.

Kusaria e Ulqinit, me gjithë ngjyrimet legjendare që mund t'i këtë marrë në rrjedhën e kohës, është në thelb një realitet që këtë qytet e ka karakterizuar që nga koha ilire, më të gjitha baticat e zbaticat e jetës gjatë kohës kur në të janë ndërruar sundues të ndryshëm, gjatë kohës së aspiratave të pushtuesve të huaj. Ulqini, megjithatë, e ka ruajtur vazhdimësinë e jetës detare dhe lulëzimin e detarisë në shekullin XVII – XVIII disi shkon krahas me lulëzimin e kusarisë, me një dallim që këtë të fundit. Porta, duke qenë e rrezikuar edhe nga kusarët e famshëm ulqinakë, pas Luftës së Moresë filloi ta zhdukte piratërinë.

GJENEALOGJI

Jahja DRANÇOLLI
(Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë, UP)

TË DHËNA MË PAK TË NJOHURA PËR HISTORINË E FAMILJËS BEGOLLI

Në kërkim të gjenealogjisë shqiptare

Gjenealogjia dhe prosopografia, si shkenca themelore ndihmëse e historisë, por edhe shkencat e tjera ndihmëse të historisë, për shkaqe të deficitit të dijës, por edhe për shkaqe të politikës së ditës, nuk është praktikuar pothuaj fare në shkencat tona humanistike dhe shoqërore. Në aspektin gjenealogjik kanë mbetur të patrajtuara edhe shumë familje bujare arbërore gjatë mesjetës, por edhe gjatë periudhës moderne. Ky kontekst deficitar, por edhe politik, ka ndikuar edhe në trajtimin jo vetëm të prejardhjes së kryezotërinjëve Begolli nga Peja, por edhe të familjeve bujare të tjera, të cilat i kanë dhënë Shqipërisë dhe Kosovës, personalitete të shquara deri në ditët e sotme.

Historiografia jonë nuk e ka trajtuar sa duhet çështjen e historisë së trojeve shqiptare gjatë historisë, të cilat sot gjenden jashtë kufirit politik të Shqipërisë. Së këtejmi, jo vetëm territori i sotëm i Republikës së Kosovës, por edhe territoret shqiptare të Maqedonisë dhe Malit të Zi ndodhen jashtë kornizave të historisë së popullit shqiptar.

Në këtë kontekst, kanë mbetur të patrajtuara pothuaj fare edhe formacionet politike shqiptare në shekujtë e sundimit osman, formacione këto, sikurse ishin Pashallëku i Pejës në krye me Mahmut Pashë Begollin, Pashallëku i Prishtinës me familjen shqiptare Gjinolli, ai i Tetovës me Mehmet Pashë Derrallën, i Rrotllajve të Prizrenit, si dhe të ndonjë familjeje tjetër bujare po ashtu të njohur.

Me këtë rast, unë do t'i sillëm vetëm një segmenti historik, që ndërlidhet me prejardhjen e Begollajve. Tabelat gjenealogjike kushtuar Begollajve ose më mirë për të thënë qemtimet për prejardhjën e tyre deri më sot, janë mbështetur më tepër në histori

gojore. Interesi ynë, për këtë çështje, është përqendruar në hulumtime të gjenealogjive të njohura, si, bie fjala, "*Chroniques Greco-Romanes*" të Charl Hopf-it, "*Illyricum Vetus et Novum*", "*Familiae Byzantine*", të Caroli Du Fresne Domini Du Cange, si dhe "*Gjenealogjia e Shtëpisë Muzaka*" nga Gjon Muzaka (Hopf, Charles, *Chroniques Gréco-Romanes*, Berlin, Librarrie de Weidmann, 1873), si dhe në burime të pabatuara dhe të botuara të kohës, të përmbledhura në ato latino-italiane, osmane dhe sllave. Nga gjithë kjo lëndë e konsulltuar me vite të tëra rezultojnë vetëm disa burime të drejtpërdrejta, ndërkaq pjesa kryesore e tyre, duke përdorur metodën komparative, ndriçojnë vetëm tërthorazi çështjën që e kemi në shqyrtim.

Një burim i drejtpërdrejtë, që mua më pëlqen më tepër t'i referohem, është dokumenti që mban datën 1 shtatorit 1750 dhe ruhet në fondet e *Archivio di Stato di Venezia*, *Cinque Savi alla Mercanzia* (Arkivi Shtetëror i Venedikut, konsujtë e Shkodrës). Aty, mes tjerash, thuhet: "Njoftime të tjera nga bota nuk ka veçse luftimi i madh që ndodhi në Fushë-Kosovë midis Hoda Verdi Pashës, komandant i tanishëm i Dukagjinit dhe Ali Pashës nga Gjakovës dhe dy pashallarëve të tjerë vëllezër [...]. I njëjti Hoda Verdi Pashë Mahmud Beg Ogllu është nga ajo shtëpi shumë e nderuar nga e cila e *ka prejardhjen shtëpia Bolica që gjendet në Kotorr* në radhët e bujarisë lartë" ("[...] *Questo Hoda Verdij Passà Mahmut Begh Ogli è di quella Casa cospicua dà cui à orrigine la Casa Boliza esistente à Cataro in grando di Nobilità*").[1]

Kush ishin pjesëtarët e familjës bujare Bolizza?

Familja aristokrate Bolica (*Bolizza*, *Boliça*, *Bunalica*, *Buualiça*), në Historinë e Kotorrit është sigurisht njëra ndër më të

[1] Archivio di Stato di Venezia consoli di Scutari, li 11 settembre 1750; ***Relatione et descrittione del sangiacato di Scuttari, dove si ha piena contezza delle città et siti, loro villagi, case et habitatori, rito, costumi, havere et armi di quei popoli, et quanto di considerabile minutamente si contenga in quel ducato, fatta da Mariano Bolizza, nobile di Cattaro***, in: F. Lenormant, ***Turcs et monténégrins***, Paris 1866, pp. 286 -330; in: Š Ljubić, in: ***Starine***, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Zagrabiae, 1880-XII, pp. 164-205; dhe, in: I. Zamputi, ***Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shekullin XVII***. vol. 1, Tiranë 1963; R. Elsie, ***Early Albania, a Reader of Historical Texts, 11th - 17th Centuries***, Wiesbaden, 2003, pp.130-169

vjetrat dhe më të shquarat. Rreziqet, të cilat kishin përfshirë shumë shpesh këtë qytet me pozitë të jashtëzakonshme kishin ndikuar të ruhen shumë pak kujtime nga kohërat e lashta edhe për këtë familje.

Megjithatë, kur jemi te familja Bolica dhe prejardhja e Begollajve nga familja në fjalë, duhet vënë re se, pjesëtarë të familjës Bolica, sipas dokumenteve që zotërojmë kanë ruajtur marrëdhënie me Pejën, që nga fillimet e shekullit XIV. Sipas një regjistrimi të popullatës së Kotorrit nga vitit 1553, familja Bolica i numronte 74 anëtar. Ajo, në shekuj kishte ruajtur stemën e vetë, kishte dhënë shumë ipeshkëv, shkencëtarë, juristë, shkrimtarë, poetë, profesorë dhe kalorës të merituar. Për historinë tonë më i rëndësishmi padyshim ishte *Marian Bolica*, i cili, duke qenë njohës i shkëlqyeshëm i trojeve shqiptare nën osmanët, në vitin 1614 kishte përpiluar një "*Realacion dhe përshkrim për Sanxhakun e Shkodrës*",[2] sanxhak ky, i cili përveç Malit të Zi, përfshinte: Shkodrën Ulqinin, Tivarin, Plavën dhe Podgoricën. Është fjala për një burim shumë të çmueshëm për histori, gjeografi, demografi, etnologji dhe për çështje politike. Një kopje origjinale e këtij realacioni sot ruhet në bibliotekën Paravia të Zarës, ndërkaq kopja tjetër në bibliotekën e Shën Markut në Venedik (Marciana).

Një tjetër pjesëtar i kësaj familjeje ishte *Gjon Bolica - Bona* (? – 1572). Vepra kryesore e tij është *Përshkrimi i Kotorrit*, të cilën ia kishte kushtuar poetit arbëror, latinistit Elia Zguri nga Kotorri. Është për të vënë re se, një pjesë e familjes bujare arbërore Zguri, me origjinë nga Kotorri, që nga shekulli XV ishin ngulitur në qytetin e Venedikut. Vargjet e tij, siç thoshte ai, ishin të udhëhequra nga muzat ilire.

Në mesin e pjesëtarëve të familjës Bolica i ndeshim edhe dy personalitete të shquara në lëmin e shkencës dhe arsimit. Është fjala për gjysh e nip, që të dy me emër *Nikollë*. I pari ishte caktuar në vitin 1549 për rektor në Universitetin e Padovës, ndërkaq i dyti pasi që ishte shquar për ligjerues të shkëlqyeshëm, po në këtë universitet, në vitet 1593-94 ishte emëruar për rektor. Në objektin e vjetër universitar, respektivisht në Pallatin Bo, në Padova, për meritat e tij edhe sot ruhet një pllakë mermeri me mbishkrim.

[2] "Descrizione del Montenegro, Scutari, Antivari e Dulcigno con le loro adiacenze"

Është për t'u theksuar se, për disa pjesëtarë të kësaj familjeje ka mjaft lëndë të pabatuar, sidomos në arkiva, biblioteka e muzeume të Kotorrit, Zarës e Venedikut.

Edhe pse Begollajt kishin përqafuar islamin dhe kishin arritur status të lartë në shoqërinë osmane, prejardhja e tyre shqiptare asnjëherë nuk është kontestuar nga studiues seriozë, meqë si të tillë i kanë ndeshur jo vetëm në dokumente latino-italiane. P. sh. Mahmud pashë Begollin e ndeshim me apelativa, *Principe Albanese*, *Mahmut begh Albanese*.[3] Dokumentet venedikase ose raguzane, ndërkaq të njejtin e quanin *Bassa d'Albania*.

Derisa, dilemat për prejardhjen etnike të Begollajve nuk janë të diskutueshme, në anë tjetër, për prejardhjen etnike të familjes bujare kotorrase Bolizza, nuk është diskutuar pothuajse fare, duke i konsideruar ata për familje të lashtë romane, e cila gjatë sundimit të dinastive sllave edhe në qytetet e Bokës së Kotorrit, pjesërisht iu kishte nënshtruar sllavizimit. Më pastaj, një pjesë e vogël e sllavizuar e familjës kishte zënë të parqitet me kalkën sllave *Bivoljičić* dhe *Grbičić*.

Është e njohur se Ilirët mu në Bokë të Kotorrit kishin themeluar formacione të para politike-shtetërore të qëndrueshme. Po ashtu kishin lënë mjaft gjurmë kulturo-historike deri në mesjetën e hershme, periudhë kjo e transicionit të ilirëve në arbër. Përveç Teutës dhe mbretit Balaj, të cilët rezidonin në Rizan të Grykës së Kotorrit, aty ndeshim në gjurmë të gjuhës ilire, respektivisht arbërore, si dhe ofiçinë të pasur të monedhave ilire. Ky kontinuitet iliro-arbëror është ruajtur gjatë gjithë mesjetës, që është shprehur sidomos nepërmes të religjionit, arteve figurative dhe mbi të gjitha pranisë së popullatës arbërore këtu, çështje kjo të cilën e kamë trajtuar më së njëherë.[4]

Boka Kotorrit, me seli në Kotorr, në vitet 1420-1797, shpesh në burimet venedikase ndeshet me nocionin, "*Arbëria Venedikase*". Kjo madje bëhet edhe termi zyrtar për zonën venedikase të asaj pjese të Adriatikut. Para se gjithash, lypset përkujtuar se territori i Arbërisë, për një territor më të gjerë

[3] S. Bizozeri, La Sagra Lega contro la Potenza Ottomana, Milano, MDCXC; C. Contarini, Istoria della Guerra di Leopoldo Primo Imperatore e de Principi collegati contro il Turco, Parte seconda, Venezia, MDCCX.

[4] J. Drançolli, Iliro-arbërit në Mal të Zi gjatë antikitetit dhe mesjetës, in: Në një cep të Ilirisë, Monografi e shqiptarëve në Mal të Zi, ed. Anton K. Berisha, Ulqin, Art Club, pp. 1014.

arbëror, ndahet edhe shumë më herët se sa dominimi venedikas, në qindvjetshin XIV, në burimet e huaja dhe vendase në konteste të llojllojshme dhe për treva të nduarnduarta, veçmas lidhur me Zetën dhe Bregdetin. Në atë epokë, sigurisht kjo është shenjë e përzerjës së dukshme etnike të popullatës, e cila, sipas analizave të ndonjë studiuesi serioz ka jetuar bashkërisht "pa paragjykime etnike dhe nacionale". Ndaj mund të përdoreshin nocione të llojllojshme për anët veç e veç.

Në këtë kontekst mund ta spikasim edhe shembullin, që del nga një dokument i shek. XVII, i cili ruhet në Perast, ku sipas të cilit në kuadër të konceptit Arbëri përfshihet edhe Kotorri. Ndaj citohet kalimthi nga historiani i madh kroat i shek. XVII, *Johannes Lucius* dhe monedha e farkuar me inskribcionin e këtij karakteri.

Në burimin tjetër nga fillimi i shek. XVIII (relacioni i argjipeshkvit *Vinçenc Zmajeviq*it, dërguar kardinalit *Albertini*), qendron qartas se si Republika ka poseduar më heret një "pjesë të mirë të Arbërisë", kështu që tani, kur e ka humbur atë, do ta ruajë së paku titullin, por jo veç titullin e zhveshur, por të lidhur për krahinën e caktuar.

Nga gjithë ajo që u tha më sipër, del qartë se botëkuptimi "Arbëri Venedikase", qe një shenjë e pranisë së arbërve edhe në Kotorr.[5]

Një varianti tjetër mbi prejardhjen e Begollajve kishte zënë fill nga mesi i shekullit XIX. Edhe pse është fjala për një metanarracion të periudhës së romantizmit i sajuar në vitin 1845 nga Petar Petroviq-Njegosh, shkrimtar dhe poet më i madh malazias, dhe më pas nga recidivët e tij, ndonjë studiues francezë, si, *Hyacinthe Hecquard* (më 1858) këtë sajim të Njegoshit e kishte marrë për referencë të rëndësishsme.[6] Pas tij kishte shkuar edhe *F. Lenormant* më 1866.[7]

Në të vërtetë, Njegoshi dhe Mali i Zi, të gjendur para kthesave të mëdha që kishin përfshirë jo vetëm Ballkanin, por edhe më gjerësisht, për të hyrë në skenën e historisë europiane kanë pasur nevojë për një personalitet, të cilin e njihte tërë Europa.

---

[5] J. Drançolli, op. cit., pp. 24-28.

[6] Hyacinte Hecquard, *Histoire et description de la Haute Albanie ou Geugarie*, Paris, 1858, pp. 432-433.

[7] F. Lenormant, ***Turcs et*** *Monténégrins*, Paris, 1866, pp. 69-70, 289.

Ky personalitet ishte Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Së këtejmi, pa ndonjë standard kronologjik e aq më tepër gjenealogjik u zbulua Skënderbeu malazias i shekullit XVI me prejardhje nga familja princore Cërnojeviq, përkatësisht nga Maxim Cërnojeviq.

Po në këtë kombinim ishte shpikur edhe Mahmut pasha i Pejës ose Mahmud Begu, i cili ruante prejardhjen po nga kjo familje, nga i vëllai i Maxim Cërnojeviqit, Ivan Obrenbegoviç,[8] personalitet ky i shpikur nga Njegoshi.

[8] Idem.

HISTORIKE

SHQIPTARËT PËR ARBËNESHËT E ZARËS

Prof. Dr. Aleksandar Stipčević

Krejt afër qytetit të Zarës (Zadar) në Dalmaci u themelua vendbanimi Arbënesh (Arbanas), i cili e fitoi emrin si mbas shqiptarëve katolikë të ardhur prej rrethit të Liqenit të Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XVIII. Deri sot arbëneshët e ardhur e kanë ruajtur dialektin gegë, si dhe shumë SHENJA të kulturës popullore. Pozita gjeografike e Zarës dhe të Arbëneshit, vendbanim fqinj, ishte në vijën detare, nëpër të cilën çdo ditë lundronin anije, jo vetëm tregtare, prej Adriatikut jugor dhe Detit Jon në drejtim të Venedikut dhe anasjelltas. Ato anije shpesh kanë kërkuar strehim në mol të Zarës, në raste të motit të keq, ose për furnizim, përkatësisht për punë tregtie. Pa kurrfarë dyshimi, bash këto rrethana i sollën shumë shqiptarë në Zarë dhe, në këta raste i kanë shfrytëzua për të vizituar bashkëkombësit e vet në Arbënesh, vendbanimin e afërt. Nuk kemi të dhëna të sigurta për ato vizita të KOHË MBAS KOHE, por Tulio Erber, historian i Zarës i informuar mirë, në monografinë e parë për Arbëneshin e Zarës të botuar më 1883, vërteton që është "e njohur se asnjë shqiptar, i cili gjatë udhëtimit kthehet në Zarë, nuk do të humb rastin, të paktën vetëm shkurt të shkojë në Arbënesh, ku i pritshin me kënaqësi". Nuk jemi të njoftuar me emrat e atyre shqiptarë, por mund të supozojmë, se bëhet fjalë për tregtarë, ndoshta priftërinj, të cilët kanë shkua në Venedik me punë. Nuk kemi njoftime as që dikush prej tyre ndonjëherë të publikojë ndonjë reportazh për PËRSHTYPJET dhe takimet me arbëreshë. Në të vërtetët, deri kah fundi i shekullit XIX, dijetarët shqiptarë, politikanët dhe publicistët nuk treguan interes për arbëreshët e Zarës, por atëherë vjen deri te ndryshimi, dhe ky për dy arsye. E para ka qenë LËVIZJA politike të vetë Arbëneshët, te të cilët u shfaq interesimi për ngjarjet në tokat shqiptare në KOHËN AFËR krijimit të shtetit shqiptar të pavarur, kurse e dyta arsye ka qenë shfaqja e mendimit te politikanët dhe dijetarët shqiptarë, që arbëreshët e

Zarës, për arsye të lidhjeve të mira me Vjenën, mund t'u ndihmojnë në luftë që kanë zhvillua për të fituar pavarësinë. Kah mbarimi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, veprimtarët kulturorë dhe politikë shqiptarët filluan t'i shpeshtojnë vizitat në Arbëreshë të Zarës, e po ashtu për Arbëreshin e Zarës edhe në shtyp shkrimet e ekspertëve dhe publicistëve shqiptarë shpeshtoheshin dita ditës, më parë ata informativë, e mandej ata shkencorë. Duhet ta kujtojmë, që Arbëneshi i Zarës, në atë kohë, hyri nëpër derën e madhe në jetën politike të Zarës dhe të krejt Dalmacisë. Krijohen parti politike, sindikate punëtorësh, shoqata të ndryshme kulturore etj. Ai aktivitet nuk mund të mbetet i pa vërejtur në rrethen politike të territoreve etnike të shqiptarëve, të cilët bash në atë kohë bëhen gati për ndodhitë MADHËSHTORE të cilat do të sjellin krijimin e shtetit shqiptar. Politikanët të vendit dhe ata në emigracion e kanë vlerësua që sidomos arbëreshët e Zarës, për arsye të vlerës politike të Zarës në suaza të Monarkisë Austro-Hungare, mund të luajnë rolin pozitiv në ngjarjet e ardhshme TË STUHISHME. Aso shpresash u shfaqen edhe në rrethin politik të Vjenës, ashtu që Arbëneshi menjëherë u gjet në qendër të lojërave politike të fuqive të mëdha. Pa hyrë në shqyrtime të hollësishme të këtyre proceseve, tërheqim vërejtën në publikimet e shkrimeve të para në shtypin shqiptar për Arbëneshin. Njeriu që e kuptoi çka ndodhte në Arbënesh dhe si arbëreshët e Zarës mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset politike të atëhershme në lidhje me krijimin e shtetit shqiptar, ishte Faik Konica, intelektual shqiptar e njohur. Kah mbarimi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, Konica vizitoi, me sa e dimë, katër herë Arbëneshin e Zarës. Mendimi i tij ishte që në Arbënesh të botohet një gazetë në të folmen arbëneshe me emër «Zani i Šćyptarit», e cila do të duhej të njoftojë për ngjarjet politike të asaj kohe, jo vetëm arbëreshët e Zarës, por edhe të gjithë shqiptarët në atdhe dhe nëpër botë. Gazeta nuk u botua kurr, por edhe vetë fakti që Konica mendoi që duhet një aso gazete të botohet në Arbënesh, mjaft qartë flet për angazhimin e MJEDISET politike shqiptare të shkaktuara nga ngjarjet politike në atdhe. Por, Konica vetë e botoi revistën «Albania» (1897-1909), e cila më parë u botua në Bruxelles, e prej 1903 në Londër, në të cilën Konica shkruante për arbëneshët e Zarës[2]. Në atë revistë gjejmë edhe disa shkrime tjera, të cilat do t'i përmendim më tutje në tekst. Në atë kohë, vetë arbëneshët kanë tregua

interesim për ngjarjet në atdheun e moçëm, ashtu që për herë të parë rivendosën kontakte me shqiptarë nga Shqipëria. Si dëshmi e ngjalljes së interesit për arbëreshët e Zarës nga ana e shqiptarëve, duhet të ceket fakti, që ngjarjet politike në Arbënesh nxitën shqiptarët (Arbëreshët) e jugut të Italisë që në botimet e tyre të komentojnë ngjarjet politike në Arbënesh. Njëri prej atyre shqiptarë (Anselmo Lorecchio) më 1897 u paraqit me revistë «La Nazione albanese» në vendin Pallagorio, afër qytetit Catanzaro në Kalabri. Revista u botua deri më 1924[3]. Në atë revistë pati shkrime për ngjarje në Arbënesh të Zarës nga pena e vetë Lorecchios, i cili në revistë futi shkrime që i merrte redaksia prej Arbëneshit[4].

Përveç rrethanave politike të përmendura, lidhjeve të Arbëneshëve të Zarës me atdheun e të parëve u NDIHMOI edhe ardhja e mësuesve shqiptarë në Arbënesh. Për ata do të flitet edhe më tepër kur do të shkruajmë për mësim të gjuhës shqipe në shkollat arbëneshe prej 1897-1916. Ardhje atyre mësues e ka pasur rëndësinë më të madhe për të rikthye lidhjet ndërmjet Arbëneshëve të Zarës dhe të atdheut të moçëm, për arsye se ata mësues kanë qenë të parët që patën kushtet të njoftojnë më mirë historinë dhe jetën e Arbëneshëve të Zarës, si dhe të shkruajnë për atë çka panë atje. Vetëm atëherë Arbëneshët e Zarës do të jetojnë në krijesën e njëjtë shtetërore (Jugosllavi) me shqiptarë, jo me të gjithë, por vetëm me ata nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe nga trevat e tjera të Jugosllavisë ku jetonin shqiptarët. Vetëm pak vite mbas mbarimit të Luftës II Botërore filluan shqiptarët ta vizitojnë Arbëneshin e Zarës. Atëherë vinin gazetarë e publicistë shqiptarë, të cilët shkruanin reportazhe, intervista etj. për Arbëneshët e Zarës. Ndërkaq, vijnë edhe dijetarë, të cilët interesohet veçanërisht për të folmen arbëneshe. Historianët, për ndryshe, interesohen sidomos për ngjarje në Arbënesh të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, kurse kritikët letrar i interesojnë shkrimtarët arbëneshë të cilët i shkruajnë veprat e veta në të folmen arbëreshe. Në këtë punim përmblodhëm librat dhe artikujt e autorëve shqiptarë, për arsye të qartësisë, në disa grupe. Në përmbledhjen e parë hyjnë *Reportazhet dhe paraqitja e përgjishme për Arbëneshët e Zarës.* Reportazhet dhe paraqitjet janë kryesisht të natyrës informative për historinë e Arbëneshëve, për gjuhën e tyre, adetet e të ngjashme, ashtu si shkruan shumë shqiptarë nga Kosova. Rëndësia themelore e paraqitjeve të tyre

është simpatia e theksuar e autorit për vendin Arbënesh dhe banorët e tij. Ishin shumë, por këtu do të përmendim vetëm ata për të cilët mendojmë se janë më të rëndësishëm. Kanë shkrua Murat Isaku[5], Shaban Osmanaj[6], Akil Koci[7], D.E.[8], Skender Gashi[9], Reshat Nexhipi[10], Maksut XH. Haxhibrahimi[11], Kujtim Morina[12], Hilmi Agani[13], Gjovalin Shkurtaj[14] e tj, e sidomos la përshtypje vizita e studentëve të Prshtinës më 1953, të cilën në Arbënesh i kujtojnë edhe sot[15].

Mirëpo, të gjithë vizituesit e Arbëneshit nuk u kënaqën vetëm me shkrime reportazhesh. U gjetën ndër ta dhe asi, të cilët provuan të analizojnë disa anë të jetës të Arbëneshëve të Zarës dhe për ata të shkruajë në mënyrë studiuese në revista e gazeta. Njëri prej tyre ishte edhe prof. dr. Simë Gjon Dobreci, i cili, me rastin e vizitës së vet, ka takua dhe bisedua me njerëz të vendit. Arbëneshët e kanë bindur për dashurinë që kanë për të folmen arbëreshe. Ata mburren që e kanë ruajtur gjuhën e vet, e me këtë edhe identitetin kombëtar. Dobreci i ka publikua përshtypjet e veta nga ai udhëtim në revistën «Buzuku». Dëshmia e tij ka nxitë interesim të madh te lexuesit, për ç'arsye e ka botua dy herë në atë revistë[16].

U renditë edhe shumë tjerë, të cilët me kureshtje të madhe i kanë zbuluar veçantitë kulturore e sidomos ato gjuhësore të arbëreshëve të Zarës. Ashtu, Zenun Çelaj, gjatë qëndrimit të vet në Arbëreshë, veçanërisht i impresionuar me jetën kulturore të vendasve, në artikullin e vet shkroi që ky vend është «votra kulturore»[17]. Nuk na habit vështrimi i tij, se në atë kohë kur e shkroi këtë, në Arbëreshë jetonin e punonin shkrimtari Josip Vladović Relja, shkrimtari dhe muzikanti Šime Dešpalj, mësuesi Budimir Perović i cili ka shkroi edhe artikuj shkencor, si dhe punime letrare, kurse prej Arbëneshit ishte edhe shkrimtari i njohur kroat Augustin Stipčević, politikani Josip Gjergja dhe shumë tjerë. Në vitet tetëdhjeta të shekullit XX, Arbëneshin e ka vizituar edhe shkrimtari e publicisti Nasho Jorgaqi prej Tirane, i cili pati rast të takojë shumë Arbëneshë dijetarë dhe me ata të bisedojë për gjendjen në këtë vend. Përshtypjet e veta dhe bisedat që pati i qiti në librin udhëpërshkrues të tij «Larg dhe afër»[18].

Këtu po paraqesim edhe emrat e disa shqiptarëve tjerë, që i vizituan arbëneshët e Zarës dhe shkruan për ata. Këta janë Musa Ahmeti[19], Jahja Drançolli[20], Gjekë Gjonaj[21], Sylejman Morina[22] e tj. Veçmas duhet të përmendet Frrok Kristaj, udhëpërshkrues dhe

veprimtar kulturor. Ai është autor i më shumë librave dhe të artikujve; ka vizituar arbëneshët e Zarës dhe në mbështetje të bisedave me shumë prej tyre si dhe në ndihmë të literaturës, ka shkruar disa artikuj për historinë, kulturën dhe jetesën e arbëneshëve të Zarës. U kujdesua të paraqes një pamje sa më të plotë dhe interesante për vendin dhe personat e njohur që i takoi gjatë qëndrimit në Arbënesh. Artikujt e vet më parë i botoi në gazetën e Prishtinës *Bujku*[23], kurse intervistën me Al. Stipčević-in[24], në bashkëpunim më gazetarin Ibrahim Berishëm, e botoi në gazetën *Rilindja – Bujku* (Tirana-Prishtina). Ata artikuj i ka botuar pastaj në librin e vet udhëpërshkrues «Ura e kujtesës»[25]. Përveç këtyre, ka shkrua edhe artikuj tjerë për arbëneshët e Zarës[26]. Arbëneshët e Zarës i ka vizituar edhe Ismail Doda, etnolog dhe punëtor kulturor prej katundit Ostros, afër Liqenit të Shkodrës, i cili pastaj ka shkrua një paraqitje të hollësishme për jetën kulturore të arbëneshëve të Zarës[26a].

Historia arbëneshëve të Zarës

Vendosja shqiptarëve afër Zarës, si dhe fati i tyre në atdheun e ri në të ardhmen, ishte temë e shumë polemikave, për të cilat më të shumtën i shkruan historianët e Zarës dhe të Arbëneshit, e mandej edhe ata të territoreve shqiptare. Kuptohet pse historianët vendas më të shumtën u morën me këtë çështje; ata kishin mundësi të shërbehen me fondin e pasur të Arkivit Shtetëror të Zarës. Monografinë e parë për arbëneshët e Zarës e shkroi Tullio Erber, historian i Zarës. Libri i tij «La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara» u botua në Dubrovnik motit, më 1883. Ajo monografi ishte kohë të gjatë e vetmja, prej së cilës historianët kishin mundësi të njoftohen jo vetëm për shqiptarët e ardhur në rrethin e Zarës, por edhe për jetesën e tyre në atdheun e ri. Me këtë libër janë shërbyer edhe historianët shqiptarë dhe linguistët për hulumtime të veta. Se sa shqiptarët e kanë çmua atë libër, shihet nga fakti që ajo në trajtën e shkurtuar u përkthye më 1902. E përktheu i dituri patër Pashk Bardhi, i cili e shfrytëzoi qëndrimin e vet në Arbënesh, atëherë i angazhuar t'u mësojë fëmijëve gjuhën shqipe. Ai përktheu ato pjesë të librit të Erberit, për të cilat mendonte që janë më interesante për lexuesin shqiptar[27]. Krejt libri i përkthyer në shqipe u botua në Zagreb më 1997[28].

Kontribut të rëndësishëm për studimin e historisë së moçme të arbëneshëve të Zarës e dha Kruno Krstić-i, i cili punoi

një kohë në Arkivin Shtetëror të Zarës; ai në bazë të dokumenteve të rinj arriti të rindërtoi të gjitha ngjarjet në lidhje me vendosjen e arbëneshëve të Zarës[29]. Ky është studimi më i ploti për shpërnguljen e shqiptarëve (arbëneshëve) prej zonës së Liqenit të Shkodrës, çka nuk është çudi që ai studim tërhoqi vëmendjen e historianëve shqiptarë. Ashtu, Zekeria Cana, historian i njohur i Kosovës, atë studim të Krstić-it e ritregoi dhe e plotësoi me të dhëna më të reja të historisë arbëneshe dhe e botoi në vazhdime në gazetën e Prishtinës «Bota e re»[30]. Studimi i Krstić-it, më 1988, i plotësuar dhe i zgjeruar, është botuar si libër i veçantë[31], për çka ka qenë i njoftuan publiku shqiptar[32].

Për ardhjen e arbëneshëve në Zarë, rolin kryesor e luajti Vicko Zmajević-i, më parë kryeipeshvi i Tivarit e pastaj i Zarës. Jo vetëm që roli i tij ka qenë vendimtar në organizimin e lëshimit të katundeve afër Liqenit të Shkodrës, por edhe vendosja e tyre afër Zarës. Për këtë rol të tij kanë shkruar historianë dhe gazetarë shqiptarë[33].

Rëndësi të veçantë pati tubimi shkencor i kushtuar kryeipeshvit Vicko Zmajević-it, i mbajtur në Zagreb më 1995, me rastin e shënimit të 250 vjetorit të vdekjes së Zmajević-it. Në atë tubim u lexuan referate, përveç tjerash, edhe ata që drejtëpërsëdrejti kanë lidhje me rolin e Zmajević-it në historinë e arbëneshëve të Zarës. Pët këtë rol në këtë tubim foli kryeipeshkvi i atëhershëm i Zarës Ivan Prenđa, përndryshe arbëreshë prej Zemunikut, kurse pjesëmarrësit tjerë të tubimit trajtuan veprimin Zmajević-it në trevat shqiptare (Zef Mirdita, Gjergj Gjergji, Shan Zefi, Frok Zefi i Odette Marquet)[34]. Për rolin e Zmajević-it në vendosjen e arbëneshëve në Zarë ka shkrua Zef Mirdita në monografinë e vet për krishterimin e popullit shqiptar[35].

Vëmendjen e historianëve shqiptarë e tërhoqën TRONDITJET politike në Arbënesh në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX. Në atë kohë, përveç opsionit të partisë politike kroate mbizotëruese, u shfaq edhe partia autonome (talijanaška, pro italiane), kurse kah fundi i shekullit XIX u shënuan simpatitë FILLESTARE për shqiptarët, popullin amtar. Kjo ishte koha kur Monarkisë Austro-Hungareze i përshtatej angazhimi i arbëreshëve të Zarës në politikë, e cila do të FAVORIZOJË jo aq interesat shqiptare, por ato të Vjenës. Ishte koha kur fuqit e mëdha evropiane dëshironin ta ruajnë ose ta shtrijnë ndikimin e vet në tokat, të cilat ende ishin nën Turk, dhe

kjo bash atëherë kur ishte e qartë që pushtetit turk në territoret shqiptare i afrohet fundi. Nga ana tjetër, edhe italianët kishin interesat e veta që të forcohen në bregdetin lindor të Adriatikut dhe të Jonit. Këto interesa të kundërta të Fuqive të Mëdha Evropiane kishin si rezultat që ato të merren me ngjarjet politike në Arbënesh.

QËNDRIMIN e intertesave shqiptare në KOHËN AFËR krijimit të shtetit shqipat, kah fundi i shekullit XIX, më së mirit e ka formulua Faik Konica, i cili erdhi në Arbënesh ta STIMULOJË botimin e një gazete politike në gjuhën shqipe në Arbënesh. Tjerët politikanë dhe intelektual shqiptarë (psh. Fan Noli), po ashtu, në fillim të shekullit XX, i vizitojnë Arbëneshët, atëherë nën Monarkinë Austro-Hungareze, duke besuar që ata mund të ndihmojnë në aspiratat për krijimin e shtetit shqiptar të pavarur. Për këto ngjarje të koklavitura dhe të STUHISHME në Arbënesh dhe rreth tij në mënyrë studiuese shkroi Muhamet Tërnava[36].

Arbëneshët e Zarës përcillnin me kënaqësi të madhe ngjarjet në lidhje me lindjen e shtetit shqiptar[37].

Por, lidhjet e vendosura ndërmjet arbëneshëve dhe tokës amnore u ndërprenë gjatë sundimit italian të Zarës. Shumë rrallë përmenden ngjarjet, të cilat mund të krijojnë parandjenjë që ka pasur ndonjë lidhje të fortë të arbëreshëve me Shqipërinë e sapokrijuar mbas shkatërrimit të Monarkisë Austro-Hungareze. Në vetë Arbëneshin nuk ndodhte asgjë që mund të zgjojë interesim te politikanët dhe shkencëtarët ose te publicistët shqiptarë për arbëreshët e Zarës. Ngjarje të mëdha nuk patir as mbas Luftës II Botërore, por në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur Zara, bashkë me vendbanimin Arnënesh, u gjet në të njëjtën krijesë shtetërore me shqiptarë, të cilët banojnë në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi; e tash, kur këta shqiptarë e kishin kollaj të vizitojnë Arbëneshin, u paraqitën çdo ditë e më shumë gazetar, shkrimtarë dhe shkencëtarë shqiptarë, të cilët vinin në Arbëneshë dhe mandej shkruanin për ta në shtyp. Vizituesit shqiptarë interesoheshin veçanërisht për histori, jetesë, gjuhë dhe kulturë të arbëneshëve të Zarës. Në atë kohë, ekspertët shqiptarë shpesh e më shpesh shkruanin për të kaluarën e arbëneshëve të Zarës, kurse gazetarët dhe publicistët shkruanin shpesh artikuj, më të shumtën informativë, me qëllim që publiku shqiptar të njoftohet sa më mirë për jetesën, gjuhën etj. e arbëneshëve të Zarës. Ndër

historianë shqiptarë duhet të përmendet veçanërisht prof. Dr. Zeqirja Neziri, profesor i albanologjisë në Universitetin e Shkupit. Ka shkrua disa punime të vlefshme për arbëreshët e Zarës[38].

Në hulumtimin e historisë arbëreshe marrin pjesë edhe shkencëtarë tjerë, por në vitet e para mbas Luftës II Botërore, megjithatë mbizotërojnë reportazhet, artikujt për ngjarjet kulturore në Arbëneshët, e posaçërisht intervistat me personat arbëneshë të njohura. Paraqitja e atyre artikuj tregon, që publiku shqiptar ishte veçanërisht i interesuar për ngjarjet më të reja në fushën e sportit, në kulturë, muzikë dhe fusha të aktiviteteve tjera, në të cilat arbëreshët e Zarës janë bërë të njohur, jo vetëm për publiku e Zarës, por edhe për krejt të Kroacisë dhe Jugosllavisë, e po ashtu edhe për publikut shqiptar. Megjithatë, shpesh e më shpesh paraqiten punime shkencore të ekspertëve shqiptarë dhe të publicistëve. Për të kaluarën e arbëneshëve të Zarës, por edhe për ngjarje të tashme, ka tregua interesim të posaçëm revista *Buzuku* e Ulqinit, të cilën e redakton prof. dr. Simë Gjon Dobreci. Interesimi i kësaj reviste është i kuptueshëm për arsye se arbëneshët e Zarës kanë prejardhjen prej katundeve afër Ulqinit, ashtu që e folmja e arbëneshëve i përngjet më të shumtën atij që flitet në atë pjesë të Malit të Zi dhe të veriut të Shqipërisë, pastaj edhe shumë adete janë të ngjashme e tj. Pra, jo rastësisht, arbëreshët e Zarës vendosen lidhje të mira me atë trevë. Në revistën *Buzuku* publikohen shumë artikuj, të cilët kanë të bëjnë me arbëneshët e Zarës, e këtu është e mjaftueshme të përmenden vetëm disa prej tyre. Historiani prej Kosovës, Jahja Drançolli, shef i Katedrës së historisë në Universitetin e Prishtinës, me rastin 280 vjetorit të ardhjes së arbëneshëve në Zarë, shkroi artikullin për arbëneshët dhe atdheun e tyre të parë[39]. Për lokalitetet prej kah janë shpërngulur arbëneshët e Zarës u shkrua në atë revistë edhe disa herë, p.sh, Besnik Simë Dobreci[40]. Në shumë numra të *Buzuku*-t gjejmë këngë, të cilat i kanë këndua arbëneshët e Zarës në gjuhën arbëneshe. Ashtu në nr 20 (2006) gjejmë dy shtojca që sjellin këngë arbëneshe, të botuara në gazetën *Feja/Vjera,* e cila filloi të botohet në Arbënesh. Në revistën *Buzuku* janë botuar intervista me arbëneshë të njoftuar, të shkruara prej Sylejman Morinës e tjerë[41].

Është e qartë që arbëneshët e Zarës kanë nxitë vëmendjen edhe të historianëve tjerë shqiptarë. Ashtu një artikull të bukur

popullor për historinë arbëneshe e shkroi historiani Zija Shkodra[42].

Episod DOMETHËNËS i rëndësishëm në historinë e arbëneshëve ishte prova e botimit të gazetës *Zani Šćyptarit* në Arbënesh më 1897. Mendimi për publikim e asaj gazete ishte i Faik Konicës, mirëpo ky plan nuk u realizua. U shtyp vetëm trakti në gjuhën arbëneshe dhe italiane, në të cilën thirren njerëzit e interesuar për parapagesë, dhe jo vetëm ata të Arbëneshit, por edhe prej të gjitha shteteve ku jetojnë shqiptarë. Për këtë provë shkroi hollësisht arkivisti i Zarës, A. M. Strgačić, në bazë të dokumenteve të ruajtura në Arkivin Shtetëror të Zarës[43]. Gjurmët e këtij artikulli e kthyen në këtë çështje edhe historianin Muhamet Tërnavën[44].

Për mësimin i gjuhës shqipe në Arbënesh

Lidhjet e forcuara të arbëreshëve me trevën e moçme sollën edhe mësimin e gjuhës shqipe në shkollat arbëneshe. Interesimi për mësim të gjuhës shqipe ndër arbëneshët e Zarës përputhej me planet e Vjenës për krijimin e kuadrit administrativ, ushtarak etj, që do të dijë të flas në gjuhën shqipe, kur kjo do t'i përshtatet planeve të Vjenës për shtrirjen e ndikimit të vet politik në trevat etnike shqiptare. Mësimi i gjuhës shqipe në Arbënesh në disa shkolla filloi më 1897 dhe zgjati deri më 1916. Mësuesit e gjuhës shqipe ishin shqiptarë, më të shumtën prifta françeskanë prej Shqipërisë veriore, të cilët mund të merreshin vesh kollaj me arbëneshë. Për atë episod të mësimit të gjuhës shqipe në Arbënesh më të shumtën shkruan ekspertet shqiptarë. Me sa jemi të njoftuar, për mësim të gjuhës shqipe në Arbënesh i pari ka shkrua Mark Gurakuqi[45], kurse shkrimi i Hasan Kaleshit është më i gjani dhe më dhe më i kompletuar. Në bazë të dokumentacionit të madh, i cili ruhet në arkivat e Vjenës, shkruan punimin shumë të mirë dhe të dokumentuar për mësuesit shqiptarë në Arbënesh (Pashk Bardhi, Shtjefën Gjeçovi e tj.) [46]. Për shkencën, në punimin e tij janë më të rëndësishme dokumentet arkivore burimore, nga të cilët kanë thithë shënime të gjithë, të cilët u morën me këtë çështje më vonë. Dhe e saktë, duke ju falënderuar dokumenteve të riprodhuara nga Hasan Kaleshi, por edhe në bazë të lajmeve gazetareske për mësimin e gjuhës shqipe në shtypin e Zarës, e preku këtë çështje edhe Halit Tërnavci[47].

Mësimi i gjuhës shqipe në Arbënesh shkaktoi kureshtje edhe ndër shqiptarë jashtë atdheut. Faik Konica e njofton

publikun për këtë në revistën *Albania*[48], kurse shqiptari prej Italisë Anselmo Lorecchio preku këtë temë në revistën *La Nazione albanese*[49].

Me shkatërrimin e Monarkisë Austro-Hungareze (1918) u ndërpre edhe mësimi i gjuhës shqipe në shkolla në Arbënesh. Është interesant që kjo çështje u aktualizua përsëri mbas Luftës II Botërore. Arbëneshët besuan, që atëherë u erdhën raste të reja që mundësojnë të përtërihet mësimi i gjuhës shqipe në shkolla si lëndë fakultative. Por dëshira e arbëneshve nuk u realizuan, e ata të cilët kanë folur për këtë në vendbanim janë dënuar nga pushteti i ri, për çka sjell lajme interesante dr. S.Dobreci[50].

Për gjuhën e arbëreshëve

Françeskani shqiptar i shkolluar Pashk Bardhi ka pabanuar në Arbënesh si mësues i gjuhës shqipe kah fillimi i shekullit XX. I ka njoftua mirë arbëneshët dhe të folmen e tyre, mblodhi këngët e tyre popullore dhe shkroi tekstin e parë të shkurtë për të folmen e arbëneshëve të Zarës[51]. Me gjithë që, e folmja e arbëneshëve të Zarës ishte krejt e kuptueshme për Bardhin, ai nuk kishte mundësi ose ndoshta nuk donte, që në artikullin e vet të shkurtë të paraqes analizën detale të asaj të folme. Po e përmendim artikullin e tij për arsye se ai ishte i pari punim i një shqiptari për të folmen e arbëneshëve. Shumë kohë u desh të kalojë deri që te ekspertet shqiptarë të paraqitet interesimi serioz për të folmen arbëneshe. Veç mbas Luftës II Botërore, profesori i Prshtinës, Idriz Ajeti, atëherë i ri, qëndroi në Arbënesh dhe në mënyrë solide e studioi të folmen e banorëve të atjeshëm. Në bazë të kërkimeve të veta, e shkroi disertacionin e doktoraturës, të cilën e mbrojti më 1958, kurse më 1961 e botoi në Sarajevë[52]

E folmja arbëneshe zgjoi interesim të shumë filologëve evropian të njohur, por të gjithë ata qëndruan shkurtë në Arbënesh dhe nuk i kryen mirë hulumtimet e veta. Si mbas mendimit të dr. Krune Krstić-it punimi i Ajetit është më i miri për të folmen arbëneshe. Për këtë flet edhe fakti, që më të mirë nuk e shkroi askush në 50 të vitet e fundit. Ajeti shkroi edhe disa punime më të vogla për këtë çështje[53], në bazë të cilave mund të konstatohet, që ai e përpunoi të folmen arbëneshe në mënyrën e më të gjithanshme deri sot. Ka rëndësi të konstatohet, që ajo e folme ruajti disa fjalë arkaike dhe forma gramatikore, të cilat janë të rëndësishme për të studiuar zhvillimin e gjuhës shqipe. Prej filologëve shqiptarë duhet të përmendet edhe Kolec Topalli, i cili

shkurtimisht e vështroi atë të folme në referatin, të cilin e lexoi në tubimin shkencor në Zagreb më 2006, me rastin e shënimit të 280 vjetorit të ardhjes së arbëneshëve në Zarë. Ai analizoi të folmen arbëneshe dhe tërhoqi vërejtjen në veçantitë e saja, të cilat u zhvilluan larg tokës amnore, për ç'arsye ai i ruajti shumë trajta gramatikore dhe leksikore arkaike[54]. Për këta elemente gjuhësore të rëndësishme të folmes arbëneshe e tërhoqi vërejtjen edhe Kadri Halimi[55].

Nuk guxojmë ta harrojmë Eqrem Çabejn, filologun e madh, i cili nuk shkroi asnjë punim për të folmen e arbëneshëve të Zarës, por në studimet e veta, veçanërisht të etimologjisë, shpesh citon dhe komenton pasurinë gjuhësore të arbëneshëve të Zarës. Këtu duhet të përmendim recensionet të filologëve dhe të gazetarëve shqiptarë, të cilat u shfaqen në shtypin shqiptar me rastin e botimit të librit (1987) të arbëneshit Kruno Krstić-it «Rječnik govora zadarskih Arbanasa». Më rëndësi të veçantë ishte recensa që shkroi Idriz Ajeti[56], si autoriteti më kompetent të folmen arbëneshe, por nuk guxohet të lihen mbas dore as paraqitjet, që atëherë u publikuan në gazeta shqiptare[57].

Për shkrimtarët

Arbëneshët kanë shkruar veprat letrare në gjuhët kroate, italiane dhe arbëneshe. Ata që shkruan në të folmen arbëneshe fituan rastin t'i botojnë këngët dhe prozën në revistat *Jeta e re* (Prishtina), *Drita* (Tirana) i *Buzuku* (Ulqin). Disa prej këngëve dhe tregimeve mandej u botuan edhe në libra të publikuara në Prishtinë. Këngë dhe proza më të shumtën u publikuan në revistë e Prishtinës *Jeta e re* prej 1952 – 1979. Me revistën *Drita* dhe *Buzuku* shkrimtarët nuk bashkëpunuan drejtpërsëdrejti, por redaksia e atyre revistave i ka mbartur këngët dhe prozën prej revistës *Jeta e re*[58].

Këngët popullore të arbëneshëve të Zarës i pari i shënoi dhe i botoi Pashk Bardhi[59] motit më 1905, e në kohën më të re (1991) i publikoi Bajrush Morina[60] në revistën e Prishtinës *Zeri i rinisë*. Për krijimet letrare të arbëneshëve të Zarës në gjuhën amnore arbëneshe u shkrua shumë në shtypin shqiptar, si dhe në monografi. Nuk na habiten ky interesim i shqiptarëve që merren me kritikë dhe histori të veprave letrare, mbasi ata letrarë ishin interesantë sidomos për gjuhën arkaike, në të cilën kishin shkruar veprat e tyre. Vëmendjen më të madhe kritikët shqiptar e treguan për krijimet letrare të dy shkrimtarëve arbëneshë. Ata janë

dramaturgu Josip Vladović Relja dhe muzikologu dhe shkrimtari Šime Dešpalj-i. Vladović Relja u bë i njohur me dramat e veta të shkruara në gjuhën arbëneshe. Ishte jo vetëm më prodhuesi, por edhe më i miri shkrimtar arbënesh, i cili në opusin e vet letrar shkroi në gjuhën amtare. Ai shkroi 13 drama dhe shumë këngë. Është i vetmi shkrimtar, që iu botua përmbledhje veprash. Ia shtypen në Prishtinë më 1968-1971[61] , mbas vdekjes. Për këtë shkrimtar u publikua një numër i madh studimesh, artikuj, intervista dhe veçanërisht paraqitje të dramave të tij, të cilat u shtypen në disa botime në shqipe dhe të përkthyera serbisht; ato u prezantuan në teatrat e ndryshëm nëpër krejt Kosovën, si nëpër pjesët tjera të Jugosllavisë. Nuk mund të përmendim këtu të gjithë artikujt, paraqitjet, intervistat e tj, të shkruara prej shqiptarëve që merren me kritikë, gazetari dhe histori të veprave letrare, por po përmendim vetëm ata, të cilat i shkruan kritikët e gazetarët e njohur. Për këtë shkrimtar, shpejt mbas vdekjes së tij, doli monografia e Ali Jasiqit[62]. Autori i monografisë, Jasiqi, përveç kësaj, para dhe mbas vdekjes së Vladović Relja-s, shkroi një numër më të madh studimesh dhe artikujsh (të rastit përkujtimor)[63].

Për jetën dhe veprat e Josip Vladović Relje-s e shkroi disertacionin Isak Shema. Ai disertacion më 2002 u shtyp si libër i veçantë[64].

Prej kritikëve tjerë është mjaft të përmenden Rexhepa Qosja[65], Ibrahim Rugovu[66], Ramiza Kelmendi[67], Sabri Hamiti[68,] Ali Aliu[69], e duhet të përmenden edhe emra të kritikëve dhe gazetarëve tjerë – Hysni Hoxha, Mirash Gjokaj, Mehmet Kraja, Nehat Islami, Hasan Hasani etj[70]. Ka rëndësi të thuhet që jehona e madhe të veprave letrare të Josip Vladović Rela-s në trevat shqiptare nuk mund SPJEGOHET vetëm me faktin, që ai ka shkrua në gjuhën amtare, arbëneshe, por edhe të vlerës artistike të dramave të tija, veçanërisht më të suksesshmes ndër ata «Nita». Kritikët në studimet dhe artikujt e veta tërhjekin vërejten në elementet popullore, arbëneshe në dramat e tija. Shkrimtari i dytë arbënesh i cili u tërhoqi vëmendjen kritikëve dhe gazetarëve shqiptarë ishte Šime Dešpalj-i (1897-1981). Në Kroaci ishte veçanërisht i çmuar si muzikolog dhe pedagog i muzikës (për çka do të bëhet më fjalë në këtë punim); ai u shqua edhe si poet dhe prozaik në të folmen arbëneshe. Punimet e veta i ka botua më të shumtën në vitet gjashtëdhjeta të shekullit XX në revistën letrare

të Prishtnës *Jeta e re*; në Prishtinë botoi edhe koleksioni i tregimeve («Tregime arbëneshe» 1966.) dhe dy koleksione këngës («Agimet e parabromjet të Arbëneshit» 1968, dhe «E vërteta», 1972). Ata libreza zgjuan interesin e kritikëve dhe gazetarëve shqiptarë, ashtu që Šime Dešpalj, shkrimtar, si mbas rëndësisë u radhit menjëherë mbas Josip Vladović Relje-s. Për atë si shkrimtar, me rastin e vdekjes së tij, studimin më të gjatë e shkroi Hasan Mekuli, kritiku kosovar i njohur. Kritiku i njëjtë shkroi edhe artikuj e paraqitje tjera për veprat letrare të Šime Dešpalj-it[71], kurse për veprat e tija u paraqiten edhe tjerë gazetarë dhe kritikë letrarë[72]. Disa me intervista ia afruan Dešpaljin publikut shqiptar[73].

Š.Dešpalji, si shkrimtar është i radhitur në edicionin «Fjalor enciklopedik shqiptar» (Tirana: Akademia e shkencave e Shqipërisë, 2004, fq.455. Autor shtojce: Nasho Jorgaqi) dhe në edicionin «Leksikon i shkrimtarëve shqiptarë 1501-1990» (Prishtinë: Shkëndia, 1994, fq. 74. Autor shtojce: Hasan Hasani). Veprimtari i tretë kulturor, i cili e provoi fushën e leterësisë, ishte mësuesi Budimir Perović-i (Miro Kikica). Ai shkroi libreton «Nita» në bazë të dramës të Josip Vladović Relje-s në të folmen arbëneshe, i cili kurrë nuk u botua, e po ashtu në dorëshkrim i mbeti edhe libreti «Teuta», po ashtu në të folmen arbëneshe[74].

Shkrimtari Augustin Stipčević (1912-1999) është arbëneshi, pa dyshim, më i frytshmi dhe më i miri poet dhe shkrues i romaneve. Ai shkroi shumë romane, eseje dhe këngë – të gjitha në gjuhën kroate. Në disa romane të veta shkroi për jetesën e arbëneshëve të Zarës, por krijimet e tija nuk shkaktuan ndonjë interesim të kritikët shqiptarë, me gjithë që romani «Glad na ledini» është përkthye në gjuhën shqipe me titull «Uria në ledinë». Përkthimin e botoi shtypshkronja «Rilindja» më 1968 (përkthyesit ishin Sulejman Drini dhe Vehap Shita). Të përkujtojmë, që njëri ndër më të mirët kritik kosovar ia kushtoi studimin vështrues këtij shkrimtari arbënesh[75]. Vëmendjen e publicistëve shqiptarë e tërhoqi edhe veprimi letrar i Ivice Đovanija Matešić Jeremije-s, autorit e reportazheve historike, të përkushtuara më të shumtën ngjarjeve të Luftës atdhetare nëZarë[76].

Për shkencëtarët

Është numër mjaft i madh i arbëneshëve të dalluar si shkencëtarë, por media shqiptare vëmendjen e drejtoi vetëm në

ata që merreshin dhe që ende merren me çështje albanologjike. Kruno Krstić-in veç e kemi përmendur, e na mbeti të përmendim Aleksandar Stipčević-in, ilirolog dhe albanolog. Libri i tij «Iliri», po sa doli më 1966 në gjuhë italiane në Itali, e përktheu në gjuhën shqipe Zef Mirdita (u botua në Prishtinë më 1967), e mandej botimi pak i ndryshuar dhe i zgjeruar në gjuhën kroate më 1974, po ashtu e përkthyer shqip (përkthyesi: Nazmi Rrahmani). (Origjinali kroat « Kultni simboli kod Ilira» u shtyp në Zagreb më1981; përkthye shqip «Simbolet e kultit te Ilirët», Rilindja, Prishtinë, 1983.). Botimin shqip e përktheu Zef Mirdita. Ata përkthime mbërritën të ribotohen në Prishtinë (1990), Tiranë (2002). Për këta libra botohet numër i madh recensionesh në revista e gazeta në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup, të cilat dalin në revista shkencore dhe në gazeta. Është e mjaftueshme të përmenden vetëm disa nga ata recensione. Françeskani shqiptar Vinko Malaj, i cili një koha jetoi në Romë, me pseudonim Tush Murgu, në revistën shqiptare *Shêjzat/Le Pleiadi*,e cila botohej në Romë, i shkroi recensionet e librave *Arte degli Illiri* (Milano 1963), *Gli Illiri* (Milano 1966) i *Bibliographia Illyrica* (1967)[77]. Vazhdojnë artikuj e recensione për libra tjera albanologjike dhe ilirologjike[78], si dhe intervista të shumta[79]. Me rastin e 70 vjetorit të jetës së tij shtypet në Prishtinë për nder të tij numri i veçantë i revistës *Dardania sacra* (nr 2, 2000), ku radhitën shumë punime të shkencëtarëve shqiptarë. Vëmendjen e gazetarë shqiptar e tërhoqi edhe prof. dr. Leonard Marušić, ekspert për komunikologji në Universitetin e Zarës, për atë kemi intervistë të bukur të Sylejman Morinës[80].

Për muzikantët

Shqiptarët, njësoj si tjerët që i njoftuan arbëneshët e Zarës, ishin të befasuar me ekspresivitetin tyre muzikor. Posaçërisht u ka lënë përshtypje familja muzikore Dešpalj, ashtu që shqiptarët njohës dhe kritikues të muzikës kanë shkruar shumë, si për krejt familjen, ashtu edhe për secilin anëtar të familjes. Mirëpo, shkruanin edhe për këngëtarë dhe kompozitorë të muzikës zbavitëse të Arbëneshit. Familja Dešpalj solli interesim të veçantë ndër shqiptarë, më të shumtën të ata të Kosovës. Me të drejtë, se për atë familje në media të Kroacisë flitej si për familjen muzikore më të njohur në Kroaci. Për shqiptarë, më interesanti ishte i zoti i shtëpisë, Šime Dešpalj, më të shumtën për arsye të krijimeve letrare në të folmen arbëneshe, por është shkruar edhe

për krijimet e tija në muzikë dhe për arritjet e tija pedagogjike. Për atë, si muzikolog, shkroi publicisti dhe shkrimtari Nasho Jorgaqi[81], i cili maestron e njohu gjatë qëndrimit në Zarë. Šime Dešpalj-i ka komponua, përveç tjerash, edhe këngë KORALE në frymen popullore, të cilat u paraqitën në Prishtinë me titull «Këngë shqiptare» (Prishtina, 1973). Atë koleksion e analizoi muzikologu Rexhep Munishi në gazetën e Prishtinës «Rilindja»[82]. Për angazhimin e tij muzikor u paraqiten edhe ekspertë tjerë shqiptarë[83].

Për sportistet

Sporti në Arbënesh ishte, por edhe tash është, shumë mirë i zhvilluar. Për këtë dëshmon monografia e madhe dhe e hollësishme, të cilën e përgatitën Drago Marić i Bernard Kotlar[86]. Për sukseset në garat nacionale dhe ndërkombëtare shkruan të gjitha gazetat kroate dhe jugosllave, e po ashtu edhe ato nga trevat etnike shqiptare të ish-Jugosllavisë.

Shqyrtime përfundimtare

Nga shënimet bibliografike, pa dyshim jo të plota, të cilat i sollëm këtu, mund të përfundohet, që mediet e shtypit shqiptar përcollën me vëmendje çka ndodhte në Arbënesh, dhe që shkencëtarët ishin më tepër të interesuar për historinë dhe gjuhën e arbëneshëve të Zarës. Libra, artikuj shkencorë, recensione librash, intervista etj, u shtypën më të shumtën në Kosovë, më pak në Maqedoni dhe Mal të Zi, e më s'paku në Shqipëri. Nuk është vështirë të shpjegohet ajo gjendje faktike e ngjarjeve. Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi ishin prej mbarimit të Luftës II botërore në përbërje të krijesës shtetërore (Jugoslavisë), në suaza të cilës ishte edhe Zara, bashkë më vendbanimin e afërt, Arbëneshin, për ç'arsye gazetarët, veprimtarët kulturorë dhe shkencëtarët nga të përmendurat republika dhe krahina jugosllave kishin mundësi të udhëtojnë dhe të vizitojnë Arbëneshin e Zarës, të konsultojnë arkivat e pasura të Zarës, si dhe të vendosin kontakte individuale me Arbëneshët e Zarës. Kurse nga Shqipëria deri më vitet nëntëdhjeta të shekullit XX, kur në Shqipëri erdhi deri te ndryshimet demokratike, e mandej deri te çelja e Shqipërisë kah bota, shkencëtarët, publicistët etj. e kishin shumë vështirë t'i vizitojnë Arbëneshët e Zarës, çka është arsyeja kryesore e numrit relativisht të vogël e punimeve të shkruara në Shqipëri për arbëneshët e Zarës. Nuk guxojmë ta shkapërcejmë rolin e SHOQATAVE shqiptare në Kroaci për të njoftuar publikun

lexues shqiptar me arbëneshët e Zarës. Veçanërisht duhet të përmendet aktiviteti i Misionit katolik shqiptar në Zagreb, i cili organizoi dy tubime shkencore të ushtuara krejtësisht ose pjesërisht arbëneshëve të Zarës. I pari i u organizua më 1995 me rastin e 250 vjetorit të vdekje së Vicko Zmajević-it, i cili është më i merituari për ngulimin e arbëreshëve afër Zarës dhe për punën e tij si vizitor apostolik në trevat shqiptare në kohën turke, si dhe për vendstrehimin e ardhacakëve dhe jetesa e tyre e ardhshme në atdheun e ri[87]. Në përmbledhjen, e cila u shtyp në botimin e Misioni katolik shqiptar në Zagreb, referati i arqipeshkvit të Zarës Ivan Prenđa-ës («Kryeipeshkvi Vicko Zmajevich dhe arbëneshët e Zarës») ka të bëjë drejtpërsëdrejti me arbëneshët e Zarës, kurse referati tjetër ka të bëjë pjesërisht me ata.

Të dytin tubim shkencor e organizoi Misioni katolik shqiptar dhe Këshilli i pakicës nacionale shqiptare të qytetit të Zagrebit me rastin 280 vjetorit të ngulimin të arbëneshëve në Zarë. Referatet e lexuara në atë tubim u shtypën në publikim të veçantë[88]. Në atë u botuan referatet e Zef Mirditës («Mbi shpërnguljet e shqiptarëve»), Ivan Prenđa-s («Kryeipeshkvi Vicko Zmajevich dhe arbëneshët e Zarës»), Aleksandar Stipčević-it («Zadarski Arbanassi u svjetlu znanosti i publicistike»), Serđa Dokoze-Nikpalja-s («Arbanasi u Zadru i Hrvatskoj»), Kolec Topallit («Për një shtresim kronologjik të veçorive fonetike në të folmen e Arbëneshëve të Zarës»). Artikujt dhe njoftime të ndryshe për arbëneshët e Zarës i gjejmë po ashtu edhe në revistat e Zagrebit «Informatori», «Iliria» etj Nga titujt e cituar në këtë punim është e QARTË që pjesa më e madhe e tyre ka të bëjë vetëm me vendin Arbënesh, e mandej me kontributin e arbëneshëve të Zarës në literaturë, shkencë, muzikë, politikë, sport e veprime tjera jetësore, por të shpeshta janë edhe intervistat me individë të njohur prej Arbëneshit. Veçanërisht në reportazhet e publicistëve dhe gazetarëve shqiptarë është vërejtur entuziazëm, kur flasin për arritjet e arbëreshëve në fushat e ndryshme të shkencës, artit, muzikës etj, ashtu që më 1962 Zenun Çelaj shkroi që Arbëneshi është «katund, votra kulturore». Nëse atëherë autori e konsideroi Arbëneshin si vatër kulturore, më vonë, për arsye të numrit të madh të arbëreshëve të njohur të cilët u dalluan në fusha të ndryshe të veprimit, udhëpërshkruesit patën mundësi të vërtetojnë konstatimin e atij gazetari, çka ata edhe e kanë bërë. Arbëneshët e Zarës zhvilluan aktivitet të gjallë në studimin dhe

prezantimin e pasurisë së trashëguar, e cila në mjedisin shqiptare u regjistrua në gazeta dhe revista. I përmenduri publict shqiptar, Sylejman Morina i njoftoi lexuesit shqiptarë me një numër të madhë artikujsh, ku shkruan për CD-et dhe DVD-it, të cilat i përgatiti Bernard Kotlari[89], arbënesh i Zarës.

Shkaku i faqeve në disponim, e hoqëm Literaturën. Kërkojmë djesë, Kryeredaktori.

Romeo GURAKUQI
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Departamenti i Historisë

SHQIPËRIA DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE PAS LUFTËS SË PARË BOTËRORE

(1 nëntor 1918 - 9 nëntor 1921) (statusi, kufijtë dhe rindërtimi shtetëror)

Punimi i titulluar: ***Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore****, (1 nëntor 1918 - 9 nëntor 1921) (statusi, kufijtë dhe rindërtimi shtetëror), është një përpjekje për të trajtuar historinë politike të Shqipërisë në një hark kohor që përfshin periudhën nga përfundimi i Luftës së Parë Botërore deri në përcaktimin e statusit ndërkombëtar të këtij shteti dhe kufijve të tij, më 9 nëntor 1921. Përveç historisë politike, monografia merret gjerësisht me trajtimin diplomatik të Çështjes Shqiptare pas Luftës së Parë Botërore, gjegjësisht në Konferencën e Paqes së Parisit dhe në Konferencën e Ambasadorëve që e pasoi atë, deri në zgjidhjen përfundimtare në parim të çështjes së statusit dhe kufijve, më 9 nëntor 1921. Punimi është mbështetur mbi një bazë të gjërë dokumentare që vjen nga Public Record Office, fondet e Foreign Office, nga dokumentet dorëshkrimore që ruhen në Biblioteken e London School of Economics and Political Science, nga dokumentet e botuara të Arkivit Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe një numër burimesh të tjera burimesh arkivore të botuara, italiane, britanike dhe amerikane, që autori ka pasur mundësinë t'i hulumtojë gjatë punës studimore. Pra, bëhet fjalë për më shumë se tre vjet histori politike, diplomatike dhe në një masë më të kufizuar, sociale, kulturore, të Shqipërisë dhe çështjes së saj.*

Vendin kryesor në libër e zë trajtimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes së Parisit. Në fakt, Çështja Shqiptare u

trajtua në këtë hark kohor trevjeçar në tri instanca ndërkombëtare, me radhë dhe paralelisht: në Konferencën e Paqes së Parisit, në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve. Çdo trajtim paralel apo vijues i çështjes shqiptare, ka qenë i lidhur dhe i kushtëzuar nga vendimet themelore të paqebërësve të mbledhur në Konferencën e Paqes së Parisit më 1919. Vetë këto instanca madje ishin ngritur nga forumi më i lartë i Konferencës së Paqes, nga Këshilli Suprem, dhe qenë të ngarkuara për t'u dhënë zgjidhje çështjeve të veçanta që kishte ngritur lufta, mes të cilave edhe çështjes shqiptare.

Çështja shqiptare u lidh nga kjo Konferencë me trajtimin e çështjeve ballkanike dhe asaj adriatikase. Shqipëria dhe çështja e saj, në këtë shqyrtim të gjatë ndërkombëtar, u lidhën në mënyrën më të ngatërruar me një sërë aktesh pararendëse ndërkombëtare, dhe me nyjën e vështirë të një diplomacie të fshehtë që vështirësisht po hapej në një botë të ndryshme. Pavarësisht se Shqipëria ishte viktimë e pushtimeve të njëpasnjëshme të vendeve ndërluftuese gjatë Luftës së Parë Botërore dhe nuk kishte të bënte fare me palët në konflikt, ajo u trajtua njëlloj si vendet humbëse, d.m.th. pretendimet e përfaqësuesve të Shqipërisë për njohjen e shtetit në kufijtë kombëtarë, nuk u morën në konsideratë. Bile përkundrazi, në diskutim të rrezikshëm u vendosën kufijtë e Shqipërisë së vitit 1913. Nga ana tjetër, Serbia dhe Greqia, dy shtetet me të cilat Shqipëria ndante kufirin shtetëror, u konsideruan nga kjo Konferencë si vende fituese e për rrjedhojë pretendimet e tyre territoriale u vlerësuan me një përparësi të veçantë, në dëm të interesave të Shqipërisë dhe në kundërshtim të plotë me parimet e vetëvendosjes së shpallur me aq bujë në Paris. Kjo ngjante sepse politika që u ndoq në punimet e vendimet e Konferencës ka qenë ajo e ndëshkimit për ish-kundërshtarët dhe shpërblimit për aleatët dhe të asocuarit. Paqebërësit e mëdhenj, duke u nisur nga të tilla interesa, dhunuan në një farë mënyrë vetë parimet e kulturës së tyre politike dhe krijuan shtete artificiale, funksioni i të cilave ishte vetëm ndëshkimi i mëtejshëm strategjik i kundërshtarëve të djeshëm të Luftës. Një prej shteteve të shpërblyera me përparësi ka qenë Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene, krijesë kjo që do t'i peshojë rëndë veçanërisht Shqipërisë.

Çështja shqiptare nuk u arrit të zgjidhej në fakt nga Konferenca e Paqes së Parisit, d.m.th. në këtë Konferencë

Shqipëria nuk u copëtua. Por italianët e mbajtën Shqipërinë e pushtuar deri në gushtin e viti 1920, kur shqiptarët u ngritën kundër tyre dhe i hodhën ata në det. Pas këtyre zhvillimeve dhe pas Protokollit Paraprak të 2 gushtit 1920, italianët u tërhoqën ushtarakisht nga Shqipëria, por filluan të zbatojnë një politikë të depërtimit të suksesshëm ekonomik dhe gradualisht edhe politik. Jugosllavët nga ana e tyre, përveçse bënë inkursione të rëndësishme ushtarake brenda vendit, mbajtën deri në fillim të vitit 1922 një rryp të ngushtë toke, që shpesh herë shkonte deri në 15 km në brendësi të kufirit shqiptar të vitit 1913. Çështja e statusit ndërkombëtar të Shqipërisë, çështja e kufijve të saj dhe pozita e Italisë në vendin e vogël ballkanik, është zgjidhur në parim shumë kohë pas Konferencës së Paqes dhe është rregulluar nëpërmjet marrëveshjeve diplomatike. Kurse zgjidhja në terren e problemit të kufijve të Shqipërisë është një proces teknik dhe politik që shkon shumë përtej kufijve kohorë, në të cilët kemi vendosur punimin tonë, dhe nuk do të jetë në këtë rast objekt i këtij studimi.

Përveç trajtimit diplomatik, trajtesa jonë shqyrton, rifillimin e jetës së brendshme politike shqiptare pas Luftës së Parë Botërore, kronologjinë e qeverisjeve nga dhjetori 1918 deri në dhjetor 1921, strukturat konstitucionale mbi të cilat u ndërtuan dhe vepruan qeveritë shqiptare të kësaj kohe, procesin e kristalizimit të partive kryesore politike dhe programet e tyre respektive, rifillimin e ballafaqimit të brendshëm politik e fillimin e veprimeve antikonstitucionale të ndjekura nga individët e caktuar. Një vëmendje e veçantë në këtë monografi u kushtohet përpjekjeve të bashkërenduara private dhe shtetërore, për të mbrojtur tërësinë territoriale të Shqipërisë së vitit 1913, kundër intervencioneve jugosllave, italiane dhe greke, si dhe prirjet destabilizuese që shoqëruan rilindjen e shtetit shqiptar, që më shumë se pjella të ndërhyrjeve të shteteve të interesuara për copëtimin e Shqipërisë, kanë qenë shprehje e ballafaqimit të brendshëm për rrugën drejt së ardhmes, mes forcave politike që mbronin një Shqipëri si zgjatim të Turqisë së djeshme dhe atyre forcave politike të lirisë, që kërkonin një ndryshim të njëmendët në kahun demokratik dhe evropian.

1 nëntori i vitit 1918 është marrë si datë e parë e fillimit të shqyrtimit kronologjik të ngjarjeve, mbasi mund të konsiderohet si data kur fillon procesi i rivendosjes së administratës

ndërkombëtare në Shkodër, qyteti më i madh i Shqipërisë, e së bashku me të kryhet cikli i plotë i ndryshimit të okupimit ushtarak në Shqipëri, e Lufta e Parë Botërore mund të konsiderohet e mbyllur për këtë vend. Si datë përmbyllëse kemi vendosur 9 nëntorin 1921, ditë në të cilin Fuqitë Aleate marrin vendimin përfundimtar mbi statusin dhe kufijtë e Shqipërisë. Vendimi i 9 nëntorit 1921 ka një rëndësi kryesore në listën e dokumenteve ndërkombëtare për njohjen e shtetit shqiptar, ndonëse ky vendim nuk i zgjidhi përfundimisht të gjitha çështjet që lidheshin me Shqipërinë. Duke qenë se përmbyllja e rrugës së filluar me 9 nëntor 1921 është një proces mjaft i gjatë dhe mjaft i ndërlikuar teknik dhe politik, vendosem që librin ta mbyllin në këtë datë. Në funksion të këtyre ngjarjeve të aspektit ndërkombëtar të Shqipërisë janë ndërtuar e përkufizuar edhe të gjitha ngjarjet e planit të brendshëm shqiptar të trajtuara në libër.

Monografia përbëhet nga Hyrja, 12 Kapituj, Përfundimet dhe Bibliografia.

Punimi është fryt i një punë intensive dyvjeçare, kryer gjatë viteve 2005-2006, periudhë në të cilën autori qenë i atashuar pranë *London School of Economics and Political Science*, gjegjësisht pranë *Center for the Study of Global Governance (CSGG), si Research Fellow*. Kjo periudhë ka shërbyer për të bërë një kërkim intensiv pranë *Public Record Office (National Archives*) në *Kew Gardens* (Londër) dhe njëkohësisht për të shfrytëzuar bibliotekën më të pasur të shkencave politike dhe sociale të Mbretërisë së Bashkuar, pra biblioteken e LSE dhe bibliotekën e *School of Slavonic and East European Studies (University College of London*).

Një përgjithësim i përfundimeve në të cilat arrin autori në këtë monografi paraqitet si vijon:

Tri vitet që pasuan Luftën e Parë Botërore janë vitet në të cilat rinis procesi i themelimit të shtetit shqiptar, në aspektin e brendshëm institucional, ashtu edhe në planin ndërkombëtar: njohja e statusit dhe e kufijve të tij. Themi rinis, sepse përpjekjet e para të brendshme më 1912, 1913 dhe 1914, u fundosën nga trazirat sociale, politike dhe fetare, gjegjësisht nga kryengritja e Shqipërisë së Mesme dhe nga përpjekjet uzurpatore të Esad Pashë Toptanit, si dhe nga zhvillimet që pasuan fillimin e Luftës së Parë Botërore. Pushtimet malazeze dhe serbe, e më pas ato austro-hungareze, franceze dhe italiane fshinë strukturat institucionale

shtetërore të shtetit të parë shqiptar pas çlirimit nga Perandoria Osmane. Megjithatë, zonat austro-hungareze, franceze dhe italiane nën të cilat u vendos pjesa më e madhe e Shqipërisë, pas dezintegrimeve që pësuan ushtritë malazeze dhe serbe, përjetuan periudha të qeta, në të cilat jeta sociale dhe kulturore e shqiptarëve pësoi zhvillime të konsiderueshme në orientimin përparimtar. Kjo vinte sepse pushtimet respektive ndryshonin thelbësisht nga ai i vjetri otoman dhe nga pushtimet grabitqare të vendeve të reja ballkanike. Bëhej fjalë kryesisht për zona strategjike okupimi, nën të cilat jeta ekonomike, kulturore dhe arsimore e shqiptarëve u zhvillua me ritme të kënaqshme, krahasuar me periudhën turke. Sidomos në zonën austro-hungareze dhe atë franceze, mund të themi që shqiptarët përjetuan një periudhë rilindjeje të dytë, në aspektin arsimor dhe kulturor. Në një farë mënyre, hyrja e trupave austro-hungareze u mirëprit nga një numër shqiptarësh për shumë arsye: Së pari, këto trupa nxorën jashtë Shqipërisë dhe Kosovës trupat serbe dhe malazeze; së dyti, për shkak se kjo perandori ka qenë arkitektja kryesore e krijimit të shtetit shqiptar më 1912-13; Së treti, në Shqipëri austriakët garantuan një autonomi të kufizuar të brendshme, nën të cilën u krijua një administratë civile e përbërë nga shqiptarë dhe në gjuhën shqipe, u ndërtuan një numër rrugësh dhe urash, dekovili, u financuan dhe u mbajtën shkollat shqipe, u mbështetën botimet e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe dhe studentët shqiptarë u dërguan në shkollat austriake. Edhe në pjesën tjetër të Shqipërisë, në zonën e Korçës, që ndodhej nën fuqinë tjetër kundërshtare, Francën, pati zhvillime të ngjashme në aspektin e zhvillimit politik, kulturor dhe arsimor. Përndryshe, në zonën italiane zhvillime pozitive janë vënë re në aspektin e ndërtimit të disa linjave kryesore të komunikimit. E gjithë kjo ndikoi që rinisja e vitit 1918 të mos ishte e ngjashme, në aspektin e brendshëm shqiptar, me atë të vitit 1912, por të mbështetej mbi një bazë më të gjërë të burimeve njerëzore, arsimore e kulturore. Por gjithsesi, në pikëpamje ekonomike, Shqipëria paraqitej një vend që nuk e kishte kapacitetin e nevojshëm për të riprodhuar kapitalet e nevojshme për nxjerrjen e vendit nga situata nënzhvillimore. Një problem mjaft i rëndë që paraqitej në tërësi në shkallë vendi ishte prapambetja e saj arsimore dhe kulturore, e shkaktuar nga ndalimi i arsimimit në gjuhën shqipe gjatë keqqeverisjes së gjatë turke. Ky nivel i ulët arsimor e bënte jashtëzakonisht të vështirë vendosjen e

një sistemi qeverisjeje modern demokratik dhe parlamentar, për shkak të përhapjes së gjerë të analfabetizmit dhe pushtetit të pakufizuar që gëzonin bejlerët e krahinave të ndryshme të vendit. Një problem mjaft i mprehtë me të cilin do të ballafaqohej vendi ka qenë problemi social, veçanërisht nevoja për një reformë agrare, e ndjeshme veçanërisht në jug të vendit, ku problemi agrar gërshetohej me atë fetar, për shkak se bejlerët e pronësuar nga ish perandoria, zotëronin pjesën më të madhe të tokave, ndërsa fshatarët e krishterë, shqiptarë apo grekë, nuk zotëronin asgjë. Përndryshe, në aspektin ndërballkanik, Shqipëria u ballafaqua pak a shumë në mënyrë të ngjashme, me të njëjtat vështirësi dhe me të njëjtët aktorë, por që tashmë ndodheshin nën një kontroll më të rreptë prej Fuqive Aleate.

Periudha e marrë në shqyrtim në këtë monografi është ndër më të rëndësishmet e historisë kombëtare, pasi në drejtimin e populli shqiptar, u ofruan intelektualë dhe fisnikë të vërtetë, të shkolluar mirë, kryesisht në Perëndim, të cilët kuptuan drejt që *me bashkim mund të rrisnin edhe gjërat e vogla, me mosbashkim edhe të mëdhatë mund t'i shkatërronin.*

Është periudha në të cilën populli shqiptar, ndoshta për herë të parë, i përfaqësuar nga kjo klasë intelektuale dhe qytetare e përgjegjshme, diti të ndikojë mbi vendimmarrjen e politike të brendshme e evropiane, të ruajë të paktën Shqipërinë që kishte fituar më 1913 dhe të mundësojë përfshirjen në diskutim në planet diplomatike edhe të disa krahinave që u ishin marrë padrejtësisht në këtë vit. Një rol veçanërisht të madh kanë dhënë në këtë drejtim patriotët shqiptarë që qenë shtrënguar të emigronin në SHBA pas vitit 1900. Sipas statistikave të regjistrimit, të cilat kemi pasur mundësinë t'i gjejmë në burimet arkivore britanike, pothuajse të gjithë emigrantët e kësaj periudhe ishin të krishterë ortodoksë nga Shqipëria e Jugut. Të brumosur me filozofinë e lirisë, ata luajtën një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e çështjes shqiptare pranë organizmave ndërkombëtare dhe pranë qeverisë së SHBA. Një pjesë e tyre madje u kthye në Shqipëri me një qëllim të qartë dhe krejt ideal: ndryshimin rrënjësor të situatës në Shqipëri, nëpërmjet reformave të menjëhershme politike, institucionale dhe sociale, në mënyrë që të copëtonin dhe zvogëlonin pushtetin ekonomik dhe politik të bejlerëve. Synimi kryesor ishte që forcat e reja intelektuale patriotike, me orientim demokratik dhe perëndimor, të fitonin një zë të rëndësishëm në

përfaqësimin e vendit. Por një ndryshim i tillë i menjëhershëm do të rezultojë praktikisht i parealizueshëm. Një prej arsyeve të impaktit të kufizuar të kësaj nisme, duhet të kërkohet në mungesën e koordinimit efektiv mes nukleve me orientime të tilla përparimtare në Veri të vendit. Megjithatë, për herë të parë në këto vite, në arsyetimin e mendjeve më të shquara të klasës intelektuale filloi të përvijohej nevoja për një orientim të ri të Shqipërisë së re në politikën e jashtme: orientimi anglo-amerikan, d.m.th. nevoja e gjetjes së mbështetjes nga Mbretëria e Bashkuar apo edhe nga SHBA. Dezintegrimi i Perandorisë Austro-Hungareze në përfundim të Luftës së Parë Botërore, u hoqi shqiptarëve në përgjithësi, dhe katolicizmit shqiptar në veçanti, mbrojtësin historik të të drejtave të tyre, pikërisht në momentin që ky vend u çlirua nga pesha e rëndë që ushtronte mbi Shqipërinë që po rilindte, Rusia Cariste, mbrojtësja e botës sllave dhe greke në Ballkan. Shqiptarët u gjendën në momentet e para të fillimit të bisedimeve të paqes në Paris, në një pozicion shumë të vështirë, pikërisht për shkak të mungesës tashmë në skenën ndërkombëtarë të mbrojtësit kryesorë të interesave kombëtare, Austro-Hungarisë dhe për shkak të lëkundjeve të parregullta të Italisë nga pozicioni i shpallur i saj më 1917 në mbrojtje të një Shqipërie etnike. Në fakt, në njëfarë mënyre, patriotët shqiptarë, që më së shumti mbështeteshin tek ish-perandoria dualiste, u gjendën të çorientuar pas Luftës dhe nganjëherë ranë edhe viktima të reflekseve të gabuara politike. Mbi të gjitha, zëvëndësimi i orientimit proaustriak me atë proitalian, nuk rezultoi i goditur, si për shkak synimeve krejt të ndryshme që mbarte Italia në Shqipëri, ashtu edhe për shkak të dallueshmërisë në shkallën e kuptueshmërisë dhe ndjeshmërisë ndaj çështjes shqiptare që ekzistonte mes austriakëve dhe italianëve.

Ndryshimet e kursit të Italisë në të gjithë rrjedhën kohore të marrë në shqyrtim nga ana jonë, erdhën për shkak të vështirësive që ajo ndeshi në realizimin e të gjitha pretendimeve të saj në Adriatik për shkak të kundërshtimit të *Presidentit Wilson*. Sa herë që Italia shihte pamundësi për të realizuar objektivat e veta në Veri të Adriatikut, përpiqej të kënaqej nëpërmjet gjetjes së kompensimeve në Shqipëri. Kjo gjë bëri që ky shtet të prirej më shumë nga gjetja e zgjidhjeve të shpejta duke u marrë veçmas vesh me fqinjët e Shqipërisë, sesa duke vazhduar të mbronte Shqipërinë e vitit 1913. E gjithë balanca e ndryshuar

në arenën ndërkombëtare, pas Luftës së Parë Botërore, shtroi para udhëheqësisë së lëvizjes për rindërtim shtetëror, riorientimin me një elasticitet të ri, të bazuar mbi një logjikë të re, që duhej t'i përshtatej ndryshimeve gjeopolitike ne Evropë, raporteve të reja të krijuara mes Fuqive Aleate, pozicioneve të reja që po merrnin fuqitë e vjetra dhe të reja ballkanike etj. Mirëpo, kjo udhëheqësi, e pa kanalizuar nën një lidership të vetëm, për shkak të mungesës së trashëgimisë shtetërore, nuk veproi si një njësi me vete, me një projekt të qartë strategjik dhe të përpunuar teknikisht. Ministria e jashtme e shtetit shqiptar, ishte një "ndërtesë" imagjinare, e pa strukturuar në asnjë lloj aspekti. Kësisoj, në këtë periudhë mjaft të ndërlikuar politike, kur po rivendoseshin balancat ndërkombëtare, Shqipëria nuk doli me një politikë të jashtme të njësuar, dhe të përpunuar nga ana profesionale. Atë që në fakt duhej ta bënte qeverisja shqiptare (qeverisjet e caktuara të periudhës 1918-1921), e bënë individë vullnetmirë dhe largpamës, që për fat të keq ishin të paktë. Një rol të rëndësishëm në mbruajtjen e një ndjenje të tillë ka luajtur Arqipeshkvi i Shkodrës, Imzot *Jak Serreqi*, i cili u kërkoi përfaqësuesve britanikë në Shkodër, marrjen nën mbrojtje nga ky shtet të Shkodrës dhe Shqipërisë. Ndërsa *Mehmet Konica, Dr. Turtulli* dhe *Mid'hat Frashëri* do të kërkojnë mbrojtjen amerikane dhe, në mungesë të saj, atë britanike

Por zëri i tyre ka mbetur zë i izoluar në shkretëtirë brenda asaj që mund të quhet paria e shqiptarëve, e cila përbëhej nga elemente të orientimeve nga më të ndryshmet, varësisht formimeve arsimore dhe kulturore, varësisht ndërlidhjeve paraprake me shtetet që kishin zotëruar apo ndikuar në Shqipëri, apo për shkak të interesave të vjetra e të reja ekonomike në vend. Mbi të gjitha, Shqipëria e vogël dhe shqiptarët që u munduan ta përfaqësonin atë, e kishin të vështirë të ndryshonin rrjedhat e vjetra dhë të rejave të orientimeve të Fuqive të Mëdha. Por pengesa më e madhe për vetë Shqipërinë, ka qenë prapambetja e thellë e trashëguar nga Perandoria Otomane, prapambetje që e kishte shkëputur këtë vend nga rrjedhat normale të përparimit ekonomik, arsimor dhe kulturor europian, e kishte shndërruar në një geto të varfërisë masive në zemër të kontinentit të vjetër, një vend që e kishte të vështirë të gjeneronte aftësi vetëqeverisëse e të zhvillonte rende institucionale dhe shtet të bazuar mbi forcën e ligjit dhe konstitucionit.

Megjithatë, duke filluar nga periudha e marrë në studim, vërehet në fakt një rënie e politikave të mbështetura tek prijësit dhe të fortët rajonalë dhe fillimi i ndërtimit të politikave të prirura mbi bazën e interesave kombëtare. Është e vërtetë që ky proces tashmë i filluar nuk mund të kishte rikthim. Por, për shkak të bagazhit të prapambetur e shkallës së ulët kulturore që mbante trupi jetësor i vendit, ai është një proces zhvendosjeje progresive që nuk ecën lehtësisht në truallin shqiptar. Thënë ndryshe, nga kjo kohë filluan të shihen sinjalet e para që besnikëria ndaj prijësve të ndryshëm filloi të konvertohet ngadalë në një besnikëri ndaj qeverisë qëndrore. Mirëpo, vertetë nga skena politike vërehet shuarja graduale e Esat Pashës, por fara që e kishte mbjellë pashain tiranas, ishte brenda vendit, dhe kushtet për riprodhime apo riciklime të ngjashme ishin ende pjellore në Shqipëri. Të vetmet ndryshime pozitive që do t'i jepnin efektet më vonë, kanë qenë mosvarësia e mëtutjeshme e vendit nga Perandoria Otomane që i kishte hequr klasës së vjetër feudale mbështetjen politike të mëparshme, era e re që frynte në kontinentin e vjetër pas Deklaratës së famshme të presidentit Wilson, e cila nuk mundësonte më ndërtime sistemesh shtetërore obskurantiste. Një ndryshim shumë i rëndësishëm qenë vetë shqiptarët e rinj që po shkolloheshin në perëndim, apo në shkollat laike që drejtonte Kisha Katolike dhe vendet perëndimore në Shqipëri.

Kjo zhvendosje progresive e mekanizmit të funksionimit të politikës shqiptare dhe rajonale nga duart e vjetra, në duart e djalërisë shqiptare, është penguar nga rivaliteti i ashpër në territorin shqiptar në mes Mbretërisë së Italisë dhe Mbretërisë SKS, e në fund nga krijimi i një situate trazire të përhershme nga Greqia në Jug të vendit. Paria politike shqiptare nuk arriti të kapërcejë vështirësitë e krijuara nga ky rivalitet e ndërhyrje, nëpërmjet krijimit të një lobi zyrtar probritanik, apo proamerikan që do të mundësonte mbrojtjen nga Fuqi të tjera larg interesave rajonale.

Për të gjitha këto arsye, zëri në mbrojtje të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris nuk ka qenë një, e vizioni i rindërtimit të Shqipërisë se re nuk ka qenë ai që duhej të ishte. E gjithë kjo ka ndikuar në një ndjeshmëri minimale në vendimarrjen e paqebërësve të mëdhenj, dhe në planin e brendshëm, në fragmentarizimin e qeverisjeve, si në planin hapësinor, ashtu edhe në atë kohor. Mbi të gjitha, mosgjetja e konsensusit të brendshëm

për të ndërlidhur Shqipërinë e viteve 1918, 1919, 1920 me Shqipërinë e viteve 1913, 1914 në pikëpamje institucionale, dëmtoi rëndë përpjekjet për rindërtim paqësor, logjik dhe të monitoruar të institucioneve kushtetuese shtetërore, krijoi pështjellim të brendshëm në atë që mund të quhet klasë politike shqiptare për një periudhë gati 10 vjeçare, krijoi hapësirë më të madhe për ndërhyrje të fuqive ballkanike dhe adriatikase në dëm të Shqipërisë dhe ndihmoi në zgjatjen edhe për tre vite të procedurave, fillimisht politike e më pas ligjore, të zgjidhjes së statusit ndërkombëtar dhe kufijve të shtetit shqiptar. Paria shqiptare bëri një gabim të rëndë teknik në mbështetjen e kërkesës politike: ajo shkëputi çështjen e njohjes së statusit të Shqipërisë nga vetë Shqipëria si shtet tashmë i formuar, i njohur ndërkombëtarisht më 1913 dhe i institucionalizuar më 1914. Ne nuk mund të themi se një kërkesë e tillë nuk ka ekzistuar, por duke mos qenë e lidhur me të gjithë trashëgiminë e kësaj periudhe, me institucionin e Princit, statutin themeltar shtetëror të përvijuar aso kohë nga vetë Fuqitë (KNK), qeverisjen etj., kërkesa e mësipërme humbte peshën, krijonte një vakuum të tejzgjatur institucional, linte shkas për rigjallërimin e aventurierëve apo lindjen e të rinjve, mundësonte keqinterpretime, krijonte destabilitet të tejzgjatur politik, ndërsa në planin e jashtëm i jepte një shkas më shumë intepretimit pozitiv të Traktatit të Fshehtë te Londrës e keqinterpretimeve më pas të vendimeve të karakterit operativ të Këshillit Suprem të Fuqive Aleate e ndërlidhjes gati të pafundme të çështjes shqiptare me Çështjen e Adriatikut. Mirëpo ata udhëheqës shqiptarë që e kanë menduar këtë kanë qenë të paktë, e mbi të gjithë ka munguar vullneti i përbashkët për të ndjekur, me ose pa princ *Wied*-in, legalitetin e vitit 1914. Rivendosja e Turhan Pashës në krye të qeverisjes së re në dhjetor 1918 nuk e plotësonte dot të gjithë spektrin e kthimit të legalitetit të periudhës së para Luftës. Mbi të gjitha, një qeveri e venë nën presion dhe në ndonjë parametër edhe nën kontroll nga njëra prej Fuqive të interesuara dhe nënshkruese të Traktatit të Fshehtë të Londrës, e bënte plotësisht infektive përpjekjen për rilindje dhe rikthim të legalitetit. Ndryshe nga çfarë është shkruar deri më tani, autorit nuk i rezulton se shkalla e kontrollimit të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, nga autoritetet italiane të pushtimit, të ketë qenë deri nivelin e një qeverie kukull. Natyrisht, hapësira në të cilën e ka ushtruar veprimtarinë Qeveria e Përkohshme ka qenë

krejtësisht e kufizuar dhe forca imponuese e ushtarakëve italiane ka qenë e madhe. Nga ana tjetër, baza mbi të cilën u ngrit kjo qeveri, ka qenë një lloj marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë në planin ndërkombëtar, gjë që është shkelur tërësisht nga pala italiane. Politikanët shqiptarë të qeverisë së Durrësit e mbrojtën me dinjitetet të plotë çështjen kombëtare në të gjitha instancat ndërkombëtare, madje duke kundërshtuar edhe qëndrimin e Italisë. Por për shkak të situatës në terren, startit fillestar të saj, kjo qeverisje erdhi duke e humbur gradualisht efektivitetin dhe kuptueshmërinë, e ndërrimi i saj pas Kongresit të Lushnjës, ishte një veprim krejt i logjikshëm dhe përparimtar. Kongresi i Lushnjës, në një farë mënyre, e la të hapur çështjen e rivendosjes së statusit të vitit 1914, por kjo gjë nuk u shoqërua me një vendosmëri më të madhe në rikthimin e legalitetit të periudhës në fjalë, duke përvijuar rrugën e bisedimeve të mëtejshme politike, qoftë në planin e brendshëm, e mbi të gjitha në planin e jashtëm. Gjithsesi, duhet të kemi parasysh se rrethanat politike të vitit 1920 nuk mundësonin debate të pafundme për të mbushur mendjet e të gjithë prijësve fisnorë për rrugën që duhej ndjekur. Momenti kërkonte zgjidhje të shpejta afatshkurtra, me hapësira për ndërlidhje afatgjata institucionale. Vetë realiteti shqiptar paraqitej mjaft i ndërlikuar dhe nuk premtonte që një zgjidhje e përshtatshme dhe funksionale të arrihej në mënyrë të përnjëhershme. Në fakt, në pesë vitet që vijuan, Shqipëria përjetoi sistematikisht trazira politike, të cilat u mbyllën vetëm me vendosjen e dorës së fortë të Ahmet Zogut.

Në planin e marrëdhënieve ndërkombëtare, monografia e trajton çështjen shqiptare, gjegjësisht statusin dhe kufijtë e Shqipërisë, në një hark kohor trevjeçar, në tri forume ndërkombëtare, dy nga të cilat, Konferenca e Paqes në Paris dhe Konferenca e Ambasadorëve, të ndërlidhura në aspektin funksional dhe insitucional. Punimi përpiqet të sistemojë kronologjikisht të gjithë rrjedhën e trajtimit të problemit shqiptar dhe të analizojë pak a shumë qëndrimet e Fuqive Aleate dhe atyre të Asocuara, nga dita e parë e paraqitjes se prezantimeve të qeverisë shqiptare të Durrësit dhe vendeve të lidhura me çështjen shqiptare, deri më 9 nëntor 1921, kur statusi i Shqipërisë zgjidhet *de jure*. Duhet të nënvizojmë se për më se dy vjet (nga muaji prill 1919-deri në nënshkrimin e Traktatit të Rapallos, 12 nëntor 1920), problemi i Shqipërisë nuk është trajtuar si një problem me vete,

por si pjesë e problemeve madhore me të cilat u morën paqebërësit e mëdhenj. Pse ndodhi një gjë e tillë? Duhet të kuptojmë se paravërsisht nga Doktrina e Re që Presidenti Wilson promovoi në përfundim të Luftës së Parë Botërore, një pjesë e rëndësishme e problemeve të mbartura dhe të lindura pas Luftës, vazhduan të trajtohen me parimet e Diplomacisë së Vjetër. Dhe është e kuptueshme që në këtë moment tranzicioni mes dy konceptimeve të punës së diplomacive, sfidat të merrnin trajtime të dyfishta. Arsyeja e dytë ka të bëjë me faktin që, me fillimin e punës së Konferencës së Paqes, Aleatët nuk kishin arritur ndonjë marrëveshje të veçantë në lidhje me Shqipërinë. Për Çështjen Shqiptare, të përfshirë brenda Çështjes së Adriatikut, apo Çështjes Greke, nuk është arritur ndonjë rezultat konkret pozitiv gjatë gjithë vitit 1919. Kthesa e parë pozitive, që ka ndryshuar rrjedhën, së paku të trajtimit të problemit shqiptar, ka ardhur nga nota amerikane e 6 marsit 1920, në bazë të së cilës kërkohej që çështja shqiptare të mos përfshihej në diskutimet e përbashkëta në mes Italisë dhe Jugosllavisë. Gjithashtu, presidenti Wilson nuk e aprovoi me këtë rast që tokat shqiptare në Veri dhe në Jug të përdoreshin si kompensime territoriale për toka që Jugosllavia dhe Greqia ishin privuar diku tjetër. Ndërhyrja e qeverisë amerikane përbën goditjen e parë të fuqishme ndaj Traktatit të Fshehtë të Londrës e njëkohësisht një zhvlerësim të parë të Marrëveshjes Tittoni-Veniselos. Në thelb, këmbëngulja e presidentit Wilson, në zbatimin e parimit të vetëvendosjes, çoi në kapitullimin e italianëve në lidhje me Shqipërinë, që në tre muajt e parë të vitit 1920. Kjo ndërhyrje bëri që plani britaniko-franco-italian për ndarjen e Shqipërisë të arkivohej dhe Konferenca e Paqes të mbyllej pa rritur ndonjë marrëveshje për Shqipërinë. Në këtë mënyrë, praktikisht, Shqipëria i shpëtoi copëtimit. Ndryshimi i qëndrimit amerikan ka pasur tre përbërës të rëndësishëm: së pari, ai i lidhur me filozofinë që e ka drejtuar politikën e jashtme amerikane në këtë kohë, që është filozofia e lirisë dhe e vetëvendosjes së popujve; së dyti, skuadra e ekspertëve amerikane në bisedimet e paqes, erdhi duke e zgjeruar nivelin e njohurive teknike për Shqipërinë dhe elementet përbërëse të çështjes së saj; së treti, një kontribut të pamohueshëm ka dhënë komuniteti ortodoks i Shqipërisë, për ndriçimin e realitetit etnik-kulturor dhe politik në Shqipërinë e Jugut, e në radhë të parë emigracioni

shqiptar në SHBA, nga Rumania dhe në mënyrë të spikatur vëllezërit, *Faik* dhe *Mehmet Konica*.

Megjithëse Shqipëria shpëtoi nga pushtimi në Konferencën e Paqes, ajo vazhdoi të mbetej e pushtuar prej ushtrive të huaja. Në këtë moment, vendimtare ka qenë nisma e ndërmarrë nga udhëheqësit nacionalistë, për riorganizimin politik të vendit dhe fillimin e përgatitjeve ushtarake për çlirim. Kongresi i Lushnjës ndërtoi rrugën e Shqipërisë drejt shtetformimit: Mbajtja e zgjedhjeve elektorale çoi në mbledhjen e së parës Asamble kombëtare legjislative në Tiranë, më 27 mars 1920 dhe fillimin e jetës parlamentare shqiptare; krijimi i një Regjence të përbërë nga katër shtyllat përbërëse fetare të Shqipërisë, ka shërbyer si një zgjidhje e mençur për të mbajtur të balancuar dhe të stabilizuar në këtë aspekt vendin; themelimi i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare shërbeu më pas si një institucion për vendosjen e integritetit të shtetit, një instrument i rëndësishëm për çlirimin e vendit, që hapi rrugën drejt largimit të italianëve nga Shqipëria dhe frenoi serbët nga përparimet e mëtejshme.

Një moment shumë i rëndësishëm i vitit 1920 ka qenë pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve me 17 dhjetor 1920. Ky akt shërbeu si një moment i kthesës së plotë në të mirë të çështjes së Shqipërisë, mbasi Shqipëria u njoh si një shtet sovran dhe i pavarur. Ky pranim hap rrugën për diskutimin profesional të një problemi shumë të papërcaktuar në të drejtën ndërkombëtare të asaj kohe; d.m.th., pranimi i një vendi në Lidhjen e Kombeve a përbënte një akt të barazvlefshëm me njohjen e këtij vendi nga ana e po atyre shteteve që e kishin votuar në këtë organizëm ndërkombëtar? Ky ka qenë fjalëkryqi që Fuqitë Aleate u përpoqën t'i japin përgjigje juridike dhe politike. Natyrisht, ky problem thjesht teknik nuk ka qenë i vetmi në pengesat që duhej të zgjidhnin Fuqitë Aleate për Shqipërinë, por gjithsesi, zgjidhja e kësaj nyjeje juridike lehtësoi gjykimin politik dhe asnjanësoi të gjitha përpjekjet e vendeve të interesuara për ta mbajtur Shqipërinë një territor të varur politikisht dhe ushtarakisht.

Mjaft i rëndësishëm mbetet analizimi i qëndrimit britanik. Bëhet fjalë për një Fuqi Aleate pa interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri, por një fuqi e vendosur në një pozicion udhëheqës në zgjidhjen e problemeve të mbartura nga Lufta e Parë Botërore, e kësisoj, e interesuar për t'i siguruar stabilitet kontinentit në vjetër në tërësi. Duhet të nënvizojmë se që nga fillimi i Konferencës së

Paqes, e në vijim deri në zgjidhjen e statusit të Shqipërisë, vërejmë një rrjedhë të caktuar të qëndrimit të FO në lidhje me Shqipërinë. Në faqet e librit njihemi me hollësi për qëndrimin që ka mbajtur në kohë të ndryshme FO, dhe njëkohësisht me dinamiken e këtij qëndrimi. Kjo rrjedhë është e përcaktuar nga nevoja për të ruajtur raportet e vendosura me fuqitë kryesore aleate me interesa në rajon dhe Shqipëri, për të pasur të njëjtën përkrahje më pas, në hapësirat ku Mbretëria e Bashkuar mbronte interesat e veta perandorake. Kështu për shembull, fillimisht, politika e jashtme e FO është drejtuar nga nevoja për të mbështetur Francën në planin e Konferencës, e cila, nga ana e saj, mbështeste mëtimet greke dhe jugosllave. Më pas, një rol veçantë në ndjekjen e një orientimi progrek të FO pati mbrojtja që kryeministri Veniselos i bëri çështjes greke në Konferencën e Paqes. Ndryshimi i qëndrimit britanik ka qenë krejt gradual, shpesh herë me hapa edhe prapa, varësisht zhvillimeve të problemeve madhore në lidhje me çështjen shqiptare, dhe ndërlidhur me fillimin e zbatimin nga ana e FO të parimeve të Diplomacisë së Re. Megjithatë, duhet të thuhet se që në fillim britanikët nuk kanë qënë në të mirë të mëtimeve të padrejta të jugosllavëve për sa i përket Shqipërisë së Veriut, ndërsa për sa i përket Shqipërisë së Jugut, ky qëndrim ka qenë në të mirë të dhënies së pjesës më të madhe të Shqipërisë së Jugut Greqisë, por është rrotulluar 360 gradë, në fund të periudhës, së bashku me ndryshimin e qëndrimit të diplomacisë franceze e varësisht kundërshtimit serioz të diplomacisë amerikane në këtë çështje. Për sa i përket Shqipërisë së Jugut një ndikim të veçantë ka pasur marrja e informacioneve të besueshme, veçanërisht nga konsulli *Eyres*, se popullsia e këtij rajoni ishte e kënaqur me qeverisjen e qeverisë shqiptare të Tiranës gjatë vitit 1921, dhe se popullsia ortodokse shqiptare ishte një realitet ekzistues, madje mazhoritar në këtë krahinë. Kur në fund të muajit prill 1921 qeveria shqiptare i kërkoi Këshillit të Lidhjes së Kombeve t'u jepte një zgjidhje përfundimtare problemeve që kishin lidhje me Shqipërinë dhe çështja u kalua për shqyrtim në Konferencën e Ambasadorëve, diplomacia britanike, me sa kuptohet, e kishte ndarë mendjen në dhënien sa më parë të zgjidhjes së problemit dhe i vetmi shqetësimi procedural për te, mbetej ai i zgjidhjes juridike të problemit. Në planin politik probleme më vete paraqitej edhe kapërcimi i këmbënguljeve të fundit e të pasinqerta të Italisë, dhe

mundësia e goditjeve të papritura, të minutës së fundit, prej anës së shteteve të papërgjegjshme ballkanike (Greqia dhe Mbretëria SKS). Është vendi këtu të bëjmë një dallim thelbësor në mes Greqisë dhe Mbretërisë SKS: Qenia e Veniselos-it në krye të qeverisë greke u ka mundësuar Aleatëve një kontroll të plotë të politikës greke në lidhje me Shqipërinë e Jugut, duke shmangur plotësisht veprimet e pakontrolluara ushtarake të ekstremistëve. Krejt e kundërta ka ngjarë me qeverinë e Beogradit, e cila, e kontrolluar nga klanet më të fuqishme serbomëdha, ka qenë plotësisht e pamenaxhueshme për Fuqitë Aleate në politikën e veprimet ushtarake ndaj Shqipërisë së Veriut. Ndryshimi dhe serioziteti me të cilën e trajtoi diplomacia britanike, e drejtuar nga *Earl Curzon*-i, çështjen shqiptare në muajt e fundit para zgjidhjes përfundimtare, pat si rezultat kërkesën këmbëngulëse dhe refuzimin e Lord Curzon-it që çështja shqiptare të vazhdohej të trajtohej si pjesë e zgjidhjes së përgjithshme të problemeve të Adriatikut dhe Ballkanit.

Ndërsa, për sa i përket Italisë, duhet të themi se, kur ajo hoqi dorë përfundimisht prej Traktatit të Fshehtë të Londrës së vitit 1915 (edhe kjo është relative sepse politika e jashtme italiane ndaj Shqipërisë ka ndryshuar mjaft edhe brenda të njëjtit kabinet qeveritar), po mendojmë, kur erdhi në pushtet *Giovanni Giolitti*, ajo mbështeti kufijtë e Shqipërisë së vitit 1913, mbasi këto kërkesa përkonin me interesat e saj, që kishin të bënin me eliminimin e ndikimit jugosllav apo grek në bregun lindor të Adriatikut. Megjithatë, në tërësi, madje edhe në momentet më të fundit, kur çështjes shqiptare po i jepej zgjidhja, duhet të themi se diplomacia italiane nuk është sjellë në mënyrë të sinqertë, qoftë me Fuqitë Aleate negociatore, e para së gjithash me aspiratat e popullit shqiptar. Kanë qenë pikërisht ndërhyrjet e Lordit Curzon-it që në tre muajt e fundit, para përcaktimit të statusit, arritën të shpërbëjnë nga njëra-tjetra, pjesën e ligjshme dhe të sinqertë të qëndrimeve të Italisë, nga pjesa e pasinqertë, që synonte kufizimin e pavarësisë së Shqipërisë. Mund të thuhet se rënia e politikës së jashtme italiane në lidhje me Shqipërinë, në planin e autoritetit të Fuqisë së Madhe negociatore, ka qenë e plotë. Përndryshe, nga pikëpamja e synimeve të saj minimale (kufizimi i ndikimit grek dhe serb në Shqipëri), ajo politikë ia ka arritur qëllimit. Politikëbërësit italianë në lidhje me Shqipërinë, në të gjithë veprimtarinë e tyre trevjeçare bënë një seri gabimesh, në

gjykimet dhe analizat e tyre. Këto gabime nisin me përpjekjet për ta vënë në kontroll të paarsyeshëm dhe përkundrejt interesave kombëtare shqiptare, qeverinë e Durrësit, kthimin e Shqipërisë në një *placdarm* për agresion të nacionalistëve malazezë kundër Mbretërisë SKS, këmbëngulja e pafundme për zbatimin e klauzolave të Traktatit të Londrës, apo përpjekja për ta mbajtur pjesore hijen e këtij traktati famëkeq, përpjekjet për të ndaluar mbajtjen e Kongresit të Lushnjes në të mirë të qeverisë tashmë të kontrolluar plotësisht të Durrësit dhe në fundin e serisë së qëndrimit të saj, përpjekja për të ndikuar në përmbysjen e qeverisë së Sulejman Delvinës duke financuar përpjekjen e dështuar të përkahësve të Esad Pashës dhe përgjithësisht përpjekja për ta zgjatur pa fund për interesat e veta në planin e diplomacisë së Fuqive të Mëdha, çështjen e statusit të Shqipërisë. Të gjitha këto sa thamë më sipër, janë tregues jo vetëm të humbjes së besimit në politikën italiane nga ana e shqiptarëve, por, para së gjithash, janë tregues të një politike dritëshkurtër, aspak racionale dhe mjaft egoiste.

Kur Këshilli i Ambasadorëve të Fuqive Aleate u mblodh në Paris, në fakt përfaqësuesi britanik ende pretendonte dhënien Shqipërisë Jugore, d.m.th. asaj në jug të vijës *Tittoni-Veniselos*, Greqisë, mbasi në gjë e tillë edhe ishte këshilluar nga ekspertët britanikë. Mirëpo italianët dhe francezët kundërshtuan dhe atëherë britanikët, me anën e eksperteve të tyre, patën kohë të riekzaminojnë çështjen dhe të japin edhe ata verdiktin në të mirë të kësaj zgjidhjeje që përfshinte edhe jugun e Shqipërisë brenda shtetit shqiptar. Si parim i përgjithshëm u përcaktua vendosja e kufijve të vitit 1913 dhe iu la ekspertëve që të propozojnë modifikime në Lindje dhe në Veri, në mënyrë që ta bënin më të logjikshme ndarjen e kufirit. Mirëpo rekomandimet e ekspertëve nuk qenë shumë rezultative në lidhje me Shqipërinë, për sa kohë që ato u shoqëruan me cungime të mëtejshme territoriale në Lindje dhe nuk bënë asgjë në lidhje me përfshirjen e dy fiseve të rëndësishme të Malësisë, Hotit dhe të Grudës në Shqipëri. Rimbajtja jashtë Shqipërisë, për së dyti, e Hotit dhe Grudës, i hoqi Shkodrës dhe katolicizmit shqiptar dy krahë të rëndësishëm të energjisë dhe peshës së saj tradicionale politike në Shqipëri. (Për fat të keq, problemi i Triepshit dhe Kojës u la krejt në heshtje, mbasi, siç kuptohet, konsiderohej i kapërcyer nga diplomacia britanike, për shkak të një aneksimi më të hershëm të këtyre dy

fiseve të Malësisë prej Malit të Zi, d.m.th. pas krizës Ballkanike 1875-1878. Ndërsa në lindje, nevoja për të krijuar një basen praktik komunikimi dhe njëkohësisht marrëdhëniesh ekonomike për qytetet dhe rrethinat e Dibrës dhe Prizrenit, i hoqi Shqipërisë rreth 400 km2, të banuar nga popullsi e pastër shqiptare

Ky qe epilogu teorik i zgjidhjes së problemit të kufijve të shtetit shqiptar në tavolinën e bisedimeve të Konferencës së Ambasadorëve. Zgjidhja teknike është një odise e vërtetë, që do të zgjasë edhe për disa vite të tjera. Duke filluar nga vitit 1922, të gjitha trupat jugosllave dhe greke u larguan nga territori i Shqipërisë. Por Shqipërisë do t'i duhej të priste deri më 30 korrik 1926, kur Greqia, Mbretëria SKS, së bashku me Britaninë e Madhe, Francën dhe Italinë, të nënshkruanin marrëveshjen përfundimtare që njihte kufijtë e Shqipërisë. Gjithashtu, problemeve të papjekurisë së brendshme të institucioneve demokratike në Shqipëri, vazhduan t'i bashkëngjiten me intensitete të ndryshme intrigat italiane dhe jugosllave, të cilat bënë që procesi i stabilizimit shtetëror të jetë një proces shumë i vështirë.

HULUMTIME

Emilio BERTOTTI

"EKSPEDITA JONË NË SHQIPËRI"

Materiali i botuar më poshtë është përgatitur nga kujtimet e gjeneralit italian Emilio Bertotti, i cili ka qenë komandant i Trupave Speciale në Shqipëri dhe i ka botuar ato në librin e tij "Ekspedita jonë në Shqipëri", ku ai u referohet edhe disa kolegëve të tij të ushtrive të tjera që asohe kanë luftuar në territorin shqiptar.

Lufta e Parë Botërore, e cila preku dhe Shqipërinë, është bërë objekt i hulumtimeve nga shumë historianë dhe studiues të huaj, të cilët duke shfrytëzuar kujtimet e botuara nga ish-ushtarakët që kanë qenë në Shqipëri, si dhe dokumentacionet e pasura që janë ruajtur nëpër arkivat e Italisë, Austro-Hungarisë, Pragës, Beogradit e disa shteteve të tjera evropiane të cilat u përfshinë në vorbullën e asaj lufte, herë pas here kanë botuar libra të cilët kanë ngjallur interesa nga lexuesit e shumtë.

"Golgota shqiptare"

Duke parë se ushtria serbe e kral Pjetrit u mund përfundimisht në fushën e luftës nga ana e austriakëve, si rrugëzgjidhja e vetme për të shpëtuar të gjallë pjesën e mbetur të asaj ushtrie u pa kalimi nëpër territorin shqiptar për të dalë në detin Adriatik e më pas për t'u rikthyer në Beograd. Tërheqja e Ushtrisë serbe nëpër Shqipëri, konsiderohet si një nga ngjarjet më tragjike të Luftës së Parë Botërore, apo siç njihet ndryshe nga studiuesit e shumtë që janë marrë me atë periudhë si "*Lufta e Madhe*". Aty nga fillimi i tetorit 1915, pasi Ushtria serbe u sulmua në pjesën veriore të saj nga forcat austro-gjermane dhe në lindje nga bullgarët, të cilët kishin si synim që të pengonin bashkimin e forcat franko-angleze që ishin dislokuar në Luginën e Vardarit, ushtria serbe u detyrua që të sprapsej drejt Perëndimit ku kishte mbështetjen e malazezve. Pas këtij vendimi nga Nishi ku

ishte dislokuar, filloi tërheqja e gjithë ushtrisë dhe në ballë të kolonës së gjatë prej 70 mijë forcash, ata kishin vënë robërit austro- hungarezë, të cilët i kishin zënë rob gjatë luftimeve që kishin zhvilluar në fazën e pare të luftës. Sipas burimeve të ndryshme arkivore italiane, udhëtimi i asaj kolone të gjatë të forcave serbe nëpër malet dhe gërxhet me borë të Shqipërisë së Veriut, ishte një ferr i vërtetë për Ushtrinë serbe, të cilët detyroheshin të marshonin ditë e natë pa pushim për të shpëtuar nga hakmarrja e kundërshtarëve të tyre që po i ndiqnin nga veriu dhe lindja e Serbisë. Gjatë atij marshimi rraskapitës nga kushtet e vështira të motit, në radhët e Ushtrisë serbe, e cila gjithashtu ishte dhe e paushqyer, pati humbje të mëdha prej epidemisë së tifos që preku një pjesë e madhe të ushtrisë, duke bërë që t'i shpëtojnë atij kalvari vetëm 27 mijë prej tyre.

Lidhur me këtë ka shkruar në kujtimet e tija dhe ish-oficeri çekosllavak, *Rudolf Prohaska*, në një libër që e ka botuar në Pragë në vitin 1928.

Në kujtimet e tij, Prohaska shkruan: "Gjatë atyre dy muajve, tërheqja e robërve çekë së bashku me masën e robërve austro-hungarezë në krye të Ushtrisë serbe, ishte një përvojë e tmerrshme për ne. Asokohe ne ecnim e marshonim të rraskapitur nëpër atë ngricë dhe acar, ku nga çasti në çast mund të gjenim vdekjen nga të papriturat e asaj rruge në shkrepa malesh të mbuluara me dëborë. Shumica e ushtarëve ishin të lehtësuar disi nga pajimet personale që mbanin mbi shpinë, sepse gjatë rrugës në afërsi të fshatrave ata i kishin shkëmbyer rrobat e batanijet me mish gjengji dhe patate me banorët e rrallë të atyre zonave ku kaluam".

Pas përshkrimeve të hollësishme të atij marshimi, ish-oficeri çekosllavak Prohaska, i zënë rob nga forca e Ushtrisë serbe, në librin e tij flet dhe për shqiptarët. Në mes të tjerash ai shprehet: "Të pajisur me një instikt të paepur për lirinë, por të privuar nga sensi i disiplinës, në rebelime të përgjakshme e të vazhdueshme me autoritetet e veta, të papërgatitur për çdo shkëndijë të pranimit të shtetit dhe të ndarë në klane (fise) përjetësisht rivalizuese me njëri-tjetrin, ata preferonin më mirë të merreshin vesh me robërit austro-hungarezë, sesa me serbët që i shihnin në mënyrë armiqësore". Në fund të atij kapitulli ku Prohaska flet mbi vuajtjet dhe torturat që pësuan ushtarët serbë në atë marshim rraskapitës që bënë në territorin shqiptar, ai shprehet:

“Jo të gjithë ushtarët serbë i rezistonin mundimeve mbi shtigjet me borë të atyre maleve të larta. Kush binte i rraskapitur, vdiste pa pasur mundësi që t’i jepej asnjë ndihmë. Gjatë atij marshimi serbët hodhën në lumin Drin të gjitha ato pajisje që i pengonin për të ecur, si kamionë, topa e deri dhe automobilin e Mbretit të tyre Pjetrit”.

Okupimi i Shqipërisë

Lidhur me vorbullën e Luftës së Parë Botërore ku u përfshi dhe territori shqiptar, autori gjerman *Helmut Shvanke* shkruan: “Prej fronteve më të vogla të Luftës së Madhe (është fjala për Luftën e Parë Botërore) si ato palestineze, kaukaziane, mesopotamike, dardaneleve, frontet e ndryshme koloniale dhe ai për zotërimin e Kanalit të Suezit, fronti shqiptar ishte ai që zgjati më tepër, i shtyrë deri në përfundim të konfliktit botëror, edhe pse sigurisht njëri prej më pak të përgjakshmeve. Por ka qenë një front me aspekte tepër dramatike, nëse llogaritet përveçse Ushtrisë serbe, lufta detare, në sipërfaqe e nën det për kontrollin e kanalit të Otrantos. Fronti shqiptar ishte edhe strategjikisht i rëndësishëm për kufizimin e presioneve aneksioniste të vendeve kufitare dhe sepse kishte hyrë në pengesën ballkanike të Antantës.

E bërë e pavarur një vit para shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u kthye përsëri për të qenë gjatë konfliktit një vend i okupuar, ashtu siç kishte qenë në shekuj nga pushtimet e romake dhe bizantine. Në atë luftë të madhe ajo u okupua në dy të tretat e territorit të saj, prej austro-hungarezëve dhe në pjesën tjetër në Jug prej italianëve e francezëve.

Bombardimi i Durrësit, i cili ndodhi më 6 dhjetor 1915 nga anijet e flotës austro-hungareze, kishte shtyrë Esad Pashën, i cili në atë kohë kishte pasur Princ Vidin, për tu tërhequr në Tiranë. Duke lëvizur nga liqeni i Ohrit, bullgarët depërtuan ndërkaq nëpër Shqipërinë qendrore dhe pushtuan qytetet e Beratit, Fierit dhe Kavajës. Në nëntor të atij viti komanda supreme gjermane kishte tërhequr nga fronti shqiptar pothuaj tërësisht trupat e saja. Nga kjo gjë u gjendën të lirë austro-hungarezët, të cilët vendosën për të pushtuar Malin e Zi dhe Shqipërinë. Nga ana e gjermanëve kjo gjë u pa si një zgjidhje e pakëshillueshme dhe e diskutueshme për aleatët e tyre austriakë, për arsye se shikohej e pamundur furnizimi i ushtrisë në rajonet pa rrugë që kishin ato vende dhe ku armiqësitë në mes popullsive ishin evidente. Në

këtë kontekst ai veprim do t'u kërkonte një shpërpjesëtim të madh ushtarak. Për pushtimin e Malit të Zi, austro-hungarezët përdorën në fakt më tepër trupa se në Serbi, gjë e cila ishte e barabartë me 20 % të popullsisë vendase. Pasi kishin pushtuar në fillim të janarit 1916 Lovqenin, austro-hungarezët e patën rrugën të lirë për të marshuar në drejtim të Shkodrës dhe Shqipërisë Veriore", shkruan autori gjerman Helmut Shanke në librin e tij.

Austro-hungarezët në Vjosë

Nisur nga situata që po precipitonte në atë kohë në Shqipëri, trupat italiane duke përfituar prej vështirësive të trupave austrohungareze, nisën mbrojtjen e Durrësit me brigadën "Savona" , Batalionin 159 territorial dhe disa bateri artilerie. Por me gjithë angazhimin e gjithë këtyre forcave, në shkurtin e vitit 1916 trupat italiane u thyen nga sulmet e katër brigadave austro-hungareze. Nga fundi i shkurtit qyteti i Durrësit ishte zbrazur plotësisht nga trupat italiane të cilat u imbarkuan nëpër anije, por pa mundur që të merrnin me vete instalimet e artilerisë të cilat mbetën tërësisht të paprekura në dorën e ushtrisë austro-hungareze. Pas rënies së Durrësit, aty nga prilli i vitit 1916, trupat austro-hungareze përparuan deri në brigjet e lumit të Vjosës, i cili shënonte dhe vijën kufizuese të frontit me italianët. Objektivat e ekspeditës italiane në Shqipëri, mbetën pothuaj të kufizuara në zotërimin e pjesës jugore dhe në lindje me armatën franko-angleze të komanduar nga gjenerali francez Serrail, që vepronte në Selanik. Me gjithë neutralitetin e Athinës që u prish vetëm më 29 gusht 1917, atëherë kur Greqia u fut në luftë duke dalë në krah të Antantës, Armata e Lindjes u rrit me 220 mijë francezë, 120 mijë anglezë, 80 mijë serbë, 20 mijë italianë (nën komandën e gjeneral Petitit) dhe 16 mijë rusë. Lidhja me franko-anglezët e bëri të nevojshëm një operacion italian i cili çoi në zbrazjen dhe evakuimin e territoreve shqiptare të okupuara në Jug prej Greqisë që në vitin 1914 dhe të aneksuara në mars 1916. Më 28 qershor të vitit 1916 repartet italiane shtinë në dorë rajonin e Himarës dhe aty nga fillimi i shtatorit dhe qendrat e Tepelenës, Gjirokastrës, Delvinës dhe Sarandës. Pak kohë më vonë ato hynë në kontakte dhe me pararojat franceze në rajonin e Korçës. Në territoret shqiptare të pushtuara, italianët dhe austro-hungarezët bënë çmos për të fituar simpatinë dhe bashkëpunimin ushtarak me popullsinë vendase dhe nga kjo italianët arritën të vendosnin së bashku dy

batalione trupash lokale, kundër batalioneve të ndryshme të rekrutuara në veri nga kundërshtarët e tyre.

Konflikti italo-austro-hungarez

Nisur prej konflikteve të brendshme që kishin përfshirë Greqinë prej dhunimeve të sovranitetit territorial nga ana e francezëve dhe anglezëve, kishin bërë që në qershorin e vitit 1917 të provokohej dorëheqja e Mbretit Konstandin, i cili u zëvendësua nga i biri Aleksandri. Në atë kohë aty nga data 29 e atij muaji, Greqia hyri në luftë përkrah Antantës dhe territori i saj u bë baza e veprimeve ushtarake në Ballkan. Pasi u bë mobilizimi i përgjithshëm, nga tre divizione që ishin në fillim të vitit 1918, në atë kohë numri i tyre arriti në nëntë. Po atë pranverë sulmet e francezëve në territorin e liqenit të Ohrit, bënë që të thyhej plogështia e frontit shqiptar duke i detyruar që të zbrapsen forcat e Koorporatës XIX austro hungareze, sistemi mbrojtës i së cilës hyri në krizë në muajin korrik të po atij viti si pasojë e ndërhyrjes së Korparmatës XVI italiane. Si rezultat i kësaj, pasi humbën zinxhirin kodrinor të Mallakastrës në verilindje të Vlorës, austro-hungarezët u detyruan të tërhiqen në vijën e frontit për rreth tridhjetë kilometra. Më 2 tetor të vitit 1918, Koorparmata XVI italiane e përbërë nga disa brigada këmbësorie dhe regjimente artilerie, nisi sulmin kundër austro-hungarezëve të cilët e kufizuan rezistencën e tyre në mbrojtje të tërheqjes. Trupat austro-hungareze të komanduara nga gjenerali Karl von Pflanzer - Baltin, prej pusive që kishin ndeshur në rajonin e Mirditës, kishin lënë në dorën e rebelëve shqiptarë rreth 1200 pushkë, dhe 10 mijë korona austriake ari. Duke përfituar nga humbjet e mëdha të ushtrisë austro-hungareze, trupat italiane hynë në qytetin e Elbasanit më 8 tetor të vitit 1918 dhe në datën 14 të atij muaji ata u futën në Durrës dhe një ditë më vonë në Tiranë. Pas rënies së Tiranës, më 31 tetor trupat italiane hynë dhe në qytetin e Shkodrës i cili kaloi i gjithi nën administrimin ndërkombëtar.

Thyerja e italianëve më 1920

Fundi i Luftës së Parë Botërore, apo siç njihet ndryshe nga studiuesit e huaj si Lufta e Madhe, rindezi vatrat anarkoide në brendi të Shqipërisë dhe shpresat aneksioniste në vendet fqinje, të cilat dolën të gjitha fitimtare nga ajo luftë. Riatdhesimi i kontingjenteve të shënuara të Trupave Speciale italiane dhe

transferimi i disa reparteve në Mal të Zi e Dalmacinë Jugore, në fillimin e vitit 1919 e dobësuan seriozisht pozicionin ushtarak italian në Shqipëri, i cili nuk u përmirësua dot as me ardhjen e gjashtë batalioneve alpine që u dërguan apostafat nga Italia. Nga kjo gjë përfituan bandat e shumta të kusarëve që plaçkitnin nëpër krahina, pasi ishin armatosur mirë me plaçkën e mbetur nga lufta. Nga sulmet që po iu bëheshin në atë kohë trupave italiane në Shqipëri, gjë e cila për gjeneralin italian Piacentini do të thoshte fillimi i një preludi për një revolucion të mundshëm nga ana e shqiptarëve, e detyroi atë që në majin e 1920-ës, të kthente në Itali garnizonet ushtarake që ishin shpërndarë nëpër qytetet kryesore të Shqipërisë. Pasi në fillim të atij viti francezët kishin ikur nga Shkodra dhe Korça, në Shqipëri mbeti vetëm garnizoni italian i Vlorës i reduktuar në 1800 forca të cilët në qershorin e atij viti u sulmuan nga 6000 forca shqiptare. Në fillim italianët mundën që tu bëjnë ballë sulmeve shqiptare, por më pas ata u thyen dhe u tërhoqën nga Vlora. I vetmi që mbeti në atë kohë në duart e italianëve ishte ishulli i Sazanit.

...

Prof. dr. Emin KABASHI

JERONIM DE RADA DHE HAPËSIRA EVROPIANE E VEPRËS SË TIJ

* Çështja kaherë e hapur në studimet tona për letërsinë: a është epoka e romantizmit e vonuar në letërsinë shqipe.

* Përpjekje për të dëshmuar jo vetëm kohshmërinë, por edhe hapësirën evropiane të kësaj epoke letrare, falë letërsisë shqipe të arbëreshëve të Italisë.

* Pa këtë pjesë të letërsisë shqipe, do të ishte e mangët hapësira evropiane e letërsisë shqipe.

* Shqyrtime kritike edhe për këtë çështje gjejmë që nga studiuesit e parë të kësaj pjese të letërsisë shqipe, por më të qëndrueshme janë shqyrtimet e *Gaetano Petrotta*, më 1931, të *Çabej*t, më 1936, të *Francesco Altimari*t, më 2003 e të ndonjë studiuesi tjetër.

* Rrafshi i hapësirës evropiane të kësaj pjesë të letërsisë shqipe zë fill vetëm me veprën e parë të romantizmit shqiptar *Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës* (1836) të *Jeronim de Radës*, si e para vepër artistike në kulturën shpirtërore shqiptare.

* Duke qenë bashkëmoshatare me simotrat evropiane të epokës së romantizmit, mund të thuhet se e tërë letërsia shqipe e arbëreshëve deri te *Zef Skiro*i, që është njëri prej krijuesve të mëdhenj të kësaj letërsie.

* Shqyrtimi krahasues prek edhe anën e realizimit artistik të veprave të shkrimtarëve arbëreshë, të cilët jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe në hapësirën e asaj evropiane, janë vlera të pakontestueshme.

1

E kam për qëllim të shtroj tri çështje:

Një, se epoka stilistike e romantizmit nuk është vonuar në kulturën dhe letërsinë shqiptare, siç është bërë ves të thuhet, Dy,

nuk ka letërsi arbëreshe, siç thuhet keq, por ka letërsi shqiptare e arbëreshëve të Italisë, dhe, Tre, vepra e Jeronim de Radës, si e para dhe deri te ajo e Zef Skiroit, thuajse më e realizuara, në mungesë të përmasës kombëtare, kishte prani të përmasës evropiane.

2
Jeron de Rada dhe Evropa
(Pararomantizmi dhe Romantizmi)

Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës (1836), është vepra e parë e letërsisë moderne shqiptare, që ka komunikuar me kulturat evropiane. Kjo është edhe vepra e parë artistike e romantikut tonë të parë, Jeronim de Rada. Mosha e krijimit, vlera artistike, niveli i receptimit të kësaj vepre, kanë përmasë evropiane.

Poemën madhore të Jeronim de Radës e kishin njohur qarqet kulturore dhe artistike të disa qendrave të Evropës, siç janë ato në Francë, në Gjermnai, në Austri, në Itali, por edhe me larg, deri në Amerikë dhe Brazil. Siç na bëjnë me dije bashkëkohanikë të poetit, (Elena Gjika, Zef Serembe, Lekë Gruda, alias Luigj Gurakuqi, Xhuzepina Knorr, Lamartini, Mistrali, e ndonjë tjetër, siç e kanë hetuar studiues të veprës së tij, (Skiroi, G. Gradilone, E. Gioradano, V. Gualtieri, Jup Kastrati, Rexhep Qosja, Ali Xhiku, Francesco Altimari, e ndonjë tjetër, siç e kanë vlerësuar historianë të letërsisë, (Geatano Petrotta, M. Marchiano, Dhimitër Shuteriqi, e ndonjë tjetër, por edhe siç dëshmon letërkëmbimi i tij, (me Dh. Kamardën, me Elena Gjikën, me Th. Adornon, Me Lamartinin, me Tomazeon, me Z. Jubanin, me Sami e Naim Frashërin, e ndonjë tjetër. Nga të gjitha këto dëshmi, letrare dhe jashtëletrare, del qartë interesimi dhe rrafshet e komunikimit që ka pasur vepra e tij e parë artistike, pra vepra e parë e letërsisë moderne shqiptare. Në studimet e deritashme për veprën e De Radës është trajtuar edhe kjo çështje, mirëpo sa e di unë, vetëm në kontekstin e ndikimeve dhe të fërkimeve të kësaj vepre me simotrat e kulturave të popujve të ndryshëm evropianë, që shpreh, në një mënyrë ose në një tjetër, mendësinë e inferioritetit të kulturës dhe të dijes shqiptare.

3

Rrafshi i identifikimit me kulturat evropiane
De Rada dhe përkufizimi i letërsisë së tij

Në kulturat e popujve të ndryshëm të Evropës, sidomos në Francë dhe në Angli, bëhej përpjekje e madhe, që nga pararomantizmi e deri në zhvillimin e hovshëm të epokës stilistike të romantizmit evropian, që të krijoheshin, qoftë edhe mbi bazë të miteve, bardë dhe heronj kombëtar, në mënyrë që letërsia evropiane të çlirohej nga barra e madhe e trashëgimisë së lashtësisë greke, sidomos nga barra e miteve dhe legjendave greke. Andaj u krijuan edhe *Këngët e Osiianit*, *Këngët e Nibelungëve*, Sagat irlandeze, andaj bëri gjithë atë përmbysje ardhja e Jejms Makfersonit në kulturën evropiane, rrjedhimisht edhe në Itali e të arbëreshët tanë, jo vetëm në kulturën shpirtërore të popujve të ndryshëm të kulturave evropiane, që nga përpjekjet për t'u çliruar nga trashëgimia e lashtësisë greke, por edhe nga pesha e miteve të tyre, deri te krijimi i themeleve të trashëgimisë së tyre kulturore, mbështetur në kërkesat e romantizmit, për ringjalljen e lashtësive, qoftë edhe duke rikrijuar mite e bardë fiktiv, por që ishin të pranueshëm për kulturat e ndryshme të popujve evropian.

(James Macpherson (1736-1796), skocez me origjinë, hyri në letërsi me një mistifikim, me "përkthimet" e këngëve nga keltishtja në anglishtet, që ia atribuonte bardit të lashtësisë (shek. III pas Krishtit), Ossian-it).

Për ndryshim nga këto, edhe pararomantizmi shqiptar, andaj edhe romantizmi shqiptar, i prirë nga De Rada i madh, shëmbëllimin e krijimit të epopesë kombëtare, as nuk kishin nevoja ta krijonin duke hequr barrën e rëndë të trashëgimisë së lashtësisë greke, as të kërkonin shëmbëllimet nëpër errësirat e epokave historike. Romantizmi shqiptar, veçmas ai i Jeronim de Radës, e bashkë me të edhe krijues të tjerë arbëreshë, që nga Santori e te Dara i Riu e deri te Zef Skiroi, e kishin epokën e madhe të Motit të Madh, si e quajnë arbëreshët epokën historike të Gjergj Kastriotit- Skënderbeut me gjithë oshtimën e madhe që kishte krijuar jo vetëm në kulturën shqiptare, por edhe në atë evropiane. Përkundër faktit, se edhe arbëreshët tanë, që njëri, si Dera, botonte "ditarët" e tij intimë, që ishin zë lirikë i heronjve të shekullit XV, Santori që lakmonte dhe kërkonte fatin e bardëve popullorë, të cilëve askush nuk ua di emrat, Gavril Dara i Riu, që

pohonte se *Kënga e sprasme e Balës* ishte krijim popullor, por ai edhe përpiqej të argumentonte këtë pikë të çështjes së aktit krijues, e Skiroi që kishte adhurim për të gjithë këta krijues të mëdhenj, sa që mund të thuhet se *Rapsodie Albanesi*, është një homazh për veprën dhe këta krijues arbëreshë, prapë se prapë, në thelb, hapësira evropiane e letërsisë shqipe të arbëreshëve të Italisë, nuk mëtonte të çlirohej nga barra e rëndë e trashëgimisë së lashtësisë greke, apo të ndonjë lashtësie tjetër.

(Santori, I fatti contemporanei, " Brizandi, Lletixja, Ulladheni").

Ky qëndrim esencial i ndryshëm në fillesën e qasjes, nga ai që kishte ndjekur romantizmi i kulturave të ndryshme evropiane, e bën më të qartë, më përmbajtjesor, më pak të lidhur me mitet e lashtësive të kulturave të popujve të tjerë, doemos pra, e bën origjinal, të freskët, siç e kanë hetuar edhe krijues të qarqeve evropiane, kur kanë folur për veprën e De Radës, apo për gjurmë të krijimtarisë sonë popullore.

4

Kur janë shtruar këto çështje, zakonisht është thënë se romantizmi në letërsinë shqipe është vonuar, rrjedhimisht pra, është vonuar edhe monumenti i parë artistik i kësaj letërsie. Mund të jemi dakord, nëse këtu është e domosdoshme, që për një letërsi, e cila shtron kërkesa të komunikimit brenda epokës së vet stilistike, që të ketë të zhvilluara të gjitha gjinitë dhe llojet letrare, por duke u marrë me një anë të konstatimit, nuk është e udhës të lihen pas dore anët e tjera, do të thosha, bërthama e këtyre çështjeve - vlera artistike e krijimit në raport me simotrat e saj evropiane. Për nga mosha, vepra e parë artistike e romantizmit shqiptar, **Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës**, është e një moshe me gjithë prodhimin e mirëfilltë letrar të kulturave të popujve evropianë, në Perëndim dhe në Lindje.

5

Rrafshi i moshës se romantizmit shqiptar

Këtu po sjellim të dhënat që i kemi publikuar që në vitin 1994, jo të gjitha, për të hetuar për të satën herë moshën e veprave kreysore të romantizmit evropian dhe të veprës së parë të Jeronim de Radës.

Xh. G. Bajroni: *Udhëtimet e Çajld Haroldit, I, II, III, IV*, (1818), *Manfredin* e boton më 1817, kurse *Don Zhuanin*, më 1819-1824. V. Hygo, *Odet dhe baladat*, më 1818, *Odet*, më 1822, *Këngët Orientale*, më 1829, dramën historike, *Cromvell*, më 1827, *Legjenda e shekujve*, më 1859, romanin, *Të mjerët*, më 1862. Lamartini: *Mendime poetike*, më 1820, *Harmonia poetike dhe religjioze*, më 1830, epin romantik *Jocëlyn*, më 1836, kurse *Rënia e shenjtë*, më 1838. (Siç edhe poeti ynë që kishte iluzion të ndërtojë epopenë kombëtare të shekullit XV, edhe Lamartini kishte iluzionin të ndërtojë epopenë e fatit njerëzor). Mistrali: *Ishujt e purpurtë*, më 1875, novelën *Nerto*, më 1884 , kurse tragjedinë *Mbretëresha Ivanë*, më 1890. Manxoni: *Vdekja e Karlo Imbonatit*, më 1816, *Shpirtrat*, më 1817-1822, me rastin e vdekjes se Napoleonit boton poemën *Pesë maj*, më 1821, dramën historike *Princi nga Karamanjola*, më 1820, kurse romanin e tij të njohur *Të fejuarit*, më 1827. Leopardi: poemën *Italisë*, më 1818, *Këngët*, më 1861, kurse romanin *Fëmijët e moralshëm*, më 1877. Pushkini: *Ruslandi dhe Ludmila*, më 1817-1820, *Robërit e Kaukazit*, më 1820-1821, kurse romanin dy fish lirik, *Eugjen Onjegini*, më 1823-1831. Në Gjermani, Novalisi boton më herët se bashkëkohanikët e tij evropianë. Më 1808 boton prozën poetike *Himne nate*, kurse romanin *Henrih von Ofterding*, më 1802. Jeronim de Rada: *Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës*, **më 1836**, sado që të dhënat flasin për kohën e krijimit të dorëshkrimit së paku dhjetë vjet më herët.

6
Shekujt e letërsisë së arbreshëve dhe të vlerës artistike të veprës së Jeronim de Radës

Në veprat e Jeronim de Radës, duke filluar nga poema e tij e parë artistike në gjuhën shqipe, **Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës**, e te vepra e tij madhore, **Scanderbeccu i pa-faan**, që ende nuk i është e njohur opinionit të lexuesve shqiptar, as kur u kremtua 125-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila nuk mund të mendohet pa përmasën e saj shpirtërore, letërsinë e Rilindjes Kombëtare, gjejmë të gdhendur një periudhë madhështore të popullit tonë në luftë kundër hordhive osmane. Këtu nuk janë futur vetëm personazhet, vetëm ngjarjet, vetëm përmasa kohore, që ishte mësimi themelor i romantizmit evropian, andaj edhe i romantizmit të De Radës, (ku

përmasa e kohës vendosej para dhe prapa ngjarjeve që trajtoheshin në vepra), e që më thotë mendja është shkollë e mësuar nga Eskili e këndej, nuk është futur vetëm hapësira gjeografike, që aq shpesh kapërcente përmasat e hapësirës kombëtare, vetëm imazhet, që është një krah tjetër i shkollës së romantizmit, por është bartur edhe fryma e asaj kohe, edhe idetë e mëdha se vetëm me luftë mbahet liria e atdheut dhe varet shpëtimi i tij, që, siç dihet, ishte edhe mësim i romantikëve evropianë, veçmas në periudhën e parë të zhvillimit të kësaj epoke stilistike. Krijimtaria artistike e De Radës, si bijë e epokës stilistike të romantizmit, ishte e brumosur edhe me frymën e madhe heroike që kishte sjellë nga atdheu i të parëve krijimtaria gojore. Teprimet që janë thënë lidhur me çështjen e ndikimeve dhe të fërkimeve të letërsisë gojore në krijimtarinë artistike të De Radës në gjuhën shqipe dihen kaherë. Këtu do shtuar se nuk ishte faji i De Radës, që fillonte i pari një epokë të re stilistike në letërsinë shqipe, ngase ai ishte zëdhënës i kohës së tij, i aspiratave që kishte sjellë në mbarë Evropën Revolucioni Francez (1789), e pastaj edhe epoka stilistike e romantizmit. Të këtyre shtrirjeve, të këtyre interesimeve, të këtyre vlerave artistike, me ndryshimet që ishin pjellë e kulturave të veçanta kombëtare, ishte edhe krijimtaria artistike e krijuesve kryesorë të romantizmit evropian. Figurat e personazheve, që poeti ynë i kishte marrë nga letërsia gojore, dhe nga historia kombëtare, nuk ishte as e metë, as privilegj i tij. Cili krijues i madh i letërsisë botërore nuk mori heronjtë e popullit të tij, qofshin ata fiktiv, apo historikë? Do të sjell këtu një mendim të De Radës, thënë për këngët e letërsisë gojore që kishte mbledhur dhe për veprën e tij të parë artistike në gjuhën shqipe, për të shtruar një çështje interesante për mendimin tim:

"*U përpoqa që të hartoj ndonjë në mënyrën e atyne, dhe nuk ia dola fort keq, ndërsa për sejcilën këngë të re, që këndohen nëpër rrugë, gratë delshin ta dëgjojshin ndër dritare. Mora zemër dhe shestova romanin tim dyfish lirik".*

(Cit. sipas Jup Kastratit, Tiranë 1956). Çështja që dua të shtrojë: cili prej krijuesve evropianë, të kësaj epoke stilistike, nuk ka përkufizime të këtilla, apo të përafërta, herë për të fshehur vetveten, herë për të krijuar iluzionin e përjetësisë së vlerës artistike të krijimeve të tyre, ngjashëm me përjetësinë e artit të letërsisë gojore, ku kishin marrë shëmbëllimet. Vetëm fëmijët e një brezi mund të kenë dhe të shtrojnë kërkesa të ngjashme kudo

që ato ndodhin, pa hequr sysh veçantitë e përmasës historike dhe të mjedisit shoqëror ku kanë jetuar. *"Kam ardhur këtu të flasë në mbrojtje të ndikimve(...). Ndikimet veprojnë sipas ngjashmërive (...)"*, thoshte Andre Gide, që më 1900. (Andre Gide, ligjeratë mbajtur më 1900-Bruksel).

7

Rrafshi i pranimit dhe i komunikimit
të veprës së Jeronim de Radës
(* De Rada, Lessingu dhe edukimi i gjinisë njerëzore)
(* Shkolla kombëtare e romantikëve shqiptarë)

Shekulli i tetëmbëdhjetë, që në historinë e letërsisë së përbotshme njihet si shekulli i arsimimit, është kohë e kulturës së përbashkët evropiane, ku në parimet themelore mbretëron shpirti kritik, morali shoqëror, njerëzorja dhe toleranca. Në atë kohë, Lessingu fliste për edukimin e mbarë gjinisë njerëzore. Ky shekull, kjo kohë, kjo përmasë e vlerës së kulturës evropiane është e vonuar në kulturën shqiptare. Por, nuk është vonuar romantizmi, siç është bërë ves të thuhet. Andaj, si pjellë e këtij vonimi, në krijimtarinë e të gjithë romantikëve tanë, në radhë të parë të atyre arbëreshë, ndoshta edhe që nga periudha e pararomantizmit, nëse do të kishte vend aty, fjala vjen, Dorsa me shokë, duke përfshirë këtu edhe veprën më të arrirë të romantizmit shqiptar, atë të Jeronim De Radës, e deri te Skiroi me shokë, hetojmë praninë e elementeve të epokës së arsimuesve evropianë. Thuajse të gjithë romantikët tanë kishin pasur kontakte dhe ishin njohur me rrymimet kulturore evropiane, gjë që manifestohet edhe në veprat e tyre, por edhe në publicistikën e tyre. Për De Radën, këtë e kanë pohuar thuajse të gjithë studiuesit e tij, por edhe miqtë dhe bashkëkohanikët e tij. Por, këto kontakte i kishte edhe pjesa e letërsisë shqipe që zhvillohej po ashtu në kolonitë të tjera shqiptare, shkapërderdhur nëpër botë, duke filluar nga Zef Jubani dhe Thimi Mitko, Vaso Pasha dhe Kristoforidhi, Naimi, Samiu dhe Visar Dodoni e të Asdreni me brezin e tij. Mund të thuhet, prandaj, se e tërë shkolla e romantizmit shqiptar, kudo që zhvillohej ai, veçmas të arbëreshët e Italisë, ishte në rrjedhat e të arriturave evropiane në fushën e dijes, të arteve dhe të kulturës.

8

Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës

(* Veprat e krijuesve arbëreshë sa janë origjinale, do të thotë sa janë shqiptare)

(* Deomos, kjo dilemë shtrohet edhe për veprën e parë të letërsisë moderne shqipe, *Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës*, të Jeronim de Radës)

(* Sa e inkuadron letërsinë tonë të re në hapësirën evropiane)

(* Në këtë kontekst, duke e veçuar më të madhin, sa është evropiane vepra poetike e Jeronim de Radës)

Kur shtrohet çështja e fërkimeve të mundshme, e ngjashmërive të mundshme të krijimtarisë artistike të arbëreshëve të Italisë, andaj edhe të Jeronim de Radës, me periudhat e ndryshme kohore dhe me epokat e ndryshme stilistike, është marrë parasysh përpjekja që të gjendet përgjigje për çështjet që u shtruan më sipër, pra për dilemat që në të parë nuk duken fort artistike, as nuk përputhen fort me qasje me kritere letrare, sado që si për tërë letërsinë e romantizmit shqiptar, andaj edhe për letërsinë e romantizmit shqiptar të arbëreshëve të Italisë, këto çështje dilemore nuk mund të kenë përgjigje të argumentuar edhe pa faktorët jashtëletar.

Nëse përafërsisht është arritur të shtrohen çështje që janë me interes për të hetuar shtrirjen evropiane të kësaj krijimtarie, atëherë së pari duhet të thuhet se poeti ynë është bashkëkohanik i sivëllezërve evropianë. Bashkëkohanik: - me kontekstin kohor, - me moshën e veprës së tij, - por edhe me vlerën artistike të veprës së tij poetike.

9

De Rada dhe çështja shqiptare

(* De Rada, Elena Gjika dhe Skënderbeu - përmasa evropiane e tyre)

Vepra e Jeronim de Radës në qarqet evropiane u njoh nga bashkëkohanikët e tij, krijues, publicistë dhe politikanë. Kjo njohje, nuk është vetëm interesim i evropianëve për kulturën dhe çështjen shqiptare, por në radhë të parë është punë madhore e shqiptarëve që të bëhen pjesë e familjes së kulturës evropiane. Falë këtij angazhimi, përmasa evropiane e veprës së Jeronim de

Radës, kishte ngjallur interesim të madh, jo vetëm të qarqeve kulturore, por edhe të atyre politike dhe publicistike. Sot, në shkencën shqiptare për këtë periudhë të letërsisë, është shkruar aq pak, sa të gjithë ata që janë marrë dhe të gjithë ata që merren me këtë periudhë të letërsisë shqipe, nuk do të duhej ta ndjenin veten mirë. Është shkruar aq pak, fjala vjen, për letërkëmbimin e De Radës me të gjitha zyrat e rëndësishme politike të fuqive evropiane, ku është trajtuar aq bindshëm, aq qartë dhe në mënyrë aq njohëse çështja shqiptare, e pazgjidhur edhe sot e kësaj dite.

Nuk është gjë gand dhe e rastit që De Rada ishte bërë figurë kryesore e kontakteve, e njoftimeve, e paraqitjeve të kulturës dhe të çështjes shqiptare. Jo rastësisht, edhe e madhja Elena Gjika, kur i shkruan poetit amerikan Longefellou, që të shkruaj një poemë për Skënderbeun, burimet e të dhënave për këtë epokë, trashëgiminë shpirtërore të artit gojor dhe të vlerave artistike i merr te De Rada. Jo rastësisht, prandaj, ajo mbështetet te ndikimi i tij që kishte në qarqet kulturore dhe politike evropiane, që të bëhet e mundur hapja e Akademisë shqiptare, të cilën e kishte përkrahur edhe Garibaldi, por edhe intelektualë dhe politikanë evropianë.

Nga këndi i ngjarjeve të sotme të çështjes shqiptare, prania dhe komunikimi i veprës së Jeronim de Radës në hapësirën evropiane, mbetet një lakmi e përhershme e krijuesve, e dijes dhe e kulturës institucionale shqiptare. Sepse, pa angazhimin kombëtar të romantikëve shqiptarë, as që mund të mendohet as vlera e krijimtarisë së tyre artistike, dhe për çudi të shqiptarëve, askush në Evropë nuk i qortojë ata se veprat e tyre kanë më pak vlera artistike se simotrat e tyre evropiane. Kjo mendësi e Rilindjes kombëtare, veçmas e të mëdhenjve të kësaj periudhe të letërsisë shqipe, sa shihet e sa preket, ende nuk është bërë mendësi kombëtare e kulturës shqiptare, rrjedhimisht edhe e letërsisë shqiptare të shekullit tonë.

Shënime për argumentim:

Dr. MICHELE MARKIANO, *L'Albania e l'opera di Girolamo De Rada, V. Vecchi, Tipografo-Editore, Trani, 1902,* (veçmas kap. III- *Il Milosao* (f. 58-71; kap. IV - *Serafina Thopia* (

f.72-77); kap. VI- *Lo Skanderbeg* (f. 87-123); kap. VIII- *Lo specchio d'Umano Transito* (f. 128-149).

VITTORIO G. GUALTIERI, *Girolamo De Rada, poeta albanese*, Palermo, 1930.

GAETANO PETROTTA, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931 dhe 1932. U shfrytëzua ribotimi i veprës në Palermo, më 2003, fq. 258-273.

Gaetano Petrotta i kthehet disa herë krijimtarisë së Skiroit, si në veprat *Poeti siculi-Albanesi*, Palermo, 1950, pastaj te vepra *Svolgimento strico della kultura e della literatura albanese*, Palermo, 1950. Gaetano Petrotta, në Kuvendin I të Studimeve shqiptare, që u mbajt në Tiranë, më 12 prill 1940, ai mbajti ligjëratën *Letteratura italo-albanese.*

GIUSEPPE GRADILONE, "Caratteri romantici dell'el opera", "I canti di Milosao" di Girolamo de Rada, në *Studi di Letteratura albanese*, Roma, Urbinati 1960, f. 28 :

" E' chiario, infatti, che il De Rada vive nell'epoca romantica (egli è nato nel 1812 e morto nel 1903) e, ne fosse o no consapevole, fa suoi i postulati e le esigenze dei tempi". "Se per romantismo poi intendiamo *sincerità e libertà* di sentimento e di espressione, tali caratteri sono propri dell'anima del De Rada e di conseguenza anche della sua poesia".

Po ai, po aty: "Di qui balza evidente un altro carattere romantico del *Milosao*, quelo nazionale e patriottico, ubbidendo al quale il poeta trasferisce le vicende dell'opera in Albania, e le oggettiva nel figlio del despota di Scutari del secolo XV."

Po ai, po aty: "Infine romantica è la forma di contrasto che l'amore assume".

GIUSEPPE GRADILONE, "I canti di Milosao" di Girolamo de Rada, në *Studi di Letteratura albanese*, vep. e cituar, f. 14: "(…) i Canti, almeno alcuni, hanno una genesi occasionale ed autobiografica, cioè il poeta ha vissuto una vicenda sentimentale, che ha offerto materia ai primi di essi".

"*I canti di Milosao* sono pagine poetiche, espressioni di particolari stati d'animo, ed è inutile quindi volere in essi l'unità e l'organicità che è di altri generi letterari, quali l'epica e il romanzo: l'unità va cercata in ogni singolo canto e in ciascuna immagine in sé conchiusa e densa di vita poetica. La migliore delle letture quindi è quella episodica, che trascuri trama e

sviluppo di azione, per concentrarsi tutta nel godimento della poesia."

Po ai, po aty, f. 32: "Il suo classicismo è quindi un classicismo di spirito, di misura, una categoria spirituale, più che imitazione di esteriorità del mondo antico, quali la mitologia, di cui andava alla ricerca il Gualtieri in tutta l'opera deradiana e non rinveniva con sua sdisfazione che qualche raro esempio, in quanto ciò avallava la sua tesi romantica, o di generi letterari, come voleva il Marchianò secondo le vecchie poetiche ed estetiche e ne restava deluso o insoddisfatto".

Giuseppe Gradilone, *La leteteratura albanese e il mondo clasico (Quatro studi)*, Romë, 1983, veçmas, fq. 30-85.

KLARA KODRA, *I canti di Milosao di Girolamo De Rada, un' opera poetica profondamente europea*, në "Microprovincia"/41 (Rivista di cultura diretta da Franco Esposito), nr. 41 (2003) – Omaggio a Girolamo De Rada, f. 80-87.

"Qui il De Rada si distacca dai romantici che consideravano la felicità irragiungibile, o che la proiettavano in un lontano avvenire, o in un mondo sopranaturale, e si rialaccia agli antichi greci, o, forse ai preromantici."

KLARA KODRA, *Tipologjia e poemës arbëreshe*, Tiranë, 2000.

NAMIK RESULI, *"Jeronim De Rada",* në *Shkrimtarë shqiptarë*, Tiranë, Gurakuqi 1941, f. 257 – 258:

"Serafina Thopia". Sigurisht me këngët e Serafinës poeti pati ndërmënt të shkruante një farë *ditari lirik* të një vajze shqipëtare – si pas fantazisë s'auktorit, të Serafina Thopisë, princeshë e Artës dhe pastaj e Zadrimës…

[…] Mirë po këjo histori e kësaj dashurije dhe sidomos ky kundërshtim i martesës së Serafinës me Bosdarin, që duhej tishte thelbi dramatik i poemit, na ësht dëftyer në mënyrë aq të çthurur e t'errët, sa me-zi kuptohet prej lëçitësit… Edhe këtë poemth Jeronimi e ka shkruar në trajtë *autobiografike*, si Milosaat. Madje ësht sidomos *nga kjo pikëpamje që ndryshon Serafina nga të gjitha ripunimet e dyta* e të treta";

f. 259-260: "Milosaat"- Në fillim këto vargje përbënin disa "kangjelje" a këngë të vogla, të frymëzuara prej kësaj dashurije, pa ndonjë lidhje në mes tyre. Vetëm më vonë i ra në ment poetit t'i u japë një "kurnizë", një thurje poemthi, me një argument të

vetëm. Po edhe më pas një lidhje të ngushtë këto këngë nuk e patnë; as që përbëjnë një "poemth" me atë kuptim që i japim sot kësaj fjale. Prandaj me plotë arësye auktori i tyre e thirri "*romanx lirik"* këtë vepër, pse e tillë është me të vërtetë. […] Të gjitha këto në botimin e parë (1836) janë kënduar mbrënda tridhjetë këngëve. Po botimi i dytë (1847) i janë shtuar edhe nj'a gjashtë këngë të tjera. Një veçori tjatër e këtij botimi janë datat fiktive që ka çdo këngë, të vëna më qëllim që vepra të dukej me të vërtetë si një "ditar lirik" i shekullit XV, për t'i u përshtatë titullit".

EQEREM ÇABEJ: *De Rada, Noli, Lasgushi,* në "*Jeta e re*" 4/ 1998, Prishtinë, f. 658.

Për Çabej-in "De Rada është i pari poet i psikës femërore në literaturën shqipe". Kjo figurë është një nga nyjet që lidh romantizmin shqiptar me romantizmin evropjan. Serafina është alter-egoja femërore e Milosaos, është kundërpesha evropjane e përkatësisë arbëreshe dhe shqiptare të poetikës deradiane, është simbol i dashurisë për arësyen, për përsosjen morale dhe asketizmin: pra tregues i dimensionit klasiçist të këtij romantizmi. Kjo rrugë konsolidohet në botimet e mëvonshme të novelave lirike që bëhen gjithnjë e kulturor deradian.

REXHEP QOSJA, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III*, Prishtinë, 1986.

JUP KASTRATI, *Jeronim de Rada (Jeta dhe vepra*), Tiranë, 1979.

JUP KASTRATI, *Studime për De Radën*, New York, 2003.

FRANCESCO ALTIMARI, *Studi sulla letteratura albanese della „Rilindja", Radhonjtë e „Zjarrit*", 11, Grottaferata, 1984.

MATTEO MANDALA, *La diaspora e il ritorno mito storia cultura tradizionale nell'opera di Giuseppe Schiro,* Palermo, 1990.

ANTON N. BERISHA, *Mbi letërsinë e arbëreshëve të Italisë*, Tiranë, 2000.

„*Shejzat*", Romë, 1964, nr.7, 8, 9, 10, 11, 12.

„*Microprovincia*", *Rivista di cultura diretta da Franco Esposito*, Nuova Serie, nr.41- Gennaio-Decembre, 2003.

KUMTESË

Prof. dr. Agim Vinca

TIVARIADA SHQIPTARE: NJË HISTORI E PËRGJAKSHME

Kur më erdhi ftesa për të marrë pjesë në këtë konferencë shkencore kushtuar masakrës së Tivarit, e para gjë që m'u kujtua ishin dy vargje të një kënge popullore: *"M'çove ushtar, o moj nanë,/ në Tivar, në kasaphanë..."*. I pata lexuar për herë të parë këtu e njëzet e dy vjet më parë, në një intervistë të shkrimtarit Sulejman Krasniqi dhënë gazetës "Shkëndija" të Prishtinës (janar 1991) dhe që atëherë nuk më janë shlyer nga kujtesa. Përkundrazi. Më janë kthyer me forcë e kumbim të veçantë sa herë më ka rënë të dëgjoj për ngjarjen që në kujtesën tonë kolektive ka hyrë me emrin "Masakra e Tivarit". Për ngjarje si masakra e Tivarit, kudo në botë shkruhen, pos veprave shkencore e dokumentare (artikuj, studime, monografi etj.), edhe poema, drama, romane, tragjedi, fejtone, epope dhe vepra të tjera artistike: tablo, kompozicione, opera, simfoni etj. Lufta dhjetëvjeçare e Trojës i dha njerëzimit epet e mëdha homerike: *Iliadën* dhe *Odisenë*; *Gernika* e Pikasos (Guernica) lindi pas bombardimit të qytetit me të njëjtin emër nga forcat fashiste gjatë luftës civile në Spanjë; po nga kjo luftë u frymëzua edhe romani *Për kë bie kambana?* i Heminguejit dhe poema *Spanjë 1937* e poetit amerikan Uinstan Hju Odën; beteja e famshme e Vaterlosë frymëzoi poemën *Vaterlo* të Hygoit, për të cilën përkthyesi i saj shqiptar, Namik Namazi, alias Fan Noli, thoshte: "Po ka një ngushëllim për katastrofën e Waterloo-së. Pa të nuk do të ishte shkruar kjo kryevepër e pavdekur". Kadareja ynë ka një tregim të shkëlqyeshëm (*Komisioni i festës*) për masakrën e Manastirit të vitit 1830, në të cilën Porta e Lartë vrau pabesisht krerët shqiptarë (rreth 1500 veta) të ftuar në "festë"!

Temë-tabu gati gjysmë shekulli

Ç'ndodh në letërsinë shqipe me një ngjarje sa tragjike, aq edhe misterioze, si kjo për të cilën flasim? Sa dhe si është trajtuar masakra e Tivarit në krijimtarinë tonë letrare e artistike dhe a kanë arritur krijuesit tanë "t'i dalin hakut" kësaj teme të madhe?

Përgjigjja, fatkeqësisht, është mohuese. Jo. Numri i veprave tona letrare e artistike, që trajtojnë këtë ngjarje, por edhe i atyre shkencore e publicistike, është ende i vogël, madje tejet i vogël, në krahasim me peshën dhe përmasat e saj, ndërsa për vepra të mëdha, kapitale, që do ta jepnin tragjedinë e Tivarit në përmasat e saj të plota dhe me një vizion të fuqishëm artistik, as që mund të bëhet fjalë. As pas gati shtatë dekadash nga koha kur ndodhi kjo masakër, ne nuk kemi ndonjë vepër letrare, veçanërisht nga ato të llojeve të mëdha, epike, çfarë janë romani dhe drama, me anë të të cilave do të mund t'ia paraqitnim botës të vërtetën për këtë ngjarje, e cila për nga makabriteti dhe misterioziteti ua kalon edhe krimeve naziste të holokaustit dhe pogromeve staliniste të kohës së "spastrimit të madh" të vitit 1939. (Për ndonjë film artistik të përmasave që përkojnë me ngjarjen në fjalë, as që mund të flitet). Deri në vitin 1990-91, kur ra sistemi komunist, që edhe ishte autor i këtij krimi makabër, arsyet e mungesës së Tivarit në letrat shqipe duhen kërkuar te rrethanat politike që diktonte ai sistem, këndej e andej kufirit, por pas kthesës së viteve '90, mund të thuhet se ato qëndrojnë diku tjetër: te mungesa e gatishmërisë dhe e afinitetit të krijuesve tanë për t'u rrekur me tema të tilla, sa të vështira, aq edhe delikate. Nuk dimë si ta shpjegojmë ndryshe këtë çështje! Masakra e Tivarit, sikurse edhe krimet e tjera të shovinistëve serbo-malazez në periudhën e pasluftës, që kishin për qëllim dobësimin e faktorit shqiptar konform doktrinës së Çubrilloviqit dhe ideologëve të tjerë të politikës gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve (Drenica, aksioni i armëve, shpërngulja në Turqi etj.), ishte temë tabu, e ndaluar për t'u trajtuar. Në elaboratin e dytë të Çubriloviqit, atë mbi zgjidhjen e çështjes së pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re, dërguar Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë dhe komandantit të saj suprem, mareshalit Tito, më 3 nëntor 1944, në Beogradin e posaçliruar, propozohej shpërngulja me dhunë e shqiptarëve nga trojet e tyre dhe likuidimi në masë i tyre. Në të, ndër të tjera, thuhej: "Ajo që në kohë paqeje kërkon dekada dhe shekuj, gjatë kohës së luftës kryhet brenda muajve".[9] Në Kosovë masakra e Tivarit ishte temë-tabu gati gjysmë shekulli. Nuk mund të shkruhej për të as edhe një vjershë a tregim i shkurtër, se jo më ndonjë vepër e përmasave të mëdha. Por as në Shqipëri, edhe pas

[9] Cituar sipas S. Krasniqit, i cili i referohet këtij dokumenti në veprën e tij: te romani *Njeriu dy herë i pushkatuar*.

prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, nuk preferohej trajtimi i kësaj teme dhe i temave të tjera të ngjashme. Shkrimtari Sulejman Krasniqi, autor i romanit *Njeriu dy herë i pushkatuar*, flet për peripecitë e botimit të veprës së tij me këtë temë, e cila mundi të shihte dritën e botimit vetëm në vitin 1991 (madje në diasporë, në Gjermani), plot 24 vjet pasi qe shkruar… "Kur e pata dorëzuar në shtëpinë botuese 'Naim Frashëri' dorëshkrimin e këtij romani, më qe thënë: Romani është i arrirë nga ana artistike, por nuk mund të botohet tash për tash. Është i barabartë me një aktakuzë kundër regjimit të Beogradit… Do t'i vijë koha edhe këtij romani".[10] Kështu, vepra e parë e shkruar e këtij shkrimtari të frytshëm, romani për Tivarin, për shkak të përmbajtjes dhe mesazhit të tij, do të botohet ndër të fundit! Por, ç'përmban në fakt romani *Njeriu dy herë i pushkatuar* i Krasniqit?

Romani për fatin e të mbijetuarit

Hero i këtij romani është një djalë i ri nga një fshat i Dukagjinit me emrin Sokol Dardhani, i cili "u shpëton dy pushkatimeve brenda një viti" (herën e parë në Kosovë, kur oficerët e OZN-ës shtijnë mbi një grup të burgosurish shqiptarë, në mesin e të cilëve është edhe Sokoli, kurse herën e dytë në Tivar) dhe vazhdon të jetojë deri në Luftën e UÇK-së në vitin 1999. Fati i Sokolit, i ngjashëm me fatin e autorit, është tipik për njerëzit që luftojnë për idealin e lirisë dhe që janë të paepur në rrugën e tyre. Sokol Dardhani është 15-16 vjeç kur "pushkatohet dy herë në të njëjtin vit", aq sa ishte S. Krasniqi kur ra në burg dhe u bë objekt torturash të tmerrshme të udbashëve të tërbuar nga urrejtja për shqiptarët. Sokoli, të cilin njerëzit e pushtetit e dinë të vdekur, vazhdon të jetojë e të luftojë me emrin e dytë, "Curr", të cilin e merr ngaqë njërin vesh ia kanë prerë masakruesit serbë. ("Ja, ai buzëçaraveshuri ma këputi llapën e veshit, ndërsa më çonin për t'më pushkatuar. Quhet Svetisllav Zllosheviq").[11] Fati i këtij personazhi ndërthuret me atë të një vajze me moshë e fat të përafërt me të, me të cilën ai është "i dashuruar dhe i besatuar". Të dy janë jetimë; bij të prindërve të pushkatuar, madje babai i Sokolit është vrarë përpara se të lindë ai vetë, fat ky që i ka ndjekur shpesh njerëzit tanë si pasojë e krimeve të pushtuesve

[10] Shih: Sulejman Krasniqi, *Jetëshkrim*, Tiranë 2011, f. 116.
[11] Sulejman Krasniqi, *Njeriu dy herë i pushkatuar*, Shtëpia botuese "Dita", 1991, f. 250.

e, ndonjëherë, edhe si pasojë e gjakmarrjes. Si në shumicën e romaneve të Krasniqit, veçanërisht në ato me temë nga historia, lëvizin njerëz me fate tragjike, në mesin e të cilëve gruaja shqiptare zë një vend të veçantë. E tillë është nëna e Sokolit, Saimja. Atë e lë burri të re, me Sokolin në bark, të cilit kur lind, ia vë emrin e të shoqit, Sokol; e rrit me mundime, kujdeset për të ditë e natë, përpiqet ta mbrojë nga çdo e keqe dhe lufton bashkë me të për çlirimin e vendit. Vetë autori, duke folur për këtë vepër në librin e tij autobiografik *Jetëshkrim*, e quan nënë Saimen "prototip i femrës stoike shqiptare".[12] Veprimi i romanit zhvillohet kryesisht në fshatin Hjekë (emër simbolik), në qytetin Rrënzëmal dhe në vendbanime të tjera të Anëdrinit gjatë Luftës së Dytë Botërore, për të marrë një zhvillim më dinamik sidomos në vitin e fundit të saj. Sokoli, edhe pse i ri, është i lidhur me luftën antifashiste dhe jep ndihmesën e tij në luftën kundër fashizmit, por vihet në shënjestër të krerëve të OZN-ës, në mesin e të cilëve ka edhe çetnikë të maskuar si komunistë e partizanë. Të tillë janë: Svetisllav Zllosheviqi, Batriç Zveroviçi, Govan Kapetani, Shushko Zhderovski. Të vihet re karakterizimi i personazheve nga shkrimtari, veçanërisht atyre negative edhe nëpërmjet emrave: Zllosheviq (zllo-i keq), Zveroviç (zver-egërsirë), Govan (govno-jashtëqitje), Zhderovski (zhder, zhderonja-llupës) etj., si dhe bashkëpunëtorët e të parëve nga radhët e shqiptarëve: Cipe Takami, Dërgut Keqi, Rrapazhyti etj. Në një moment në roman del edhe ministri i brendshëm jugosllav i pasluftës, shoku "Marko" (pseudonim i Aleksandër Rankoviqit), kurse në tekstin e veprës citohen pjesë nga Naçertania e Garashaninit, nga elaboratet e Çubrilloviqit dhe dokumente të tjera me përmbajtje antishqiptare, që i japin veprës karakter pak a shumë dokumentar. Krahas tyre, në vepër ka edhe personazhe komunistësh të ndershëm serbë, kroatë e sllovenë, si Radomir Dunavaci, Milan Bačkovaci dhe Marjan Mlineci, të cilët i quajnë të parët "varrmihës të revolucionit" dhe "neogestapovcë që masakrojnë njerëz të pafajshëm".[13] (Dyluftimi i njeriut, Sokolit të plagosur, me ujkun te vendi i quajtur Honi i Ujqërve, ku fitues del, megjithatë, njeriu, është ndër pjesët më të bukura e më plastike të romanit. Shikuar në kontekstin e përgjithshëm të veprës, ky episod mund të thuhet se ka kuptim simbolik: njeriu di të jetë

[12] S. Krasniqi, *Jetëshkrim*, f. 110.
[13] Po aty, f. 182.

edhe më i keq se ujku! Të tillë janë vrasësist dhe masakruesit e djemve të rinj shqiptarë në Tivar!). Protagonisti i romanit, Sokoli, është pjesë e karvanit të rekrutëve shqiptarë, të mobilizuar nga të gjitha viset e Kosovës, që nisen nga Prizreni për në Tivar, në pranverë të vitit 1945. E përballon atë rrugëtim, gjatë të cilit humbin jetën shumë bashkëvuajtës të tij, për t'u bërë pre e plojës barbare të njerëzve të OZN-ës dhe komandantëve çetnikë "me yll në ballë" me të arritur në qytetin bregdetar. Tok me më të riun e rekrutëve të masakruar, Ximin e plagosur, e mbijetojnë edhe këtë kalvar: i shpëtojnë masakrës. I zbulon rastësisht në kanalin tek janë fshehur një fshatar shqiptar, i cili qëllon të jetë rapsod. Derisa i bart me qerren e tij për në shtëpi, rapsodi Kolë Gurabardhi fillon të këndojë këngën e krijuar ndërkohë për plojën e Tivarit dhe viktimat e tij ("Na paskan ngritur këngë - i çuçuriti Ximi rrëzë veshit Sokolit"). Për shkak të vlerës që ka kjo "këngë" si tekst letrar, po e citojmë në tërësi:

"Ç'paska di'lli që mbyll sytë?
Ç'paska hana që s'ban dritë?
Ç'paska qi'lli i vranjtue?
Deti dallgët ka trazue!
Pse pranvera në k'to troje,
me çel sythin, paska droje?!
Ç'paskan ba ata carrokë,
f'tyrëlëmue e njomzakë,
zbathë e zhveshë, f'mijë të ngratë,
rrug'tue kanë ditë e natë
nën kanosjen e mashinkës
t'mitralozit e të thikës?!
Ç'kenkan ata faqenxirë,
sykatila e t'pamëshirë,
dalë nga shpellat e tin'zisë
si gjakpir'sa të rinisë!
Ku po shkojnë? Ku po i çojnë?
- pyesin nënat, me dijtë donë.
E Tivari në flakë ndizet,
në ullishte paqja prishet.
Lugina m'kodra rrethore
u mbyt n'gjak, kthehet në thertore.
Bumllon gryka, teshtin deti.
T'mjerët na f'mijtë ç'i gjeti!

Prind't e tyne partizanë
luftojnë n'veri si luan,
për lirinë e pjellës vetë.
N'Tivar bahet gjaku det…
Nana pyet: Ku je, dritë?
Në Tivar ta kanë mbytë.
Motra pyet: Sugar, ku je?
N'grykë t'Tivarit ta kanë pre.
Gjyshja pyet: Ku t'kam, nip?
Nër kufoma tuj dhanë shpirt…
Kurrë Tivari s'do t'harrojë.
Dielli rrezet do t'shumojë,
me djegë maskën e vrastar've,
me ndriçu' gjak'n e shqiptar've…".[14]

Nuk e dimë nëse ky tekst është këngë popullore a krijim i vetë autorit të romanit? (Më shumë ngjan të jetë e dyta: poezi e krijuar në frymën e poezisë gojore, posaçërisht të baladave shqiptare), por, sido që të jetë, do të mund të thoshim, besoj pa e tepruar, se vështirë mund të gjendet ndonjë krijim tjetër artistik në gjuhën shqipe, që e jep në mënyrë kaq dramatike dhe me kaq forcë emocionale tragjedinë e Tivarit! (Zbulimi i autorësisë së këtij teksti mbetet detyrë e studiuesve). Me mënyrën e shtjellimit të ngjarjes dhe forcën sintetizuese të fjalës, me dialogun dramatik dhe tonin elegjiak, me figuracionin e kursyer e fjalëpak dhe me përgjithësimin e fuqishëm artistik, me një fjalë me të gjithë përbërësit e tij, ky tekst t'i kujton, si thamë, baladat e lashta shqiptare, por edhe poemat e De Radës dhe të Darës së Ri, të ndërtuara mbi gjedhen e tyre: ka një "dhembje universale", si i gjithë "arti i madh". Dhimbja që shpërthen me gulçe, si gjaku nga plagët e të vrarëve, kap përmasa kozmike, duke përfshirë jo vetëm njerëzit, ata që po vdesin dhe ata që pyesin për fatin e tyre, por edhe diellin, hënën, qiellin dhe detin "e trazue", që do të bëhet, në rrjedhën e viteve, simbol qendor i të gjitha krijimeve artistike të frymëzuara nga tragjedia Tivarit. *"M'çove ushtar, o moj nanë,/ në Tivar, në kasaphanë…".* Kënga popullore e cilëson masakrën e Tivarit me fjalën "kasaphanë", çfarë edhe ishte në të vërtetë: një thertore njerëzish. Ushtari që vdes i korrur nga plumbat e pabesisë, sikurse pararendësi i tij i *Këngës së urës së Qabesë* dhe i

[14] *Njeriu dy herë i pushkatuar*, f. 296-297.

baladave të tjera të nizamëve, në çastet e fundit të jetës i drejtohet njeriut më të dashur: nënës. Rima që sajohet me fjalët kuptimisht të kundërta: *nanë-kasaphanë* ka, veç efektit tingullor, edhe efekt semantik; e thellon kuptimin e vargut dhe ekspresivitetin e tij. Të ngjashme me këtë dyvargësh, si për nga intensiteti i dhembjes, ashtu edhe për nga prosedeu, janë edhe vargjet: *"Kush po vjen-o prej Rumisë?/ M'ka marrë malli i shtëpisë. / M'ka marrë malli për vatan/ M'ka marrë malli për bab' e nanë. / Kush e ka t'zezën nanë/ S'po e lan' lot't buk' me ngranë. / Kush e ka t'zezën grue/ S'po e lan' lot't me gatue"*.[15] Dhembja për të rënët manifestohet në dy rrafshe: në rrafshin familjar dhe në rrafshin kombëtar. Shtëpia, nëna, gruaja simbolizojnë të parin; vatani të dytin. Mali i Rumisë është konkretizim i të dytit: i gjeografisë së atdheut. Vepër "e arrirë nga ana artistike", siç thotë vetë autori, duke cituar redaktorët e shtëpisë botuese "Naim Frashëri", romani *Njeriu dy herë i pushkatuar* i Sulejman Krasniqit vuan nga disa dobësi karakteristike të letërsisë së realizmit socialist, çfarë janë: tendencioziteti i theksuar, qasja pak a shumë bardhë e zi temës, ndarja si me thikë e të mirës dhe të keqes, disa veprime të pamotivuara sa duhet të personazheve dhe disa rastësi, që shumë rrallë ndodhin në jetë etj. Kështu, Sokolin e shpëton nga "pushkatimi" i parë, në Kosovë, Dikë Berisha, duke e mbrojtur me trupin e vet, kurse ky e shpëton të nipin e tij, Ximin, në Tivar, duke e mbajtur atë mbi shpinë të plagosur në gjirizet e kanalizmit, derisa hasin në fshatarin shqiptar që këndon këngën e ngritur ndërkohë për ta. Ndryshimi qëndron në faktin që xhaxhai i Ximit, Dikë Berisha, vritet nga ekzekutorët, kurse Sokoli, arrin, me përpjekje mbinjerëzore, të shpëtojë edhe veten.

Viktimat e Tivarit dhe aktualiteti politik

Tema e Tivarit trajtohet, tërthorazi, edhe në dramën *Viktimat e Tivarit* (1991) të regjisorit dhe dramaturgut Ekrem Kryeziu. Bardhi, Bardh Shala, jurist, gjykatës, është i biri i njërës nga viktimat e Tivarit, Metit (Mehmet Shalës), i cili e ka mbijetuar atë, ka mbetur gjallë, por me pasoja të rënda mentale dhe gjendet në një spital psikiatrik. Vetëm kur lëkunden themelet

[15] Këto vargje u dëgjuan gjatë punimeve të konferencës nga goja e një pjesëmarrësi të saj (Imam Bajram Hajdarit), i cili tha se i kishte dëgjuar nëpërmjet telefonit nga një mërgimtar i moshuar i kësaj treve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

e sistemit komunist, Bardhi, i cili deri dje kishte dënuar me burg "irredentistë", përfshirë edhe shokun e vet (Bekimin), kujtohet ta kërkojë të atin; t'i bie në gjurmë atij, për ta gjetur, gjallë a vdekur! Që ta bëjë këtë veprim nxitet nga situata politike dhe nga një miku i tij gazetar, Mentori. Bardhi është kuadër i funksionarit të lartë politik, Alekos. Ai e ka ngritur në karrierë dhe në njëfarë mënyre edhe e ka mbrojtur. Por, vijnë ngjarjet e vitit 1989-90 dhe ai si të thuash "zgjohet", vetëdijësohet në pikëpamje kombëtare dhe nis aksionin për zbardhjen e fatit të babait të tij. "Kërkimi dhe gjetja e babës i bëhet qëllim i jetës". Por pas dyzet e pesë vjetësh! E konceptuar si "një tërësi dramatike në 18 pamje", drama e Kryeziut, më shumë se për të kaluarën, flet për të tashmen, për kohën kur, si pasojë e shkallëzimit të dhunës së pushtetit serb mbi shqiptarët, zgjohet nga gjumi edhe një pjesë e inteligjencies shqiptare, deri atëherë plotësisht e përgjumur e luajale ndaj pushtetit (pjesa dërrmuese) dhe bëhet pjesë e dramës së popullit të vet dhe e përpjekjeve të tij për liri e pavarësi. Drama e Tivarit del vetëm pjesërisht në këtë tekst dramatik, kryesisht si evokim, ëndërr ose ankth. Hiq pjesët më të mira të veprës, ku shpërthen invencioni i shkrimtarit, çfarë janë, fjala vjen, vizita e Bardhit në fshat, tek e ëma, që është gruaja tipike shqiptare, e cila e ka rritur me thonj të birin dhe përgjërohet për të, pastaj rrëfimi i Beqës, partizanit shqiptar, që ka qenë fillimisht, në start, por jo edhe më vonë, përcjellës i karvanit të rekrutëve shqiptarë; imazhi i vetë masakrës, i shfaqur si ëndërr dhe ndonjë mendim sintetik mbi të, pjesa tjetër e veprës, pjesa më e madhe e saj dhe sidomos dialogu i stërzgjatur mes kryepersonazhit dhe funksionarit të lartë politik shqiptar në Beograd, Alekos (Ali Shukriut), shndërrohet në debat politik. Bardhi, i cili deri dje e ka konsideruar si një baba të dytë mentorin e tij politik, Alekon, tani sillet vrazhdë me të: jo vetëm i kundërshton idetë e tij politike, por edhe e fyen atë në shtëpinë e tij! "Ju në njëfarë mënyre keni qenë demiurg i jetës sime…" - i thotë Bardhi Alekos në f. 209, por vetëm disa faqe më poshtë ia përplas në fytyrë thëniet: "për ty varr në Kosovë nuk do të ketë" (f. 222) dhe "Ti je kufomë që ecën e kundërmon" (f. 223). Nëpërmjet dialogut Bardh-Aleko, lexuesit e veprës mësojnë disa gjëra për luftën, për mbetjen e Kosovës nën Serbi, për mobilizimin e djemve të rinj shqiptarë në mbarim të luftës "për t'u therur si berret" në Tivar; për kërkesat politike të shqiptarëve; për protestën e tyre kundër dhunës dhe fyerjeve që u bëhen (detaji

i pshurrjes së miellit në magje); për grevën e minatorëve të Trepçës në mars të vitit 1989 etj. Alekoja, funksionari politik shqiptar i tipit kuisling, herë-herë, flet serbisht; është nevrik, por jo edhe krejtësisht pa rezon politik: *"Unë askënd nuk e kam rrejtur. As në fillim të luftës as tash. Nuk kam dashur që shqiptarët të pësojnë si në mesjetë. Një çerek shekulli që Skënderbeu e mbrojti Evropën nga Turqia… Çka fituam ne pos këngëve popullore… Asgjë. Gjysma e më tepër se gjysma e popullit u vra në ato beteja të pakuptimta… Të tjerët, ata që ia puthën dorën Sulltanit, fituan shtete, shkolla, u shtuan vit për vit… Të gjykosh të kaluarën me përvojën e të sotmes nuk është punë e drejtë…"*.[16] Paragrafi i mësipërm, i cili, sa i personazhit, mund të jetë edhe i autorit, ngre disa dilema, që do të dëgjohen gjithnjë e më shpesh në diskursin politik shqiptar të pas viteve '90. Ka edhe njëfarë paralajmërimi, qoftë edhe me një fjali të vetme, të burokratizmit dhe karrierizmit të politikanëve që do të dalin në skenë në fillimet e pluralizmit politik në Kosovë (pak më vonë edhe në Shqipëri), pas brezit të komunistëve, tani me parashenjën e "demokratëve": *"Mendon se këta të demokratikes nuk luftojnë për karrige?"*,[17] por edhe të rekrutimit të tyre nga radhët e ish-mbështetësve të regjimit: *"Këta që tash po më gjykojnë mua* - thotë Alekoja - *ku ishin më parë? Në korin e duartrokitësve tanë"*.[18] Autori i dramës *Viktimat e Tivarit*, nëpërmjet të sotmes, tenton ta zbulojë të kaluarën dhe ta verë atë në funksion të së ardhmes, duke nxjerrë mësim prej saj. *"Nganjëherë më shkon mendja* - thotë njëri nga personazhet e veprës, Beqa - *se në Tivar ishim të gjithë, edhe ti, edhe ky gazetari, bile edhe fëmijët e palindur… Tivaret janë pjesë e shpirtit tonë"*.[19] Dhe shton: *"Të shpresojmë se nuk do të na përsëriten më"*.[20] Ndërkaq, babai i Bardhit, Meta, gjatë takimit me të në spital, pa e ditur se me kë flet, i drejtohet me këto fjalë: "*A ke fëmijë ti*?" - e pyet Bardhin dhe pas përgjigjes pohuese të bashkëbiseduesit, shton: *"Keq, shumë keq… Fëmijët të pikëllojnë… Ata që nuk kanë fëmijë janë si zogu në mal… Fëmija s'të lë të fluturosh… Si ta kishe rreth qafe gurin e mullirit. Si*

[16] Ekrem Kryeziu, *Viktimat e Tivarit*, në librin *Drama*, Pejë 2008, f. 221.
[17] Po aty, f. 221.
[18] Po aty.
[19] Po aty, f. 187.
[20] Po aty.

atdheu… Edhe atdheu është si fëmija… Të lidh… Të lidh për një lis, për një livadh, për një shtëpi skaj lumit. Të lidh për një copë pëlhurë, që ne i themi flamur".[21] Drama e Ekrem Kryeziut, e realizuar edhe si film televiziv në vitin 1991, me aktorë të shquar shqiptarë si Ndrekë Luca, Rikard Ljarja, Petrit Mala e Ema Andrea në rolet kryesore, hyn në radhën e veprave të para të autorëve kosovarë, që trajtojnë temën e Tivarit. Ka pjesë të bukura, pasazhe interesante, personazhe të individualizuara mirë, por edhe veprime të pamotivuara sa duhet artistikisht. Bardhi e akuzon Alekon se ka heshtur për Tivarin, por ai vetë nuk është interesuar për fatin e babait të tij, që është viktimë e Tivarit, duke e lënë atë dyzet e më shumë vjet nëpër spitalet psikiatrike të ish-Jugosllavisë si njeri pa njeri, për ta gjetur në fund dhe për t'u bërë bashkë si familje, nëpërmjet një *happy end*-i! Është mbresëlënëse figura e Nënës së Bardhit, që del në pamjen e nëntë (Fshati), të cilën e karakterizon përkushtimi i nënës shqiptare për të birin, por edhe urtësia e një nëne të shumëvuajtur, e cila ka sakrifikuar shumë për ta rritur djalin e saj të vetëm, tek i cili i ka mbështetur shpresat për jetë dhe vazhdimësinë e saj. "Sa herë më ka marrë gjumi në dërrasë të vekut".[22] Frika nga e kaluara dhe instinkti i nënës, ka bërë që ajo, "përpara varrit të burrit të vdekur", të preferojoë "djalin e saj të gjallë".[23] Edhe dialogu i Bardhit me Bekimin në burg (i dënuar nga ana e të parit), që zhvillohet kryesisht nëpërmjet funksionalizimit të mitologjisë antike (miti i Haronit/ Karontit, që bart shpirtrat në ferr), nuk është pa interes. Bekimi përfaqëson të burgosurin politik shqiptar, që nuk e akuzon gjykatësin për dënimin e tij, sepse e konsideron edhe atë viktimë të sistemit dhe nuk kërkon të hakmerret ndaj tij. Figurat e tjera të dramës: Hana, Mentori, Mjeku, madje edhe vetë Meta, janë të zbehta. Më saktësisht të zakonshme dhe pa ndonjë zbulim inventiv të realitetit jetësor, përkatësisht pa ndonjë përjetim të fuqishëm artistik dhe pa sensin e duhur tragjik, që e kërkon tema e zgjedhur për trajtim. Të tilla janë edhe pjesa dërrmuese e skenave (pamjeve) të këtij teksti dramatik, që i mungon në masë të madhe pikërisht dramaticiteti.

[21] Po aty, f. 199.
[22] Po aty, f. 161.
[23] Po aty, f. 165.

Një sintezë e fuqishme artistike

Vepër interesante, si me temën, ashtu edhe me konceptin e saj, është poema *Prush plagësh të pambyllura* e autorit Gjokë Dabaj, e botuar me rastin e 60-vjetorit të Masakrës së Tivarit në vitin 2005. Me origjinë nga kjo trevë, ku ka lindur dhe është rritur, autori i kësaj vepre e ka mbajtur, si thotë vetë, gjatë tërë jetës, barrën e kësaj ngjarjeje në shpirt, gjersa ka ardhur koha ta hedhë në letër. *"Unë, që e kam shkruar këtë poemë* - shkruan autori i kësaj vepre në parathënien me të cilën e hap atë - *jam një shqiptar nga Tivari. Në kohën e asaj ngjarjeje, që përshkruhet në këtë poemë, unë isha diku rreth 7 vjeç, por atë që ndodhi, nuk munda ta harroj kurrë dhe nuk do të mund ta harroj gjer në varr"*. Në vazhdim, mësojmë historinë e lindjes së kësaj vepre, nga ideja fillestare e gjer tek dalja e saj në dritë, e cila, siç do të shohim, është e ngjashme me atë të romanit *Njeriu dy herë i pushkatuar* të S. Krasniqit: shtrihet në disa dekada.

"Poemën e kam hartuar për herë të parë në vitin 1968, por nuk e kam botuar dot. Mbas 37 vjetësh shpirtcfilitjeje, duke e mbajtur nëpër sirtarë dhe duke e lexuar e ripunuar shumë herë, para dhe pas çdo dërgimi nëpër redaksira, më në fund, mbase po arrij t'ua dorëzoj brezave, si një shenjë që, ne shqiptarëve të Tivarit, veç asaj që na dhemb shpirti për ata djem njësoj si të afërmve të tyre atje në Kosovë, na rëndon edhe barra se i kemi përditë para syve ato vende ku na janë vrarë".[24] Modest si njeri dhe krijues, autori i kësaj vepre, nuk e fsheh, megjithatë, ambicien për të krijuar një vepër madhore, që t'i përgjigjej pak a shumë përmasës së ngjarjes së cilës i kushtohet: vrasjes së mijëra djemve të rinj shqiptarë, të mobilizuar si ushtarë, në Tivar. "Jo më kot e kam quajtur '*Iliada në vazhdim'*… Së pari, shpirti i kombit tonë e di që mbi trupin tonë janë përsëritur **Trojat** pa mbarim. Disa të pakta **i kanë** këngët, por shumica nuk i kanë. Për ato që nuk i kanë këngët, poemat, detyra jonë është që t'i krijojmë, se, po të mos krijojmë vepra arti për **Trojat** që kanë kaluar, lëmë shtigjet hapur për të na e shkatërruar jetën edhe **Troja** të tjera… Së dyti, e quajta '*Iliada në vazhdim'*, sepse thuhet që pikërisht vargjet e *Iliadës* kanë ndikuar që shpirti i grekëve të vjetër të fisnikërohet. Ata, thuhet, duke përjetuar atë vepër arti, kanë ndier njëfarë

[24] Citati i mësipërm është marrë nga versioni elektronik i veprës, dërguar autorit të këtij shkrimi nga autori i saj, i cili, në versionin e botuar, fjalën "poemë" e ka zëvendësuar me "elegji".

pendese për mizoritë që paraardhësit e tyre kanë kryer në **Trojë**. Kështu që, më vonë, mbi temën e **Trojës** është krijuar në Greqinë e atëhershme një letërsi e tërë, shprehje, siç thuhet, e një lloj autokritike. Në këtë mënyrë, unë do të dëshiroja që edhe ndër sllavët, ndër fqinjët tanë, paraardhësit e të cilëve kanë bërë të këtilla krime siç është ky i **Tivarit**, të fillojë një proces fisnikërimi, duke i njohur më thellë ato ngjarje dhe duke i dënuar edhe **ata** shkaktarët e të tilla gjakderdhjeve. Është koha që, jo vetëm sllavët, por të gjithë gjeneruesit e plojave të kësaj bote, t'i rivlerësojë historiografia, ndërsa arti t'ua ofrojë shpirtrave njerëzorë për t'i përjetuar dhe, si pasojë e përjetimit, edhe për t'i parandaluar". Poema e Dabajt, të cilën, në versionin e saj të botuar (2007), autori e quan, si thamë, "elegji", konceptohet si një thirrje drejtuar botës, njerëzimit, për t'ia bërë me dije mynxyrat që kanë pësuar shqiptarët nga fqinjët e tyre sllavë, një prej të cilave është, pa dyshim nga më dramatiket, masakra e Tivarit.

"Një mijë dhimbje i kemi ne shqiptarët, o Botë! (...) E unë tash/ veç njërën prej tyre po ta rrëfej.../ (Në e rrëfefsha dot!)"[25]

Me vargun e saj të shkallëzuar, me enumeracionet e shumta, eksklamacionet e pareshtura, patosin e lartë emocional dhe apostrofimin e Botës si një "dominantë estetike", poema e Dabajt t'i kujton poemat e Majakovskit dhe të Ricosit (sidomos), që janë ndër poetët më me ndikim në poezinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX. Gjithnjë sipas manirit të tyre dhe poetëve të tjerë revolucionarë, poeti merr përsipër të flasë në emër të popullit të cilit i takon, duke e artikuluar rrëfimin poetik në vetën e parë shumës, por pa e shndërruar atë në fjalim a pamflet politik, dobësi kjo prej së cilës e shpëton në radhë të parë toni elegjiak.

"Brenda ditës na i kanë vrarë/ E ne s'i kemi varrosur ende as sot!/... E ne ende s'i kemi qarë! / Ende s'i kemi qarë dot, po them!/ A më dëgjon mirë, o Botë!"[26]

Përsëritjet e tipit: "po them", "më dëgjon" e të tjera të ngjashme, përftojnë efektin e dialogut të subjektit lirik me botën të cilën e rrethon dhe posaçërisht me të mëdhenjtë e saj, ata që vendosin për fatin e Botës. Autori i poemës në fjalë dëshiron ta bëjë sa më bindës rrëfimin e tij poetik. Në funksion të autenticitetit të rrëfimit janë edhe shprehjet sllavisht, që hasen në tekstin e poemës, të përdorura qëllimisht nga ana e autorit:

[25] Gjokë Dabaj, *Prush plagësh të pambyllura*, Prishtinë 2007, f. 5.
[26] Po aty.

"Slloboda" (Liria), "Zhivella slloboda" (Rroftë liria), "Nasha borba" (Lufta jonë) etj. Ngjarja e Tivarit është një krim *sui generis* për shumë arsye. E para, pse bëhej ndaj njerëzve që ishin antifashistë, madje edhe partizanë (një pjesë e mirë e tyre); e dyta, pse krimi bëhej nga njerëz, që e konsideronin veten po ashtu luftëtarë të nazifashizmit dhe çlirimtarë, madje nën parullën e "vëllazërim-bashkimit", të proklamuar si parim dhe si qëllim të kësaj lufte dhe, e treta, po aq e rëndë, në mos edhe më e rëndë se dy të parat, për shkak se ky krim i paparë, ku u vranë e masakruan mizorisht mijëra njerëz të pafajshëm, që të gjithë shqiptarë, djem të rinj, u mbulua me heshtje jo vetëm në kohën kur ndodhi, në mbarim të luftës, por edhe për një kohë shumë të gjatë pas luftës (gati gjysmë shekulli). Nuk dimë ç'thonë dokumentet sekrete arkivore (është punë e historianëve që t'i hulumtojnë ato, gjë që në kohë të fundit, pak a shumë, edhe është bërë), por kronistët thonë se shtypi i kohës nuk shkroi pothuajse asnjë fjalë për këtë ngjarje makabër. Heshti shtypi i vendit dhe ai botëror. Heshtën politikanët, diplomatët, intelektualët… Heshtje pothuajse e plotë. Madje jo vetëm nga ana e atyre që e bënë masakrën (jugosllavët), por edhe nga pala që i takonin viktimat: pala shqiptare. Në të dy anët e kufirit politik shqiptaro-shqiptar, që vazhdoi të qëndronte aty tek ishte edhe pas luftës: në Kosovë dhe në Shqipëri nuk u fol publikisht për këtë ngjarje. Askund përpos nëpër odat e burrave. Edhe një rrethanë tjetër e bën shumë të rëndë masakrën e Tivarit, madje, në masë të madhe, edhe misterioze. Kolona e të rinjve të mobilizuar shqiptarë të nisur nga Kosova për në Tivar me pretekstin e luftës kundër gjermanëve në frontin dalmatin, kaloi nëpër territorin shqiptar. Bëri nëpër territorin e shtetit atëbotë të çliruar shqiptar një rrugë bukur të gjatë: nga Kukësi deri në Shkodër. Pesë ditë e pesë net zgjati kjo rrugë, nëpër borë e shi; nën kërcënimin e armëve dhe provokimet e spiunëve. *"Ishin net të ftohta e të gjata shumë!/ Kur pushonte era, binte borë,/ kur pushonte bora, binte shi…/ Breshëri plumbash,/ roja, spiunë!..."*.[27] Në vazhdim poeti evokon kohën e fëmijërisë së vet, të kaluar pikërisht në vendin ku ka ndodhur ploja e madhe, kur po merrte fund Lufta e Dytë Botërore dhe pritej të vinte liria e premtuar për të gjithë. Por shpresa mbeti e kotë, sepse arat na u mbushën me varre, varre njëzetvjeçarësh, të vrarë pabesisht e mizorisht nga ata me të cilët luftuam bashkë në një front kundër

[27] Po aty, f. 27.

murtajës fashiste. Por ja që një murtajë edhe më e zezë shfaqet në horizont: ajo e shovinizmit serbo-malazias dhe mbulon në zi tokën, qiellin, katundet, qytetet, çdo gjë; nënat që kishin vënë kusitë në zjarr për të zier për "djemtë që zbritnin nga malet" (partizanët), vërejnë në fytyrat e tyre një buzëqeshje të shtirur, të cilën poeti e cilëson me togfjalëshin: "buzëqeshje teneqeje".

"Njëfarë Zdravko e njëfarë Milenko/ vinin e na mbanin fjalime,/ me një buzëqeshje teneqeje në buzë./ Jemi shokë, thoshin,/ Jemi edhe vëllezër! Se ***nasha borba****/ ia ka përdredhur tash/ demit shovinist zverkun".*[28]

Kështu flasin "komandantët" Zdravko e Milenko, hipur mbi kuaj e mushka, ngarkuar me armë e municion. Ndërsa turma e njerëzve që i grahin si të ishte bagëti skërkave të Shqipërisë veriore, nuk guxon as ta vërë në dyshim "dashurinë" e tyre. *"As supet s'i rrudhje dot në shenjë dyshimi"*.[29]

Poema e Dabajt kushtuar masakrës së Tivarit, prek aspekte të shumta të marrëdhënienve shqiptaro-serbe. Jo vetëm gjatë luftës, por edhe pas saj, kur shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, do të mbeten sërish, pa dëshirën e tyre, nën Jugosllavi, do të vazhdojë jo vetëm politika e diskriminimit ekonomik, social e politik, por edhe përbuzja e nënçmimi ndaj tyre. Dhe, përsëri, si për çudi, një nga levat e kësaj politike dhe të kësaj përbuzjeje, do të jetë fjala "shok", e shqiptuar me përçmim e ironi. *"Fjala* ***shok*** *na kushtoi tepër shtrenjtë ne kosovarëvet./ Aq shtrenjtë, sa për një gjysmë shekulli,/ vazhdonin të na tallnin ende rrugëvet:/ "****Shok****!" (Përpara kinemavet.)/ "****Shok****!" (Tek shisnim kikirikë.)/ "****Shok****!" (Kur na shihnin me sharrë krahëvet.)/ "****Shok!.. Shok more****!"/ (Kur nga mërgimi i postonim një letër shtëpisë.)/ "****Shok****!" (Gjithnjë me përqeshje.)/ "****Shok****!" (Gjithnjë me cinizëm.)/ Ruhuni, shokë! Ruhu, lum miku!/ Mos ia atriboni kujtdo këtë emër!/ As mos e pranoni nga gjithkush!/ Është fjala që do përdorur me shumë kujdes./ E kanë persekutuar fjalën* ***shok*** *si mos më keq!/ Janë qesëndisur me të (Me ne),/ si me një kloun cirku,/ kudo që shihnin një qeleshe,/ anembanë ish-RFSJ-së!".*[30]

Poema e Dabajt ka momente të bukura lirike, vargje e figura mbresëlënëse. Në atmosferën përgjithësisht të vrazhdë të rrëfimit për ngjarjen makabër, ato tingëllojnë si çaste prehjeje. I

[28] Po aty, f. 13.
[29] Po aty, f. 25.
[30] Po aty, f. 35.

tillë është përjetimi i pranverës, stinës së luleve, nga njerëzit shumica e të cilëve janë në lule të moshës: *"Lulet e pjeshkëvet, që sipër xhadesë,/ donin të buzëqeshnin./ Dardhët donin të hidhnin petale të bardhë/ mbi supet tanë"*[31] dhe sidomos kontakti i djemve të rinj kosovarë me detin, kur arrijnë në Tivar. Shumica e tyre, në mos të gjithë, e shihnim detin për herë të parë. "*Ishim të gëzuar që e pamë së paku njëherë... detin*".[32] "*Detin, ne kosovarët s'e kishim parë ndonjëherë*", thotë poeti, duke u identifikuar me turmën dhe duke e zhvilluar rrëfimin në vetën e parë shumës: "*ne*". Pason një krahasim i bukur për ngjashmërinë mes detit dhe djemve sykaltër: "*Ne syqiell, edhe ai faqeqiell*" dhe një protestë për marrjen e detit, ashtu sikurse edhe të tokave shqiptare, nga "*të mëdhenjtë e botës*": "Zeusat e Moskës, Berlinit, Londrës!...".[33]

Në librin e tij në dy vëllime *Shestani*, një studim gjithëpërfshirës enciklopedik, Gjokë Dabaj i bën një përshkrim të hollësishëm masakrës së Tivarit, duke u mbështetur kryesisht në të dhënat që jep i mbijetuari i saj dhe dëshmitari okular (sypamës), *Azem Hajdini - Xani*, në librin *Tragjedia e Tivarit*. Ky libër i Dabajt u botua në vitin 2004, në kohën kur autori e kishte shkruar poemën për Tivarin, por ende nuk e kishte botuar. Rrëfimi i tij (i Dabajt), që shtrihet në mbi dhjetë faqe tekst të librit, është ndër më tronditësit që mund të lexohen për masakrën e Tivarit. Kjo tregon se sa i mishëruar ka qenë ky krijues, siç e thotë vetë, me këtë ngjarje makabre, të cilën nuk mundi ta harronte kurrë. "*Nuk munda ta harroj kurrë dhe nuk do të mund ta harroj gjer në varr"*. Kur ndodhi masakra e Tivarit, brezi i poetit, që në atë kohë ishte fëmijë, këndonte këngë për lirinë duke luajtur me gëzhoja plumbash pranë shtëpive të djegura e të rrënuara. Ishte koha kur këngë lirie këndonin edhe popujt, kombet, krahinat, përfshirë edhe Kosovën tonë të shkretuar sa e sa herë gjatë historisë.

"Guxuam të ëndërrojmë, se tash e tutje/ do të mund të merreshim me të tjera punë!/ Kullat tona, murenxira e shpresëbardhë,/ guxuan të shpresojnë,/ që nuk do të kish më aq

[31] Po aty, f. 29.
[32] Po aty, f. 31.
[33] Po aty.

shumë/ varreza njëzetvjeçarësh/ në këtë tokë…/ Aq shumë,/ sa të detyrohemi t'i lëmë djerr/ gjysmat e aravet…/ për ***varre****!"*.[34]

Parulla e "vëllazërim-bashkimit", nën të cilën qe zhvilluar lufta kundër fashizmit, po dilte e gënjeshtërt. Premtimet për liri, barazi e të drejta të barabarta nuk po bëheshin realitet. "Demit të shovinizmit" nuk "i qe përdredhur qafa", siç thuhej. Jo. Tani që lufta po merrte fund, çuditërisht, ai po merrte një hov të ri në dëm të shqiptarëve. Dhe e tërë kjo ndodhte jo rastësisht. Jo për fajin e ndonjë personi të caktuar a keqkuptimi të rastit. Shfarosja e shqiptarëve, posaçërisht e rinisë shqiptare, ishte program politik dhe synim strategjik i krerëve të politikës jugosllave, e cila kishte ndërruar qimen, por jo edhe hujin. Në luftë, siç e kishte përcaktuar akademiku Çubrilloviq, kjo gjë mund të bëhej më lehtë se në paqe. Mobilizimi masiv i të rinjve shqiptarë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare këndej kufirit në fund të '44-s dhe në fillim të '45-s për t'i dërguar në luftë në Sanxhak, në Bosnjë, në Srem dhe tutje në Dalmaci e Istri, ishte në funksion të kësaj ideje famëkeqe. Tivari, ndërkaq, ishte akti më makabër i kësaj tragjedie shumaktëshe, të luajtur në trojet shqiptare. Ja si e paraqet poeti "grumbullimin" e qeleshebardhëve që do të niseshin për "dikund" dhe aktin e dhimbshëm të ndarjes së tyre nga nënat, motrat, gratë dhe të dashurit e tyre. *"Në sheshet përpara katundevet,/ në ata mëngjese marsi ndaj të gdhirë,/ grumbuj qeleshebardhësh!/ Po i nisnin për dikund./ Rrugët e ndarjes së djemvet prej nusevet,/ prej motravet,/ prej nënavet… buzëngriravet,/ u shpështollën rreth oborrevet,/ rrotull gjerdhevet,/ rrotull kodravet/ dhe rrotull lamtumiravet…"*.[35] E botuar privatisht, madje me shumë vështirësi, nga një autor që bën jetë larg qarqeve letrare dhe institucioneve të uzurpuara nga klanet, poema *Prush plagësh të pambyllura* e Gjokë Dabajt nuk ka tërhequr as përafërsisht sa do të duhej vëmendjen e kritikës letrare (nuk dimë të jetë shkruar qoftë edhe një recension i vetëm për të) dhe nuk ka pasur jehonën që meriton të ketë në mjedisin kulturor shqiptar. E mbajtur gati një jetë të tërë si peng në ndërgjegjen e krijuesit, kjo vepër është, megjithatë, një zë i fuqishëm i ndërgjegjes njerëzore dhe artistike për njërën nga ngjarjet më tragjike të historisë më të re shqiptare, masakrën e Tivarit të vitit 1945.

[34] Po aty, f. 11.

[35] Po aty, f. 15.

Tabloja trazuese

Edhe shkrimtari i njohur Hivzi Sulejmani, në vëllimin e dytë të romanit të tij autobiografik *Njerëzit* , e prek kalimthi këtë temë, ngjarjen e Tivarit, në zanafillën e vet, duke folur për të, më shumë sesa me anë të tekstit, nëpërmjet nëntekstit. Gjatë një udhëtimi nga Prishtina në Prizren në pranverë të vitit 1945, personazhi narrator i veprës, Hafizi, që në të vërtetë është vetë Hivziu, vëren një kolonë njerëzish të rinj, të përcjellë me roje të armatosura deri në dhëmbë nga të dy anët.[36] Hafizi ngryset nga kjo pamje. I duket se po sheh një kolonë ushtarësh të zënë robër. "Hafizi u ngrys nga kjo pamje. U ngrys, sepse iu duk se po shihte një kolonë ushtarësh të zënë robër, të përcjellë nga roje gjermane, të cilën dikur e kishte parë në luginën e Ibrit gjatë kapitullimit të Jugosllavisë së vjetër".[37] Pas pyetjes drejtuar bashkudhëtarit (një udhëheqësi krahinor) se kush qenkëshin këta njerëz, mëson: "Janë ushtarë të sapomobilizuar. I çojnë në Shqipëri. Në të vërtetë shkojnë për Mal të Zi dhe më tutje në Dalmaci…". Episodi përmbyllet me fjalët: "Hafizit iu duk enigmatike krejt kjo punë, aq më shumë që në mesin e djelmoshave me plisa të bardhë në kokë nuk vërejti pjesëtarë të kombeve të tjera".[38] "Mos është fjala për ndonjë mosbesim ndaj pjesës shqiptare të banorëve, iu fut në kokë pyetja ndjellakeqe. E tundi veten menjëherë dhe i erdhi inat për shkak të një mendimi të këtillë. Madje e ndjeu veten si në dofarë darësh. Sepse, po të jetë e vërtetë diçka e këtillë, atëherë i vinte rëndë pse kjo po vinte prej komunistëve. E nëse nuk është e vërtetë, atëherë trazohej pse ai si komunist mund të mendonte diçka të këtillë. Prej këtyre darëve të mendimeve e liroi shpejtimi i makinës, duke lënë pas tablonë që e trazoi".[39] Si përfundim do të mund të thoshim se autori i romanit *Njerëzit* për këtë ngjarje, më shumë sesa përmes tekstit, flet nëpërmjet nëntekstit, duke e gjykuar veprimin e njëanshëm, mobilizimin vetëm të shqiptarëve, si akt që nuk përkon me moralin "komunist".

[36] Hivzi Sulejmani, *Njerëzit 2*, "Faik Konica", Prishtinë 2009, f. 89.
[37] Po aty.
[38] Po aty, f. 90.
[39] Po aty.

Dëshmia e Atë Zef Pllumit

Një dëshmi interesante për ngjarjen për të cilën flasim - Masakrën e Tivarit - jep edhe Atë Zef Pllumi në ditarin e tij *Rrno vetëm për me tregue*, botuar në vitin 2006.

"N'atë kthesë rruge pame që po vinte nji varg i gjatë i pafund ushtarakësh. Rruga gjarpënonte vijave t'atyne kodrave: të gjitha dredhat e leget e saj ishin plot me atê uniformë të urrejtun. Na hini frigë e madhe dhe u shmangëm mbi rrugë dhe u ulëm si për pushim, tue mendue se ç'e zezë e madhe po i kercnohej Shkodrës nga nji tjetër valë brigadash partizane. Kur u aviten, pothuej si në parakalim para nesh: Shka me pa! Vetëm Komandanti që printe ndjekun nga katershja e parë ishin të armatosun: të gjithë tjerët, djelm të gjatë e të thatë, pa bark, si të remtë e me zigoma të theksueme mbi faqe, të lodhun, të raskapitun, me uniformat zhele te shkopsituna, pa armë, që mezi i lëvizshin kambët prej lodhjes, kalojshin të rreshtuem katër e katër para nesh. Mbetëm shtang: ç'ishte kjo ushtri!... Këta mezi mbaheshin në kambë! Largas, anash rreshtit, kishin roje të armatosuna që bërtitshin me kërcnim: "Lëviz, luaj këmbët!". Ndërkaq njani prej tyne pat guxim para vdekjes dhe na foli: "Për iza të Zotit a keni nji copë bukë!". A keni nji copë bukë?! O sa tmerr! As na nuk kishim nji copë bukë: racioni për secilin ishte 300 gram. Edhe na ishim të unshem. Gjithë popullsia ishte unshëm. Shka te bajshim tashti? "Për iza të Zotit ma jepni nji copë bukë! Për iza të Zotit na jepni nji copë bukë!"...

Prej të gjithve filloi të ndigjohej vetem kjo fjalë që kalonte, kalonte... Kalonte në humnerë... Ato ushtojshin ndër veshë tonë njisoj si ato krismat e nji çekani që rreh gozhdat e arkivolit në bregun e vorrit.

- Prej kah vini ju?

- Prej Kosove.

- Tash nji javë dit që ecim pa pushue, pa bukë!... Kemi kalue gjithë ato male... male.

- A ishi të Xhaferr Devës? – i pvetëm.

- Jo, jo. Na jena e zeza e vedit.

Un kam pa ushtrinë e thyeme të Jugosllavisë së Kralit tue hi në Shkodër në prill të 1941, e lodhun, e untë, e raskapitun, e shkopsitun. Nuk ka pamje mâ të keqe se atë të nji ushtrisë së thyeme. Por jo! Tash nuk mund bahej kurrfarë krahasimi me parakalimin e nji ushtrie të tillë: Këtu ishte vetem nji vargan i

gjatë, i gjatë pa mbarim i atyne skeletesh të djelmoçave të rij kosovarë që të rrethuem nga dhuna, ecshin drejt kujt?

Mbasi kaluen ata, na zbritem perseri në rrugë. Por tue kenë se parakalimi i të mjeruemve na kishte marrë shumë kohë, atëherë u kthyem. Hypem te Ura e Qafës dhe nëpër rrugen ma të shkurtë menduem me shkue në Kuvend. Zbritëm poshtë Pazarit të vjetër e duelem në rrugen në breg të liqenit. Prej aty na u çfaq gjithnji ai vargan i gjatë i të mjeruemve që po kalonte mbi Urën e Buenës.

Gjermanët urës i kishin hjekë nji pjesë, pa i prishë ndonji kambë. Partizanët e kishin meremetue perkohsisht me disa trenë e drrasa ku mund kalojshin krahas deri në tre-katër kambësorë. Nuk mund u kthyem në qytet pa sjellë kryet e me kundrue edhe nji herë atë kob të zi. Në horizont të perëndimit qielli ishte i përgjakun: gjithshka shifej kjartë. Vargani mbi urë ecte i mendueshem dhe rryetas. Ndoshta u dukej se po kalonin mbi urë të Siratit, ura e fundit që lidh boten e gjallë me atë të përtejme.

Ishim në mitologji apo në realitet?...

Mbas disa ditësh në Shkodër u hap fjala vesh në vesh se dikund afër Ulqinit partizanët kishin vra të gjithë rininë kosovare. O Zot po t'lutem më trego: çfarë mëkati ka ba ky popull që meritoi nji dënim kaq të randë?...".[40]

Rrëfimi i Atë Zef Pllumit është i vërtetë, autentik, por pa ndonjë përgjithësim të fuqishëm artistik. Është një tekst deskriptiv, si e gjithë vepra nga e cila është shkëputur. Përjashtim bën krahasimi i thirrjeve të ushtarëve të uritur me çekanin që godet dërrasat e arkivolit, si dhe përqasja e kalimit të varganit mbi urën e Bunës si mbi urën e Siratit, që lidh botën e gjallë me atë të përtejme, që zgjon asociacionin e vdekjes së shpejtë të tyre. Bie në sy gjithashtu fakti që grupi i njerëzve që vijnë nga "lutjet Shêjtnore" nuk ndërmerr asgjë, ama bash asgjë, për t'ua lehtësuar sado pak vuajtjet djelmoshave të uritur e të leckosur kosovarë, që shkojnë drejt vdekjes, madje as edhe t'i ofrojë ndonjërit prej tyre një trohë bukë a një pikë ujë, por mjaftohet vetëm me të kundruarit e tyre me dhembshuri nga larg! Që ishin keq për vete, kjo dihet (dhe thuhet), por në situata të tilla njeriu bën çmos të bëjë diç për njerëzit e rënë në fatkeqësi, aq më shumë kur ata i ka

[40] Atë Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, shtëpia botuese "55", Tiranë 2006, f. 34-35.

vëllezër gjuhe e gjaku dhe kur bëhet fjalë për njerëz të devotshëm, çfarë është kasta e klerikëve dhe besimtarëve të tjerë, të cilësdo fe qofshin. Ngjashëm me Hivzi Sulejmanin, Atë Zef Pllumi përshkruan kolonën e rekrutëve shqiptarë, të zhveshur, të zbathur e të pangrënë e të rrethuar me roje të armatosura, në rrugë për në Tivar dhe që të dyve ata u kujtojnë ushtrinë e thyer të Jugosllavisë së Vjetër dhe konstatimin se nuk ka pamje më të keqe se ai i një ushtrie të thyer.

Marrja e Tivarit nga malazeztë në vitin 1878

Edhe një autor tjetër nga kjo trevë, Mehmet Kraja, e trajton temën e Tivarit, por në një plan tjetër e në një kohë tjetër. Dhe, gjithsesi, edhe në mënyrë tjetër. Sado që kur e lexon për herë të parë titullin e romanit *Selvitë e Tivarit* (2008), lexuesit mund t'i shkojë mendja te masakra e vitit 1945, në fakt në të flitet për marrjen e Tivarit nga malazeztë në vitin 1878.[41] Duke e konceptuar rrëfimin nga pozita e një djaloshi adoleshent (prosede që në letërsinë shqipe e ka përdorur me sukses të veçantë Kadareja te romani *Kronikë në gur)*, Kraja jep pamje dhe mjedise autentike, por edhe ngjarje dhe fate tronditëse njerëzish të kësaj treve: të qytetit të Tivarit dhe rrethinës së tij. Koha e zhvillimit të ngjarjeve në roman nuk përcaktohet qartë, por, siç shprehet personazhi-rrëfimtar në kapitullin e tretë të veprës, "ato ditë rreth qytetit tonë gatitej të bëhej një luftë e madhe".[42] Tri ushtri mëtojnë ta shtinë në dorë qytetin e njohur bregdetar: ajo e Dovletit turk, e krajlit të Cetinës dhe ushtria e Ingleterrës. Dy të parat janë të pozicionuara në tokë, në të dy anët e qytetit, kurse e treta në det. Thënia e vjetër se ushtritë i ndjekin pas qentë dhe kurvat, konkretizohet artistikisht në këtë roman. Një pjesë e madhe e syzheut të romanit shtjellohet rreth personazhit të Zuke Kalimanit, femrës sensuale, e cila, pas shumë bredhjesh nëpër botë, kthehet në Tivar pas njëzet e tre vjetësh, për të hapur aty shtëpinë publike me emrin "Dera e Parajsës", siç shkruhet në pesë gjuhë.[43] Komandanti i ushtrisë angleze, Stjuarti i çalë, i shkon çdo të dytën ditë në vizitë Zukes famëmadhe; komandanti i ushtrisë së

[41] Sipas të dhënave historike, në fund të tetorit të vitit 1877 Tivari u rrethua nga forcat e ushtrisë malaziase dhe, pas një qëndrese tremujore, u pushtua më 10 janar 1878, me ç'rast u shkatërrua tërësisht kështjella. Shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori enciklopedik shqiptar 3*, Tiranë 2010, f. 2217.
[42] Mehmet Kraja, *Selvitë e Tivarit*, "Onufri", Tiranë 2008, f. 14.
[43] Po aty, f. 11.

Dovletit deklaron se Zuken nuk e lëshon nga dora "edhe sikur taborët e ushtrisë t'i faroheshin deri në një", kurse komandanti i ushtrisë së krajlit të Cetinës ia pret: "Për shalët e Zuke Kalimanit e shes edhe vatanin!".[44] Masakra që bëjnë të dy ushtritë rivale mbi banorët e qytetit të Tivarit dhe veçanërisht ushtria e Krajlit: krimet monstruoze mbi popullsinë civile shqiptare, burra, gra e fëmijë, tingëllon si një parathënie e largët e krimit të madh të '45-s, në mos edhe si një parabolë e tij (Kapitulli i tridhjetepestë i romanit). Një lloj letërsie paraqet edhe rrëfimi i njërit nga të mbijetuarit më në zë të Tivarit, Azem Hajdinit - Xanit. Ditarët dhe kujtimet, sipas përkufizimeve teorike, janë lloj i letërsisë. Në vitin 1990, kur u hoq censura dhe u krijuan kushtet për të folur për disa tema të ndaluara, ky autor botoi librin me titull *Masakra e Tivarit*, të cilin e ribotoi në vitin 1998 nën titullin *Tragjedia e Tivarit*. Libri i këtij autori është doracaku i parë, në mos edhe i vetëm, i shkruar, i një pjesëmarrësi direkt të masakrës në fjalë, i cili pati fatin t'i shpëtonte vdekjes. Mbi rrëfimin e dëshmitarit Azem Hajdini e ka bazuar rrëfimin e vet për këtë ngjarje autori i librit *Shestani*, Gjokë Dabaj. Fryt i një njeriu me kulturë të gjerë letrare, rrëfimi i tij përjetohet më fuqishëm se i pari. Ndër veprat e tjera me temën e Tivarit, që kemi arritur t'i konsultojmë, po përmendim edhe: poemën *Viktimave të Tivarit* të poetit dëshmor Mustafë Shyti (në librin *Pranverë gjaku*-2001), një libër për Tivarin shkruar nga publicisti Apostol Duka (*Masakra e Tivarit*), vargje dhe poezi të poetëve Din Mehmeti, Ali Podrimja, Azem Shkreli, Vehbi Skënderi, Sadri Ahmeti, Hamit Aliaj, Ndue Sinishtaj, Milaim Berisha, Besim Zymberi, Jakup Ceraja (edhe te romani *Lida*) etj., ndër të cilët edhe Bedri Hysa: *Ti varr Tivar*, Mexhit Mehmeti, *Baladë shqiptare*;[45] Ibrahim Berjashi, *Gjëmë ulliri*[46] etj.

Është interesant të theksohet fakti se për të krijuar përfytyrimin e masakrës së Tivarit të vitit 1945, të kësaj gjakderdhjeje të madhe, na ndihmojnë edhe vargjet e një vepre të shkruar gati një shekull më parë (rreth vitit 1885), poemës *Kënga e sprasme e Balës* të Gavril Darës së Ri. Në një nga këngët e kësaj poeme, në atë që flet për betejën e Beratit, ku shqiptarët e zënë në befasi pësuan disfatë nga turqit, hasim ndër të tjera edhe këto

[44] Po aty, f. 15.
[45] Mexhit Mehmeti, *Përtej harrimit*, Prishtinë 2008, f. 94-95.
[46] Ibrahim Berjashi, *Gati u harruem*, Art Club, Ulqin 2013, f. 55.

vargje: *"Gjak në erë, gjak në re,/ Gjak në ujë, gjak në dhe;/ Gur më gur një copë mish/ Kreje a llëre trimash kish!"*.[47] Poeti flet për një betejë të pesë shekujve më parë (betejën e Valkalit të vitit 1465), por lexuesit i cili mund të mos e dijë këtë fakt, vargjet e mësipërme, ku fjala *gjak* është fjalë kyçe, i tingëllojnë si të ishin shkruar për ngjarjen e vitit 1945 në Tivar, këtë "betejë" tmerrësisht të pabarabartë mes njerëzve të armatosur gjer në dhëmbë, me armë e urrejtje, në njërën anë (shovinistëve serbo-malazez) dhe shqiptarëve duarthatë, në anën tjetër, nga e cila rrodhi gjak që spërkati jo vetëm dheun e ujin, por edhe qiellin dhe retë! Përgjithësimi i fuqishëm artistik, që është veti e kryeveprave, nuk njeh kufij kohorë as hapësinorë.

Si përfundim disa konstatime në formë konkluzash:

1. Për Tivarin në letërsinë shqipe është shkruar pak, shumë më pak se ç'meriton kjo ngjarje e madhe dhe tragjike e historisë sonë më të re.

2. Arsyeja pse është shkruar pak (ose relativisht pak) duhet kërkuar në radhë të parë te rrethanat historike në të cilat kanë jetuar shqiptarët në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, në të dy anët e kufirit dhe, rrjedhimisht, te censura dhe diktati politik, që kanë kufizuar lirinë krijuese dhe zgjedhjen e lirë të temave dhe të mënyrës së trajtimit të tyre.

3. Tema e Tivarit deri vonë, pra deri në fillim të viteve '90, kur ra sistemi komunist, ka qenë temë e ndaluar (në Kosovë), kurse jo shumë e dëshiruar, për të mos thënë edhe e padëshiruar në Shqipëri. (Vetë fakti që në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* të vitit 1985 nuk trajtohet fare masakra e Tivarit, e konfirmon këtë).

4. Për Tivarin nuk kanë shkruar shkrimtarët më të mirë shqiptarë, krijuesit me potencë dhe përvojë më të madhe krijuese (Kadare, Qosja, Shkreli, Kraja, Dibra, Shehu etj.), por kryesisht krijues me mundësi krijuese mesatare ose nën mesatare.

5. Ndër veprat që arrijnë ta trajtojnë më gjerësisht dhe të depërtojnë më në thellësi të kësaj drame të madhe e tragjike, mund të përmenden: romani *Njeriu dy herë i pushkatuar* i Sulejman Krasniqit, drama *Viktimat e Tivarit* e Ekrem Kryeziut dhe poema *Prush plagësh të pambyllura* e Gjokë Dabajt.

[47] Gavril Dara - I Riu, *Kënga e sprasme e Balës*, Tiranë 1965, f. 77.

6. Nuk pretendojmë se kemi informacion të plotë për gjithë sa është shkruar për Tivarin dhe aq më pak se kemi arritur t'i konsultojmë të gjitha ato krijime në të cilat trajtohet ose edhe preket kjo temë, prandaj çdo sugjerim në këtë drejtim do të ishte i mirëseardhur.

7. Tema e Tivarit mbetet e hapur për trajtime nga më të ndryshmet (letrare, artistike, historike, publicistike etj.), por konsiderojmë se shtrohet si kërkesë e ngutshme shfrytëzimi i njerëzve që e përjetuan vetë atë sa janë gjallë për të nxjerrë prej tyre dëshmi që do të ndihmonin në trajtimin sa më të plotë e më të nuancuar të kësaj teme të madhe, të denjë për penën e një Homeri a Shekspiri.

Le të shpresojmë se do t'i ketë në të ardhmen.

(Tekst i paraqitur si kumtesë në Konferencën Shkencore kushtuar Masakrës së Tivarit, mbajtur në Ulqin më 30-31 mars 2013)

GJUHËSI

Shefkije ISLAMAJ

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT DHE ÇËSHTJE TË LEKSIKUT

Nëse drejtshkrimi është fusha e normuar më me rreptësi e gjuhës standarde, leksiku është fusha më së lirshmi "e normuar" brenda sistemit gjuhësor. E nisëm kështu për të përfushur tezën që do të përvijohet në këtë kumtesë e cila jo vetëm vërteton një fakt të gjithënjohur, por lejon edhe mundësinë për t'iu kundërvënë atyre që thonë se Kongresi i Drejtshkrimit i bëri një padrejtësi të madhe e të palejueshme leksikut të dialektit verior, dialektit gegë, dhe se kjo u bë për qëllime thjesht politike dhe të tjera.

Sot pas më shumë se 40 vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit, i cilësuar nga mendjendriturit si ngjarja më e madhe kulturore në jetën e shqiptarëve përgjatë shekullit XX, diskutimi për vlefshmërinë e standardit për shqiptarët, diskutimi për vlefshmërinë e rrugës që është ndjekur për këtë standardizim dhe, më në fund, edhe diskutimi për përmbushjen a mospërmbushjen e funksioneve komunikuese në të gjitha rrafshet nga ana e këtij standardi, shikuar nga perspektiva e së tashmes dhe e së ardhmes së shqiptarëve, duket jo vetëm prapakthyese, por, më shumë se kaq, verbëri dhe mospasje vizioni për ecjen e shqiptarëve bashkë në kohën qe po vjen.

Duke ndjekur tezën e ngritur për diskutim në fillim shtrohet pyetja: a e ka normuar Kongresi i Drejtshkrimin leksikun, në të vërtetë a e ka sanksionuar përdorimin a mospërdorimin e një pjesë të leksikut të shqipes? A ka qenë e mundur kjo? E para që duhet të thuhet është: shumëfunksionaliteti dhe shtresëzimi i gjuhës standarde janë kriteret më të rëndësishme për "normimin" e leksikut. Këto dy kritere nuk janë marrë dhe as nuk po merren parasysh në mënyrë kritike në debatet shkencore e joshkencore. Kjo ka sjellë gjykime jo të drejta dhe argumentime të pambështetura shkencërisht për normën tonë gjuhësore, rrjedhimisht edhe për normën leksikore.

Brenda këtyre diskutimeve, më së shumti u debatuan e po debatohen *drejtshkrimi, paskajorja* dhe *leksiku.* Nëse i pari, pra *drejtshkrimi*, "përfitoi" nga ky debatim e aktualizim edhe disa propozime konkrete, në të shumtën e herës të paarsyetuara shkencërisht dhe praktikisht, në Këshillin Ndërakademik të Gjuhës, i cili u krijua këtu e dhjetë vjet më parë, në rend të parë, si rrjedhojë dhe si presion pikërisht i këtyre debateve, e dyta, *paskajorja* pret në radhë për t'u bërë çështje e "nxehtë" po në këtë Këshill. Mund të thuhet, madje, se ende nuk janë hapur të gjitha çështjet që pretendohen të hapen e të "zgjidhen", dhe për më tepër priten edhe rrjedhoja të tjera të këtyre debatimeve, jo vetëm në rrafshin e drejtshkrimit, po sidomos edhe në rrafshin morfo-sintaksor. Çështja e tretë *leksiku* nga këto debate mund të duket se do të kalojë më së lehti, pikërisht pse çështja e leksikut nuk mund të krahasohet me çështjet e fonetikës dhe gramatikës, ndërsa paragjykimet për këtë të fundit rrëzohen lehtësisht. Çështja e leksikut i takon më shumë dijes së linguistikës njohëse a konjitive dhe vetëm ajo mund të sqarojë më së qarti lidhjet e leksikut me normësinë, rrjedhimisht edhe me drejtshkrimin, dhe për arsye se kjo çështje nuk ka të bëjë me asnjë lloj normësie të caktuar a të paracaktuar në Kongresin e Drejtshkrimit. Si e tillë kjo çështje kërkon diskutim e jo debatim dhe gjithsesi në nivele profesionale-gjuhësore me platforma që do ta shohin problemin realisht e jo me argumentime joshkencore, paragjykime politike, ideologjike, krahinore, e të tjera.

Se cilat janë problemet e leksikut të shqipet lidhur edhe çështje të normës leksikore na e sqaron drejt e qartë, pos të tjerëve, leksikologu ynë i shquar, prof. Jani Thomai në referatin e paraqitur po në këtë Këshill për çështje aktuale të leksikut të shqipes, në të cilin midis të tjerash thotë: "Problemet e leksikut në shqipen e sotme standarde janë shumë më të veçanta sesa në nënsistemet e tjera të gjuhës, si fonetika, gramatika e fjalëformimi, së paku për katër arsye themelore: A) për shkak të veçantisë së normës leksikore; B) për shkak të raporteve të leksikut të standardit me leksikun e gjuhës në përgjithësi C) për shkak të dinamikës dhe të lëvizjeve të mëdha e të shpejta në leksik me gjithë qëndrueshmërinë e normës drejtshkrimore e gramatikore, dhe Ç) për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë e të menjëhershëm të zhvillimeve e të ndryshimeve historike,

ekonomike, shoqërore, madje edhe politike ose të politikave të zbatuara në planifikimin gjuhësor".

E trajtuar kështu çështja e leksikut të shqipes ligjëson edhe moskodifikimin e asnjë rregulle të ngurtë e të rreptë për leksikun e shqipes në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes dhe konfirmon absurditetin e diskutimeve për "lënien anash", si thuhet qëllimisht, të leksikut të gegërishtes për rrjedhojë edhe "varfërimin substancial" të shqipes pa këtë leksik. Me këtë rast po tumir një mendim të Ardian Vehbiut, i cili u sillet shpesh këtyre debateve. Citoj: "Fakti më i dukshëm, më absolutisht i rëndësishëm, që u shpëton – nga padija ose nga mendja e keqe – ithtarëve të "pasurimit" të standardit me fjalë gege të lëna deri më sot jashtë, është se dy kryedialektet e shqipes dallojnë mes tyre sidomos në fonetikë dhe gramatikë, por jo dhe aq në leksik; dhe se këto dialekte i kanë shumë fjalë, me qindra në mos mijëra, të përbashkëta mes tyre – duke filluar nga fjalë të rëndomta, si ***pishë, dorë, mend, gjej, shkoj, i mirë, kot, dje***, etj.; pa përmendur pastaj që variacioni leksikor brenda një kryedialekti ose dallimet leksikore midis të folmeve (të themi, e folmja e Zadrimës dhe e folmja e Drenicës), shpesh është po aq i theksuar, në mos më tepër, se variacioni leksikor midis kryedialekteve." Dhe se "dallimet leksikore ndërdialektore luajnë rol të parëndësishëm në mënyrën si strukturohet dhe si funksionon leksiku i sotëm normativ i shqipes; para së gjithash, ngaqë folësi përgjithësisht nuk mund ta dijë se nga ç'dialekt ka hyrë një fjalë e caktuar në standard, përveçse po të jetë specialist dialektolog." 2 Në linguistikë, siç thotë Dejvid Kristal 3 vlen aksioma që të gjitha gjuhët përzihen dhe ecin në hap me shoqërinë dhe njëra nga rrjedhojat e kësaj përzierjeje është lindja e fjalëve të reja, e mënyrave të reja të shqiptimit, e gjedheve të reja gramatikore, e kodeve dhe e varianteve regjionale dhe shoqërore, krahas zhdukjes së shkallëshkallshme të mënyrave të moçme të shprehjes. Kjo vlen edhe për shqipen, prandaj përcaktimi i kufijve gjuhësorë diakronikë dhe sinkronikë, për më tepër përcaktimi i kufijve regjionalë - dialektorë, krahinorë e lektalë, është shumë i vështirë.

Më tutje, po përpiqem ta plotësoj mendimin e drejtë të Vehbiut, të shprehur me lart, se leksiku i shqipes është përftuar në kontekstin mbidialektor të shqipes dhe paraqitet si një sistem që po zhvillohet përmes burimeve të ndryshme: krijimit, huazimit,

shfrytëzimit të burimeve dhe të mjeteve fjalëformuese të shqipes të të dyja dialekteve dhe të folmeve të tyre. Standardi i shqipes nga aspekti leksikor shpreh potencial për zgjerim e zhvillim e jo mbyllje e frenim. Ja dhe një arsye që vërteton vështirësinë e kodifikimit të një norme të rreptë leksikore. Natyra e standardsisë dhe e asnjanësisë në fushën e leksikut, ashtu si edhe mundësitë e gjuhës standarde shqipe në rrafshin e leksiku, më së miri shfaqen në prodhimin letrar, në prodhimin e publicistik, në prodhimin shkencor, në prodhimin leksikografik, shkurt në punën e shkrimtarit, të publicistit, të gazetarit, të shkencëtarit, të përkthyesit, të leksikografit, të terminologut, të redaktorit gjuhësor, e kështu me radhë, me një fjalë të të gjithë atyre që me gjuhën shënojnë, krijojnë dhe zhvillojnë botën tonë. Përpjekja për ta normuar leksikun në kuptimin e përjashtimit, siç parakupton koncepti "normë", në të vërtetë do të thotë përpjekje për të vënë në kallëpe dhe për të modeluar përvojën e një bashkësie gjuhësore, prandaj është e gjykuar të dështojë para se të fillojë të zbatohet. Kjo ndodh edhe në rast të përpjekjes për zbatim të dhunshëm të një "norme" leksikore. Hartuesit e rregullave të drejtshkrimit të shqipes e kanë ditur mirë këtë fakt.

Në debatet për leksikun shkohet edhe me tutje. Edhe fjalori i gjuhës së sotme shqipe, bashke me plotësimet që ka njohur deri më 2006, cilësohet si përjashtues i një pjese të madhe të leksikut te Veriut. Nuk është gjuha standarde fjalori i vitit 1980, as plotësimet e tij të mëvonshme, sepse nuk është e mundur të paraqitet e gjithë pasuria e saj në një fjalor. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, i quajtur si "Fjalori i Kongresit" nga kundërshtuesit e standardit, pos fjalësit të përbashkët të të dyja dialekteve, që është pjesa e kryesore e fjalorit, pjesa më e madhe absolute, ka përfshirë edhe mjaft njësi leksikore me përcaktuesin dialektizma të ngushta, që shpesh janë të burimit të huaj, turk, grek e sllav, e që i gjejmë në të dyja dialektet. Fjalori ka përfshirë gjerësisht materialet gjuhësore të gegërishtes nga vepra e Fishtës dhe nga veprat e autorëve të tjerë gegë, nga fjalori i Bashkimit e nga fjalorë të tjerë të arealit gegë. Një hetim më i hollë në këtë rrafsh e dëshmon fare mirë këtë pohim.

Mund të shtrohet pyetja - a kanë mbetur jashtë këtij fjalori fjalë të gegërishtes? Natyrisht se kanë mbetur. Dhe kanë mbetur jo vetëm të gegërishtes, po edhe të toskërishtes, edhe të të folmeve të tjera të të gjithë arealit shqipfolës, deri edhe të atyre të

arbëreshëve të Greqisë, të arbëreshëve të Italisë e të Zarës dhe më gjerë, sepse nuk ka qenë dhe nuk është e mundur as të përfshihen të gjitha dhe as të mblidhen të gjitha fjalët a shprehjet. Por duhet të thuhet me këtë rast se gjuha standarde është e hapur posaçërisht ndaj fjalëve me burim popullor (dialektor a krahinor), sepse "për arsye historike që dihen, ka një mospërputhje midis pasurisë së madhe leksikore (fjalësore) të gjuhës së folur që rron në dialekte dhe në të folme të shqipes dhe pasqyrimit të kufizuar të kësaj pasurie në botime të ndryshme." 4

Nuk është leksiku i gjuhës standarde tërësia e fjalëve të një fjalori sado i madh e përfshirës të jetë ai, sepse kjo është pamundur të realizohet. Edhe kriteret e përzgjedhjes gjithmonë mënjanojnë numër të caktuar të fjalëve, siç ka ndodhur edhe me fjalorët që kemi: u është dhënë përparësi fjalëve vendëse para fjalëve të huaja, fjalëve me shtrirje më të gjerë para atyre me përdorim shumë të rrudhur, neologjizmave para huazimeve e kështu me radhë. Konsideroj se ky nuk është problemi që duhet të na shqetësojë. Ka problem të tjera që lidhen me leksikun e leksikografinë shqipe që mund të konsiderohen të ngutshme dhe jo lehtë të zgjidhshme.

Për dallim nga gjuha si sistem, çdo gjuhë si standard, ashtu si edhe shqipja, është e lidhur pandashëm me kombin që e flet, si njëri ndër përbërësit më thelbësor në procesin e shndërrimit dhe të ngritjes së tij nga aspekti thjesht i tërësisë etnike në bashkësinë shoqërore globale me shkallë të lartë të lidhjes ekonomike, politike, kulturore e institucionale. Në këtë kontekst leksiku, si bartësi themelor i kuptimit në gjuhë dhe si thesar i përvojës kulturore-qytetëruese është mjeti më i fuqishëm ndikues brenda këtyre shndërrimeve e ngritjeve. Në rrethanat shoqërore-gjuhësore, në të cilat gjendet këtu e më shumë se dy dhjetëvjetësh edhe gjuha shqipe, çështjet e leksikut, më në fund edhe vetë çështja thjesht pragmatike e "normësisë" leksikore, që lidhet me përzgjedhjen e fjalëve në situata të ndryshme komunikuese, nuk paraqet vetëm faktin e përcaktimit gjuhësor, por bëhet edhe një si "gjysmë gjuhë", pikërisht për arsye të politizimeve dhe mistifikimeve edhe në këtë rrafsh gjuhësor. Po u nisem nga konteksti dhe nga kuptimi, mikro dhe makrostilet përkatësisht shumëfunksionaliteti dhe shtresëzimi i gjuhës standarde si kriteret më të rëndësishme për "normimin" e leksikut nga pikëpamja e standarsisë bashkëkohore, mund të thuhet se sot hetohen prirje

negative, në të vërtetë ndikime negative të rrethanave politike, shoqërore e kulturore në përgjithësi në leksikun dhe në të ashtuquajturën "normë leksikore", ndikime të cilat viteve të fundit janë shprehur, pos të tjerash, edhe përmes aspektit negativ të përzierjes së stileve dhe, rrjedhimisht, edhe të mosmarrjes parasysh të shtresëzimit funksional të leksikut, duke shpërdorur kështu edhe kriteret e epshmërisë së normës leksikore dhe të traditës tashmë të qëndrueshme standardologjike në shqipen, e cila gjedhen e normësisë vazhdon ta kërkojë në gjuhën e shkrimtarëve të mëdhenj. Prandaj mund të thuhet se më parë se për një normë leksikore sot duhet të flitet për parime normative që ndërtohen mbi aktualizimin dhe kontekstin gjuhësor, rrjedhimisht edhe konteksti i përdorimit të shenjës gjuhësore – fjalës. Ky kriter duhet të jetë përcaktuesi i vetëm i rëndësishëm për përzgjedhjen e leksikut dhe jo përkatësia e tij dialektore a krahinore. Dija mbi gjuhën, përkatësisht standardologjia si pjesë e saj, është e detyruar ta kërkojë vendin dhe rolin e saj sot në një situatë tejet të përbërë shoqërore, politike kulturore, prandaj edhe gjuhësore, në hapësirën shqiptare.

Në këtë përvjetor të Kongresit të Drejtshkrimit, kur po kur po shënohet dyzetvjetori i tij, gjerësia e problematikës që mund të shtrohet e të diskutohet sot i kalon kufijtë e çdo konference shkencore të organizuar për të. Kjo problematikë do të mund të përfshinte trajtime që lidhen jo vetëm me aspektin e normës dhe të normësisë, të rregullave të drejtshkrimit, të rëndësisë dhe të kuptimit të këtij Kongresi për shqiptarët në perspektivën e sotme e të mëtejshme gjuhësore, për njohjen dhe zbatimin e rregullave të drejtshkrimit, por edhe trajtime që lidhen posaçërisht me leksikun (tërësinë e fjalëve) dhe fjalëformimin e shqipes, me leksikografinë shqipe (teorinë dhe praktikën e hartimit të fjalorëve të tipave të ndryshëm), me përfshirjen e leksikut popullor (dialektor e krahinor) me vlerë letrare potenciale në Fjalorët e gjuhës së sotme shqipe (1980) dhe në fjalorë të tjerë të shqipes a me shqipen, me pasurimin e mëtejshëm të leksikut të saj, me terminologjitë e shqipes, me sfidat në kontekstin e ri shoqëror-politik, me letërsinë artistike, me prirjet e reja zhvilluese në gjitha rrafshet e stilet e gjuhës, e kështu me radhë.

Mund të sjellim përfundimin se gjuha standarde për këto 40 vjet e shkuar ka dëshmuar se i përmbush mirë funksionet e një gjuhe të përbashkët mbarëkombëtare dhe se ajo nuk mund të

identifikohet me idiomën mbi bazën e së cilës është ndërtuar. Si e tillë ajo paraqet pasurinë e përbashkët gjuhësore, brenda së cilës janë mbrujtur forma, struktura, morfema, leksema, frazeologji e ndërtime të mbarë shqipes në vertikalen e horizontalen e saj. Dhe, në këtë pasuri kanë hisen të gjithë shqiptarët, sepse ajo është krijuar përgjatë historisë së tyre të përbashkët dhe në proceset e sotme të zhvillimit të tyre dinamik në të gjitha fushat e jetës dhe pse ajo është pasuruar dhe po pasurohet edhe përmes lëvizjeve dhe komunikimit ndërshqiptar shumë të dendur dhe shumë domethënës sot.

FUSNOTAT

1. Jani Thomai, *Probleme të leksikut në shqipen standarde,* material i përgatitur për Këshillin Ndërakademik të Gjuhës, shkurt 2012.

2. Ardian Vehbiu, *Mistifikimet e fjalës gege,* blogu *Peizazhet e fjalës* – internet.

3. Kristal, Dejvid, *Smrt jezika*, Beograd, 2003, f.208.

4. Hajri Shehu, *Androkli Kostallari, pse fle sirtarëve puna e tij kolosale?,* "Gazeta shqiptare", Tiranë, 23.3.2011.

Gjurmë lashtësie

Fahri XHARRA

BARKAT E QEPURA ILIRE DËSHMOJNË SE ISHIM TË HERSHËM

E pamundur dhe shumë e vështirë të mos e lidhësh historinë tonë me zbulimet e nënujit dhe të nëntokës që vazhdimisht na befasojnë me mrekullitë e të kaluarës tonë. Sa më shumë po zbulohet, po shihet që historia na i ka ruajtur shënimet e saja në mënyrë të virgjër, që një ditë të na e thotë ato që nuk guxonim t'i thoshim ne. Nuk guxonim, por edhe nëse guxonim, flisnim "me të dëgjueme", se nuk kishim prova. Provat, ah provat!

Tentimi për të zhvlerësuar çdo gjë

Sa e paturpshme më duket kur më thonë që po kërkoj për të gjetur shqiptar në shpellat e Azisë, në jashtëtokësorët, në gjithësi. Në një anë, *mosdija* dhe qëndrimi absolut në përkrahjen pa dhembje në *mosdijen* individuale dhe atë kolektive, e në anën tjetër, dëshira e qëllimshme për mohimin e çdo gjëje shqiptare dhe të kaluarës së saj. Derisa fqinjët e nxjerrin vetveten të vjetër dhe vendas të këtyre tokave, të vjetër mbi 8000 vjet, disa nga ne në mënyrë absolute mundohen të zhvlerësojnë çdo gjë.

Por kur t'ju them që ne i kishim edhe *barkat e qepura* që ato ishin pjellë e mendjes së të parëve tonë për ta për ta lehtësuar bartjen, lëvizjen dhe komunikimin ndërnjerëzor, në arë kohë nuk kishte as sllavë e as turq këndejpari. Barka e qepur e gjeur këto ditë në ujërat e njelmët të Kroacisë, që sipas arkeologëve daton mbi 3200 vjet e vjetër, është një falënderim që na ka bërë natyra duke na i ruajtur reliktet e kohës, që në kohën e si të dokumentojmë që ishim këndejpari kur nuk kishte njeri tjetër, ishim ne.

"Një barkë e kohës së Bronzit u gjet në Mesdhe" - shkruan gazeta "Le Poin-fr" – duke i falënderuar syçeltësisë së një peshkatari. Pra, në lagunën Zambratija në Kroaci, arkeologët nënujorë ia dhanë dritën një barke të vjetër 3200-vjeçare, të

fshehur në fundin e detit. Një shpërblim i natyrës me ruajtjen e saj.

"Ky është një bulim i jashtëzakonshëm" – thoshte e ngazëllyer Giulia Boettto, arkeologe detare e ngarkuar për hulumtime nga CNRS. E gjithë kjo ishte një vazhdim pune e bashkëshortëve kroatë: Ida Konçarit (arkeologe) dhe burrit të saj, Marko Uhaç (Ministër i Kulturës së Kroacisë), të cilët që në vitin 2008, në bazë të shenjave që iu kishte dhënë peshkatari, kishin ndërmarrë zhytje–hulumtim dhe i kishin sjellë mbi ujë provat e një barke që mendohet të ishte romake (?). Por, falë restaurimeve të sondimit me karbonin C14, u pa që objekti ishte i kohës pararomake, nja 1200 vjet para Krishtit. S'kishte as Romakë atëherë, e as Perandori Romake.

Qepja me litarë bimorë

Fjala ishte për një konstrukt, plotësisht i veçantë, tipik për Detin Adriatik. "Barkat e qepura" ishin një teknikë e posaçme lundrimi e jetësuar në Adriatik, deri në ardhjen e romakëve, dikush thotë "epokën e romake". Mjeshtëria ishte në atë që dërrasat mbaheshin ndër veti me një "qepje" me litarë bimorë. Këta litarë futeshin ndër zgavrat të cilat shpoheshin nëpër dërrasa dhe kështu e krijonin tërësinë që qëndronte.

Nga kjo barkë e madhe apo anije e vogël, kanë mbetur 7 m nga gjatësia dhe 2,5 m nga gjerësia e saj, d.m.th. lidhjet dhe pjesa tjetër është kalbur. Pjesa e mbetur, pra, është pjesërisht e ruajtur mirë. Dërrasat ishin nga druri i bredhit, verrit dhe elmit.

"Mënyra e rregullimit, teknika e të lidhurit dhe e përforcuarit të dërrasave ndër veti, ishin tipike për Histritët dhe Liburnët, dhe me këtë mund të them me sigurinë më të madhe se ishte fjala për një mjet lundrues të ndërtuar nga njerëzit lokalë" – thotë arkeologia Giulia Boetto. Por nuk mbaron me kaq, arkeologët kroatë, nja disa qindra metra larg anijes së vogël gjetën mbi një sipërfaqe të madhe prej më shumë se një hektar, shtylla të drurit, të cilat ishin mbajtëset e shtëpive të vjetra mbi ujë.

Pas analizimit mathymetrik të gjirit, qeramikave dhe kockat e kafshëve të ndryshme të gjetura në vendin e përmendur, duket se epokën e Bronzit, gjiri ishte në të vërtetë... një lagunë.

Liburnia – një thesar i gjetur

Seç më ra laku në fyt dhe gati ma zuri frymën, gati më ngulfati kur e pashë të shkruar që nuk paskemi vazhdimësi nga ilirët, se qenkemi "të mbirë" mbi këta mijëravjeçarë nga farat e kërpudhave të sjella nga Azia në një vend që i "kishte" banorët e saj që moti. E ne si "ardhacakë", të vendosur si për "gjynah" në malet e bjeshkët e Ilirisë "pritnim leje" që të vazhdonim jetën. "Mirësia e vendasve" si kundërshpërblim për shërbimet që i bënim na mundësoi të bëhemi ata që jemi. "Duhet t'ua dimë për nder" që "na dhanë" pak tokë, pak ujë dhe pak frymë! A jemi ne në vete? Po kush e pranon këtë? Ne duhet të jemi plotësisht të shitur, plotësisht të pagjakë, që të alivanosemi nën ndikimin e aromës së joshjes për të mohuar çdo rrënjë tonën. "O Perëndi, a ndjeve, po lanë pa histori dhe e kishte për ta fajësuar Zotin, e ti rri e gjuan me rrfe lisat nëpër maje kot" Pudi! Liburnia! Çudi Histritët! Po, si një thesar i gjetur të vlerave unike të përzierjes së trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike. ("Liburnët, të parët e shqiptarëve", nga FXh) Liburnia, shkruajnë kroatët, është një simfoni e pamjeve dhe e zërave nga aroma e shijeve dhe e kultit.

Primorja dhe Gorski-Kotari (Kroacia e sotme) shtrihen mbi atë që dikur ishte pjesa perëndimore e asaj bote antike, e thurur si pëlhurat në vekat e lashtësisë, nëpër thellësinë e hapësirës dhe kohës. Bota e natyrës, me llojllojshmërinë e saj ishte e bekuar nga Zoti. Valët specifike të habitatit të Alpeve Dinarike dhe ngrohtësia e Adriatikut, e bëjnë reliefin që të zgjon krenarinë e një toke të trashëguar. Pozita gjeografike e kësaj pjese të Ilirisë, që bënte lidhjen më të shkurtër në mes qytetërimeve të Mesdheut dhe asaj të Evropës Qendrore, ishin të bekuar për këtë rënie të domosdoshme në lakminë historike. Historia e saj është aq e pasur sa trashëgimia natyrore nga ajo. Në një tokë aq të vogël shekujt e tërë janë përplasur ne pushtues dhe mbrojtës, me luftëra dhe tregti, dhe famë e kulmin historik, deri në rënie në duart të ardhësve që ndërroheshin pa mëshirë. Liburnia ishte tokë e Liburnëve, një tokë përgjatë Adriatikut verilindor, në kohët e sotme Kroacia, kufijtë e të cilit lundronin në zgjerimet e tij duke e rritur dominimin e Liburnisë në mes të shekujve 11-të 1 të epokës sonë.

("*Kosova sot*", e enjte, 27 mars 2014, fq. 8)

Folklorike

Dilaver KRYEZIU
(koreograf)

KËNGËT NGA MALËSIA E MADHE

(*Malësorçe***)**

Folklori shqiptar është shumë i pasur, si i tillë jeton edhe sot me terë ndryshimet në shoqëri. Ajo që mund ta presë më së miri këtë pasuri është kënga, sidomos ato këngët e vjetra tona shqiptare të karakterit pagan, këngë lirike, këngë kreshnike, këngë këto që më së miri tregojnë kushtet, rrethanat sociale-ekonomike dhe historike nëpër të cilat kaloi populli ynë. Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë këngët për folklorin tradicional të një populli, ato duhet të ruhen e të kultivohen, të mblidhen e të flitet për karakteristikat e tyre, sepse ato në të kaluarën e edhe sot janë pjesë përbërëse e muzikës artistike.

Këngët malësorçe si lloj i traditës gojore, përmbajnë elemente të rëndësishme kulturore të kësaj tradite. Këto këngë i përkasin kohës së lashtë, këngë që këndohen në një mënyrë të vjetër. Këto këngë janë trashëguar brez pas brezi, natyrisht duke u transformuar sipas kërkesave të kohës. Emri i tyre na tregon për prejardhjen e tyre dhe përdorim,in e tyre nga malësorët, të cilëve vetë kushtet jetësore u kishin imponuar një mënyrë të tillë këndimi. Por këto kushte jetësore i bënë malësorët të jenë njerëz të fortë, krenarë që i bëjnë të dallojnë jo vetëm nga popujt e tjerë ballkanas, por edhe me vetë shqiptarët e tjerë. Për malësorët thuhet se këngën dhe vallen e kanë pjesë të pandashme të jetës dhe, mu për këtë dëshiroj të citoj një të dhënë të dalë nga populli: *Malësori edhe kur shkon thikë përpjetë me një barrë miell të ngarkuese në shpinë, ia fishkëllen, ia këndon. (Prof. dr. Rexhep Munishi:* Çështje të folklorit shqiptar).

Këngët malësore, edhe pse të afërta nga karakteri, ato i gjejmë me emërtime të ndryshme: *këngë kushtrimi*, *majekrahi*, *përmajekrahi* ose *përkryekrahi*. Me këto emërtime i gjajmë në disa vende në Mal të Zi dhe në Malësinë e Mbishkodrës. Por

ndonjëherë i gjejmë edhe me emrat *asqerçe*. Në disa vende në Kosovë si: në Gjakovë, Rugovë, Dukagjin etj., i gjejmë me emrin *malësorçe, piskë, kangë me gisht në vesh*; në anën e Gollakut e të Karadakut quhen *kangë të krushqve*.

Emërtimet lidhen me mënyrën e interpretimit, sipas shtrirjes gjeografike, sipas zërit etj. Këngët malësorçe u kënduan në lufta, në festa (dasma), disa me zë të ulët e disa me zë të lartë. Këngët malësorçe varësisht se ku shtrihen ato kanë karakteristika të përbashkëta, krahas gjuhës ato paraqesin ngjashmëri edhe në fushën e kulturës materiale dhe shpirtërore. Sa i përket tematikës së tyre këngëve ato ndryshonin varësisht kërkesave të kohës. Ato për nga përmbajtja nuk janë shumë të pasura, kanë një tekst i cili përsëritet, herë-herë përsëritje të modifikuara, por me këtë strukturë tekstuale këto këngë tregojnë lashtësinë e tyre, këto këngë me pak tekst tregojnë një mesazh të qartë. Një karakteristikë tjetër e veçantë e këngëve malësorçe është edhe pozicioni i këngëtarëve gjatë interpretimit, dy nga ato themeloret janë pozicionin këmbë dhe ai në gjunjë.

Këngët që këndohen në këmbë mund të interpretohen gjatë ecjes dhe kur jemi të ndalur. Kur këndohen këngët malësorçe në këtë pozicion nga dy këngëtarë, atëherë ata vendosin gishtin në vesh apo edhe e mbulojnë veshin etj. Këngët që këndohen në gjunjë, gjatë interpretimit këngëtari ose mban dy gjunjët poshtë ose njërin poshtë dhe tjetrin lart.

Këngët malësorçe këndohen në një vijë melodike, janë këngë njëzërëshe, nuk kanë elemente të këndimit polifonik. Këto këngë këndohen nga një apo më shmë këngëtarë. Duke mos dashur ta zgjas shumë, por gjithmonë duke e ditur rëndësinë e këtyre këngëve, në si njohës i folklorit e pata kënaqësinë të bëj një vështrim të shkurtër mbi paraqitjen dhe zhvillimin tyre si një thesar i çmuar i folklorit tonë. Shpresoj që në të ardhmen do të kemi edhe më shumë hulumtime e mbledhje, botime e incizime të këngëve të tilla, sepse përmes tyre lirisht mund të them se evidentohet edhe identiteti ynë kombëtar.

Sociokulturë

Kujtim RRAHMANI

MITI, HISTORI E ORALITET NË LETRAT SHQIPE

Si u rri miti letrave bashkëkohore shqipe, si flet me historinë dhe oralitetin?

Do të thosha se ai ka një ton armiqësor në relacion me korpusin letrar, por gjen miqësi me historinë dhe oralitetin, si dy struktura e forma të pranueshme strukturimi nga kjo letërsi. Qyshkur, mbretëria e mitit flet si ndjeshmëri e njohje e ontosit, tharmit të jetës e të universit, si shqisë e si botëkuptim, si eksperiencë, si mënyrë komunikimi e marrëdhënieje me idetë, njerëzit, sendet, kuptimet.

Modernizmi i shek. XX, duke sforcuar autoritetin e botës subjektive të autorit, ka lënë shtigje për jetën me mitet tradicionale dhe autoriale. Po ky modernizëm, ka pasur të shpallura manifeste për Rendin e Aventurën në arte, por për fat të keq (nganjëherë edhe të mirë!) tallazet mentale të shoqërisë nuk mjaftohen e kënaqen vetëm me aventura poetike, pa provuar instalimin e rendit të shpallur si *i vërtetë*, duke ngjalluar kështu edhe sensin masiv social për një lloj aventure të shoqërisë në kërkim të *rendit të vërtetë*, duke krijuar në këtë mënyrë megamitin e së vërtetës. Kështu edhe epoka më anti-mit përfundon në mit-mentalitet, përveç tjerash edhe për arsye se jeta e njeriut nuk ka kuptimi pa mit - pa lojën, kuptimin, moralin dhe *amoralin* që ofron ai. Ndaj dhe njeriu i kthehet atij riciklueshëm si një dashurie të parë nga e cila është bërë trungu i tij. Qoftë mitit për Zotin, jetën dhe format e kuptimin e gjithçkaje qoftë mitit si figurë-pamje-rrëfim i motivuar si letërsi. Prandaj dhe miti si reprezentim i un-it primordial deri te ai sociokulturor, do të bëhet pashmangshëm pjesë e studimit antropologjik të *poiesis*-it dhe ontosit human në përgjithësi.

Ndryshe nga koha e Antikës, e Mesjetës dhe deri diku e Kohërave Moderne, kur miti është mbivlerësuar dhe më rrallë nënçmuar, shekulli XX solli një perceptim bizar të mitit, duke e

konsideruar të parëndësishëm atë, duke e nënvlerësuar madje edhe etiketuar *blanco*; përveç në fushën e ngushtë të arteve. Mbase ishte Iluminizmi, pak më parë, ai që filloi t'ia jepte teposhtëzën mitit duke e mistifikuar *dijen shkencore për të vërtetën* dhe duke farkuar kështu mitin modern të së vërtetës, të shndërruar pastaj në mentalitet *scientist* po edhe më shumë se kaq. Kështu, prej zotërimit të psikës dhe të shpirtit njerëzor, miti u bë demon, prej ideologjisë religjioze e sociale u bë pengesë, mbeturinë. Fjala *shkencë* filloi të zinte fronin e mitit, duke u promovuar pavërejtshëm në një lloj mit-mentaliteti të ri. Ndonjëherë edhe sot, në botëkuptime intelektuale e në studime humane mitin e gjejmë si prodhues të një *vetëdije primitive*, sikundër mund të ndjehet lehtë në fusha të gjera studimesh se logosi apo shkenca e ka gulçuar mitin si dimension të lojës së njeriut, duke e mbuluar fushën e tij. Mendimi shkencor dhe jeta e konstruktuar, e udhëhequr mbi këtë paradigmë, e ka thyer strukturën *e brishtë* dhe të *errët* të mitit, racionalja e ka mbishkelur *iracionalen* mitike.

Është e ditur që, paradoksalisht, mitin e ushqejnë racionalja dhe irracionalja, imagjinarja dhe historikja e transcendentalja, ëndrra dhe realja, hyjnorja dhe tokësorja. Kjo nomenklaturë e *ushqimeve* të tij e bën atë të rrëshqitshëm, të pamundur, të parehatshëm për skema të ndryshme konceptuale. Natyrisht është gjithnjë më e lehtë të bëhet një taksonomi e mitit si princip i pastër letrar, kur ai vetë është dhënë dhe receptuar si i tillë. Shpesh, një mit i fenomenit bëhet mit teme dhe miti i temës bëhet mit i personazhit dhe kështu riciklohen funksionet ndërsjelltas. Telashet fillojnë aty ku miti e kalon principin e vet të motivimit si letërsi dhe bëhet më shumë – psikologji jete, botëkuptim, botëshpjegim, ideologji; qoftë si projektim individual qoftë si besim a mashtrim kolektiv.

Mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh
për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë.

Kështu fliste për *fjalën Azem Shkreli*. Pikërisht mbi fjalën edhe e ndërtoi mitologjinë e tij poetike, mitin e fjalës. Këtu *fjalë*, domethënë *jetë* - jetë e njeriut krijues. Por, fjala e Azem Shkrelit shkon deri te gjeneza biblike e fjalës si fillim. Ndërsa *Kadare* lidhej në mënyrën e tij me mitin e *Laokontit*:

O sikur të mundja gjithçka të tregoja.
Si do të ngrinit para meje si gur,
por unë i dënuar mes rropamës suaj moskokëçarëse
monologun të thur.

Një shenjë kjo se miti, edhe në tallazet e forta anti-mit të letrave shqipe gjeti rrugët e veta për të mbijetuar si frymë e bukur fiksioni. Në letrat shqipe, miti ka goxha një traditë shkrimi e receptimi. Vetë tekstet shqipe të cilave jemi mësuar t'u themi *letërsi e vjetër* kanë zanafillën e vet si një mit për kulturën, pa harruar edhe mitet kozmologjike e kozmogonike që burojnë s'atyshmi. Miti për kulturën, në periudhën e Rilindjes Kombëtare bëhet edhe mit për kombin, duke u shndërruar edhe në mit iluminist. Meqë asnjë epokë politike e kulturore nuk jeton jashtë miteve, secila i transformon dhe i transcendon ato sipas fytyrimit të vet. Në një mënyrë fare të veçantë, komunizmi i demistifikon, i zhvesh ato, për t'i shkatërruar dhe për të krijuar mbi to *të vërtetën e padiskutueshme*, duke farkuar kështu një lloj miti të ri *të së vërtetës*, duke i dhënë tipare mitike vetë doktrinës së vet ideologjike. Në instancën e fundit, mitet e reja socialiste janë shtyllat e strukturës së realizmit socialist si religjion i ri, i pashpallur si i tillë por i njohur si *e vërteta* finale. Zot final në të cilin nuk mund të dyshohej ishin të vërtetat e Partisë. Përderisa në njërën anë i shpallej luftë mitit si strukturë *e shtrembëruar* e realitetit, duke u përafruar shpesh edhe me religjiozen, në anën tjetër sforcohej logjika letrare, formacionale, e realizmit socialist, si një mit i ri për njeriun e ri socialist. Miti komunist ndërtohet si një lloj miti negativ për njeriun e ri i cili duhet ta rrënojë çdo gjë të vjetër. Miti si letërsi as që receptohej. Ai kishte kryesisht receptim të gjerë si një *ideologji e shtrembër* që duhej ndrequr.

Miti tematik i letrave shqipe në Shqipëri, pas Luftës së Dytë Botërore kishte prodhuar edhe mitin e strukturës letrare që tashmë ishte thadruar në doktrinë, sipas modelit përkatës. Madje, vetë struktura letrare ishte shndërruar në një mit të llojit të vet. Komisari politik si pronar i së vërtetës dhe i së drejtës, është figura që e markon përfundimisht këtë letërsi si ide dhe si strukturë. Vetë heroi me kazmë u bë mit bashkëkohor i njeriut shqiptar në luftë me hyjnitë. Si *njeri i ri* ai mori përmasat e mitit të madh të njeriut që e di të drejtën dhe të vërtetën. Prandaj, miti i kësaj letërsie është një vegëz direkte e lidhjes me doktrinën, duke u shpallur luftë *miteve të vjetra*, atyre që origjinarisht lidheshin

më spontanisht me natyrën e letërsisë. Mitet dhe legjendat që lidheshin me Rozafën duhej të zhvisheshin dhe ribëheshin ashtu që të pasqyronin të vërtetën, meqë miti ishte *vetëdija e shtrembër* e interpretimit marksist. Të kujtojmë vetëm një konceptim të tillë të mitit te romani *Kështjella mbi Barbanë*, të *Jonuz Dinit*, te *Shembja e idhujve* e *Skënder Drinit* etj., ku heronjtë mitikë zëvendësohen me të keqen njerëzore që ka fytyrë të armikut të klasës e të popullit. Në Kosovë, ky lloj demistifikimi ideologjik ndodh më pak dhe kryesisht si ndikim nga literatura që vjen nga Shqipëria.

Në krejt letrat shqipe, miti është i zhvilluar më pak si letërsi dhe motivim letrar dhe më shumë si prani e mentalitetit që merr shenjat ideologjike të një psikologjie të bashkësisë. Fatmirësisht, letrat shqipe ruajnë brenda vetes gjithnjë edhe motivimin e qëndrueshëm letrar në relacion me mitin. Në letrat shqipe, këtë princip estetik individual të krijimit të miteve, si personazhe e si struktura të ndryshme letrare e gjejmë në mënyrë më ilustrative te I. Kadare në Shqipëri dhe te *A. Pashku* në Kosovë, si dy ikona letrare mbas emrave të të cilëve vijnë krijues të tjerë që mitin e duan, e lexojnë dhe e trajtojnë brenda statusit të tij fiksional. Por, hapësira e gjerë letrare mbahej nga prirja për zhbërjen dhe *zhveshjen e miteve*, dhe kjo gulçon frymëmarrjen e vetëmotivueshme fiksionale të letrave bashkëkohore shqipe. Mitet e krijimit, rruzullimit e universit, parabolat biblike të dhëna me gjuhë miti, sikur edhe mitet nacionale të forcuara gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare të viteve ’30, përmes të cilave artikulohej e bukura e poezisë si pjesë e këndimit për atdheun, u tretën menjëherë pas *Çlirimit* socialist. Ndonëse edhe te realizmi socialist estetika hyn në funksion të etikës sikur te rilindësit dhe iluministët shqiptarë, kjo ndodh në mënyrë më specifike, sepse etika prodhohet nga *lart* dhe jo si vullnet e motiv krijues individual e grupor. Atdheu i dikurshëm rilindës, si piemont i dashurisë së kësaj jete, i shndërruar në mit, vazhdon të jetë i tillë edhe në letrat bashkëkohore, në Kosovë kryesisht si mit rilindës, iluminist dhe me primesa të konceptimit poetik modern, ndërsa në Shqipëri si mit nacionalsocialist. Madje kjo duket se flet si një shenjë që thotë se mentaliteti poetik shqiptar flet e ndjen si mentalitet politik. Kjo shkon aq larg sa shpesh vetë fjala *poezi* domethënë në rend të parë *atdhe*. Kështu ndjen *D. Agolli* te *Nënë Shqipëri* dhe te poezia e tij në përgjithësi, po edhe poetët e

Kosovës, *Ali Podrimja, Din Mehmeti, Fahredin Gunga, A. Shkreli* etj., sikundër edhe poetët arbëreshë që atdheun e ëndërrojnë dhe sjellin para si një lloj memorje poetike.

Prandaj, krahas motivit social e politik, atdheu del temë e madhe e letrave shqipe të shek XX. Me mija poezi e faqe proze, nga ’45-ta e këndej, përshkruajnë jetën e rëndë të fshatarësisë dhe klasës punëtore, të njerëzve që vuajnë nga pushtimet e huaja, nga reaksionarët, kulakët, armiqtë. *Atdheu përmbi të gjitha*, i pasur, socialist etj., përshkon letrat shqipe kryqetërthor. Në këtë kontekst do situar edhe misioni patriotik i kësaj letërsie i cili del kryesisht si filozofi sociopolitike dhe jo estetike, duke i dhënë krah kështu mitit negativ të *njeriut të ri*. Miti i ri socialist, por pa licencën e *mitit*, është parë kryesisht si një zëvendësim i miteve të vjetra, i historisë apo edhe i kulturës orale. Ai i ka zëvendësuar mitet e vjetra në emër të zhveshjes së miteve, historia *e re* e ka zëvendësuar historinë *e vjetër* dhe folklori *i ri* e ka shpëlarë folklorin *e vjetër*. Historia që del nga doktrina socrealiste merr formën e fabrikatit dhe jo të rrjedhojës historike e kulturore. Në këtë frymë gjithë mitet historicizohen duke u shndërruar në *vlera pozitive* për shoqërinë, edhe folklori i vjetër rikonfigurohet e rimotivohet në frymën e jetës së re, të këngëve për partinë dhe *führer-in*, për atdheun sipas masës së kësaj ideologjie. Po ashtu historia shfrytëzohet si autorizim për të vërtetën e sotme të ideologjisë; si autorizim për pronësi të padiskutueshme mbi të vërtetën. Kultura *e re* orale bëhet ornament i kësaj historie dhe i shmanget esencës së vet të mëhershme si traditë. Tradita tashti është *e re*, e vjetra është vetëm e konstruktueshme dhe e konstruktur për hir të historisë dhe ideologjisë së sotme të *së resë* e *progresives*. Kodet tradicionale si janë *Kanuni, Kangët Kreshnike*, doke, zakone etj., bëhen anakronizma e konservatizma që duhen zhdukur, prandaj bëhen të dënueshme si motivime letrare, përveç si motive negative që prodhojnë damkë. Ta zëmë, çdo fenomen që lidhej me traditën e Kanunit, në parim duhej damkosur edhe në letërsi. Mbetej ndonjë ornament i mikpritjes, besës etj., jo si kulturë, por si një etiketë gjoja për tradicionalen. Historikja dhe moralja janë nënrenditje e ideologjikes në letrat shqipe, ashtu si në jetën shqiptare të gjysmëshekullit të fundit. Shoqëria shqiptare e pranoi *moralin e ri* që erdhi nga instalimi i ideologjisë së re, në shërbim të *historisë së re*. E ndodhur në një ambient që sapo kishte nisur të marrë frymë në ambientin e ideve

liberale-humaniste të shek. XX, sistemi i vlerave të jetës shqiptare, në politikë e kulturë, u kthye në një bumerang të ardhjes së rendit *të ri*. Madje, nocioni *rend i ri* u rifarkua edhe një gjysmë shekulli më pas në petka të globalizmit.

Pothuaj për një gjysmë shekulli, të familjarizuar me njëri-tjetrin, miti, ideologjia, historia, politika e folklori hyjnë në *bashkëbisedim* të vazhdueshëm, duke krijuar pastaj një lloj kontrate intertekstuale e interdiskursive, që nga vokabulari e deri te tezat, nga epiteti e te alegoria. Kështu, për një çast dalin pabesueshëm të ndërlidhura fusha të ndryshme diskursesh edhe kur këto diskurse fillimisht përjashtohen për shkak të proviniencave dhe kërkesave të ndryshme. Diskursi historik dhe ai gojor e mashtrojnë vazhdueshëm natyrën e tyre, e simulojnë historinë dhe folklorin sipas një gjedheje ideologjike dhe po kështu ndodh edhe me mitin. Ta zëmë, romani historik zhvillohet mbi primesat dhe qëllimet e *ndriçimit të historisë sonë të ndritur nëpër shekuj*, pra duke abstraguar motivimet fiksionale të autorëve. Fiksioni bëhet instrument në shërbim të *pasqyrimit* të realitetit historik ideologjik. Në vend se historia dhe oraliteti të jenë mjete dhe struktura që shfrytëzohen nga fiksioni, ky i fundit bëhet i shfrytëzueshëm dhe i shfrytëzuar nga ato; një shenjë kjo e një letërsie doktrinare dhe fort të angazhuar.

Në këtë kontekst, miti, historia dhe folklori e oraliteti shqiptar ekzistojnë dhe funksionojnë si histori e gjallë jete dhe jo si fiksion. Kultura orale e shfrytëzuar artistikisht bindshëm në vitet ’30 ndërron formë. Tashti çdo përrallë, mit a legjendë duhej të nxirrte një moral për *jetën e re*. Letërsia në përgjithësi duhej medoemos t’i ngjante jetës socialiste, duke u bërë kështu një lloj mega-metonimie. Prandaj u fuqizua epiteti në Shqipëri dhe alegoria në Kosovë. Historia u zhvillua si *histori e inventuar*.

Oraliteti *i ri*, në trajtën e një agjitpropi folklorik ideologjik, u shpall traditë dhe kështu miti, tradita e oraliteti u kthyen në shërbim të historisë së inventuar ose edhe historisë së re – edhe *historisë* edhe *e re* (!)– për ta mbajtur kështu artin në lojën më të pakëndshme të motivimeve jashtartsistike. Vetë diktatura, edhe etimologjikisht (*dicter – them, diktoj*) vjen nga fjala e thënë së larti, nga urdhri gojor që duhet shpërndarë në masa. Kështu oraliteti *i ri* bëhet vëllam i tonit autoritar, diktatorial. Ngjashëm kësaj, edhe fiksioni që njeh për shtrat të vetin doktrinaritetin dhe oralitetin autoritar, shfaq dëshirën që ta joshë dhe mashtrojë

masën me letërsinë e vet si shërbesë. Retorika e kësaj letërsie motivohet për të bindur ideologjikisht para se letrarisht.

Pra, historia dhe tradita u inventuan për qëllime ideologjike përderisa tradita e njohur si e tillë u përpoq të transcendohej pjesërisht për aq sa ishte e mundur në forma të pranueshme nga autoritetet politike. Tërë letrat u shndërruan në një lloj miti negativ – të letërsisë *së vërtetë* apo *pasqyruese të së vërtetës*. Në këtë kuadër kanë funksionuar disi vetëm disa mite të inventuara ose të sforcuara e *të parrezikshme* kulturore si miti i *epokave të lavdishme historike* si ajo e Skënderbeut, ai i Epopesë së LNÇ-së etj., si mite të fabrikuara për heroizmin dhe legjendaritetin e personaliteteve nacionale-internacionale. Ideologjia e re e bëri vetë historinë *e re* mit, duke e afishuar atë me gojë e me shkrim.

Rrjedhimisht, letërsinë shqipe të gjysmës së fundit të shek. XX po edhe më vonë, e ushqen oraliteti, ndërsa oralitetin. Nga ana tjetër, miti dhe oraliteti e ushqejnë iluzionin e historisë si komb-krijim dhe shtetbërje.

IDEOLOGJIA ANTIGLOBALISTE

mr Dritan Abazoviq
politikolog

Para se të filloj që të shkruaj për Antiglobalizëm, do të kisha dashur që të shfrytëzoj dhe në pika të shkurta të shkruaj disa fjalë për globalizimin si nocion, që në vazhdim të kemi pasqyrë të qartë se kundër (anti) çkahit në të vërtet janë antiglobalistët. Globalizimi është term kuptimi i të cilit nuk është i qartë aq sa duhet, prandaj edhe ekzistojnë dallime të mëdha mes autorëve rreth përkufizimit të tij. Disa Globalizimin e shohin si një proces i cili çon drejt bashkimit të njerëzve, shteteve dhe kulturave të ndryshme, si një proces i cili synon ta shndërrojë botën në një "fshat global", fshat të vogël ku të gjithë do të jetonin në marrëdhënie shumë të mira ndërshtetërore.

Nëqoftëse do të kishte ekzistuar një kuptim i vetëm për globalizimin, atëherë ai dotë ishte "integrim në nivel botëror". Autorët tjerë, globalizimin e shohin si proces që mundëson lidhjen e njerëzve nga mbarë bota dhe krijimin e përfitimeve për të gjithë, ndërsa disa të tjerë që janë më tepër antiglobalizimit, atë e shohin si proces që individëve dhe shteteve të pasura ju mundëson që të pasurohen edhe më tepër në kurrizin e të varfërve. Pra, që të kemi fitues çdoherë duhet të ketë edhe humbës. Pjesa e dytë, e humbësve ne suaza të globalizimit çdoherë është më e madhe dhe ndoshta mu prej këtu edhe lindin kritikat negative në adresë të globalizimit, kritikë kjo që në literatura te ndryshme do ta hasim si "antiglobalizim" apo ndokund edhe si "lëvizje antiglobaliste".

Anti-globalizimi është qëndrim politik i opozitës, për të perceptuar aspektet negative të globalizimit. Lëvizja përkatëse është e njohur gjerësisht si lëvizje e anti-globalizimit dhe është kryesisht një përpjekje bazë, me mbështetje nga disa elitat intelektuale. Antiglobalizmi është nocion që më së shpeshti përdoret për të shënuar lëvizjet, ideologjitë ose politikat shtetërore, të cilat në këtë ose në atë mënyrë kundërshtojnë proceset e globalizimit, fuqinë politike të korporatave shumëkombëshe dhe pushtetin e ushtruar përmes kontratave tregtare.

Termi “antiglobalizim”, është një term që më shumë e preferojnë mediet. Kjo mund të çojë në disa ngatërrime, sepse aktivistët i kundërshtojnë vetëm disa aspekte apo forma të globalizimit, e jo edhe vetë globalizimin. Vetë aktivistët, për shembull Noam Chomsky, kanë thënë se ky emër është i pakuptimtë, ngase qëllimi i kësaj lëvizjeje është globalizimi i drejtësisë (shtrirja e drejtësisë sociale në mbarë globin), ‘‘lëvizja për drejtësi globale’’ është një emër i përbashkët për ta. Shumë aktivistë ndërkaq bashkohen nën sloganin “një botë tjetër është e mundur”.

Aktivistët e antiglobalizimit protestojnë kundër marrëveshjeve të tregtisë globale, efekteve negative të tregtisë së lirë për vendet e varfra dhe ndotjen e mjedisit jetësor, gjegjësisht ata protestojnë kundër efekteve negative të globalizimit. Në fakt, shumë prej njerëzve të përfshirë në lëvizjet antiglobaliste nuk janë kundër një bote pa kufij dhe mbështesin lidhjet e ngushta ndërmjet popujve dhe kulturave të ndryshme të botës. Pjesa më e madhe e tyre janë pro-globalizmit. Anti-globalistët mendojnë se nganjëherë janë të margjinalizuar nga medietkryesore dhe qeveritë e tyre për shkak të shikimeve të forta "anti-biznes", shumica e medieve nëpër botë janë në pronësi të të pasurve apo korporatave të mëdha, për të cilët aktivistët besojnë se kanë konflikt të interesave me pjesën tjetër të shoqërisë.

Antiglobaliste është mjaft e gjërë, duke përfshirë grupet e kishës, grupe çlirimtare, parti të majta, parti nacionaliste, ambientaliste, bashkimet fshatare, grupe antiracizëm, anarkiste, e tjerë. Sidoqoftë shumica janë reformatore, të cilët luftojnë përnjë formë më humane të kapitalizmit. Disa të tjerë janë më revolucionare duke besuar tek një sistem më human sesa tek kapitalizmi. Protestat e lëvizjes për drejtësi globale i kanë detyruar takimet e larta (samitet) ndërkombëtare të mbahen larg qyteteve të mëdha ku mbaheshin zakonisht, në lokacione të vetmuara ku protestat janë të pamundshme. Si organizata më të njohura antiglobaliste janë Fifty Years is Enough, International Forum on Globalization, ATTAC, Global Exchange, Globalise Resistance, Ruckus Society, Ya Basta (sipas thënies së njëjtë zapatiste që do të thotë “Mjaft më!), Indymedia (Independent Media Center), Black Bloc, Food not Bombs (FNB), Friends of Earth, Public Citizen etj.

Janë të shumta aspektet ku kundërshtohet globalizimi. Antiglobalistët i arsyetojnë qëndrimet e veta në aspektet vijuese. Duke filluar këtu nga problemet ekonomike, dimenzioni shoqëror, ai politik, si dhe problemet e mjedisit. Nëse analizohen me vëmendje do të vërejmë se të gjitha këto dimensione janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Kështu, vetëm për të përmendur disa shembuj, problemet e mjedisit nuk mund të trajtohen si të izoluara as nga dimensioni i "ekonomisë" dhe as nga ai i "politikës". Është bërë e qartë se globalizimi po krijon pabarazi edhe më të mëdha në mes shteteve të botës dhe bota është bërë bipolare, gjegjësisht botë e vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Në përgjithësi, kritikët shprehen se rezultatet e këtij procesi nuk janë ato që ishin parashikuar kur u synua rritja e tregtisë se lirë dhe për më tepër se shumë institucione të përfshira në sistemin e globalizimit nuk kanë marrë në konsideratë interesin e vendeve të varfra e të klasës punëtore si dhe çështjet e mjedisit. Teoricienët e tyre, mbështetur në argumente ekonomike, deklarojnë se tregtia e lirë e pakufizuar krijon përfitime për të pasurit në kurriz të të varfërve.

Antiglobalistët preferojnë ta shohin globalizimin jo si një fenomen që sjell përftime për të gjithë por si një fenomen të iniciuar dhe kontrolluar nga vendet e zhvilluara kapitaliste dhe korporatat transnacionale. Institucionet Kryesore (Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata Tregtare Botërore) dhe korporatat transnacionale nuk e promovojnë zhvillimin ashtu siç thonë. Ato sipas antiglobalistëve paraqesin një ”kolonializëm të ri”, përmes dhënies së huave shteteve të Botës së Tretë, me kusht që të zbatojnë politikat në përputhshmëri me interesat e elitave të shteteve të Botës së Parë.Shumë konferenca të mbajtura nga ministrat e tregtisë dhe të financave të vendeve që e përbëjnë thelbin e kombeve të globalizimit zhvillohen nën protesta të mëdha, herë-herë të dhunshme, nga kundërshtarët e ‘‘globalizmit të korporatave”. Këtu bëhet fjalë për një ndarje që ka mbetur që nga koha e Luftës së Ftohtë kur SHBA-ja dhe aleatët e tyre e llogaritnin veten si shtete më të zhvilluara, pra si Botë e Parë, BRSS-ja dhe aleatët e tyre, pra shtetet komuniste llogariteshin si shtetet e Botës së Dytë, ndërsa shtetet tjera të pazhvilluara llogariteshin si Botë e Tretë.

Korporatave transnacionale të cilat llogariten si forca kryesore lëvizëse e globalizimit ekonomik u mundësohet që të

bëjnë eksploatimin e burimeve natyrore të Botës së Tretë dhe të pasurohen në kurrizin e tyre. Antiglobalistët mbrojnë tezën se politikat që po zhvillon Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe korporatat transnacionale janë shkaktare për problemet globale, si ngrohja e atmosferës së tokës, vrima e ozonit, apo shpyllëzimi i pyjeve tropikale. Një aspekt tjetër që kundërshtohet nga antiglobalistët është dimensioni shoqëror. Padyshim se bota po shndërrohet në një "global village". Përveç komuniteteve tradicionale si familja apo fqinjësia, po dalin në skenë komunitete të reja komunikimi (chat, e-mail, facebook), por ato nuk zëvendësojnë dot këto hapësira tradicionale komunikimi. Nëse do kalonim pastaj në dimensionin kulturor të globalizimit, ata thonë se si rezultat i afrimit të kulturave të ndryshme, vjen deri te shkatërrimi dhe zhdukja e disa kulturave. Këtu vlen të përmendet zhdukja e kulturave Indiane, si dhe ajo e popullit Maja dhe Actekëve, kultura këto të cilët edhe pse ishin të mëdha, nën ndikimin e kulturës Amerikane dhe Meksikane pothuajse janë zhdukur plotësisht.

Kur jemi te kultura duhet të përmendnim edhe shembullin e Hollywood-it, ku prej një qendre lansohen prodhime të cilat mund të shihen në të gjithë botën e kësisoj nuk duhet mohuar një lloj "amerikanizimi" i kulturës. E njëjta gjë po ndodh edhe me gjuhën. Kohëve të fundit vërehet shfrytëzimi çdo ditë e më i madh i gjuhës Angleze si në komunikim zyrtar ashtu edhe në komunikimin e përditshëm nëpërmjet futjes së fjalëve angleze në formë të internacionalizmave. Si element i kulturës duhet shqyrtuar edhe aspektet fetare. Kohëve të fundit rezistenca më e madhe ndaj globalizimit vjen nga shtetet lindore ortodokse. Kjo ndodh pasiqë vet procesi i globalizimit çon në humbjen e rolit të kishës në udhëheqjen e politikës shtetërore. Por duket se një nga dimensionet ku antiglobalistët janë edhe më të zëshëm, është dhe ai i politikës. Ata kundërshtojnë ideologjinë e ”globalizimit liberal” SHBA-të pasiqë dolën më të fortë nga Lufta e Ftohtë, ato i kanë dhënë të drejtë vetes që kinse me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, ushtarakisht të intervenojnë nëpër vende të ndryshme të botës. Në këtë këndvështrim antiglobalistët e konsiderojnë globalizmin si një formë tjetër të “amerikanizmit”, dhe i llogarisin SHBA-të si një “ polic botëror”. Secili shtet që merr guximin t’i rezistojë atij, si Afganistani, Iraku, Siria, Libani, Egjipti, Sudani, Arabia Saudite, Jemeni..., duhet të llogarisë në

një agresion ushtarak, të miratuar ose jo nga ana e Kombeve të Bashkuara.

Edhepse nuk mundemi që të gjitha qëndrimet e lartëpërmendura të antiglobalistëve të hidhen poshtë si të pabaza dhe të pavërteta, që të vlerësojmë se a është procesi i globalizimit në dëm apo në dobi të njeriut, ose a është proces pozitiv apo negativ në përgjithësi, mendoj se duhet përveç anëve negative të analizohen edhe anët pozitive të tij.

Sa për fund, do të kisha theksuar se, me sa duket dhe me sa shohim dëmi i këtij procesi të quajtur globalizëm është kah rëndon, por shpresojmë që ky proces do të mare të mbarën drejt dobisë njerëzore. Globalizmi që po ndodh sot nuk është aspak në interes të njerëzve, por të korporatave të fuqishme. Globalizmi që po ndodh sot në botë është një lloj mënyre për të shfrytëzuar krahun e lirë të punës në vendet më pak të zhvilluara. Për sa kohë kjo vazhdon, edhe lëvizja e jo-globalëve do të vazhdojë.

Propozimi i literatures:

Anderson, Sarah (2000**)** *Views from the South: The Effects of Globalization and the WTO on Third World Countries***,** First Food, New York

Bauman, Zygmunt(1998) *Globalization, The Human Consequences*, Columbia University Press, New York

Gould, Carol (2008) *The New Global Ethics and its Three Faces,* in An Ethics in an Era of Globalization edited by M.S. Ronald Commers, all at Ghent University**,** Belgium

James M. Rossi, *Globalization and Its Discontents, Human Nature Review,* 2002, Volume 2, pp. 293–296

Jeff Fleischer,*After Capitalism: Economic Democracy in Action, ForeWord Reviews*, Dec. 5 2012

Melchior, Arne, KjetilTelle, and HenrikWiig (2000) *Globalization and Inequality: World Income Distribution and Living Standards, 1960-1998*, Royal Norwegian Ministry of Foreign Affairs, Studies of Foreign Policy Issues, Oslo

Sobrino, Jon (2001) *Der Erlosung der Globalisierung*, Concilium 37 (5/2001) Internationale Zeitschrift für Theologie, Mainz

Dr. Moikom Zeqo

FLAMURI SHQIPTAR (ZYRTAR) ESHTE MBARTUR NE HENE NE TRUPIN E ANIJES KOZMIKE APOLLO 14

Prishtine, 04 shtator 2003 (Alb.Info) - Duke kerkuar ne arkivin e Muzeumit Historik Kombetar gjeta nje dokument te jashtezakonshem nga te gjitha pikpamjet. Mbi nje karton te forte eshte vendosur nje fotografi e anijes kozmike Apollo 14, fotografi e bere nga siperfaqja e Henes. Krahas kesaj fotografie eshte vendosur nje flamur Shqiptar i permasave te te vogla. Nen fotografine eshte shkruar: Antares at fra mauro, kurse poshte fotografise eshte ky mbishkrim: This flag was carried to the moon onboard Apollo 14 January 31 through February 9, 1971. It is presented by Rear Admiral Alan B. Shepard, Jr., United States Navy, delegate to the 26th Session of the United Nations General Assembly. Nga ky shkrim mesohet se flamuri Shqiptar (zyrtar) eshte mbartur ne Hene ne trupin e anijes kozmike Apollo 14 nga 31 Janari deri me 9 Shkurt 1971. Ky flamur eshte paraqitur prej zevendes Admiralit Alan B. Shepard Jr., i Flotes se Shteteve te Bashkuara te Amerikes dhe qe ka qene delegat ne Sesionin e 26-te te Asamblese se Pergjithshme te Kombeve te Bashkuara. Antares eshte pjesa e anijes qe zbriti ne Hene dhe Fra Mauro eshte emri i vendit ne Hene ku zbriti anija. Ka edhe nje mbishkrim dore shkruar me boje te zeze nga Alan Shepardi, qe lexon: With the compliments of the astronautes of the United States. Alan Shepard 02.10.71, qe perkthehet ne Shqip: Me fjalet me te mira te astronauteve te Shteteve te Bashkuara. Alan Shepard, 2 Tetor 1971. Ky dokument qe permban flamurin Shqiptar me fotografine ne Hene se bashku me mbishkrimet i eshte dorezuar prej vete astronautit Alan Shepard nje dilomati Shqiptar, i cili pat marre pjese edhe ai ne Sesionin e 26-te te Asamblese se Pergjithshme te Kombeve te Bashkuara. Alan Shepard, kur ka pergatitur kete dhurate dhe per ta bere me te vertete dokumentin, ka shkruar me doren e tij pershendetjen jo vetem nga vetvetja, por edhe nga astronautet e tjere te SHBA-s. Kjo do te thote qe fakti i mbartjes se flamurit Shqiptar ka qene teme bisede e astronauteve bashkeudhetare. Pra Shepard u ka folur atyre per origjinen e tij Shqiptare. Gjesti i Shepardit eshte i madherishem. Duke lexuar

nje enciklopedi te kozmosit ku jane dhe emrat e kozmonauteve ne vite, lexohen keto te dhena per Alan Shepardin. Ai u lind ne East Dery, Nee Hampshire te SHBA me 18 Nentor 1923. Ã*ƒ*Æ'Ã¢â‚¬Â¹shte me origjine Shqipitare. Ka kryer Akademine Detare Amerikane ne Anapolis ku mbaroi dhe nje shkolle fluturimi per pilot joushtarak. Me pas beri edhe Shkollen e Marines per pilot ne Patuxent, Maryland, si dhe Shkollen Detare te Luftes ne New Port Rhode Island me 1958. Me 1961 u ngrit ne hapesire si njeriu i pare ne bote rusi Juri Gagarin. Ai fluturoi ne kozmos si pasagjer, kurse Shepardi ne misionin Apollo 4 ne Janar-Shkurt 1971 e manovroi vete anijen kozmike. Si kozmonaut, ai eshte i pari qe ka fluturuar ne kozmos si Amerikan dhe i pesti qe ka shkelur ne Hene. Para daljes ne pension Alan Shepard gradohet Admiral. Ai nderroi jete me 21 Korrik 1998; pra jetoi 75 vjet. Ne te njejten enciklopedi flitej edhe per William Gregory nje tjeter astronaut Shqiptaro-Amerikan. Gregory lindi ne Lock-port, Nju Jork me 14 Maj 1957. Ã*ƒ*Æ'Ã¢â‚¬Â¹shte me origjine nga fshati Dardhe e Korces. Me 1979 u diplomua per shkenca inxhinierike ne Akademine e Forcave Ajrore. Mori doktoraten si inxhinier mekanik nga Colombia University me 1980 dhe Doktoraten per drejtues me 1984. Ne vitet 1981 - 1986 ka qene pilot fluturimi me avionet Fl11. Me pas sherbeu si mesues pilotesh prane Forcave Ajrore Britanike. Ka fluturuar ne me shume se 40 lloje avionesh dhe ka kapercyer mbi 5000 ore flutturimi. U zgjodli nga NASA ne Janar 1990 dhe u shpall astronaut ne Korrik 1991. Fluturimin e tij te pare Shuttle STS-67 ne hapesire e kreu me 2 Mars 1995 nga Qendra e Hapesires Kenedi dhe u ul ne toke me 18 Mars 1995. Ka vendosur rekordin e fluturimeve ne hapesirat kozmike me 16 dite dhe 15 ore duke plotesuar 262 rrotullime drejt tokes. Ai fluturoi mbi 11 milion km ne kozmos, ka mbi 400 ore flutuime ne hapesiren kozmike, krahas 5000 oreve si pilot. Tani punon si drejtues per zhvillimin e biznesit ne Arizona te SHBA. Meqenese Shpardi ka vdekur, shpresojme qe Gregorin ta takojme se shpejti. Te dy keta emra kane vendin e tyre ne Muzeun Historik Kombetar dhe ne kujtesen e Shqiptareve.

Biographies - Alan B Shepard Jr.

Alan B Shepard Jr.

Born: November 18, 1923

Died: July 21, 1998

Briefly
First American astronaut in space (1961).

Image Source: Alan Shepard Jr.

MJEKËSI

Dr. Lukë Gjokaj, specialist i med. gjenerale

KISS SYNDROMA – TË QITURIT E QAFËS NË KONVENTËN E MJEKËSISË

Sit medicus senex, at tonsor iuvenis homo[48]

Vitin e kaluar në Qendrën Spirituale në Sukruq, fshat afër Tuzit, u mbajt një kongres me tema nga fusha e mjekësisë dhe punës sociale dhe mbante titullin **"Vështrim mbi të ardhshmen".** Është organizuar dhe mbajtur nën kujdesin e kësaj qendre dhe drejtuesit të saj patër **Franit Dushaj** në bashkëpunim me qendrës Marienhaus GmbH, Waldenbach nga Germania, me përfaqësuesen e saj motrën **Edith-Marie Magar**. Të dyja këto qendra janë themeluar nga rendi kishtar françeskan.
Qendra Spirituale në Sukruq është themelua nga vetë pat. Frani më vitin 2004 dhe veç kopshtit "Nënë Tereza" për fëmijët parashkollor, ka edhe një seksion për kujdesen dhe ushtrimin e fëmijëve me aftësi të veçanta, si dhe një varg godinash tjera për qëllime të ndryshme, ku janë të inkuadruar dhe shërbejnë me dhjetëra punëtorë. Qendra Marienhaus GmbH është themeluar më vitin 1903, ka një staf pune prej 13 800 personave dhe posedon 21 spitale e 31 stacionarë të vetët, ka 3 reparte për ndihmë të fëmijëve dhe rinisë, pastaj ka një numër të madh shtëpia pleqsh (azile), qela (hospice) si dhe institucione të shumta edukuese.

Interesimi për këtë Konventë ishte shumë i madh dhe morën pjesë nga Ministria e Shëndetësisë dhe politikës sociale e Malit të Zi, si dhe mjekë e punëtorë të shëndetësisë nga stafi i spitaleve, shtëpive të shëndetit, qendrave të rehabilitimit e institucione tjera të cilët vinin pothuaj, nga të gjitha qytetet e kësaj Republike. Fjalës hyrëse e mbajtën organizuesit e kësaj asambleje; motra Edith-Marie dhe patër Frani, pastaj përshëndetën edhe autoritetet

[48] Le të jetë mjeku plak, e berberi njeri i ri.

e vendit dhe të jashtëm si: Leopold Maurer ambasador i Bashkësisë Europiane etj.

Kongresi zgjati tri ditë dhe gjatë kësaj kohe u shtjelluan tema të ndryshme në lëmin e mjekësisë si: Disa mënyra të Diagnostikimit dhe Terapisë në Mjekësinë Fizikale, si dhe disa metoda të Integrimit në shoqëri të personave me aftësi të veçanta.
. Ligjëruesit ishin nga qyteti Waldbreidbach, mjekë me eksperiencë të madhe dhe tituj të lartë shkencorë. Temat ishin nga përvoja e tyre dhe problematikat më aktualet në këto lëmi të mjekësisë, si:

- **Dr. Bettina Mesenholl**, neonatologe shtjelloi temën me titull: Retardimi Mental (RM), dëmtimet dhe pengesat gjatë zhvillimit të njeriut
- **Dr. Hasmann**, ekspert i pediatrisë sociale, foli për ndihmën që duhet bërë prindërve të cilët kanë vështirësi në zhvillimin e fëmijëve dhe mënyrat si duhet vepruar. Një ndër këto është edhe metoda e quajtur ***"Stepping Stones Triple"*** gjegjësisht – *çapitje në gurë*, e cila zgjoi interesim të dukshëm. Kjo përmban këshillat më bashkëkohore që duhet dhënë prindërve, fëmijët e të cilëve, kanë pengesa në zhvillim. Shpjegon se si duhet komunikuar me ta, si duhet pasur durim për të mësuar fëmijët me u veshë, ngrënë, larë dhëmbët e veprime tjera të përditshme.
- P**rof. dr. Degenhardt** psikiatër, referoi për strukturën e ndihmës që duhet dhënë në psikiatri dhe personave me çrregullim të personalitetit duke theksuar në mënyrë të veçantë meditimin.
- **Patër Frani** në temën e tij për këtë kongres, shtjelloi ndikimin e bindjes dhe besimit tek Zoti në stagnimin e dekursit (ecurisë) të sëmundjes dhe në suksesin e shërimit duke iu referuar përvojës së vetë personale.
- Dr. **Johann G. Zeilinski** fizioterapeut, shpjegoi metodat e ekzaminimit dhe mjekimit osteopatikë në ortopedi etj.

Neve na la përshtypje të veçantë ligjërata e dr. Johanni, i cili është drejtor i fizioterapisë në këtë qendër kaq të madhe rehabilituese të Gjermanisë dhe shtjellimi i tij për metodat e ekzaminimit dhe mjekimit osteopatikë në ortopedi. Kjo zgjoi kureshtje të veçantë, ngase edhe tek ne praktikohet shërim i tillë tradicional me shekuj – brez pas brezit, por pa ndonjë shpjegim teorik dhe as praktik. Ai shpjegoi në radhë të parë dëmtimet e shtyllës kurrizore dhe në

veçanti, ato të pjesës së epërme të saj - të qafës, gjegjësisht lëndimet që kanë të bëjnë me unazën e parë të kolonës vertebrale – atlasit. Kjo unazë së bashku me unazën e dytë, Axis lidhen me bazën e kafkës, gjegjësisht kresë dhe formon nyjën e qafës (artikulacionin atlanto-oksipital) mbi të cilën mundësohen lëvizjet e shumta të kresë (fleksioni, rotacioni etj). Atlas – C1 pushon mbi unazën e dytë, axis-C2, të cilat janë të lidhura së bashku me ligamente, membrana, tetiva e struktura tjera anatomike dhe formojnë nyjën e qafës (Sub-oxipital Joint). Këto dy unaza (vertebra) dallojnë prej unazave tjera të kolonës vertebrale se nuk kanë trup, çka i mundëson kresë dhe qafës lëvizje të shumta. Ky regjion është e pajisur me një numër të madh receptorësh dhe mbaresa nervore që çojnë informacione dhe bëjnë lidhje me të gjitha qendrat nervore të trurit dhe të pjesëve tjera të SNQ.

Unazat e para të qafës

Dëmtimet e shpeshta të kësaj nyjë dhe të këtij regjioni suboksipital – SO, në literaturën mjekësore të **terapisë manuale** njihen me emrin **syndroma KISS**, kurse tek ne në popull njihen me emrin tradicional- **të Qiturit e Qafës**. Nocioni i par është akronim i fjalëve **K**inematic **I**mbalances due to **S**uboccipital **S**train, që afërsisht shprehë të njëjtin kuptim, sikur edhe fjalët në gjuhën shqipe(Mosbalancimi Kinetik për shkak të stërgjatës së Qafës)

Këto dëmtime ndodhin më së shumti gjatë procesit të lindjes, sidomos duke manipuluar me forceps e instrumente tjera

ndihmëse, si dhe gjatë përgatitjes dhe kujdesit të foshnjës në muajt e parë të jetës. Janë aq të shpeshta sa në krahinat tona, janë të paktë ata fëmijë që e mbushin vitin e parë dhe prindërit e tij të mos kenë dëgjuar për nocionin - *se fëmija ndoshta* ***e ka qitë qafën***.

Fizioterapisti Zeilinski shtjelloi ankesat që mund të bëjnë prindërit dhe simptomat që vërehen tek fëmija me këtë çrregullim si:

-Qarja e fëmijës pa ndërpre, temperaturë, të vjella (qitje për qafe) të shpeshta, torticollis (shtrembërimi i qafës), scoliosis (mbajtja e trupit të fëmijë në njërën anë), fëmija flenë gjithherë në një anë dhe nëse vihet në anën tjetër qanë pa ndarë derisa t'i ndërrohet pozita e tjera shenja, periudhat e gjumit janë të shkurtra dhe kohë mbas kohe zgjohet Nëse të qiturit e qafës – KISS syndroma nuk korrigjohet, komplikimet dhe dëmtimet do vazhdoi edhe më tepër. Do të paraqiten simptoma e komplikime tjera si rënia e flokëve në formë areole në pjesën e kresë që mbështetet në jastëk, deformim i kocës së kresë në anën që flenë, shtrembërim i trupit, marrje mendsh, pengesa në ecje të fëmijës e të tjera ndërlikime që deformojnë zhvillimin osteomuskular të fëmijës dhe ngadalësojnë zhvillimin psikik të tij. Kur këto simptoma vazhdojnë edhe më tutje tek fëmijët i moshës madhore atëherë, ky lëndim nuk quhet më syndroma KISS, por **syndroma KIDD**[49], që shprehë komplikime edhe më të rënda.



Pozita e fëmijës me Qafë të Qitun (KISS Syndrom)

[49] Dysgnosia – probleme me njohje dhe të kuptuarit; Dyspraxia – çrregullim i lëvizjeve dhe koordinimit të tyre, problem me performimin e veprimeve që i ka bërë më parë. Gjithashtu quhet si KISS – induced Dysfunctions = KID.

Pas intervenimit manual shtoi z. Zeilinski, tek fëmija shihet përmirësim i menjëhershëm: ai nuk vjellë, nuk ka më temperaturë, fillon të hajë ushqim, është më i qetë dhe flenë në çdo anë që ta vësh. Tek ne ky intervenim quhet **goditja e qafës** ose fërkimi i qafës dhe e kryejnë trapistët tradicional që kanë mësuar dhe është përcjellë nga gjenerata në gjeneratë. Edhe në këto raste, pas ndërhyrjes manuale – fërkimit, paqësimi dhe përmirësimi i shëndetit të fëmijës është i shpejt dhe pikërisht, ashtu siç shprehen në popull – u shëndosh si me ia heq me dorë. Prindërit gati çdo herë këtë intervenim e fshehin dhe nuk ia prezantojnë mjekut të vetë duke pas frikë se ata nuk e njohin dhe kështu, ndërhyrjet me terapi manuale edhe pse kanë sukses, tek ne mbesin incognito për qarqet e mjekësisë.

KISS Syndroma e dokumentuar

Veç ligjëratave, të cilat u mbajtën paradite, kishte edhe demonstrime (workshop) që u zhvilluan nëpër sesione të veçanta pas dite deri në darkë. Ato u mbajtën në kabinetet e kësaj Qendre që janë të pajisura dhe të përsosura për veprimtari të tilla.

Ditën e fundit të këtij kongresi pati diskutime të shumta dhe të gjithë shqyrtuan mënyrat e bashkëpunimit dhe zgjerimin e kësaj veprimtarie të bamirësisë.

Ripërtëri më 2014

Prim. dr Gani KARAMANAGA

SËMUNDJET E MUSHKËRIVE NË SHTATZËNËSI

Në shtatzënësi sëmundjet e mushkërive paraqiten më tepër se te gjendjet e gruas së rregullt. Infeksionet respiratore shpeshherë janë të përcjella me komplikime të llojllojshme, sepse edhe imuniteti është në nivel më të ulët. Mbrojtja prej mikroorganizmave është e vështirësuar. Faktorët rrezikues janë edhe *anemia siderpoenike*, hipovitaminozat në shtatzënësi si edhe sintezioni i zvogëluar i imunoglobulinëve dhe linfokinëve.

Rëntgen-diagnostikimi në graviditet

RTG diagnostikimi në muajt e parë të shtatzënësisë (faza eorganogjenezës) mund të aplikohet vetëm në raste të rralla kur është në pyetje jeta e nënës. Në shtatzënësi të vonë rreziku prej rrezatimit zvogëlohet, por gjithashtu ekziston. Sëmundjet e mushkërive dhe gjendjet e tjera të cilat japin mundësinë e përdorimit të kësaj metode diagnostikuese: dyshimi se te gruaja shtatzënë është paraqitur tuberkulozi, pneumonia e rëndë masive, tromboembolia masive, çrregullimet e ventilacionit dhe respiracionit me dyshim se është i mundshëm pneumotoraksi (traumatik, spontan) malignomi operabil i mushkërisë, gjirit, ovarimit, mediastinumit, çrregullimet e rënda të respiracionit (pa Co2 nën 80 mmHg) shkaku ikognit (i panjohur).

Përdorimi i medikamenteve në shtatzënësi

Në këtë pjesë do të analizohen medikamentet të cilat përdoren te sëmundjet e mushkërive dhe efektet negative.

Teolin – nuk e vështirëson zhvillimin e rregullt të fetusit. Janë përshkruar vetëm katër raste kur fëmijët e porsalindur në periudhën perinatale prej nënave të cilat para lindjes janë trajtuar me teofilin (takikardi, shqetësim, vomitus).

Agonistët beta adrenergjik – në terapi tek astma bronkiale përdoren me doza të ulëta, në mënyrë aerosol-terapie. Duhet preferuar vetëm në raste shumë të nevojshme. Një e treta e fëmijëve të porsalindur, nënat e të cilave janë mjekuar në mbarimin e shtatzënësisë me beta agonistë, tregojnë simptoma hipoglikemike të cilat korrigjohen me infuzion të glukozës.

Adrenalini – mundësia e malformimeve te fetusi.

Vazakontriktorët adrenergjike – gjithashtu nuk duhet të përdoren në shtatzënësi.

Kromolin natrium (ditek-aerosol dhe *ipratropium – bromitberodual***)** – përdorimi i tyre është mënyra aerosol–terapie, resorbohen shumë pak në gjakun e nënës dhe mund të përshkruhen, por në eksperimente dozat e mëdha ngadalësojnë rritjen e fetusit.

Antihistaminikët – përdorimi me kujdes. Dimes-hidrinati – përdorimi i tij në fund tështatzënësisë mund të indikojë lindjen e parakohshme. Disa studime eksperimentale: mundësia e malformimeve të fetusit.

Antitusica dhe mukolitika – është e ndaluar terapia meantusika prej opiumit (kodeini, dekstramorfani) si dhe sekrotolitika (acetiliystein).

Kortikosteroidet – përdorimi në tre muajt e parë tështatzënësisë mund të japin malformime te fetusi (fenomeni: buza e lepurit, placenta previa, ngadalësimi i pritjes së fetusit, stenosi D, arteriossus). Në mbarimin e tremujorit të tretë glikortikoidët mund të zhvillojnë tek fetusi insuficiencë perinatale të gjëndrrave suprarenale (doza kritike e prednizolonit 50 mg). Gjithashtu glikokortikoidët indukojnë sinezimin e surfaktantit në mushkëridhe për këtë arsye përdorimi i tyre mund të bëhet vetëm në javët 34– 39 t shtatzënësisë.

Përdorimi i antibiotikëve në shtatzënësi

Penicilini – është antibiotiku më i preferueshëm tek shtatzënat. Mund të merret në fillim dhe gjatë tërë kohës së graviditetit. Dozënduhet zmadhuar.

Cefalosporini – deri më tani nuk janë regjistruar efektenegative në fetus. Te cefalosporinët e gjeneratave të reja(cefladizin) duhet të kenë kujdes.

Eritromycin, klindamycin, lincocin – gjithashtu mund tëpërdoren. Vetëm eritromycini estolat është i kontraindikuar, sepse mund ta dëmtojë mushkërinë e zezë (hepar).

Hloramfenicoli – është i kontraindikuar. Edhe në periudhën e laktacionit nuk përdoret (efektet negative-toksigjene nëhepatopoezë).

Metronidazol – janë regjistruar efekte kancerogjene.

Hinoloni – nuk ka dituri për përdorimin e këtyre antibiotikëve dhe më së miri mos të përdoren në shtatzënësi, si dhe në kohën e laktacionit.

Sulfanomidët – nuk kanë kualitete tetrogjenike dhe mund të përdoren në tremujorin e parë dhe të dytë. Janë të kontraindikuara në kohën e laktacionit (mund të sjellë zverdhimin tek fëmijët), gjithashtu mund të zhvillohet anemia sideropenike.

Trimetropin (bactrim) – i kontraindikuar në tremujorin eparë. Nuk duhet përdorur gjatë laktacionit.

Tetraciklinët – janë të kontraindikuara gjatë tërë shtatzënësisë,si dhe në kohën e laktacionit (ngadalësimi i zhvillimit të skeletit).

Izoniazidi – i kombinuar me vitaminën B6 është terapia zgjedhëse e tuberkulozit në shtatzënësi. Në periudhën e laktacionit edhe fëmijës edhe nënës duhet ordinuar vitamina B6 (rreziku prej konvulsioneve).

Etambutoli – përdorimi me kujdes për mundësinë e anomalive tek fetusi (përqindja shumë e vogël).

Rifampicin – (si te etambutoli) – normalisht efektet negative janë minimale në raste mjekimi të tuberkulozit me tre medikamente së bashku.

Citostatikët – janë të kontraindikuar në shtatzënësi. Disa prejtyre kanë efekte teratogjene.

Astma bronkiale në shtatzënësi

Shënimet epidemiologjike tregojnë se 1-4 % e shtatzënave kanë astmë. Kur para mjekut gjendet e sëmura nga astma parashtrohentre pyetje: - Si ndikon shtatzënësia në zhvillimin e astmës; - Si astma ndikon ne zhvillimin e graviditetit; - Si mjekohet astma te shtatzënat. Te shtatzënat me astme bronkiale janë vërtetuar lindjet eparakohshme, numri më i madh i fëmijëve të porsalindur me peshë më të vogël, mortaliteti neonatal me përqindje (%) më të madhe, si dhe hipoksia neonatale. Të gjitha këto të dhëna në krahasim me shtatzënat pa astmë. Mirëpo, ndikimi i shtatzënësisë në astmën bronkiale dhe astmës në zhvillimin e shtatzënësisë nuk do të kishin kontraindikime përgruan që të mbesë shtatzënë dhe të lindë fëmijën e shëndoshë.Terapia e përshtatshme dhe koordinimi i mjekëve specialistë – gjinekologut, pulmologut paraqesin një garanci për mendimin e dhënë.

Medikamentet për shërimin e astmës në shtatzënësi

Kortikosteroidët – përdorimi në tre muajt e parë mund të zhvillojë: - Malformime tek fetusi (fenomeni buza e lepurit, placenta,placenta praevia, ngadalësimi i rritjes së fetusit, stenosis

d.arteriosus); - Në tremujorin e tretë përdorimi i glikokortikoidëve mund të zhvillojë insuficiencë perinatale të gjëndrave suprarenale tek fëmija i porsalindur (doza kritike e prednizonit 50 mg). - Gjithashtu indikojnë sintezimin e surfaktantit në mushkëridhe për këtë arsye përdorimi i tyre do të jetë vetëm prej javës 34 –39 të shtatzënësisë.

Kromoglikati – është medikamenti antiiflamik josteroid përmjekimin dhe parandalimin e astmës bronkiale. Mund të përdoret në shtatzënësi.

Agonistët beta adrenergjik – përdoren në mënyre peroraledhe parenterale. Është regjistruar oedema polmunum tek shtatzënat dhe takikardia, hipoglikemia, si dhe tremori tek fëmijët e porsalindur. Përdorimi para lindjes mund të inhibuojë kontrakcione të uterusit d.m.th. terapia me kujdes.

Metilksantinët (aminofilini) – mund të përdoren tek të porsalindurit prej nënave të mjekuara me këto medikamente, janë të regjistruar takikardia dhe irritibilateti.

Antiholinergikët – nuk janë terapi primare tek astma.Inatropium-bromit (actrovent) mund të përdoret me aerosol terapi (në këtë mënyre efektet negative si takikardia tek fetusi gjendet shumë rrallë).

Imunoterapia – mendimi është se terapia desensibilizuese e filluar para shtatzënësisë mund të vazhdohet, por nuk preferohet që të fillohet gjatë zhvillimit të shtatzënësisë.

Qëllimet e mjekimit të astmës gjatë shtatzënësisë janë: funksionimi normal i parametraverespiratore, kontrollimi i simptomave dhe sulmeve gjatë natës, aktiviteti normal i gruas shtatzënë, parandalimi i episodeve akute të sulmeve të astmës, nusefektet e medikamenteve të zvogëlohen në shkallën mëtë ulët, Me rëndësi të madhe është **lindja e fëmijës së shëndoshë**.

Tuberkulozi i mushkërive në shtatzënësi

Patogjeneza e tuberkulozit është e ngjashme si te grate jashtë shtatzënësisë. Manifestohet më së pari: tuberkulozi postprimar,tuberkulozi hematogjen (tuberculossis miliaris, meningitis miliaris) janë shumë të rrallë,tuberkolozi primar tek ne praktikisht nuk është prezent.

Patogjeneza e tuberkulozit tek fetusi dhe të porsalindurit

Në patogjenezën e tuberkulozit kongjenital më me rëndësi është tuberkulozi i placentës, kurse në mënyrë hematogjene regjistrohet shumë rrallë. Infektimi i fetusit më së shpeshti ndodh

me aspirimin ose ingjestimin e lëngut të amnionit në të cilin B. Koch depërtojnë kur ndodh ruptura e formacioneve kazeozo / nekrotike të placentës. Infektimi ndodh në periudhën perinatale (gjatë lindjes), si dhe postnatale (në mënyrë të inhalimit prej nënës së sëmurë).

Diagnostikimi i tuberkulozit në shtatzënësi

Anamneza dhe përcjellja prej mjekut (gjinekologu, mjeku Ipraksës së përgjithshme, pulmologu,). Hulumtimet bakteriologjike të sputumit (metoda direkte –Ziehl-Nilsen, si dhe kulturë me Lovenstein). Në shtatzënësi mund të aplikohet edhe metodologjia më agresive:hulumtimet bronkologjike,punksioni pleural, biopsia e pleurës së marrë: materialin do ta shikojmë në mënyrë patohistologjike ose bakteriologjike.

Tabela 1. Terapia antituberkulotike në shtatëzënësi

Medikamenti	**Doza e ditës**	**Doza max. ditore**
izoniazid	10 – 20 mg/kg	300 mg
rifampicin	10 – 20 mg/kg	600 mg
etambutol	15 – 25 mg/kg	2500 mg
pyrazinamid	30 – 40 mg/kg	2000 mg

Në kushtet bashkëkohore *streptomycini* nuk përdoret (efektet toksikogjene tek fetusi). Prej terapisë agjuvante në shtatzënësi duhet t'i shmangemi përdorimit të glikortikoidëve – posaçërisht në periudhën e organogjenezës. Antituberkolitikët depërtojnë në qumështin e nënës në doza shumë të vogla dhe për këtë arsye nuk janë të rrezikshme për të porsalindurit dhe fëmijën e vogël (kjo gjë është e vlefshme edhe për STM). Në mjekimin e tuberkulozit duhet të marrin pjesë mjeku gjinekolog, pediatri, si dhe pulmologu. Është e mundshme terapia adekuate dhe mjekimi i tuberkulozit pa pasoja negative tek fetusi dhe fëmija i porsalindur. Me këtë gjë parashikimi i tuberkulozit te shtatzënat do të ishte i njëjtë si te gratë jo gravide.

Pneumoniet

Tabela3. Mikroorganizmat më të shpeshta tek pneumoniet në shtatëzënësi

Pneumoniet bakterike	*Pneumoniet atipike*
Streptococcus pneumoniae	Mycoplasma pneumoniae
Hemophilius influenzae	Legionella species
	Chlamydia pneumoniae

Tabela 4. Shërimi i pneumonieve në shtatzënësi

Preferohen	Nuk preferohen	Janë të kontraindikuara
Penicilini	Sulfonamidët	Tetraciklinët
Preparatët e penicilinit		Kloramfenikoli
Cefalosporinët		Aminiglikozidët
Makrolidët		
Eritromicini		
Linkomicini		
Klindamicini		

Infeksionet virosogjene respiratore në shtatëzënësi

Tabela 5. Viruset – shkakëtarët e sëmundjeve të mushkërive

Influenca A virus
Influenca B virus
Adneovirus tip 4 tip 7
Rinovirusët
Enterovirusët EHO, KOKSAKI
Epstein – Barr virus
Citomegal – virus
Respiracion Sincicial virus RSV
Varicela zoster virus
Virus i morbilëve
Herpes simplex virus
Virusët e infeksioneve respiratore kemoragjike

Terapia agjuvante e pneumonieve në shtatzënësi nuk dallohet prej asaj jashtë kësaj gjendjeje:hidracia (hidratimi), përdorimi i antipiretikëve, Terapia me oksigjen e kontrolluar dhe në kontinuitet.

Dhe në vend të konkludimit:

Triada: ***Nëna-placenta-fetusi*** *është biologjikisht, farmakokinetik, si dhe farmako-dinamik, një bashkësi e cila gjithmonë do të respektohet.*

Terapia

Përgjithësisht shumë prej medikamenteve kundër viruseve janë të përmbajtur në klasifikim në grupin C FDA, i cili tregon se përdorimi i tyre është shumë i panjohur dhe normalisht paraqitet faktor rreziku. Aplikimi i kësaj terapie duhet të bazohet edhe në gjendjen e nënës dhe fetusit.

Medikamentet antivirale: Aciklovir (7.5 mg/kg – 3 në ditë), Glubolini hiperimun (tek Varicela, Amantadin, Ribavirin, Antibiotikët (më së miri Penicilin, Makorildët).

Terapia simptomatike:

- Me rëndësi të madhe për parandalimin e **embiopative virusogjene** do të jetë dhe edukimi shëndetësor dhe puna me gratë shtatzëna. Dhe në fund, vendimin për abortin e parakohshëm mjekësor duhet ta sjellë k**onziliumi** ku do të merren parasysh nëna dhe fetusi.

LITERATURA

Simpozimi Ulqin - Shkodër, Përmbajtja e kumtesave, Ulqin 2003.

Dragomir, Diklić, "Infektivne bolesti", Beograd 1966.

Republička zajednica penzijskog i invalidskog osguranja radnika-Beograd: "Dijagnostički postupci za ocenu radne sposobnosti obolelih od hroničnih, plućnih, nespecifičnih oboljenja, Beograd 1972.

Branislav, Djurić: "Sarcoidosis"- Sremska Kamenica 1975.

Stefanović Stanoje i sar. Interna medicina - Medcinska knjiga Beograd-Zagreb 1975.

Gjikopulli, Nikolla, "Duhani sëmundje pandemike ", Athinë, 2007.

Sloboda, Pavlović i sar. Tuberkuloza u praksi, Novi-Sad, 1997.

Hektor, Çoçoli, Bedri Bylyku: Sëmundjet e brendshme Tuberkulozi, Tiranë, 2007.

Hektor, Çoçoli, Sëmundjet e brendshme, Tiranë 2010.

Kapisyzi, Perlat, Elez, Selimi, Hektor, Çoçoli: Sëmundja pulmonale kronike, Tiranë, 2002.

Vesna, Bošnjak: Bolesti pluća u trudnoći, Beograd, 2000.

Vesna, Bošnjak i sar.: Nova saznanja o astmi i HOBP, Beograd, 2002.

Vesna, Bošnjak i sart. Značajna pitanja o astmi, Beograd, 1998.

Elez, Selimi, Pneumologjia - në pyetje Kuiz Tiranë, 2002.

Kraft i sar. *Detection of mycoplasma pneumoniae in the airways of adult with chronic asthma* Am J Respir Crit Care, 1998.

ITINERAR

Jozef Jan SVATEK

ULQINI

Kësaj foleje të çuditshme, të jashtëzakonshme, ia kushtoj një kaptinë të veçantë, sepse Ulqini me drejtë të plotë e meriton. Është një çerdhe e shqiponjave çfarë mund të hasim vetëm në krahinat e pashkelura të Dalmacisë dhe në bregun perëndimor të Shqipërisë. Por që më i njohuri nga ato është Ulqini. Si nga pikëpamja e themelimit të tij, ashti dhe nga ana e pozitës, popullatës dhe historisë. Gjendemi në vendin historia e të cilit ishte histori e piratërisë në këtë pjesë të Adriatikut dhe në qytetin në të cilin piratëria është ruajtur më së gjati në Evropë. Nga kjo kohë grabitqare kanë mbetur mjaft monumente, e vetëm njëri prej tyre janë zezakët – vendës i vjetër, pasardhësit e robërve që u sollën pronarëve të vet të dikurshëm dhe mbetën këtu. Këtu e kanë mirë, fundja në çka jam bindur, aq e kanë mirë sa që nuk kanë kërkesa të shkojnë dikund tjetër. Në tërë udhëtimin e kësaj vere nëpër Ballkan, Ulqini ka lënë në mua një përshtypje më të fuqishme. Është një çudë e madhe sesi në këtë anë, përkundër ndërrimeve të mëdha historike, të cilat kanë ndodhur përqark, këtu janë ruajtur doket e moçme popullore. Në Ulqin do të hasni një përzierje të të gjithë popujve të mundshëm, fiseve dhe ngjyrave, religjioneve. Këtu, siç thashë, ka zezakë vendorë, e madje e kam parë edhe një japonez. Ka shqiptarë dhe turq, si dhe sllavë. Ata njerëz janë pasardhës të popujve për të cilët vështirë se mund të themi diçka të saktë, por edhe për ata që janë një përzierje e fiseve rreth e rrotull, dhe pasardhës e atyre të pafatëve nga kindet e botës, që këtu i ka sjellë fati i mjerë i tyre, që këtu t'i ndalin përgjithmonë piratët. Është fare e qarë se shëtitja nëpër rrugën kryesore të qytetit të Ulqin, e tjetër as që ka, është njëra ndër përjetimet më interesante në Orient. Po ajo larushia e çuditshme e veshmbathjeve! Edhe ato stolitë më të çuditshme të grave çfarë nuk kam parë askund tjetër! Edhe në ditën e sotme, karakteri i pastër turk i qytetit të vjetër, pastaj disa shtëpi dhe vila, në bregun e detit, që kanë karakter evropian! Mbi këtë përzierje kontrastesh, mbi bregun shkëmbor ngrihet qyteti i dikurshëm i moçëm me shtëpi të mëdha e të larta, fare prej guri, një qytet që

mund të konsiderohet i ruajtur, sikur të mos ishte lënë shkretë dhe në të mos hynin të varfrit, që kanë zaptuar ndonjë pallat të bujarëve të dikurshëm; i çuditur kam shëtitur nëpër këtë qytet të vdekur, e që i tëri do të mund të popullohej për një orë të vetme, sepse të gjitha kanë mbetur në këmbë, vetëm që pak është vjetruar shkaku i rrjedhës së kohëve. E kam pasur ndjenjën sikur jam në një qytet të mallkuar, një qytet i cili përnjëherësh ka vdekur, ndërsa të gjitha ndërtesat i kanë mbetur të paprekura. Madje se çfarë godinash! Në dy e tre kate, prej guri, me dritare dhe ballkone jashtëzakonisht të bukura, të qitura mbi humnerën e thellë, që aq rrëpirët zbret deri në det. Këtu ka kulla të larta, faltore, tregje të vogla dhe rrugë me kthesa, të ngushta si në qytetet jugore, që vetëm pas disa hapash kthejnë në bërryl, thuaj se janë ndërtuar ashtu që të ndalin ndonjë sulm eventual të armikut. Sa i çuditshëm është ky vend, na shpie në të kaluarën, fare drejtpërdrejt, hapur dhe qartë. Në këtë vend janë zhvilluar episode të mëdha të historisë, të disa familjeve malazeze dhe turke, me të edhe të shumë shqiptare. Ky vend dikur ka paraqitur në kështjellë të fortë venedikase, ndërsa në do kohë të tjera, qeveria turke aty ka provuar të lëshojë rrënjë të forta, mirëpo, pa ndonjë sukses, sepse ka pasur punë me një popullatë e cila kurrë nuk ka dashur t'i nënshtrohet dorës së fortë. Pjesa më interesante e historisë, nëse mund të flasim për një histori të kësaj çerdheje plaçkitësish, është koha kur qyteti i takonte Venedikut. Nga ajo kohë[daton pjesa më e vjetër e qytetit e ngritur si kështjellë e fortë, në kodrën e lartë veriore të limanit të Ulqinit. Qytetin, thonë e kanë ndërtuar ardhësit nga Kolkida, për ç'shkak është quajtur *Kolkinium*. Në pjesën e dytë të shekullit të dytë para Krishtit, e kanë pushtuar romakët, në duart e të cilëve ka mbetur shumë shekuj. Në shekullin XII ka rënë nën sundimin e serbëve, të cilëve ua kanë marrë venedikasit në vitin 1423, ndërsa në vitin 1571, ka rënë në duart e turqve. Malit të Zi Ulqini i ka takuar më 17 janar 1878, por që më pas, në bazë të vendimit të Kongresit të Berlinit, i ka takuar turqve; që shumë shpejt prapë t'i takojë Malit të Zi. Në qytet kam hyrë nga ana e detit, siç thashë më përpara. Kjo anë është hyrja më atraktivja për turistin, meqë nga kjo anë shihet pamja më interesante e Ulqinit. Bregu i Ulqinit është një liman i thelluar në grykë, por që është mjaft i cekët, ashtu që të gjitha anijet më të mëdha duhet të lidhen në spirancë larg bregut, në detin e haur, gjë që mund të jetë edhe mjaft e rrezikshme, meqë

n[ë këtë pjesë deti shpesh është i trazuar, shkaku pse është i hapur aty ngrihen tallaze të mëdha, gjë të cilën e përjetuam edhe ne, për çka do të flasë pak më vonë. Limanin e Ulqinit e përbëjnë dy gryka, prej të cilëve i majti - nga hyhet në qytet nga ana e detit – është i mbrojtur nga kështjella e lashtë, në muret e së cilës fshihet një qytet i tërë. Ana tjetër është e mbuluar me të mbjella – me pyje lari dhe ullishta dhe në të është pallati mbretëror. Ai është një vilë e vogël mbretërore me një pronë dhe vresht shumë të madh. Në parzëm të këtyre dy degëve, është e vendosur pjesa më e pasur e qytetit. Aty janë disa kafehane të bukura, që gjëja më luksoze janë stolet në hijen e drunjve të lartë në bregun e detit; prej aty hapet pamja jashtëzakonisht e bukur në Kalanë e moçme, ashtu dhe në Kepin Ratisllava (e Sumës!), ku është pallati i përmendur i mbretit, ashtu edhe në detin e hapur. Bregut të limanit janë të mbjellë drunj të lartë, të bukur që bëjnë hije. Brenda bahçeve të mëdha janë ndërtuar shtëpi të bukura të malazezve dhe turqve të pasur. Aty janë shtëpitë e: serdar Sava Plamenacit, Simo Popoviqit, Marko Çukanoviqit etj. Aty janë dhe agjencitë e ndërmarrjeve të komunikacionit, dhe ajo e "Lojdit" austriak dhe Hungareze-kroate. Aty është edhe dogana, kapitaneria e portit, dhe në fund - por jo në vendin e fundit – dy "hotele". Në njërin prej tyre edhe ne jemi vendosur, ai është hoteli i Shpiro Bjelicës Miliqit, një burrë i mirë dhe këmbëngulës, i cili te ne në Çeki ka arritur një popullaritet të madh në mesin e të gjithë atyre që interesohen për Malin e Zi, meqë ky burrë i mirë – mik i sinqertë i çekëve, andaj secili që vjen nga Çekia tek ai është mysafir i mirëseardhur dhe shtëpiaku për të kujdeset sa më mirë që di.

Para këtij hoteli është një xhami e bukur, e cila e para të bie në sy, shkaku i minares së lartë. Ende është në shërbim, meqë në Ulqin ende ka shumë myslimanë, madje mund të thuhet se ata përbëjnë pjesën më të madhe të popullatës, gjë e cila mund të dallohet se vetëm qyteti ka nëntë xhami. Mu nga xhamia nis bregu ranor që zgjat deri te ai shkëmbi i egër i Ratisllavës (Kepi i Sumës!), në të cilën është një vegjetacion i bujshëm. Ky breg ranor është përparësia më e madhe e Ulqinit. Gjithashtu është faktori natyror më i rëndësishëm, sepse është i njohur gjerë e gjatë jo vetëm në Mal të Zi dhe Shqipëri – këtu vijnë mysafirë edhe nga Austria, Italia, e tash edhe nga Çekia. Bregu është ,mbuluar me një rërë të imët që ka ndikim mjekues. Gjithë ditën e nxejnë rrezet e diellit, që këtu janë shumë të forta. Tërë ditën këtu rrinë shtrirë

njerëz me reumatizëm nga Mali i Zi, dhe përpiqen që kjo rërë t'u ndihmojë t'i lirojë nga sëmundja e tyre. Përndryshe numri më i madh i të huajve këtu vijnë shkaku i larjes. Dhe, me të vërtetë, në tërë Adriatikun nuk ka larje më të lezetshme se në limanin e Ulqinit. Uji këtu është i kristaltë, i pandotur, nuk ka vaporë të shumtë dhe rrahje të mëdha të tallazeve – të gjitha tallazet e mëdha këtu qetësohen falë pozitës së limanit, andaj tallazet nuk arrijnë në atë rërën shëruese. Fundi i detit është si kadife. Është i mëndafshtë, është i pastër, pa goca dhe kërraba të mbrapshta, pa barishte që notojnë në sipërfaqe – me një fjalë: këtu edhe uji, edhe rëra edhe fundi i detit janë idealë, me të shkon dhe rrethina e jashtëzakonshme romantike, e aty, matanë limanit është kalaja e moçme, ta përmendim edhe rrethinën me vegjetacion të bujshëm, pastaj pyllin me pisha dhe shumë vreshta – gjë që në këtë pikëpamje njeriu as që mund të dëshirojë një vend më të bukur. Mirëpo, Ulqinit i mungojnë kushtet për vendosje komode, ashtu siç janë nëpër banjat detare që jemi mësuar. Ai që do qetësi dhe dëshiron t'i lëshohet vetëm detit, diellit dhe rërës, mundet që për një kohë të heqë dorë nga komoditeti dhe komfori i qytetit të madh, dhe njeriu këtu mund të kalojë jetë ideale, - këtu nuk ka asgjë që do të mundë të ngacmonte nervat e njeriut, por që ka gjithçka që t'ia qetësojë nervat. Banjë, kabina, apo çfarëdo pajisjeje për banjë nuk ka. Prandaj kostumin e larjes mund ta vishni në hotel, të hani mëngjes ashtu i veshur, e pastaj të niseni në breg. Askujt nuk do t'ia tërhiqni vërejtjen, këtu është një nobël më i madhi të ndërrohesh në plazh, e them këtë që ai i cili zgjedh këtë rend banje të mos habitet fare. Jam i sigurt se nuk do të shkojë shumë kohë, duke u shtuar numri i mysafirëve, dhe këto mungesa do të evitohen, pastaj Ulqini do të bëhet njëri ndër vendet më të bukura të Adriatikut, gjithashtu edhe më romantiku. Në liman përkunden anije dhe barka me vela. E vërteta, Ulqini dallohet për një tregti të gjallë detare dhe këtu jeton një numër i madh i pronarëve të barkave. Këta në det kanë nja 60 barka, e thonë se kanë 100, të cilëve porti i Ulqinit nuk mund t'u sigurojë mbrojtje shkaku se është i cekët. Shkaku i detit të trazuar kjo anë paraqet rrezik të madh. Nën shkëmbinjtë e larta të Ratisllavës (Kepi i Sumës!) është një mendreq për barka me vela. Sa herë jam çuditur se ku do të jenë strehuar barkat e piratëve, që këtu kanë jetuar deri vonë. Dhe e mësova, ata e kanë pasur një vendstrehim të sigurt disa kilometra më larg në veri, në një gjir jashtëzakonisht

të bukur që quhet limani *Di Noçe*, ku edhe sot, kur është deti i trazuar fshihen anijet, ku pak më vonë do ta çoj lexuesin e çmueshëm.

Romantikë më të madhe Ulqinit i jep Qyteti i Vjetër (Kalaja!) që është i mbrojtur me bedena, në anën veriore të gjirit. Drejt tij drejtohen sytë e të gjithë të ardhurve kureshtarë. Prandaj së pari do të shkojmë atje. Do t'i shmangemi rrugës kryesore, të quajtur "E Tivarit", që zgjatet tërë qytetit, gjithandej deri te mëhalla turke, dhe kthen majtas me rrugica me shtëpi turke, që e rrethojnë një xhami me varre që është po thuaj në oborrin e shtëpie turke. Aty hasim fytyra të frikësuar të grave turke – shqiptare të mbuluara me një veshje të çuditshme; kjo është një veçanti e Ulqinit çfarë nuk do ta ndeshim askund në Turqi ose Shqipëri. Gratë myslimane këtu sigurisht janë mirë të ruajtura, që nga larg i fshehin fytyrat e veta. Kur ecja rrugicave në lagjen e moçme pranë kalasë, ia arrita t'i zë në befasi gratë myslimane që përpiqeshin në shpejtësi të mbulonin fytyrat, por që në të gjitha ato raste ato ishin plaka dhe gra që s'ishin të bukura. Domethënë këto femra të pafate janë të detyruara të ecin rrugës e të mbulojnë fytyrat. Kanë një veshje modeste në trup, që përbëhet prej dy pjesësh, si fund ndërsa pjesa tjetër qitet mbi okë. Ato zakonisht janë pëlhura të thjeshta, të vjetruara, dallohen vetëm këmbët me shkarpa, por kryesisht ecin zbathur. Por gjëja më e çuditshme është guna me ngjyrë të murrme. Është një material i vrazhdët, si zhgun, me bordure të zez e të kuq. Guna ka një kapuç dhe atë duhet ta qesin vazhdimisht kudo që ecin ndërsa fytyrat e mbulojnë me faculeta të stolisura me lule, prej saj nuk mund të dallohet fytyra. Myslimanet kështu të mbuluara shkojnë nëpër qytet edhe kur bën mot i nxehtë, që në Ulqin ato ditë janë të rrezikshme për shëndet; ato fshihen prej secilit shikim, ikin duke u fshehur nga çdo turist, ashtu ato ma kujtoni kohën kur Ulqini ishte froni i kusarëve dhe treg i robërve.

E tash, të nisemi drejt pjesës së mbetur më interesante të kësaj foleje të detarëve! Arritëm deri në platonë ku është porta kryesore e Kalasë me bedena. Këtu sot është qetësi dhe vetëm krrokama e çafkave e prish atë, në këtë pjesë të qytetit të moçëm i cili dikur sigurisht që ka qenë i gjallë. Hapësira para portës dikur sigurisht ka qenë një treg i madh. Së paku kështu duket. Më vonë zotëruesit dhe banorët e këtij qyteti këtë hapësirë para portës së kështjellës e kanë shfrytëzuar për të ndërtuar një kishë pravosllave

(ortodokse!) dhe pranë saj të hapin varrezën e krishterë. Kishën, në formën e sotme, e ka ndërtuar kral Nikolla, në kujtim të fitimit të qytetit dhe të rënëve këtu në vitin 1878. Pranë kishës është një varr i zakonshëm i peshkopit i cili ka vdekur këtu. Këtu është qetësi. Gjithandej përreth shihen male të larta, dallohen Pinjeshi dhe Mali i Bardhë. Praj aty nis ullishta e madhe që paraqet burimin kryesor të jetesës së popullatës; do të shkojmë atje më vonë. Diçka e zymtë dhe heshtur duken malet tutje Ulqinit. Janë të shkapërderdhura sikur gurët nëpër rrugët nëpër të cilat ecet me vështirësi. Në to ende ka mbetje nga koha kur ka lëvizur toka nga dridhjet nëntokësore të dikurshme. Toka edhe tash shpesh dridhet. Ende nuk është qetësuar gjë e dëshmojnë burimet e katranit dhe naftës që gjenden në afërsi, si dhe burimet e shumta të ujit të nxehtë, që në rrethinë ka mjaft. Një rrugicë e ngushtë e rrëpirët na shpie drejt portë kryesore për hyrje në kështjellë. Është mbuluar me barishte, meqë këndej pak njerëz kalojnë. Mbi ne ngrihet bedeni i lartë që është pjesa kryesore e kalasë – aty ka qenë e domosdoshme të jetë bedeni më i madh. Vetëm nga kjo anë mund të hyhet në kalanë e moçme. Në të gjitha anët e tjera, shkaku i konfigurimit natyror të terrenit, kështjella ka qenë e papushtueshme. Porta e madhe prej drurit të lisit, e lidhur me shirita hekuri, ishte e hapur përgjysmë. Ashtu pak të hapura unë kujtoja se pas saj rrinë ushtarë me kilibarda. Po thuaj asgjë nuk mungon të imagjinojmë se jemi kthyer në mes të mesjetës. Aty rrinë varë vargonj të moçëm, stola që sikur presin që argatë me pagë të dalin nga oda para portës. Pas derës së portës së parë është e dyta, pastaj e treta!

Tek pas asaj porte ne hymë në qytet. Sapo i kapërcyem këto kapi arritëm në një treg të vogël, që na bëri të harrojmë se gjendemi në mes të kështjellës rrethuar me bedena. Aty, nga shekulli i mesëm kemi kaluar në shekullin e ri, madje në kohën kur turqit ishin sundimtarë këtu. Në mes të tregut është një krua turk dhe pranë tij një xhami së cilës nuk mund t'i shmangesh. Pikërisht në këtë pjesë të kështjellës së moçme rrojnë disa familje turke, të cilat kujdesen ta ruajnë shenjtërinë e vet, për aq sa u kanë lejuar mundësitë e vogla të tyre. Kjo xhami gati është rrënojë, ndërsa minarja e saj e rrëzuar për gjysmë paraqet rrezik për kalimtarët. Në xhami dallohet se është ndërtuar nga faltorja e krishterë. Është e ndërtuar me gurë të cilët sigurisht kanë qenë nga muret e bazilikës së krishterë. Në disa gurë madje kanë

mbetur kryqa të latuar, por që myslimanëve nuk u kanë penguar, e rëndësishme u ka qenë që kanë pasur gurë të mirë nga majdani afër, e në atë rast sigurisht që ka qenë bazilika, e madhe dhe, në atë kohë, e me gur të punuar, stolisur, ka qenë disa hapa më larg xhamisë. I kanë marrë shtyllat e latuar që tash shihen si stolisin hyrjen në xhami, ka mbetur edhe pa varret e bukura, plakat e të cilëve turqit i kanë shfrytëzuar të shtrojnë kalldrëm. Me neveri shikojmë minaren e rrënuar për gjysmë, për fat të keq edhe ajo s'i ka shpëtuar destruksionoit. Një pjesë e një historie të çuditshme ka të bëjë me këtë minare. Në kohën kur lufta për qytetin ka qenë më de rreptë dhe kur turqit kanë bërë hakmarrje më të tmerrshme mbi popullatën e krishterë – në këtë minare ka rënë rrufeja dhe e ka hedhur për tokë për gjysmë së bashku me myezinin në të. Kjo histori dhe ky realitet përkojnë fare mirë me mjedisin që e rrethon. Në këtë mjedis të çuditshëm më së shumti na intereson se ku do të ketë qëndruar ajo katedrale fort e moçme prej së cilës ende janë gjurmët e mëdha. Kapërcejmë si në gjumë ato mbetje të mureve të trasha të kishës e ndërtuar në atë kohë kur këtu krishterimi ka lëshuar rrënjë të thellë dhe kur në tërë bregun ballkanik është përhapur drita e fesë sllave. Aty janë shenjat e bazilikës, e mu pranë tyre shihen mbetjet e bedenave ndërtuar sipas ndërtimit romak, me ledhe mbrojtëse, aty ende është një top i moçëm nga kohë më të vonshme dhe, thonë, nga një herë qitet me të, kur në Ulqin vjen mbreti ose për ndonjë festë me rëndësi shtetërore. Aty, po ashtu, ka qenë pallati i princit nga koha kur në këto anë ka sunduar familja e Balshajve. Për ta në Ulqin kanë mbetur më së shumti kujtime. Ajo ishte familja e cila në shekullin XVI dhe XV ka sunduar me këtë tokë, dhe e cila në ato kohë ka qenë njëra ndër familjet më të famshme në Gadishullin Ballkanik. U ka takuar jo vetëm Ulqini, por edhe Tivari dhe Shkodra. Por që, siç duket, Ulqini ka qenë më i përshtatshmi, qyteti më i rëndësishëm; më vonë do ta drejtoj lexuesin në vendin ku janë pallatet e këtyre sundimtarëve që janë dëshmi të fuqisë së madhe dhe të pasurive. Këtu është edhe një vend i cili dëshmon për të kaluarën e bukur të qytetit. Aty është një cisternë (saranxhë!) e madhe, pa masë e thellë, që dëshmon se që nga koha romake këtu ka qenë vendbanim i përhershëm. Mbi të, sigurisht në kohë të hershme ka qenë ngritur pjesa më e madhe e kështjellës, prej së cilës tash kanë mbetur vetës pjesë të përdheses, por që edhe ato flasin se ka qenë një seli princore të një fuqie të jashtëzakonshme.

Prej këtu ulet në pjesën e qytetit të fortesës. Aty përmes disa ndërtesave janë rrugë e rrugica, shpesh fare të ngushta, dhe kalimi me karroca është fare i pamundshëm. Sigurisht datojnë që nga kohët e vjetra dhe të shtyjnë të mendosh për pallatet e ulqinakëve të pasur vartësve të familjes sunduese, nën mbrojtjen e së cilës kanë gjetur siguri. Të gjitha këto shtëpi janë të ndërtuar me gurë, janë shumë të forta, kanë dritare të vogla, siç është zakon në jug – mbi dritare ende sot janë konzolat prej guri për shkopinj në të cilët përpara kanë shtrirë kurtinat për t'i mbrojtur nga dielli. Shumë nga këto shtëpi janë të stolisura me dekorime prej guri, me ballkone të latuara për bukuri, me portale të që bien në sy, shkurt, shihet se këtu njerëzit kanë pasur shije dhe se kanë qenë të pasur që vetes t'i sigurojnë një jetesë të mirë. Mirëpo ato kohë kanë kaluar që kur! Shumë valë janë derdhur mbi këtë seli krenare. Furtuna e luftërave këtupari kanë kapërcyer gati në çdo shekull. Janë ndërruar sundimtarë të ndryshëm, perandori të ndryshme e kanë pushtuar qytetin dhe kështjellën. Gjithherë me luftëra të mëdha dhe përpjekje të mundimshme.

Ata njerëzit e pasur dhe dinjitozë që nëpër detet të largëta kanë nisur barkat e veta në lundrime dhe kanë qenë miqësor, më pas edhe varës të Venedikut, kanë vdekur ose janë përzënë nga turqit, që këtu kanë ushtruar sundimin e dhunës, ndërsa më pas edhe kaosin e vërtetë. Nga Ulqini krenar dhe dinjitoz - është shndërruar në fole të grabitësve detarë, është bërë një vend famëkeq për fshehje, qendër e piratëve. Të gjitha këto këtu kanë lënë gjurmë. Në shtëpitë ku kanë jetuar magnatët e fuqishëm, ku është jetuar me luks, sot është vendosur fukaraja, më të varfrit prej më skamnorëve. Këtu sot, në vend të figurave dinjitoze, neve nga dritaret na shikojnë fytyra të habitura që ende tregojnë se janë të trembura nga rreziqet kur këtupari kanë përhapur tmerr hajdutët më të këqij të Adriatikut. Nga dritaret nga të cilat edhe sot shihet një pamje e mrekullueshme në detin magjeps dhe malet e larta, të zeza e të bardha, si dhe në bregun e gjelbër, shikojnë sytë e plakura dhe shuara, e atje ku dikur ku mbi balusarda në dritare janë shtrirë perdet e shtrenjta, atje janë varë copa mishi që teren, që dielli t'i bëjë për t'u hëngër më vonë, ashtu sikur thahet edhe peshku me erë të rëndë, Vetëm ajo që ka mbet nga noblesi i kohëve të shkuara, janë shtambat prej teneqeje të mbledhura diku nëpër hedhurina në të cilat banorët e sotëm kanë mbjellë nga pak

lule – ky është tash i vetmi dekorim i gëzueshëm dhe i vetmi luks në ato ballkone të mrekullueshme dhe dritare të skalitura.

Ulemi rrugicës teposhtë drejtë shkëmbinjve të larta mbi të cilët kanë qëndruar pallate krenare me begati të pamatur. Është një pozitë që s'pushtohet dot nga deti dhe fort mirë e ruajtur kah toka. Aty – këtu mund të dallohet ndonjë shenjë e luftërave të mëdha që janë bërë për këtë qytet. Aty janë rrënuar muret me forcë, në muret e shtëpive shihen bira të hapura. Mirëpo urthi i gjelbër dhe i mirë i ka mbyllur ato plagë dhe vragë dhe ka mbështjellë edhe varrin e shumë luftëtarëve dhe ushtarëve të rënë aty. Dhe mbi këto istikame e varre të të panjohurve, mes gurëve dhe mureve të rëna, shihet bar peshku, kanë mbirë vetë lule mëllaga, kanë dalë lule të vogla, është një ngushëllim i vogël i natyrës në këto rrënoja. Gjendemi në pjesën më të rëndësishme të qytetit të vjetër dhe të kështjellës, në vendin ku ka qenë selia e familjes së Balshajve. Këtu e kanë pasur fronin njerëzit më trima dhe të fuqishëm, mes të të cilëve vend të rëndësishëm ka pasur Helena Balsha, e cila ia ka dalë që vetë ta mbaj kështjellën para sulmeve të armiqve, e sipas gojëdhënave të burrave të moçëm ajo ishte njëra ndër figurat më të ndritshme të botës së vjetër sllave. Gjendemi në mes të ndërtesave që ishin oborri i saj. Aty janë pallatet e larta, ndonëse të larta sipas standardeve të jugut. Shumica dykatëshe, me themele të forta, me të gjitha ato elemente që i kanë pasur qytetet mesjetare. Në lartësi të çrregullta janë ndërtuar ndërtesa të ndryshme, ndërsa ndonjëra godinë ishte edhe më e lartë se pallati i i Helenës, disa janë kulla të vogla, apo me mure mbrojtëse. Disa, prapë, sikur burgje, me qeli të vogla në të cilat hyhej nga lart, gjë që do të ketë qenë punë mjaft e vështirë, e mund ta marrim me mend se çfarë mundimesh do të kenë hequr armiqtë guximtarë. Cisternat (saranxha!) e thella këtu janë të mbyllura (me kapakë!), në to mblidhet uji i shiut; aty janë dhe vrojtoret prej të cilave është vështruar deti – gjithçka këtu është ndalur të na e zgjojë imagjinatën dhe na e mundëson të kthehemi në ato kohë të mundimshme kur në qytetin e Ulqinit ka qenë një kohë e furishme dhe të gjithë banorët e kalasë është dashur ta mbrojnë nga këto pozita, e mund ta marrim me mend edhe atë, kur në kohën e paqes, këtu ka qenë hareshëm, gazmende, në lëndinat me bar që ende janë ruajtur, mbi të cilat është ngritur, siç thuhet, pallati i Helenës së Balshajve, me balastrada të mrekullueshme dhe dritare të dekoruara. Nga ky vend hapet një

pamje e mrekullueshme në det, larg kah jugu, kah brigjet shqiptare dhe në vendet e tjera, ndërsa në kohën kur ne qëndronim këtu, mund të dallohej edhe vapori ndërkombëtar i ankoruar në grykën e Bunës. Sot këtu është pikëllueshëm, shumë mallëngjyeshëm. Në fushën me bar është qetësi, heshtje e thellë është ndër pallatet dinjitoze. Banorë këtu janë vetëm shqiptarë të varfër, shumë të befasuar me vizitën tonë, njëri prej tyre, madje, me vrap na zuri duke ngarendur nëpër ato rrugica të ngatërruara, hipur në një kalë të bardhë dhe u lëvdua para nesh me aftësitë e tija prej kalorësi. Menjëherë m'u kujtuan ato shkathtësitë kalorësiake në garat e shkëlqyeshme të cilat në shekujt e kaluar janë organizuar këtu – sot këtu kanë mbetur vetëm gurët e hedhur dhe birat në shtyllat prej mermeri që dikur e kanë stolisur këtë ambient. Këtu në afërsi të pallatit të dikurshëm të Balshajve, është një shkëmb i lart më i pingulti që ka kalaja. Këtu shkëmbinjtë lëshohen pingul, thellë në det. Po sa njerëz do të kenë qenë të detyruar që kësaj rrugice të ikë nga pallatet e kështjellës dhe këtë fushë të lotëve ta lerë përgjithmonë! Si na shtrëngohet shpirti kur i marrim me mend të gjitha këto dhe shikojmë këtë shkretëtirë përreth, qytetin e rrënuar dhe të vdekur, i cili, po të thuash brenda një nate, prapë do të mundë të gjallërohej, së paku në disa vende të tija. Këtu është edhe porta tjetër për hyrje në Kala, nga ana e bregut të detit. Rrugica të çon nëpër shkallët e larta, nëpër shkëmbin e rrëpirët. Hyjmë nëpër dy kapi në harqet e të cilave ende është e skalitur stema. Rrugica gjarpëron nga deti nëpër shkëmbinj, shpie deri në breg të limanit, përmbi shkëmbinj të mëdhenj që humbin nën sipërfaqen e detit. Edhe atje ku humbin thellë shihen kujtimet në kohët e shkuara, aty brenda është një top i moçëm i ndryshkur, që shumë dhjetëra vite e kanë rrahur tallazet e detit. Me çfarë rrethanash ka mbërritur këtu, sa njerëz do të ketë mbytur, sa shtëpi do të ketë shkatërruar? Kështu shumë mendime na valuan duke parë këtë dëshmitar të kohëve të kaluara, sot të hedhur në det! Sot u shërben për të lojë fëmijëve të Ulqinit. Këso përmendoresh të çuditshme në Ulqin ka mjaft!

T'i kthehemi Ulqinit të sotëm! Ai është çuditërisht interesant, sepse plotësisht ndryshon nga të gjitha qytetet e tjera malazeze të cilët i kemi parë deri më tash. Ecim xhadesë së mirë deri në breg të detit. Ajo së shpejti hapet në një rrugë të gjerë që arrin gjatë tërë pjesës tjetër të qytetit dhe paraqet arterien kryesore të tij. Nga ana e majtë është shumë bukur, është dhe vila luksoze e doktor

Gërgiqit, i cili ka kujdes prindor për banjën, po edhe ndaj nesh ka qenë shumë i kujdesshëm për shumë gjëra. Nga ana e djathtë është ndërtesa modeste e postës dhe telegrafit, ndërsa nën të ndalen autobusët e "Pragës". Në këtë vend në rrugën kryesore të Ulqinit nis një jetë e gjallëri. Propozoj të vizitohet kjo rrugë sidomos të shtunave, sepse këtë ditë në qytet vijnë shumë fshatarë nga katundet e afërta, të gjithë janë në veshmbathje piktoreske, që japin një pamje shumë interesante. Edhe në ditët e zakonshme aty mund të shihen gjëra interesante. Si në ndonjë kaleidoskop të gjallë para nesh ndërrohen pamjet dhe njerëzit në to. Te shatërvani i madh gjithherë është gjallëri, në gurët e mëdhenj përqark rrinë ata që vijnë nga rrethina në Pazar dhe aty pushojnë. Aty ka malazezë shtatlartë, si dhe malazeze të bukura. Aty ka edhe shqiptarë, e me to shpesh janë edhe gratë e tyre, me veshmbathje piktoreske. Vijnë edhe gabelë të cilët të gjithëve u pengojnë. Shihen edhe grupe njerëzish që rrinë para kafehaneve të vogla. Aty gati tërë ditën pinë kafe e çaj, konkurron edhe duhani, ajo është pjesë e jetës së malazezëve. Aty, në mes të malazezëve, shqiptarëve dhe turqve, që miqësisht rrinë bashkë dhe bisedojnë, një pamje jo e zakontë është edhe ndonjë harap! Zezakë këtu ka mjaft. Është çudë si mbijetojnë tutje këtu! Në mes tyre shumica janë fytyra që nuk tërheqin. Në atë kohë, e marr me mend, nuk do të kenë qenë dërgesë më e qëlluar nga Afrika, që e kanë sjellë piratët e Ulqinit. Sot të gjithë këta harapë janë bërë malazias (!?). Flasin nashke (serbisht) (!?), ndërsa vishen allaturka. E vërteta, vishen në mënyrë shumë piktoreske, në kokë mbajnë fes, bragesha të gjëra dhe pallto allafrënga. Në mesin e tyre e kemi hasur njërin që ishte një xhind i vërtetë. E takuam kur, me një sfurk, shkonte diku në fushë. Zumë bisedë, ndonëse dukej se nuk kishte qejf të bisedonte, madje me atë ngurtësinë edhe sikur na shikonte me bezdi. Më vonë na thanë pse. Gjatë vizitës së paradokohshme në Ulqin, knjaz Nikolla e ka takuar këtë zezak. Shkaku i shtatlartësisë, zezaku i ka pëlqyer, andaj mbreti e ka ftuar të shkojë te ai në shërbim. Por zezaku me atë ndjenjën e tij tërhequr të pakuptueshme e ka refuzuar – ka dashur të rrinte në Ulqinin e qetë, ku jeton me gëzim e pa brenga, dhe ku askush s'e shikon me çudi, ndërsa në Cetinë do të ishte inspirim për shaka pa pushim. Përveç këtij katallani kemi parë edhe shumë shokë të tjerë të tij, nëpër kafehane, nëpër do dyqane, por edhe disa që punonin si hamej. E vërteta, te vendasit nuk janë edhe fort të

dashur (!?), por që edhe askush s'i gërget, janë aty qe shumë vite dhe, përkundër bojës së pazakontë, janë bërë vendas. Në afërsi të postës është ndërtesa e komunës. Mbi të ka qenë një pirg prej ku në kohën turke janë dhënë lajme, ashtu sikur në vende të tjera të lindjes, siç kam përmendur më herët. Nga ky vend nis pazari i Ulqinit që e vlen të mbahet në mend. Pazari është qendra e qytetit, aty zhvillohet jeta, aty vihet për të bërë pazar, për t'u takuar e për të shëtitur. Prandaj aty është gjallëri. Pazari është i furnizuar mjaft mirë me të gjitha ato që i duhen qytetit të Ulqinit. Është për t'u habitur që shpesh janë gjëra që paraqesin një farë salltaneti. Për ne ka qenë fort interesante një dyqan ku shitej grosha e, njëkohësisht, shiteshin dhe lëkura shqarri, dhelpre, për të cilat zonjat tona pranonin se ishin shumë të çmueshme dhe të lira. Këtu në bazar ka më së shumti turq, ata kryesisht merren me tregti për të cilën malazezët nuk interesohen fort, ndërsa shqiptarët as që merren me fare. Këtu shihen shumë turbana, në mes të tyre ka mjaft edhe të atillë me një shirit të gjelbër, që është shenjë se njeriu ka qenë në haxhillëk në Mekë për t'u falur Allahut. Aty më së shumti shihen veshmbathjet dhe kësulat shqiptare, nga të cilat dallohen gratë turke dhe shqiptare me ato kapuçat e çuditshme për të cilat kemi folur më herët. Në këtë gjallëri përzihen edhe shtazë, ato i sjellin nga katundet: lopë, dhi, dele, gomarë, të gjitha ato rrinë në xhade, aty u jepet ushqim, nëse nuk i qesin ndokund në ndonjë lëndinë që të kullosin. Ndërsa livadhet janë aty pranë, afër dorës, meqë Ulqini i ri të cilin e kemi përshkruar shtrihet në luginën mbi të cilën qëndrojnë kodrat mjaft të larta, në të cilat janë të mbjella shtëpi, madje edhe ndonjë vilë. Në larushinë e gjallë të Ulqinit sigurisht bën pjesë edhe shkolla. Gjendet në mes të kësaj tollovie, e ndërtuar njëkatëshe dhe se nga rruga, brenda në katin përdhes, shihet fare mirë. Vëmendjen në shkollë na e tërhoqi zhurma, madje edhe klithma, që dëgjoheshin edhe në rrugë. U kthyem kah dritaret e hapura. Zhurma përnjëherësh u ndal dhe ne na shikuan të befasuar dhe të habitur nja dy duzina djemsh, me qeleshe të bardha shqiptare në kokë. Ma i habitur nga ata na shikoi fytyra e mësuesit i cili me një turban të madh në kokë rrinte një gjunjë para fëmijëve dhe diçka u fliste nga Kurani, që ata me zë të lartë e përsëritnin – tërë kohën deri sa nuk na vërejtën ne.

Bazari turk (!) gjendet në pjesën më të lartë të rrugës që kalon nëpër tërë qytetin, e pastaj shpie, duke u kthyer pak, deri te mëhalla më larg, që ishte fare turke (!). Nga këtu hapet një pamje

shumë e bukur në fushën nëpër të cilën rrjedh Buna, si dhe në malet e larta që i bëjnë kurorë Liqenit të Shkodrës. Nga ky vend e kemi përshtypjen se Ulqini është një qytet thjeshtë oriental. Aty ka xhamia të ndërtuara sipas manirit të xhamive në Turqinë e Azisë së Vogël. Xhamitë janë me varre të moçme myslimane, përreth ka trungje plepash dhe gështenjash në hijen e të cilave qesin ujë krojet turke. Këtu ka shtëpi të bukura turke me harema, një xhami e kaltër me minare të gjelbër dhe në të gjitha këto jemi mësuar nëpër qytetet e Turqisë. Rrugës në anën e majtë do të kthehemi kah një shtëpi shumë e lashtë turke me themele të larta prej muri, që katin e parë e ka fort të lartë, joproporcional – çardaku – kjo ndërtesë është në fund të qytetit dhe sigurisht do ta ketë funksionin e vet në kohë të trazirave. Kjo godinë me kulm të lartë dhe shenja të haremit, ende sot duket e vizatuar me lule të mëdha laramane, që në kohët e reja nuk duken më nëpër shtëpitë turke. Pra, edhe një kuriozitet i Ulqinit, që ia vlen të përmendet dhe, kuptohet, edhe të vizitohet.

Nga këtu, siç kam thënë, hapet pamja në rrafshinë deri në afërsi të Liqenit të Shkodrës. Ai nga këtu nuk dallohet, sepse na e pengon pamjen Taraboshi. Brezi i malit përpara nesh është Kraja, është jo fort larg nga këtu dhe është shumë e këndshme për shëtitje, meqë atje është një natyrë e paprekur e egër. Kur isha në Ulqin nuk më kështilluan të shkojë ta shoh. Ky rrafsh dhe ato male pas saj të cilët qe një kohë të gjatë janë të Malit të Zi, apo ende nuk janë të sigurta, sepse atje jetojnë fise të egra shqiptare, njerëzit nga andej janë fort të përvuajtur kur vijnë në Ulqin, por që nuk është e thënë se nuk do ta bëjnë edhe më të keqen kur të dalin jashtë qytetit.

Te Ulqini mbaron ai masivi malor që shtrihet gjatë që nga deti deri te Liqeni i Shkodrës. Aty mbaron me disa kaskada, duke u ulur shkallë – shkallë në rrafshinën nëpër të cilën rrjedh Buna. Kjo fushinë është në anën verilindore. Kufizohet me Krajsin e Vogël, që ndahet nga Taraboshi, ndërsa nga jugperëndimi, shtrihet deri në det, duke formuar disa këneta. Më e madhja është e Shasit. Aty pastaj është edhe këneta e Zogajve që është më afër Ulqinit, ndërsa përroi që del prej saj, uji rrjedh në det, në portin Milena. Në këtë grykë qëndron e ardhmja e Ulqinit si një banjë detare. Bregu fort i bukur ranor shtrihet deri te Buna, dikund ka pyje, dhe andej, jo fort larg detit, një rrugë mjaft e mirë të çon deri në Shënkoll, Sv Nikola, në grykë të Bunës. Këtu, dikur, sigurisht

do të ndërtohen banja të mëdha, këtu vërtet janë shumë kushte të përshtatshme. Ta merr mendja se për këtë do të duhen shumë duar të vyeshme, si dhe duhet evituar rrezikun që kërcënon nga kënetat të cilat këtu ende krijohen. Por, pas kësaj, Ulqini do të bëhet njëra nga plazhet më ideale në detin Adriatik. Gjatë bregut të detit këtu ka shumë pyje me lar dhe me ullishta. Këta do të jenë kualitet me rëndësi banjave të ardhshme.

Edhe më të bukur është ullishta qindravjeçare në anën tjetër të Ulqinit, në veriperëndim, kah shkon rruga e moçme. Shëtitëm deri atje një mbrëmje dhe na dukej se kemi hyrë në një peizazh biblik. Shkuam ta shihnim atë gjirin e mrekullueshëm të quajtur Val-di-Noçe, për të cilin poetët tanë, kur kanë ardhur këtu, i kanë kënduar ode.

Ai është Valdanosi, lugina e arrave, gjir që do të mund të bëhej stoli apo së paku kornizë për ndonjë përrallë fort të bukur. Edhe vet rruga deri atje është e pazakontë. Kuptohet, është fort e keqe, sepse është vetëm me gur e zhavorr nëpër të cilin me karrocë nuk mund të kalohet assesi, edhe me kalë disi me probleme të mëdha. Por, që të gjitha këto me qejf i harrojmë, sepse ai vend është fort i bukur dhe i pastër, pa prekur me atë kulturën e civilizimit, që është një dukuni përcjellëse çdo përparimi, pore çdo gjë që e prek – e eksploaton. Menjëherë jashtë Ulqinit arrin deri te ullishtat e mrekullueshme. Aty ka trungje të larta dhe fort të bukura, të kërrusura sikur të gjunjëzohen, sikur të ishin të lidhura me shumë litarë. Dhe secili trung ka një pamje tjetër, ngjashëm me ata që i kam parë në Palestinë, ndoshta edhe për këtë arsye kjo zonë në mua lë përshtypje biblike.

E po, se çfarë qetësie e pabesueshme mbretëron këtu! Një qetësi aromatike, dehëse e kaçubave të mërsinës. Frymë njeriu nuk mund të shihni. Gjithandej toka është e mbuluar me fier, të lart një bojë njeriu. Rruga mezi kalohet për mes mureve që sigurisht që në kohët e moçme i kanë ngritur për të ndalë tokën të mos rrëshqasë. Sot ata gati sa s'duhen, sepse ullinjtë janë të lartë dhe me shumë degë dhe nën to toka nuk mund të punohet. Tash qetësi dhe paqe, vetëm në kurorat e ullinjve dëgjohet shushurima nga era e lehtë. Në trungjet toka është e shtruar me bar dhe lule të ndryshme bregdetare dhe ne na duket se po shkelim nëpër një qilim të kadifenjtë. Mes trungjeve fluturon ndonjë shpesë. Thashë, s'duket njeri i gjallë. Përnjëherësh para nesh hapet një pamje

madhështore e luginës së gjelbër që përfundon në gjirin, limanin magjeps. Lugina është e mbuluar me ullishtën e pafund, aty-këtu shihet ndonjë trung i gjelbër fiku apo arre. E livadhi i bleruar si ndonjë liqen i gjelbër, shkëlqen në si pasqyrë në detin e hapur të të kaltër – të gjelbër! Mahnitëse është kjo bukuri ngjyrash, gjithandej: gjelbër: lugina, ullishta toka; kaltër: deti e qielli! Rrija i magjepsur në këtë cep të Malit të Zi, nuk besoja dhe nuk doja të besoja se jam një shtet që quhet malor. Pastaj aty pranë buronin disa kroje, e rreth tyre gjelbërim i gufuar bregdetar. Shpatet ngrihen mjaft lart mbi, sikur i bëjnë mburojë mbrojtëse kësaj lugine dhe gjiri. Të gjithë ne gati sa nuk besuam se këtu këta trungje ullinjsh, këta burime uji kanë fuqi magjike! Po si do të duket kjo luginë në pranverë, kur këto kurora ullinjsh lulëzojnë, thonë se përhap aromë dehëse në disa kilometra përqark! Këtë vetëm mund ta merrja me mend dhe ua kisha lakmi banorëve të atyre pak shtëpive të rralla në breg të detit, në atë natyrë më se të bukur, një gjir i njohur për të gjithë detarët e Adriatikut sllav; përveç gjithë asaj që kam thënë, është gjir ku anijet, si shkaku i thellësisë, ashtu edhe për fundin e sigurt, pozita e mbrojtur, gjithmonë mund të gjejnë strehim. Ia filloi mbrëmja dhe horizonti i detit, gjiri shkëlqeu me dritën e kuqërremtë të diellit në perëndim. Shkëlqente bregu me gjelbërim dhe deti i kaltër i kuqërremë me një bukuri magjike.

U kthyem duke ecur përmes atyre trungjeve të pazakontë të ullinjve të moçëm. Nën ato kurora qindravjeçare të ullinjve mitikë, që paraqesin pasuri të madhe shumicës së ulqinakëve. Kalojmë përmes parcelave të ndara me mure. Me përshtypjet më të mira dhe të paharrueshme u kthyem prapa. e kjo ishte nata e fundit e qëndrimit tonë në territorin malazez. Ne të cilët e kemi ditur Malin e Zi vetëm përmes Cetinës dhe rrethinën e tij me shkëmbinj, malore, gati sa nuk mund të besonim se edhe ky vend është Mali i Zi. Megjithatë, ky është Mali i Zi i ardhmërisë! E besoj se nuk do të kalojë shumë kohë dhe këtu do të arrijë hekurudha nga Tivari, se do të ndërtohet moli në limanin e Ulqinit, do të hapen banja detare të njohura, si dhe Valdanosi do të jetë cak i pelegrinëve që dëshirojnë t'i dorëzohen madhështisë së natyrës. Ndonëse atëherë kjo nuk do të jetë më ajo lugina magjike në të cilën, më duket se gjithandej rreth meje vallëzojnë zana e floçka. Atëherë do të jetë vend për pikniqe, mbushur me letra e mbeturina; kam frikë nëse këtu do të arrijë Evropa do të

thyhen mënjollat e reja të ullinjve, por tash për tash – është një natyrë vergjinë, e paprekur nga dora e përparimit, prandaj ngutuni ju të cilët dëshironi të kënaqeni me natyrën e bukur që me qindra vite ka mbetur ashtu siç e ka krijuar nëna Natyrë, që e ka krijuar për kënaqësinë e vet!

Kështu mendoja kur rrija në shkallët prej guri para hotelit të axha Shpiros. Ishte një mbrëmje magjike kur ndahesha nga Mali i Zi. Para meje, nën rrezet e fundit të diellit, mbulohej nga terri Kalaja e Ulqinit si një siluetë që pasqyrohej në syprinën e limanit. Me vija të qarta, krenarisht zunë të dallohen konturat e Kullës së Balshajve.; rrezet e kuqërreme binin dhe ktheheshin nga ata shkëmbinj mbi atë det që ka strehuar piratët e dikurshëm. Nga gjelbërimi që mbulohej në terr dalloheshin pullazet e pallateve të dikurshme, që tash vetëm sa ndriçon ndonjë dritë e dobët. Episodi i të kaluarës së lavdishme flinte para meje. E pjesë e asaj të kaluare ishte para meje edhe minarja elegante, që ngrihej deri në qiellin e praruar, duke iu kundërvënë: të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes. Por që ishte i dobët zëri i myezinit lart në derë të minares. I ulët dhe i pasigurt. Dhe në thirrjen e tij iu përgjigjën vetëm disa figura, duke ardhur në xhami. Lutja e tyre vinte nga thellësia e trupit dhe shpirtrave të tyre, me frikë dhe fshehurazi. Bie mbrëmja, teri nis e mbulon bregun e detin dhe çdo gjë bëhet gati për paqen e natës. Edhe zëri i myezinit pushoi. E atëherë, diku nga platoja pas nesh, u dëgjua kënga kreshnike malazeze. E trembi tufën e shpesëve të zeza, një plim shumë i madh, si një re e zezë tmerrshëm krrokati, ngutej të gjente e të ulej në ndonjë vend më të sigurt, në ndonjë pallat të moçëm në Kala, të lëshuar që kur. Atje e kishin vendin, atje sigurisht kanë jetuar ata shpirtrat e të cilëve edhe sot i mbajnë këto zogj. Ndërsa kënga e trimërisë malazeze nga diku, nga ndonjë lartësi, dëgjohej edhe më zëshëm, e shoqëronte zëri i gjinkallave – nata e ngrohtë, me tufën e yjeve të panumërt, u lëshua mbi folenë detare të moçme, që do të jetë një kornizë e ngjarjeve të kohëve të reja...

Kështu e lashë Malin e Zi. Mu tash e pasqyrova atë vend plot me ngjyra të gjalla që i mora dhe barta nga ky udhëtim imi i parë!

.....

**** Jozef Jan Svatek***, udhëpërshkrues çek. Udhëtoi nëpër Ballkan, Mal të Zi dhe Shqipëri. Ishte edhe në Ulqin e u magjeps me bukuritë e tija. Shkroi udhëpërshkrime me interes.

Burimi: *Mali i Zi dhe Shkodra*, botoi *SID*, Podgoricë, 2000

E përktheu nga gjuha malazeze: Hajro Ulqinak

PËRVJETOR

10-vjetori i ndarjes nga jeta

PROF. BEDRI DEDJA-AKADEMIK: KRIJUES, STUDIUES E BOTUES SHUMËPLANËSH, AUTOR I SHQUAR I SHEKULLIT XX

Nga: Prof. Murat Gecaj

1.Në kujtimet e jetës së tij, Prof. Bedri Dedja ka shënuar se lindi më 20 nëntor 1930. Aty shprehej: "Unë ndjehem krenar që linda në Korçë, në djepin e arsimit kombëtar laik, në Korçën që ishte…mbretëreshë e artit dhe e shkencës, trimëreshë e atdhetarizmit në kohët që shkuan dhe në kohën e sotme". Gjimnazin e mbaroi në Durrës, më 1949, kurse Shkollën e Lartë në Moskë, më 1953, në dy degë njëkohësisht: psikologji-pedagogji dhe letërsi për fëmijë. Së pari, e emëruan pedagog për psikologjinë dhe historinë e pedagogjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës. Siç ka shkruar vetë, aty "ndezi gjeneratorët e ambicies fisnike profesionale". Rreth 40 vjet rradhazi ka punuar pedagog i psikologjisë në shkollat e larta të vendit tonë. Prandaj ishte e natyrshme, kur ai kujtonte me kënaqësi se: "Edhe sot më thonë ish-studentët e mi, pas disa dekadave, se kam ligjëruar bukur në auditor, që në vitet e para të Institutit". Me ndarjen e fakulteteve në ILP të Tiranës dhe krijimin e dy dekanateve të reja, kur ishte vetëm 24 vjeç, prof. B. Dedja u emërua dekan i Fakultetit Histori-Filologji. Në atë periudhë, ai kishte nisur të bënte emër me shkrimet e tij në shtypin e kohës dhe si veprimtar i rinisë. Kështu, në verën e vitit 1954, e dërguan për pushime me një grup fëmijësh në Varna të Bullgarisë dhe më 1957 ishte në Moskë me delegacionin shqiptar, në Festivalin Botëror të Rinisë dhe më 1962, po në një festival të tillë, në Finlandë. Më pas u ftua të merrte pjesë dhe në Kongresin e Parë të Psikologëve Sovjetikë etj. Me krijimin e Universitetit të Tiranës, më 1957, plot pasion dha leksionet e psikologjisë, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë.

2. Në vitin 2001 u vu në qarkullim libri me kujtime i prof. Bedri Dedjes, me titullin tërheqës "Nëper ravat e jetës".Në hyrjen

e tij njëfaqëshe, ndër të tjera, autori shkruante: “”Nëpër ravat e jetës”! Kështu më është dukur më e arsyeshme që ta quaj librin tim të kujtimeve. Sipas “Fjalorit të gjuhës shqipe”…fjala “ravë” ka kuptimin e rrugëve të dhive në mal, ose të gjurmëve në borë. Më është dukur se rrugët e mia të jetës ngjasojnë më shumë me“ravat”. Sidoqoftë, këtë do ta dëshmojë më mirë lexuesi, i cili, besoj, do ta trajtojë me dashamirësi këtë libër…”.Më kishte treguar Profesori i paharruar se librin e mësipërm e kishte dërguar në shyp dhe prisja me padurim daljen e tij. Pas vonesave të njohura të botimeve tona, më në fund, ai pa dritën e botimit. Për këtë gjë, më njoftoi menjëherë dhe shkova ta përgëzoja. Përpra më vuri librin e tij të ri, si dhuratë për miqësinë tonë 45-vjeçare, ku kishte bërë dhe një shënim me fjalë aq të ngrohta e dashamirëse. Menjëherë vura re kënaqësinë e madhe, që ndjente dhe njëfarë lehtësimi shpërtëror. Kjo ishte e natyrshme, sepse në ato 525 faqe ishte “rrëfyer”përpara lexuesve, si në asnjë libër të tijin të mëparshëm.Siç shkruante në kujtimet e veta, në prill-maj 1945, ai kishte nxjerrë revistën e fëmijëve të qarkut të Durrësit, “Flamurtari i vogël”, që i kishte shërbyer si shkolla e parë në fushën e publicistikës dhe botimeve, pra e “nxiti drejt letërsisë së vërtetë”. Më tej, ndër faqet më interesante janë dhe ato, që ka përshkruar periudhën e punës si kryeredaktor i parë i gazetës arsimore-kulturore “Mësuesi”, që nga viti 1961, kur doli si botim i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës. Në numrat e parë të asaj gazete, pra kur isha ende student, nisa të botoja aty dhe unë shkrimet e mia modeste. Si dhe mjaft mësues e bashkëpunmëtorë të tjerë, kurdohere gjeta te Prof.Bedriu mbështetje, nxitje e dashamirësi, si publicist e padagog i talentuar që ishte.Sigurisht, libri jetëshkrimor i prof. Bedri Dedjes u mirëprit nga lexuesit tanë, të dhënë pas letërsisë dokumentare, nga miqtë e të njohurit e tij të shumtë në Shqipëri, në Kosovë e më gjerë. U botuan dhe artikuj vlerësimi nga lexuesit e studiuesit tanë në shtypin tonë, si në gazetat“Mësuesi”, “Drita” etj. Tani, që këtë pedagog, shkrimtar dhe studiues të mirënjohur nuk e kemi më ndërmjet nesh, tash plot 10 vjet, pra që nga data 13 prill 2004, ndiejmë se vlerat e këtij libri rriten, bashkë me mallin e pashuar të familjarëve dhe të të afërmve, kolegëve gazetarë dhe të fushës së arsimit, të ish-studentëve të panumërt dhe të gjithë atyre, që e kanë njohur ose kanë shfletuar krijimet e tij të rralla.

3. Veprimtaria e prof. Bedri Dedjes në fushën e shtypit pedagogjik pati hapësira të mëdha me shkrimet e tij të shumta dhe me vlera pedagogjike-psikologjike në gazetën "Mësuesi", si dhe në revistën "Arsimi Popullor". Vetë u kujdes që, nën okelion Biblioteka e "Mësuesit", të publikoheshin shkrime me sa më shumë vlera për arsimin kombëtar shqiptar dhe sidomos për historinë e tij. Veçanërisht ai i dendësoi punën studimore-pedagogjike dhe botimet në këtë drejtim, pas emërimit të tij më 1965, drejtor i Institutit të Studimeve dhe Botimeve Shkollore. Një vit më pas botoi librin "Mbi rrugët e perfeksionimit të sistemit të sotëm të edukatës familjare". Më vonë atë e dërguan drejtor i Drejtorisë së Studimeve dhe Botimeve Shkollore, në Ministrinë e Arsimit e Kulturës. Në mbarimin e vitit 1970 e caktuan në detyrën e zv.ministrit të Arsimit e Kulturës, nga u largua në nëntor 1972. Me fillimin nga puna të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 6 dhjetor të atij viti, atë e ngarkuan me detyrën e sekretarit shkencor të saj. Këtë detyrë e kreu mbi dy vjet, me ndërgjegje të plotë dhe aftësi të lartë profesionale. Më pas edhe prof. Dedjen e përfshiu "vala" e shkurtimeve dhe e qarkullimeve "vullnetare" për në bazë. Kështu, më 25 gusht 1975, e nisi punën pedagog në ILP të Elbasanit (tani Universiteti "A.Xhuvani").Pas disa ecejakeve e shqetësimeve të njohura për kohën, prof. Bedri Dedja mundi të kthehej familjarisht nga Elbasani dhe në qershor 1980 e nisi punën përsëri pedagog në Universitetin e Tiranës.

4. Bedri Dedja është shkrimtari më prodhimtar dhe më popullor i letërsisë shqipe për fëmijë, veprimtari të cilën e nisi që në rini. Ka krijuar e botuar dhjetëra vepra origjinale për fëmijë dhe 33 përshtatje e përkthime, nga letërsia klasike botërore për moshat e vogla dhe të reja. E kush nuk i ka lexuar veprat e tij të njohura, si: "Heroizmat e fatbardh Pikaloshit"(1954), "Kalamajt e pallatit tim","Një udhëtim i rrezikshëm","Shkolla e pyllit"(që më 1970 mori "Çmimin e Republikës"), "Republika e 1.100 çudirave", "Qyteti me tri kështjella", "Përrallëmadhja"etj. Shumica e tyre janë ribotuar disa herë në Shqipëri e në Kosovë dhe janë përkthyer në gjuhë të huaja. Vetëm gjatë qëndrimit me punë në qytetin e Elbasanit, botoi tre romane për fëmijë, një novelë fantastike-shkencore e dy poema, një vëllim me kritika letrare, shkroi dy drama që u shfaqën në teatrin"Skampa" etj.Kujtim i paharruar për të ishte vizita e parë në Kosovë, që e

bëri në vitin 1973. Një miku i tij kosovar, poeti Agim Deva do t'i dërgonte, shumë vite më vonë, një libër me autografin-vjershë, ku ndër të tjera thoshte: "A të kujtohet, xhaxhi Bedri,/ kur i shndërronim vargjet në fëmijë,/ ne të dëshronim këtu në Kosovë,/ ne na dëshroje në Shqipëri…". Pas çlirimit të Kosovës, bile dhe pak ditë para se të ndahej nga jeta, e vizitoi disa herë Kosovën dhe kudo u mirëprit me dashuri për meritat e shumta të tij, si pedagog, shkrimtar e studiues. Prof.Dedja, si mjaft intelektualë bashkëkohës, ishte mjaft i lodhur nga jeta dhe i ngarkuar nga krijimtaria intensive. Por gjithnjë mbeti me vullnet të çeliktë dhe i papërkulur. Kështu, nuk iu nda punës dhe veprimtarisë krijuese, letrare e shkencore, duke qenë një ndër anëtarët e bashkëpunëtorët më aktivë të Akademisë së Shkencave, të Ministrisë së Arsimit e Shkencës, Institutit të Studimeve Pedagogjike dhe Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve. Kujtojmë këtu, p.sh., se në vitin 2003 u botua vepra madhore "Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar", ku ai ishte autor kryesor dhe përgjegjës i redaksisë. Kam pasur fatin që, në atë periudhë të jetës, të bashkëpunoj me të. Gjithëherë, ndieja aftësitë e tij të rralla dhe horizontin e gjërë, taktin e punës në kolektiv e tjera.Po kështu, në kuadrin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ai drejtoi redaksinë e arsimit për ripunimin e "Fjalorit Enciklopedik Shqiptar";kryesoi bordin e vlerësimit të botimeve letrare-publicistike për fëmijë, pranë MASH, ku gjithashtu kam bashkëpunuar me të etj. Ishte kryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve dhe kryetar nderi i Shoqatës Mbarëshqiptare të Shkrimtarëve për fëmijë e të rinj. Gjithashtu, ishte bashkëpuntor pranë Universitetit të Kembrixhit për hartimin e biografive të njerëzve të shquar dhe emri i tij renditet ndërmjet anëtarëve të Lidhjes Botërore të Shkencave Pedagogjike. Për arsye financimi, i mbeti pa realizuar projekti për organizimin e Kongresit të Parë Mbarëshqiptar të Psikologëve.

Prof. Bedri Dedja ka botuar mjaft vepra shkencore dhe tekste për shkollat e larta në fushën e pedagogjisë, psikologjisë dhe historisë së arsimit e të mendimit pedagogjik shqiptar, ndër të cilët përmendim librin "Sekretet e talentit". Ka marrë pjesë në shumë tubime kombëtare e ndërkombëtare, ku janë shqyrtuar probleme të ndryshme të psikologjisë e pedagogjisë dhe të letërsisë për fëmijë etj. Është për t'u shënuar se edhe në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë, 1972) lexoi

punimin e tij, me temë: “Rreth akselerimit psikik dhe ndikimit të tij në mësimin e gjuhës letrare”.Për të ktijuar një përfytyrim më të plotë për veprim,tarinë e gjerë krijuese e botuese të Prof.Bedri-Dedjes, përmbledhurazi, po japim disa të dhëna. Kështu, ai ka botuar 4 novela për fëmijë (që nga “Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit”), 10 vëllime me tregime e përralla (që nga “Përralla popullore për kafshët”), 9 vëllime me vjersha e poema (që nga “Numrat”), 13 romane e 2 pjesë teatrore për fëmijë (që nga “Shoku i braktisur” dhe deri te “Presidenti i Planetit të Kuq”-2006), 3 libra publicistikë (“Biseda me pionierët”-1986 ; “Nëpër ravat e jetës –Kujtime”-2001 ; “Duke ecur kontinenteve - Përshtypje udhëtimesh”- 2004) dhe 13 libra për fëmijë të përkthyer nga rusishtja.Po kështu, ka botuar 14 studime dhe vepra shkencore (autor e bashkautor), në fushën e arsimit dhe edukimit e me tematikë shoqërore, deri te “Sektreti i talentit”(1998). Megjithëse në moshën mbi 73-vjeçare, por i rënduar nga gjendja shësndetësore, kishte shumë plane për botime të reja. Ai pohonte: “Kam dosjet e krijimeve, që kam përgatitur plotësisht ose jo për t’i botuar si libra më vete. E nuk janë pak, janë me mijëra faqe, që edhe i përfshin edhe nuk i përfshin bibliografia ime...”.Ishte ngjarje e veçantë për të gjithë ish-kolegët e ish-studentët, bashkëpunëtorët dhe të njohurit e shumtë dashamirë të tij, që në prill 2009, më rastin e 5-vjetorit të ndarjes së Prof. Bedri Dedjes përgjithnjë nga ne, të përurohej në kryeqytetin Tiranë një tjetër vepër dinjitoze e tij për fëmijë. Ajo mban titullin “Presidenti i Planetit të Kuq”.Në nderim të jetës dhe veprimtarisë së gjerë e shumëplanëshe të prof. Bedri Dedjes-Akademik, në vitin 2010 u botua përmbledhja me mjaft shkrime, nga kolegë, miq e familjarë të tij, me titullin “BedriDedja, në kujtesën tonë”, të cilin pata kënaqësinë ta përgatisja për shtyp.

Në 70-vjetorin e lindjes, Presidenti i Republikës i dha prof. Bedri Dedjes-Akademik, titullin e lartë “Mjeshtër i Madh”. Më parë, ishte nderuar dhe me “Çmimin e Republikës”dhe me mjaft dekorata e çmime të tjera: për jetën e shkrirë në shërbim të arsimit kombëtar, për letërsinë dhe shkencën shqiptare. Prandaj emri dhe vepra e tij do të mbeten përherë të gjalla në kujtesën e brezave tanë.

Tiranë, 13 prill 2014

Kujtesë, në 90-vjetorin e lindjes

Prof. Dr. JUP KASTRATI, NJË NGA VIGANËT E ALBANOLOGJISË

Nga: Isa Halilaj- studiues,"Mësues i merituar"

1. Prof. Dr. Jup Kastrati, një nga viganët e albanalogjisë, u nda nga jeta në shtator 2003, në moshën 79-vjeçare. Shkodra dhe gjithë shqiptarët, që e kanë njohur, e përcollën me nderimin më të merituar. Se u krijua një boshllëk i madh për shkencën albanologjike, për një nga themeluesit e saj. Po figura të tilla, si e Prof. Kastratit, kurrësesi, nuk harrohen. Me 15 prill të këtij viti, në gjallje, Profesori ynë do të festonte 90- vjetorin e lindjes. Kujtesa e historisë, jeta dhe vepra e tij shkencore e atdhetare, na obligojnë që ditëlindjen e tij dhe gjithë datat në shenjë të këtij burri të madh të kulturës e shkencës shqiptare, t'i kujtojmë e respektojmë, me nderimin më të madh.Prof.Jupi, veprat dhe jetën intelektuale e qytetare, i ka bërë vetë të njohur mjaft mirë. Po, në vlerësim të kësaj figure, janë shkruar edhe vepra e artikuj të shumtë. Kam parasysh këtu shkrimet e prof. Tomorr Osmanit, Begzad Baliut, Diana Kastratit, Mentor Qukut, Vehbi Hotit, Naim Kules e mjaft të tjerëve. Me këtë shkrim modest, edhe unë, ish-student e bashkëpuntor i tij, po shprehi nga zemra dhe mendja respektin dhe vlerësimin më të lartë, për këtë personalitet të shquar të mendimit e veprimit shkencor shqiptar.Arsimimi i tij, dëshirë e vullnet i pamposhtur, është realizuar me vështirësi e pengesa të kohës. Në vitet '30- '35 të shekullit të kaluar, mbaroi filloren plotore shkëlqyeshëm. Pastaj i futet Gjimnazit klasik ('36- '40) dhe Liceut Real ('41- '44) në qytetin e lindjes, Shkodër. Pak kohë, në këto vite, ka vazhdur në Liceun"Galileo Ferraris", Convitto Nazionale "Umberto I" në Torino të Italisë, që i vlejti shumë për horizont dhe kulturë të përgjithshme. Por, pikërisht në këtë periudhë rinie, gjatë pushtimit italian, si antifashist, është persekutuar, burgosur e internuar në fushë-përqëndrimin italian, Comando Z, te Kodrat e Tepes, në Shkodër. Pastaj, nga andej është dërguar peng në burgun famëkeq të Prizrenit, në korrik-shtator 1943, nga i cili, te Ura II e Vezirit në Kukës, u pushkatuan 16 shkodranë e kosovarë të burgosur.

2. Që nga shtatori i 1946, shërbeu mësues në qytetin e lindjes, duke mos e ndërprerë për asnjë çast përpjekjen për arsimim në nivelet më të larta. Pasi mori ILP 2-vjeçar në Tiranë, shërbeu me përkushtim në Gjimnazin e Shtetit Shkodër. Aty shquhet një mësues dhe edukator meritor, me rezultate të larta. Krahas punës në mësimdhënie, nuk rreshti së paraqituri me shkrime tematike e problemore në shtypin e kohës. E, pa shkëputje nga puna, arriti të mbarojë Fakultetin e Filologjisë, në UShT. Me këtë nivel përgatitjeje dhe me dëshirën që Shkodra të ketë arsimin e lartë, ai është nismëtar themelues, jo vetem i ILP 2 e 3-vjeçar të Shkodrës, nga 1957, por edhe ka meritën e kthimit të këtij institucioni në Universitet, me emrin "Luigj Gurakuqi", në saje të kujtimeve dhe kërkesave urtake të këtij shkodrani të mirë, pranë organeve të larta shtetërore. Aty ai sherbeu pedagog e shef katedre i gjuhës shqipe. Është periudha më intensive e prof. J.Kastratit, në fushën e gjuhësisë dhe bëhet një nga themeluesit e Albanologjisë, në krah të Akademikëve E. Çabej, M. Domi e Sh.Demiraj.

Ka shërbyer në arsim mbi 57 vjet, nga të cilët 37 në arsimin e lartë, kryesisht në Shkodër. Ishte model për t'u marrë shembull në mësimdhënie, për përgatitje të thellë shkencore, për taktin pedagogjik e korrektësinë e edukatorit. Siç shënojnë edhe ish-studentët e ti,j Ismet Bala e Naum Kule, prof. Kastrati, ndryshe nga disa pedagogë që kërkonin ta sajonin autoritetin e tyre me poza fallse, nga toni kërkues dhe denigrues, që si të thuash përdornin pedantizmin e tyre shtrydhës, duke tundur "lëkurën e ujkut", ai i jepte dritë e bindje auditorit, me njohuritë që jepte. I ishte i vetmi pedagog, që i vlerësonte studentët, në radhe të parë, me shprehjen "Ju faleminderit!" dhe, ngrohtë e ëmbël, udhëzonte: *" Për këtë çështje shikoni edhe njëherë leksionin; po shikoni te Çabej apo te Fatmir Agalliu dhe këtu e këtu…e pastaj bisedojmë përsëri…".* Kur studentët përgjigjeshin mirë e ndonjë merrej suksesshëm me punë shkencore, Profesori i vlerësonte si një hap i mirë i punës së tyre dhe vazhdonte nxitjen, *"jemi te vonuar , bota ka ecur shumë përpara, prandaj nga me hap, të ecim me vrap* !". Kjo ishte në fakt motua e punës së tij. Një meritë e veçantë e prof. Kastratit është mbrojtja e lidhjeve të punës me gjithë institucionet shkencore, në Shkodër dhe Tiranë ose në Prishtinë, Tetovë e Ulqin dhe me arbreshët e Italisë e të Greqisë, po dhe me studiues, ish-studentë e bashkëpuntorë të tij, si Xhemal Meçin e Ismet Balën, në Pukë e Tropojë; me Shefqet Hoxhën, në Kukës dhe deri

me Novruz Shehun, në Tepelenë e Naum Kulen, në Fier. Ndërsa prof.esor Mark Tirtja, ish-student i tij në ILP, nuk harron ta vlerësojë atë si nxitësin e parë e kryesor të tij, " *për t'u marrë me punë kërkimore shkencore. Ai na ka trajtuar si koleg e familjar, në ato vite mjaft të vështira për ne".*

3. Veprimtaria e Prof. Kastratit është e shumanshme, pedagogjike e shoqërore, shkencore e albanologjike, si në historinë e gjuhësinë shqiptare, albanologjinë, historinë e letërsisë shqiptare e në veçanti të asaj arbreshe, dialektologji e folklore, në historinë e shkollës shqipe e mendimit pedagogjik dhe, veçmas, në bibliografinë shqipe.Punimet shkencore kryesore të tij janë përfshirë në mbi 30 vëllime studimesh, të botuara nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti i Tiranës, po edhe në Kosovë, Tetovë, Napoli, Kalabri, Salerno etj. Veprat e tija shkencore, të botuara e ribotuara që nga viti 2001, arrijnë në një kolanë prej 40 vëllimesh dhe 6 të tjera janë të sistemuara në dorëshkrime, që presin dritën e botimit, një trashëgimi serioze e albanologjisë. Mjafton të përmendim vetëm disa prej tyre, si: "Historia e Albanologjisë", në 5 vëllime; "Historia e gjuhësisë shqiptare", "Historia e gramatologjisë shqiptare", "Sintaksa e gjuhës shqipe"; studime linguistike, filologjike e arbreshe; Bibliografi albanistike, ditar shkencor ose monografitë e bibliografitë e veçanta, si për Konicën, Skëndërbeun, De Radën, F. Shirokën, N. Mjedën (në bashkëpunim me K.Biçokun e M.Qukun) etj. Të gjitha këto, në disa vëllime.Ai dha një ndihmesë të çmueshme në studimin e fonetikës e drejtëshkrimit, ortografisë, dialektologjisë e tekstologjisë e sintaksës, si dhe në përkthime gjuhësore. Të gjitha këto, me syrin e një mjeshtri, prej pedagogu e studiuesi të palodhur e diturishumë, për t'i bërë të kuptueshme e të asimilueshme në aspektin shkollor dhe publik.

Në bibliografinë e shkrimeve të prof. Kastratit, në periudhën 1941 – 1999, bie në sy shumica e organeve, brenda dhe jashtë vendit, në mbi 90 gazeta dhe revista, nga të cilat 25 jashtë Shqipërisë, si në Kosovë, Maqedoni e Mali i Zi, në Europë, Amerikë e Azi. Ky autor i shquar kishte informacion të thellë për studimet e kryera nga albanologë dhe studiues të tjerë të huaj, për vendin e historinë kombëtare shqipëtare. E, në këtë plan, shumë nga studimet e tij janë bërë të njohura e të publikuara në gjuhë të huaja, jashtë shtetit. Ai zotëronte mjaftë mirë gjuhët latinisht, italisht, frengjisht etj.Shpirti i tij kërkues e krijues, në të gjithë veprimtarinë e tij, ka

orientim kombëtar, besnik ndaj idealit të shqiptarizmës, që përvizoi Rilindja Kombëtare Shqiptare. Prof. Kastrati, me pjekuri e guxim, mundi t'i bëjë ballë fluktualitetit politik dhe ideologjik në vite e na dha vepra me përmbajtje të shëndoshë shkencore, edukuese e me theks kombëtar, në shërbim të brezave të rinjë.Ishte pjesëmarrës në të gjitha konferencat albanalogjike e ato historike, brenda dhe jashtë vendit. Në sesione shkencore ka kumtuar mbi 120 tema e diskutime të frytshme. Më 1972 ka qenë delegat firmëtar e organizotor, në zhvillimin e *Kongresit të Drejtëshkrimit.* Me mençuri e guxim, ka mbrojtur e zbatuar besnikërisht Standartin e Gjuhes Letrare Shqipe, me idenë se, me një gjuhë e një komb, i shërbehet bashkimit kombëtar. Veçmas këtyre, e ka ndihmuar direkt Shkodrën, duke themeluar e drejtuar: *"Buletinin për Shkembim Eksperience",* "Buletinin Shkencor" të ILP, në 45 vëllime; revistën letrare *"Shkodra",*në 15 vëllime. Ka qenë redaktor te *"Gjuha Jonë", "Lidhja"*- Kozencë, *"Besa"* etj.
Prof. Kastrati, që nga viti 1958, mori tituj shkencorë, shkallë pas shkalle, në 60 vitet e punës shkencore, duke patur udhëheqës shkencor, relatorë e recensentë, profesorët më me peshë të albanalogjisë, si E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, Dh. Shuteriqi, V. Bala, E. Lika etj., duke merituar gradat e titujt: "Kandidat i Shkencave", "Docent", "Doktor", "Profesor"e "Akademik", duke u renditur kshtu me dinjitet në radhët e themeluesve të Albanologjisë dhe shkencës shqiptare. Është vlerësuar e nderuar; me mirënjohje, tituj, medalje e me urdhëra. Që nga 1979, me titullin *"Mësues i merituar"* e më 1987, *"Mësuesi i Populit";* ndërsa, në kuadrin e 75-vjetorit të lindjes, Presidenti i Republikës i dha titullin e lartë, *"Mjeshtër i Madh".*Nuk mund të lëmë pa përmendur vlerësimin meritor, që i është bërë prof. J. Kastratit, më 1998, duke e përfshirë atë në *"Enciklopedinë Ndërkombëtare të Bibliografive" (Edicioni i 13-të i intelektualëve botërorë).*
Për të gjitha këto, në kurorëzimin e veprës e jetës së tij, ka patur edhe përkrahje, vlerësime kolegjiale, kolektive e instucionale, shoqërore e shkencore, në Shqipëri dhe në botën akademike të gjuhësisë e të albanologjisë. Pikërisht për këtë, ai përkujtohet dhe do të përkujtohet me respekt, jo vetëm në këtë 90-vjetor të lindjes, por gjithmonë, sot e në të ardhmen, nga brezat e studjuesve dhe botës akademike shqiptare.

SHTOJCË

KRONIKË KULTURORE

VEPRIMTARIA NË TIRANË

Fjalët përshëndetëse

Prim.dr Gani Karamanaga
Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në emër të Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në MZ , në emrin tim personal Ju përshëndes të gjithë. Kjo veprimtari sot po organizohet më së pari falë angazhimit të posaçëm të Prof. Emil Lafes, mikut të Ulqinit.

BKSHMZ u themelua në vitin 2002. Përveç angazhimeve të shumta boton revistën vjetore “Dija”, dhe tani edhe revistën periodike “Gjon BUZUKU”.Është me rëndësi të ceket se në Ulqin botohen tri revista: ”Dija”, ”Lemba”, “Gjon Buzuku”. Me këtë gjë nuk munden të krenohen as shumë vende tjera më të mëdha se Ulqini. Gjithashtu në Tuz grupi intelektual boton revistën “Malësia”.

Miq të dashur,

Ne kemi shumë nevojë për bashkëpunim, të jemi të pranishëm te njëri-tjetri, gjithashtu kemi për detyrë të sensibilizojmë opinionin publik shqiptar, por edhe atë zyrtar në vendin tonë, por edhe në Shqipëri, në shtetin tonë amë.

Është fakt se të dy shtetet shqiptare, Shqipëria dhe Kosova, nuk kanë interesimin dhe ndihmesën e nevojshme për ne që gjendemi jashtë kufijve tuaj. Për këtë arsye, ideja e BKSHMZ, e cila po realizohet sot, dhe përurimi i revistave në gjuhën shqipe nga Mali i Zi në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe me përkrahjen e Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave mund të themi lirisht është një ngjarje historike. Jemi krejtësisht të bindur se prej sot do të ndërrohet interesimi dhe angazhimi i Institucioneve kulturore e shkencore të Shqipërisë. Ne besojmë se ka vend edhe për mbështetjen financiare, siç praktikohet në botë dhe në rajon për pjesëtarët e popullit të vet.

Kolegët e mi janë shkencëtarë, publicistë të njohur në vendin tonë edhe më gjerë. Ata ato do t'Ju njohin veçanërisht me botimet e lartpërmendura, me theks për kulturën dhe krijimtarinë e Shqiptarëve në Mal të Zi

Tiranë, 08.04.2014

Emil Lafe

REVISTAT SHKENCORE-KULTURORE TË SHQIPTARËVE NË MALIN E ZI – NJË NDIHMESË E SHQUAR NË SHKENCËN DHE KULTURËN KOMBËTARE

Të nderuar kolegë, veprimtarë të shquar të shoqatës Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi,

Të nderuar pjesëmarrës në këtë veprimtari, ku na bashkon dëshira për të qenë më pranë e për t'i shtrënguar më fort dorën njëri-tjetrit, për të tejkaluar pasojat e viteve të veçimit, për të vështruar më me besim drejt zhvillimeve të ardhme të përbashkëta!

Shqiptarët jetojnë në shtete të ndryshme, por kanë pasur dhe duhet të kenë një shtet të përbashkët kulturor kombëtar, që i ka themelet te origjina e përbashkët dhe e stërlashtë, te kultura shpirtërore dhe materiale e përbashkët dhe e lashtë, te mendësia dhe vetëdija etnike e përbashkët dhe e lashtë, te përpjekjet qindravjeçare për të mos iu nënshtruar shpirtërisht sundimtarëve e qeveritarëve të huaj, te gjuha arbërore-shqipe e përbashkët dhe e stërlashtë dhe te gjuha letrare e sotme e përbashkët, e më në fund edhe te aspirata jonë evropiane e përbashkët.

Në Malin e Zi shqiptarët përbëjnë një pakicë kombëtare, që nuk jeton në një territor kompakt. Ata jetojnë në pesë komuna: në komunat e Ulqinit e të Tivarit, që janë fqinje e me vijimësi territoriale, në komunën e Podgoricës, të Plavës e të Rozhajës. Jetesa e tyre në ish Republikën Jugosllave të Malit të Zi dhe më pas në Malin e Zi shtet i pavarur ka kaluar nëpër mjaft kthesa e përkthesa, por ata ia kanë dalë të mbeten pasardhës të denjë të të parëve të tyre, që kanë shkruar histori. Ata kanë mbijetuar. Mbijetesa është një çështje madhore për bashkësinë shqiptare në Malin e Zi prej rreth 50-60 mijë frymësh, prej të cilëve ndoshta një e treta janë në mërgim. Në kohën e sotme moderne mbijetesa kuptohet si ruajtje dhe zhvillim i mëtejshëm i kulturës kombëtare nëpërmjet mjeteve të infrastrukturës kulturore, kuptohet si ruajtje dhe zhvillim i mëtejshëm i arsimit në gjuhën amtare dhe i vetëdijes për përkatësinë kombëtare historike. Shtresa intelektuale shqiptare në Malin e Zi nuk e ka ndarë detyrën kombëtare nga veprimtaritë e përditshme për sigurimin e jetesës dhe ia ka dalë të mbajë gjallë në popull dëshirën frymëzuese për të mbetur pjesë e pandashme e botës shqiptare në kuptimin e gjerë të fjalës, për të krijuar një osmozë kulturore-arsimore-shkencore me këtë botë. Institucionet arsimore e shkencore-kulturore të Kosovës në fillim dhe ato të Shqipërisë në kohët e fundit kanë qenë mbështetje e shëndoshë edhe për ecurinë e mbarë të arsimit, të kulturës e të shkencës te bashkësia shqiptare në Malin e Zi.

Si një ndër përpjekjet e para të shqiptarëve në Malin e Zi për të krijuar periodikun e vet shkencor-kulturor duhet përmendur edhe revista “Kraja”, që u botua në nëntor 1997 nga një grup intelektualësh, me redaktor përgjegjës Mr. Ismail Dodën, kolegun tonë të zellshëm të studimeve gjuhësore e folkloristike, që përfaqësoi si delegat në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) bashkësinë shqiptare në Malin e Zi. Në një parafjalë të shkurtër

redaksia shkruan se revista “Kraja” do të ishte një tribunë e fjalës dhe e mendimit të lirë, e hapur për të gjithë, për studime e punime nga shkenca të ndryshme, për krijime letrare e artistike, për botimin e trashëgimisë kulturore popullore dhe me këtë mënyrë do t’i shërbente mbijetesës së shqiptarëve si të tillë në ato vise. Vërtet “Kraja” nuk mundi të mbijetonte (doli vetëm numri i parë), por mbijetoi ideja e saj, misioni i saj, që e vijojnë revistat (sipas radhës së botimit): “Lemba” (1998), “Buzuku” (2001), ”Dija” (2003), “Malësia” (2005), për të cilat jemi mbledhur sot në këtë tubim.

Të botosh një revistë është si t’i ngjitesh një mali të përpjetë: duhet të kesh gjunjë të fortë e zemër të fortë. Por kur arrin në majë, kënaqësia është shumë e madhe. Këtë kënaqësi e kanë shijuar prof. Simë Dobreci dhe bashkëpunëtorët e tij me 40 numrat e “Buzukut”, dr. Nail Draga dhe bashkëpunëtorët e tij me 16 numrat e “Lembës”, botuesit e 10 numrave të revistës “Dija” (Muhamet Nika, Gani Karamanaga, Simë Dobreci, Gjekë Gjonaj, Hajro Ulqinaku etj.) dhe z. Nikë Gashaj me bashkëpunëtorët që kanë nxjerrë 8 numrat e revistës “Malësia”. Të gjithë numrat e botuar të këtyre revistave shkojnë në mbi 7500 faqe shtypi. S’ka dyshim se kolegët tanë të nderuar meritojnë përgëzimet më të ngrohta për këtë. Dua të përmend se numri i parë dhe i vetëm i revistës “Kraja” hapet me një shkrim të atë Justin Rrotës për “Mesharin” e Gjon Buzukut. Dihet se Kraja, më fort se çdo tjetër trevë shqiptare, ka arsye të mëtojë se autori i librit të parë shqip është një bir i saj, ashtu siç e cilëson edhe prof. E. Çabej Gjon Buzukun pas analizës shembullore të gjuhës së librit: “bir i malësisë së Krajës, Ljarjes e Shestanit, një famullitar i dalë prej dioqezës së Tivarit a mbase të Ulqinit.” Vetë revista “Buzuku” dhe dy sesione shkencore për 440- dhe 450-vjetorin e “Mesharit” në Ulqin më 1995 e 2005, dëshmojnë se kolegët tanë të nderuar ndiejnë jo vetëm krenari, po edhe përgjegjësi intelektuale, duke qenë nga po ato vise si kryetrimi i shkrimit shqip. Vetëdija për këtë trashëgimi historike vepron si një forcë lëvizëse në Shoqatën e Krijuesve Shqiptarë të atyre trevave.

Tri nga revistat e sipërpërmendura, “Lemba”, “Dija” e “Malësia” kanë një profil të qartë kërkimor-shkencor dhe kulturor. Në to janë botuar një varg artikujsh që trajtojnë tema e çështje të mëdha e të vogla të historisë shqiptare që nga lashtësia deri në ditët tona, të kulturës popullore materiale e shpirtërore, të

letërsisë dhe të zhvillimeve letrare në përgjithësi, të gjuhës shqipe në vështrim të gjerë që nga sjellja e visareve gjuhësore origjinale të atyre trevave deri te shqyrtimet shkencore për çështje të rëndësishme të zhvillimit historik dhe të gjendjes së sotme të gjuhës shqipe e veçanërisht të gjuhës letrare. Në këto revista përveç autorëve vendës kanë bashkëpunuar edhe shumë autorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e nga bota e jashtme.

Të gjithë ata që ndjekin ose studiojnë zhvillimet e sotme ose dhe të shkuarën e viseve shqiptare më të epërme në krahun e veriperëndimit, kanë në këto revista një pasuri të pazëvendësueshme informacionesh dhe trajtesash shkencore. Prandaj ato duhet të jenë të pamungueshme në fondet e bibliotekave shkencore e universitare të Shqipërisë dhe më gjerë. Mendoj se është e nevojshme që redaksitë e revistave më të njohura albanologjike, si "Studime historike" e Studime filologjike" në Tiranë dhe "Gjurmime albanologjike" me tri seri në Prishtinë të botojnë rregullisht recensione paraqitëse për çdo numër të ri të revistave të mësipërme. Do të ishte mirë të mendohej edhe për një bibliografi të plotë të këtyre revistave, por hë për hë mund të botohej edhe nga një bibliografi tematike. Bibliografia vetëm e shkrimeve gjuhësore që kam nxjerrë prej tyre përmban: për revistën "Lemba": 52 artikuj dhe 11 recensione; për revistën "Dija" 50 artikuj dhe 2 recensione; për revistën "Malësia" 63 artikuj dhe 9 recensione, - gjithsej 165 artikuj dhe 22 recensione – një pasuri e vërtetë shkencore. (Këtu nuk përfshihen nr. 17 i rev. "Lemba" dhe nr. 11 i rev. "Dija", që dolën nga shtypi ditët e fundit).

Revista "Buzuku" i drejtohet një publiku më të hapët. Si revistë shoqërore-kulturore-informative dhe e ilustruar ajo ka krijuar një profil shumë tërheqës për lexuesin, që gjen këtu një gamë të larmishme subjektesh e çështjesh. Një meritë e revistës është se u drejtohet gjerësisht mërgimtarëve: pasqyron veprimtaritë e tyre të shumta për ruajtjen e gjuhës shqipe e të traditave, u krijon lidhje me vendlindjen, i njeh me njerëzit e mendimit e të veprimit dhe me ngjarjet e shënuara të historisë sonë kombëtare. Duke kaluar sa herë nëpër duar këtë revistë, kam sjellë nëpër mend këtë ide: me një numër aq të madh mërgimtarësh në Europë e në Amerikë a mos është koha për të themeluar një revistë të veçantë që t'u drejtohet kryesisht atyre, të jetë kryesisht për ta e për problemet e tyre?

Jeta intelektuale dhe shkencore e shqiptarëve në Malin e Zi sigurisht është shumë më e gjerë sesa revistat që përmendëm. Një varg studiuesish që jetojnë e punojnë atje, janë autorë monografish e librash me vlerë. Kemi ndërmjet nesh sy mjekë të mirënjohur: Prof. Dr. Simë Dobreci, titullar i lëndës së dermatologjisë në Universitetin e Prishtinës (tani në pension), autor i tekstit universitar "Dermatologjia" dhe i një vargu studimesh e artikujsh; po kështu Prim. dr Gani Karamanaga, autor studimesh mjekësore, ndër të cilat edhe dy libra të tij të kohëve të fundit: "Historiku i shërbimit shëndetësor në Ulqin" (2011) dhe përmbledhja e punimeve shkencore "Dielli, deti dhe shëndeti" (2013); nga fusha e gjeografisë (fizike dhe humane) Dr. Nail Draga, autor i një vargu librash studimorë, bashkëpunëtori ynë shembullor për "Fjalorin enciklopedik shqiptar" në tri vëllime (2008-2009). Sigurisht vendin kryesor e zënë botimet që kanë të bëjnë me historinë dhe traditat e trevave shqiptare, me gjeografinë fizike dhe të qendrave të banuara, me gjuhën, onomastikën, folklorin etj. Këtu do të përmenden studiues të zellshëm e të merituar si Ruzhdi Ushaku, Hajro Ulqinaku, Bahri Brisku, Maksut Haxhibrahimi, Basri Çapriqi, Haxhi Shabani, Gjokë Dabaj, Sulejman Ahmeti (dy të fundit jetojnë në Shqipëri). Do të përmendet studiuesja e zellshme nga Malësia Dr. Gjystina Cacaj-Shushka (jeton në Prishtinë), e cila ka botuar studimet më të mira për abetaret e Naum Veqilharxhit me nxitjen e akademikut Rexhep Qosja nga Vuthajt, ndërsa mbiemri i akademikut tjetër Mehmet Kraja e tregon qartë prejardhjen e tij. Veprimtaria letrare e krijuesve në Malin e Zi e nga Mali i Zi është e gjerë dhe e larmishme, por kjo përbën një temë tjetër.

Radhët e krijuesve e të studiuesve shqiptarë në Malin e Zi kanë ardhur duke u shtuar e duke u forcuar profesionalisht. Po ashtu edhe bashkëpunimi me institucione të Tiranës, Shkodrës e Prishtinës. Këtë e dëshmon edhe mbajtja e dy konferencave të gjera shkencore në Ulqin në vjeshtën e vitit 2011 si dhe botimi i akteve të tyre. Është fjala për konferencën me temë "Letërsia gojore dhe identiteti kombëtar shqiptar" dhe për konferencën tjetër "Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve". Të gjitha këto na lejojnë ta shohim me besim të ardhmen e veprimtarisë së Shoqatës së Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi dhe të bashkëpunimit të saj me institucionet e Shqipërisë e të Kosovës.

Veprimtaria e sotme promovuese e ndërmarrë nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Akademia Shqiptare e Arteve dhe e Shkencave me bashkëpunimin e Shoqatës së Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi synon ta bëjë më të njohur për publikun intelektual të Shqipërisë punën kërkimore shkencore dhe botimet në gjuhën shqipe në Malin e Zi dhe njëkohësisht të zgjerojë lidhjet tona të bashkëpunimit.

Këtu jemi në tempullin e librit, flasim për librat dhe shqetësimi, e njëherazi synimi ynë, është që libri të bëhet një mall me qarkullim të dendur, një mall sa më i kërkuar në hapësirën shqiptare. Le të gjejmë rrugët dhe mjetet që biblioteka e Ulqinit, po ashtu edhe biblioteka të tjera në vendbanimet me popullsi shqiptare, të pajisen edhe më mirë, në mënyrë që lexuesi i interesuar, e veçanërisht rinia e sotme që jeton me pulsin e kohës, të gjejë në to botimet më të reja e më të kërkuara. Le të jenë bibliotekat tona edhe qendra të promovimit të botimeve të andejshme e të këtejshme. Libri më i ri i prof. Andra Shundit "Enciklopedi e vreshtarisë dhe e verëtarisë" pati një promovim të suksesshëm në Ulqin në shtatorin e vitit të kaluar. Dy vëllimet e konferencave "Letërsia gojore dhe identiteti kombëtar shqiptar" dhe "Kraja me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve" meritojnë këtu në Tiranë një veprimtari promovuese të përbashkët; po kështu botimet profesionale të mjekëve të nderuar Prof. S. Dobreci e Prim. dr Gani Karamanaga, po kështu edhe mjaft botime të tjera. Tirana me Ulqinin janë vetëm tri orë larg, po aq sa Vlora. Dhe Ulqini nuk është vetëm një vend i mrekullueshëm për turizëm, por edhe një qendër kulturore. Sot, në vend të urës së vjetër e të ngushtë të Bunës kemi një urë të gjerë, moderne. Le ta përdorim atë për t'i zgjeruar lidhjet dhe shkëmbimet tona, për osmozën e shëndetshme kulturore-shkencore që na këndell e na gjallëron. Kohët kanë ndryshuar dhe po ndryshojnë në mënyrë të pabesueshme dhe për të mirën tonë. Kemi nevojë për horizonte më të hapëta, për frymëmarrje më të thellë e më të plotë. Ky takim i përzemërt vëllazëror le të shërbejë si thirrje e si nxitje që të ecim me hapin e kohës!

Emil Lafe
05.04.2014

Prof. Dr. Marenglen SPIRO
President i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave

KRIJIMTARISË SHQIPTARE NË MALIN E ZI

Të nderuar pjesëmarrës,

Të nderuar Zoti Drejtor Plasari dhe Zoti Kryetar Karamanaga

Të nderuar bashkë kombas dhe krijues shqiptarë nga Mali i Zi

Tradicionalisht, do të më takonte të uroja, së pari, mirëseardhjen bashkëkombasve tanë krijues e botues nga Mali i Zi dhe, këtë, po e bëj menjëherë.

Por në fakt, jam i pritur sot të përcjell, së pari, këtij Forumi, vlerësimin e lartë që i bën Akademia Shqiptare e Arteve dhe Shkencave veprës, aktivitetit dhe punëve tuaja kulturore e shkencore në gjuhën shqipe, mrekullimin tim personal kur u njoha me një sërë nga numrat e revistave tuaja dhe të zërave që kanë botuar shkrimet e tyre në 'to si dhe kërshërinë time për të njohur më shumë e në vijimësi këto prodhimtari kulturore e shkencore të trevave tuaja të mirënjohura për atdhetari, gjuhë, histori, tradita, emocione e penë!

Vlerësoj shumë faktin që Biblioteka jonë e nderuar Kombëtare, tek e cila për vite me radhë shkenca e kultura shqiptare ka mbështetur kokën e ka gjetur dritën e ngrohtësinë e nevojshme për të ecur më tej në studime, kumtime, projekte etj., është sot si aktor kryesor me ne në këtë takim. Ai është institucioni i parë autoritar e cilësor të cilit të gjithë ne duhet t'i qëndrojmë pranë, për të bërë të mundur bërjen pjesë të fondit të saj të çmuar të numrave të rregullt të revistave tuaja. Nga ana tjetër, Akademia Shqiptare e Arteve dhe Shkencave e sheh veten të motivuar mbi bazën e qëllimeve që i ka vënë vetes të komunikojë me Shoqatën e Krijuesve shqip të Malit të Zi, në vazhdimësi e rregullisht, për organizimin e veprimtarive të përbashkëta në interes të kontributit në zhvillimet kulturore e shkencore shqiptare.

Përshëndes gjithashtu, të gjithë pjesëmarrësit në këtë event, anëtarët e Akademisë; kam rastin të përmend në mënyrë të veçantë anëtaren tonë Ermonela Jaho, artiste jonë e shquar, për suksesin e arritur ne skenën e Teatrit tonë të Operas, të vogël, por të ngrohtë për ‘të dhe kulturën shqiptare; figura dhe vepra e saj nderon, si këdo në vendin tonë e diasporë, edhe Akademinë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave. Po ashtu, përshëndes një grup bashkëpunëtorësh të Akademisë, njerëz të njohur e të shquar për kontributet e tyre në jetën intelektuale të vendit që janë sot prezent.

Të nderuar miq të shkencës e kulturës, krijues shqiptarë nga Mali i Zi!

Ne do të dëshironim t’i promovojmë sa më shumë revistat tuaja (Buzuku, Dija, Lemba, Malësia etj.), disa numra të të cilave me të cilat jemi njohur nga rekomandimet e profesorit tonë të nderuar Emil Lafe na kanë lënë përshtypje të pashlyera si pasqyra të ligjërimit letrar shqip, me ngjyrat, veçantitë, pasuritë historike e kulturore të trevave ku ju jetoni. Ato janë pjesë e pandarë e kulturës sonë, shkencës e komunikimit letrar e shpirtëror, aspekte të jetës të cilat kanë mbajtur gjallë në kohëra identitetin e kombit shqiptar. Shpresojmë po ashtu që, një bashkëpunim i ngushtë e i shumëanshëm me Bibliotekën tonë Kombëtare të fillojë sot, për të ndërsjellë midis nesh vlerat më të mira krijuese shqiptare të kohës.

Takime e veprimtari të tjera të rëndësishme uroj të pasojnë me vullnetet tona të përbashkëta paskëtaj dhe, nëse më lejojnë, në emër të të gjithë pjesëmarrësve sot, ju uroj, ndërkohë, shumë suksese deri atëherë!

Prof. Dr. Marenglen SPIRO
President i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave
Tiranë, më 8.04.2013

Për revistën BUZUKU
Prof.dr Simë Dobreci

Revista "BUZUKU" ishte në program të publikimeve prej themelimit të Shoqatës Don Gjon Buzuku. Numri i parë i revistës doli me 20 qershor 2001. Deri tash dolën 40 numra, të gjitha janë në ueb faqen www.buzuku.info Revista u mor me çështje shoqërore, kulturore dhe informative. Trajtoi tema nga e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e shqiptarëve, kryesisht atyre në Mal të Zi.

E kaluara: U botuan këngë popullore, u shkrua për trashëgiminë kulturore, për traditën, doket, zakonet, për folklorin, për ngjarjet e lavdishme, për burrat e dheut, për burrëreshat, të bukurat e dheut, për gjenezën tonë dhe për fiset tona. Me një fjalë, u përpoqëm të afirmojmë vlerat tona kulturore.

E tashmja: Trajtuam tema aktuale nga të gjitha sferat e jetës sonë. Në qendër të interesimeve tona ishin problemet që e mundojnë rininë tonë - shkollimi, papunësia, narkomania, alkoolizmi, mërgimi që i shkretoi viset tona, jeta kulturo-zbavitëse. Nuk u lanë anash as shkrimet për një jetë të denjë njerëzore, tolerancë, harmoni e mirëkuptim midis të gjithë shqiptarëve kudo që janë, këtu e në diasporë, pa dallim feje e bindjeje politike. Po ashtu u shkrua edhe për zhdukjen e mbeturinave administrative komuniste, për qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave në shtetet ballkanike, siç është sot në Evropën Perëndimore, çka mendojmë se do të sjell mirëqenien e njerëzve.

E ardhshmja: Duke u nisur nga fakti se pa rini të shëndosh e të shkolluar nuk ka as komb të shëndosh e përparimtar, tentuam të prekim aso temash të cilat e nxisin gjeneratën e re për punë kreative. Në veçanti përkrahem dhe afirmuam punën e të gjithë atyre që kanë afinitet për art, letërsi, muzikë, sport e lëmi të tjera.

Për ato dëshira dhe synime, që u realizuan, u falënderohemi lexuesve të nderuar. Ata na këshilluan dhe na ndihmuan, madje edhe na kritikuan. Çdo kritikë e tyre ishte ndihmë për ne që revista të jetë më e mirë.

U falemi nderit të gjithë ekspertëve të fushave të ndryshme të diturisë dhe të gjithë gazetarëve, që me shkrimet, punimet e veta, e pasuruan dhe e zbukuruan revistën "Buzuku", si dhe e mundësuan botimin e sajë.

Pjesa dërmuese e numrave të botuar të kësaj reviste ka mbijetuar në baza vullnetare, pa kurrfarë kompensimi për të gjithë autorët e kësaj revistë.

Për mbulimin e shpenzimeve na ndihmuan të gjithë njerëzit vullnetmirë, e sidomos ata në gërbet, por edhe komuna e Ulqini dhe Fondi për pakica në Mal të Zi, për çka u jemi shumë mirënjohës.

Në të ardhmen revista do të botohet në kuadër të Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi me emrin e ri Gjon BUZUKU.

**

Me financimin e Fondit të Pakicave në Mal të Zi, më 2012, në Ulqin, u botua libri Dermatomikozat & Sëmundjet tjera të lëkurës (përmbledhje punimesh shkencorë të mia), ku, në faqet 69-72, flitet për distrofinë e 20 thonjve te pacienti I.H. (Twenty-nail dystrophy; botimi i parë në Acta derm. Iug.17, 1990:25-28). Në literaturën botërore nuk gjeta asnjë rast të mjekimit efikas të kësaj sëmundjeje. Mbasi u njoftova me veprimin e sulfatit të zinkut dhe sulfatit të magnezit në organizëm, provova terapinë me këta dy elemente. Me habiti përmirësimi i shpejtë i thonjve të deformuar.

Këtë artikull e botoi të përkthyer në gjuhën shqipe edhe revista Dija nr 10, 2012:216-220, ku shkruan që I.H. është Izet Hajdini.

Edhe në librin tim Dermatolgjia, botim i katërtë universitar më 2009, Prishtinë, në faqen 258 (në botimin e tretë: 1998:259), u shënua që ky deformim i thonjve mund të mjekohet me sulfatet e këtyre metaleve.

Simë Gjon Dobreci

Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi

Ali SALAJ

Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi nuk kanë ndonjë traditë apo ndonjë histori që do të shënonte zanafillen e gazetarisë shqiptare në këto hapësira. Nuk kemi as ndonjë botim të veçantë që merret me çështjen e gazetarisë shqipe në Mal të Zi. Të

gjendur mes dy qendrave të njohura kulturore dhe politike jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë, siç janë Shkodra dhe Raguza (Dubrovniku), shqiptarët e trojeve etnike në Mal të Zi përfshiheshin dhe trajtoheshin kohë pas kohe në periodikët që botoheshin në këto dy qytete. Në Dubrovnik botohej gazeta "Shpnesa e Shcypeniise" (1905-1908), ku botues dhe kryeredaktor ishte intelektuali i njohur nga Trieshi i Malësisë , Nikolla Ivanaj. "Shpnesa e Shcypeniise" ishte një organ me frymë kombëtare, që u ushqente mendësinë e shqiptarëve për kryengritje të armatosur dhe ngrinte idenë e bashkimit kombëtar. Gazeta botohej në gjuhën shqipe (gegërisht), serbisht dhe italisht. Botimi edhe në gjuhën serbe bëhej me qëllim që t'u kundërvihej aspiratave të Serbisë dhe Malit të Zi për uzurpimin e tokave shqiptare. Edhe shtypi i botuar në Shkodër, si gazeta "Ishkodra"(1879), "Shqyptari" (1904), "Xani i Shcyptarve" (1905-1906), "Koha-Bashkimi" (1910-1911) etj., merreshin me çështjen shqiptare, duke përfshirë këtu edhe tema që kanë të bëjnë me shqiptarët në Mal të Zi.

Edhe pse shtypi në gjuhën shqipe ishte i përhapur nëpër të gjithë rajonin dhe në qendrat më të njohura botërore si tek arbreshët e Italisë, në Vilajetin e Kosovës, në Shkup, Sofje, Bukuresht, Stamboll, Beograd, në Greqi, Egjipt e deri në SHBA, vetëm në Mal të Zi , ku ekzistonte edhe shtypshkronja më e vjetër në Ballkan, nuk doli asnjë organ i shtypit shqiptar. U desh të pritet më shumë se një gjysmë shekulli deri në vitin 1965 që në Radion e Malit të Zi të emetohet një emision javor prej 45 minutash në gjuhën shqipe. Më vonë programi në gjuhën shqipe u zgjeruan me Lajmet dhe Ditari që transmetohen gjashtë ditë në javë dhe një emision prej 30 minutash "Në fund të javës". Emisioni i parë në gjuhën shqipe në Televizionin e Malit të Zi fillon në vitin 1992 me një emision në javë për t'u zgjeruar në kohën e pluralizmit partiak në vitin 1998, kur edhe formohet redaksia e gjuhës shqipe. Në Mal të Zi veprojnë edhe dy televizione dhe një radio private TV Teuta, TV Boin dhe Radio Elita dhe disa radio publike: Radio Ulqini, Radio Tivari dhe Radio Zëri i Plavës. Fillimet e mediave publike në nivel qendror dhe vendor kishin në fokus propagandën politike e ideologjike. Në emisionet në gjuhën shqipe mbizotëronte informacioni, kronika dhe reportazhi mbi jetën e fshatit dhe zhvillimin e bujqësisë. Përveç informacioneve të

përkthyera, në këto emisione vërehej një përqasje deri në imitim dhe kopjim të mediave në gjuhën sllave.

Nisja dhe zhvillimi i mediave të shkruara në gjuhën shqipe në Mal të Zi është i vonshëm dhe mjaft i kufizuar. Fillimi dhe ecuria e këtyre mediave përcaktohej nga shumë faktorë, si ekonomikë, politikë dhe profesionalë. Shtypi i shkruar nisi natyrshëm duke e qartësuar dhe kristalizuar formën e informacionit te shqiptarët në Mal të Zi, por për fat të keq shumica e tyre pati veprimtari me një jetëgjatësi të shkurtër si pasojë e problemeve të ndryshme.

Shtypi i shkruar nisi me revistën kulturore "Koha" (1979-1990), ku brenda këtij harku kohor dolën 54 numra dhe për herë të parë sprovohen pendat e reja që më vonë do të jenë emra të njohur në fushën e kulturës, letërsisë dhe artit. Në fillim të viteve '90 fillon botimi i revistës "Fati", botuar nga Shoqata e Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club" në Ulqin, e cila mund të konsiderohet si nismëtare e shtypit pluralist që pak a shumë shkëputet nga zyrtarizimi, nga orientimet e ngurta, duke trajtuar një problematikë më të gjërë e më të larmishme. Pason gazeta e pavarur "Kronika" e lindur si gazetë lokale e Ulqinit. E botuar me ndërprerje për afro 10 vjet (1998-2007). "Kronika" trajtoi tema të ndryshme politike dhe kulturore, duke prekur shpeshherë probleme të mprehta që kishin të bënin me qeverisjen e pushtetit vendor dhe me pozitën e pakicës shqiptare në Mal të Zi. Gazetën e ndiqnin në vazhdimësi mungesa e kuadrove si dhe problemet e shumta financiare.

Në Podgoricë u botua shtojca në gjuhën shqipe në gazetën "Polis", e cila që nga viti 1981 fillimisht doli në një faqe për t'u zgjeruar në 8 faqe në vitin 1992. Gazeta konsiderohej si një segment i rëndësishëm informativ për banorët e Malësisë. Merrej kryesisht me tema rurale pa ndonjë qasje kritike mbi aktualitetet shoqërore dhe politike. Duke iu referuar ligjit të mediave, sipas të cilit shteti, përkatësisht qeverisja vendore, nuk mund të jetë themelues i mediave të shtypura, gazeta u mbyll në vitin 2003. Një revistë tejet lokale, por e një rendësie të veçantë kulturore dhe kombëtare është revista "Buzuku". Të gjitha numrat e saj janë fokusuar rreth kulturës, folklorit dhe historisë së Shestanit në rajonin e Krajës , i cili sot është një vend i asimiluar si në aspektin kulturor ashtu edhe në atë kombëtar. Me paraqitjen e gazetës "Koha javore" në vitin 2002 shfaqet një pejsazh i ri mediatik me

shumë ngjyra dhe mjaft dinamik. Në këtë gazetë vërehet një politikë redaktuese e hapët ndaj mendimeve e qasjeve të ndryshme të shqiptarëve në Mal të Zi, për çka konsiderohet përpjekja më serioze në fushën e mediave të shkruara shqipe në Mal të Zi.

Një prurje pozitive në fushën e mediave ofrojnë botimet e revistave kulturore e shkencore si "Lemba", "Dija", "Malësia", që vazhdojnë të botohen kohë pas kohe sipas mundësive financiare si dhe "Kraja", "Malësia e Madhe" dhe "Illyrikum", të cilat të shtërnguara nga faktori ekonomik dhe pa mbështetjen e duhur të institucioneve dhe donatorëve u detyruan që pas një veprimtarie të shkurtër të mbyllen.

Botimi i këtyre revistave, të cilat kryesisht janë organe të shoqatave të krijuesve dhe të intelektualëve nga Mali i Zi, luajti një rol të madh në emancipimin e lexuesit, por edhe në zbulimin e pendave të reja nga këto hapësira. Veprimtaria intelektuale elitare e botuar në këto revista solli vlera të padyshimta kulturore dhe shkencore, duke u marrë me një larmi problematikash me skeda të krijuara nëpër vite gjurmimesh. Kështu këto revista marrin vlerat e një dokumenti të mirëfilltë shkencor dhe historiografik për shqiptarët në Mal të Zi.

Lemba revista e parë në shqip në pluralizëm

Dr. Nail Draga

Jemi te nderuar qe marrim pjesë në ketë prezantim në Biblioteken kombëtare në Tiranë, me revistat të cilat botohen në shqip në Mal të Zi. Edhe pse shqiptarët në Mal të Zi janë një numër relativisht i vogël (rreth 7%)në popullsisnë e përgjithshme me botimin e revistave janë shëmbull edhe për komunitete me të mëdha. Një veprim i tillë nuk ka dilemë se deshmon qasje serioze për të ruajtur identitetin kombëtar ne një mjedis multinacional dhe multikulturor sikurse është Mali i Zi. Pra kemi të bëjmë me angazhimin serioz e plot pasion të individeve të ndryshëm përmes subjekteve të ndryshme joqeveritare (OJQ) qe kanë arritur rezultate për çdo respekt. Po ashtu duhet të them se kjo veprimtari realizohet me ndërmjetësimin e prof.dr.Emil Lafës, qe paraqet

moment të veçantë sepse është hera e parë qe organizohet një veprimtari e tillë prezantuese.

Në kohën e monizmit shqiptarët në Mal të Zi kanë pasur vetëm një revistë në shqip. Ishte kjo revista KOHA(1978-1989) e cila u mbyll në vitin 1989, duke na mbetur si kujtim 54 numra të saj në bibliotekat tona.

Në kohën e pluralizmit revista e parë në shqip është LEMBA botuar në kuadër të Shoqatës "ART CLUB" në Ulqin. Numri i parë është botuar me 10 gusht 1998, ndërsa deri më tash janë botuar 17 numra. *Revista nuk është e karakterit lokal, por në sajë të temave të trajtuar është e nivelit mbarëkombëtarë.*

Duke shfletuar numrat e botuar deri më tash del qartë se në këtë revistë janë prezantuar emra me autoritet profesional nga bota shqiptare dhe jashtë saj.

Revista ka rubrikat e saja standarde: Studime dhe Artikuj, Ese, Pikëpamje, Letërsi dhe Katalogu. Çdo rubrikë iu ka ofruar lexuesve informacione dhe përmbajtjee interesante, amdje edhe të panjohura deri më tash. Botimi i revistës si më parë edhe tash ka vështirësitë e veta, ku kryesisht dominojnë ata financiare. Por me një vullnet dhe pasion shpresojmë se do të sfidojmë rrethanat e kohës dhe Lemba, do të botohet gjithnjë, duke lundruar në vazhdimësi që do të jetë një kontribut kulturës son kombëtare dhe periodikut në gjuhën shqipe. Dhe në fund edhe një njëher iu shprehim falenderimin tonë organizatorëve te këtij takimi Akademisë Shqiptare të Shkencave dhe Arteve dhe Bibliotekës kombëatre, me shpresë se veprimtari të tilla do të kemi edhe në te ardhmën.

Për revistën "DIJA"
Gazmend Çitaku

Bashkimi i Krijuesve Shqiptar në Mal të Zi u themelua në fund të vitit 2002, ndërsa numrin e parë te revistës së vet Dija e nxori më 2003-tën.

Ideja themelore ishte që revista në mënyrë që të jetë sa më e larmishme dhe të sillte risi sa më të mëdha u vendos që kryeredaktori të jetë i ndryshëm nga numri në numër pra të

praktikohej sistemi i rotacionit ku çdonjëri do të mundte të jepte frymën e vet, fizionomisë dhe përmbajtjes së Dijes.

Skeleti i formuar më parë pra Shkencë, Art, Kulturë bëri që prurja, e shumëllojshme e teksteve të ofruara nga autorët si vendas ashtu edhe nga shteti amë dhe Kosova, të jetë shumë e madhe. Redaksia, ku peshën më të madhe mbante dhe mban Hajro Ulqinaku kishte vështirësitë e veta pasi që nga moria e teksteve të zgjedhë atë që kishte të bënte me jetën, kulturën, historinë dhe përditshmërinë e shqiptarëve që jetojnë në këto treva gjegjësisht jashtë shtetit amë.

Duke sjellë tekste të ndryshme nga jeta e shqiptarëve në Mal të Zi jemi munduar që të mos anashkalojmë edhe ngjarjet apo përvjetoret e ndryshme që kanë të bëjnë me personalitetet apo ngjarjet e rëndësishme kombëtare. Numri i tretë i Dijes ishte numër tematik dhe botoi kumtesat nga Sesioni shkencor lidhur me 450 vjetorin e botimit të Mesharit. Përcollëm përvjetorin e Masakrës së Tivarit, 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Dija ka sjellë frymën e re të krijuesve letrar shqiptarë nga Mali i Zi duke i prezantu me krijimet e tyre të pabotuara më parë. Të gjithë këta së bashku me kolosët e letërsisë shqiptare.

Dija solli risi në revista të tilla duke praktikuar që në çdo numër të saj të sjell tekste interesante nga lëmia e mjekësisë, kohë pas kohe farmakologjisë kurse ato historike e publicistike janë të përnumërta dhe i takojnë fushave të ndryshme. Nuk dua të veçoj asnjë tekst mirëpo shpresoj se sipas kushteve dhe mundësive me të cilat punon redaksia e revistës Dija, e të cilat janë shumë të vështira mendoj se sadopak jemi duke dhënë kontributin dhe mund të konstatoj se Dija është pozicionuar lartë në listën e periodikëve shqiptar si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga jetëgjatësia. Sot këtu së bashku në dorë kemi numrin e 11 të revistës që do të thotë plot 11 vite kontinuitet. Më duhet të krenohem sepse e gjitha kjo punë, e cila nuk është e vogël, bëhet në një qytet të vogël i cili quhet ULQIN e që padrejtësisht është shkëputur nga trungu i vet.

Bashkimi i krijuesve shqiptar përveç Dijes prej këtij viti, pra, prej 2014 në gjirin e vet mori edhe revistën Buzuku dhe i jep përkrahje jetëgjatësisë së kësaj reviste tash të quajtur GJON BUZUKU. Gjithashtu, janë botuar edhe shumë libra nga lëmit e ndryshme e veçoj vetëm disa nga ato: Meteor të arsimit shqip në Mal të Zi, Historiku i shërbimit shëndetësor në Ulqin, Lirika

popullor në trekëndëshin ULQIN-SHESTAN-BREGU I BUNËS etj.

Kur jemi në lëmin e botimeve Shoqata simotër Asociacioni Ulqini e profiluar në lëmin e botimeve nga viti 2006 e deri më tani ka botuar mbi 40 botime të ndryshme nga publicistika, historia, letërsia etj. Botime të këtij Asociacioni nga më prestigjiozet janë Monografitë Fotoalbumi i Ulqinit 1 dhe2, Arsimi shqip në Anë të Malit, Arsimi shqip në Krajë, Shkolla shqipe në Skënderaj, Drenica në Shekuj, Flota shekullore detare tregtare Ulqinake, Glosar-i fjalorth i të folmes detare ulqinake, Kusarët dhe detarët shqiptarë etj.

Sot shpalosëm vetëm një pjesë të veprimtarisë botuese të shqiptarëve në Mal të Zi e që kryesisht zhvillohet në Ulqin si qendra më e madhe shqiptare në Mal të Zi.

Ne kemi nevojë për bashkëpunim, ne kemi nevojë për hapësirë prezantuese, ne kemi nevojë për përkrahje.

Gazmend Çitaku

ROLI I BIBLIOTEKËS SË ULQINIT NË RUAJTJEN DHE AFIRMIMIN E LIBRIT SHQIP

Ardita RAMA

Bibliotekat, si institucione të kulturës, kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin kulturor të shoqërisë dhe paraqesin një standard të lartë civilizues. Një shoqëri e zhvilluar nuk mund të mendohet pa institucionin e Bibliotekës. Që në kohërat e lashta bibliotekat ishin ato që në fillim grumbullonin, e pastaj edhe përpunonin, katalogizonin, ruanin dhe jepnin në përdorim materialin bibliotekar.

Biblioteka e Qytetit të Ulqinit është një nga bibliotekat e para publike në Malin e Zi dhe në rajon. Sipas disa studimeve ajo është themeluar në vitin në vitin 1884, por ka mendime që ajo daton që nga viti 1881. Themelimi i Bibliotekës së Ulqinit, që në

atë kohë quhej Sallë e leximit, paraqet një datë të rëndësishme për zhvillimin e kulturës dhe jetës kulturore në Ulqin. Në vitet e para punoi me ndërprerje për shkak të luftërave. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u shkatërrua gati tërë fondi libror i Bibliotekës, por ajo përsëri u ngrit në këmbët e veta. Në vitin 1965 mori statusin e Bibliotekës Amë për territorin e Komunës së Ulqinit. Në vitet në vazhdim, Biblioteka përjetoi një zhvillim të hovshëm, duke u renditur shpejt në mesin e bibliotekave më të organizuara e më të pasura në Malin e Zi e më gjerë.

Biblioteka e Ulqinit duke zhvilluar veprimtarinë bibliotekare ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe afirmimin e kulturës shqiptare. Përveç grumbullimit, përpunimit, ruajtjes dhe dhënies në lexim të çdo materiali bibliotekar në gjuhën shqipe, ajo afirmon e promovon kulturën shqiptare përmes aktiviteteve të ndryshme tash disa dekada.

Sipas Arkivit të Bibliotekës, viti 1967 shënon datën kur Biblioteka filloi të furnizohej vazhdimisht me material bibliotekar në gjuhën shqipe (para këtij viti në Bibliotekë kanë ekzistuar shumë pak libra në gjuhën shqipe). Kur them material bibliotekar këtu nënkuptoj librat, gazetat, revistat, fletushkat dhe material tjetër të shtypur apo botuar në gjuhën shqipe. Duhet të theksoj faktin që librat në gjuhën shqipe edhe përpunohen në gjuhën shqipe, çka është veçori e Bibliotekës së Ulqinit, si e vetmja e këtillë në territorin e Malit të Zi, e cila përveç katalogut në gjuhën zyrtare, malazeze, posedon edhe katalogun e librave në gjuhën shqipe.

Shumicën e fondit libror në gjuhën shqipe e përbëjnë librat nga shkrimtarë shqiptarë, por ka mjaft edhe letërsi të huaj të përkthyer. Po ashtu, përveç beletristikës, në gjuhën shqipe në Bibliotekë ka edhe libra të fushave të ndryshme shkencore, si dhe fjalorë, enciklopedi e leksikonë. Ky fond është posaçërisht i rëndësishëm për studiuesit, për studentët dhe për të gjithë ata lexues që dëshirojnë të zgjerojnë kufijtë e dijes, të cilët rregullisht shfrytëzojnë sallën e leximit dhe të cilëve me një profesionalizëm të lartë u ndihmon personeli i Bibliotekës.

Kujdes të veçantë i kushtohet letërsisë për fëmijë, sepse mu fëmijët janë lexuesit më besnikë të çdo biblioteke. Në repartin e ndarë edhe fizikisht për fëmijë, i cili është i pajisur edhe me një sallë të vogël të leximit, zhvillohet puna me lexues të vegjël.

Fondi i librave për fëmijë në gjuhën shqipe është mjaft i pasur, duke filluar nga librat me ilustrime, e deri te lektyrat shkollore. Përveç dhënies në lexim të librave, me qëllim të afirmimit të leximit te të vegjlit, në Bibliotekë organizohen edhe takime me shkrimtarë për fëmijë, përurime të librave për fëmijë, orë letrare etj. Disa herë mysafir i Bibliotekës ishte edhe Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë nga Kosova. Po ashtu, Biblioteka është organizatore e garave të ndryshme letrare e të recituesve të rinj, si vetë ashtu edhe në bashkëpunim me shoqata të ndryshme e institucione të arsimit.

Një segment me rëndësi në Bibliotekën tonë është puna në të ashtuquajturin Fondin e Vendlindjes. Fondi i Vendlindjes përfshinë tërë atë material bibliotekar të shtypur apo të botuar në cilëndo gjuhë botërore, kudo në botë dhe kurdo, nga autorë vendas, të huaj apo nga ata që kanë jetuar në komunën e Ulqinit, si dhe çdo material që ka të bëjë me Ulqinin dhe ulqinakët. Natyrisht, kjo punë kërkon ndjekje të vazhdueshme të botimeve të reja, çka në këto kushte financiare është shumë e vështirë. Fatmirësisht, falë punës dhe kontakteve të vazhdueshme me krijuesit dhe botuesit vendas arrihet që për këtë fond të sigurohen gati të gjithë botimet e tilla dhe sot Biblioteka e Ulqinit posedon një përmbledhje të mirë të këtij materiali. Përveç publikimeve monografike, në këtë fond kemi edhe publikime serike, artikuj të ndryshëm, katalogë dhe material tjetër të rëndësishëm.

Jemi duke bërë përpjekje që në kuadër të Fondit të Vendlindjes të krijojmë edhe një fond, i cili do të përfshinte materialin bibliotekar që i përket shqiptarëve në përgjithësi në Malin e Zi. Këtë detyrë e konsideroj si obligim moral ndaj krijuesve shqiptarë në Malin e Zi, pasi që në Malin e Zi nuk ekziston asnjë institucion i mirëfilltë, i cili do të grumbullonte e ruante në një vend trashëgiminë kulturore të shqiptarëve që sot jetojnë në Malin e Zi. Deri më sot, këtë detyrë, deri në njëfarë mase, e ka kryer Biblioteka e Ulqinit dhe mendoj që në të ardhmen, këtij segmenti duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Nuk do të jetë e lehtë të realizohet një ide e tillë, sepse kontaktet me krijues apo botues jashtë Ulqinit janë të pakta, mirëpo sinqerisht besoj se me një angazhim më serioz si individual ashtu edhe institucional, kjo nuk është e pamundur.

Përveç grumbullimit, katalogizimit, ruajtjes dhe dhënies në lexim, në Bibliotekë afirmohet dhe promovohet letërsia shqipe

përmes aktiviteteve të ndryshme letrare. Në hapësirat e saj janë përuruar gati të gjithë botimet e krijuesve vendas, në mesin e të cilëve do të përmendi vetëm disa: prof.dr. Ruzhdi Ushaku, prof.dr. Simë Dobreci, Hajro Ulqinaku, Ibrahim Berjashi, dr. Maksut Haxhibrahimi, dr. Gani Karamanaga, Asllan Bisha e të tjerë, por edhe të krijuesve të tjerë shqiptarë. Janë përuruar edhe shumë numra të revistave vendore në gjuhën shqipe. Po ashtu, Biblioteka ishte organizatore e edhe takimeve me shkrimtarë e studiues shqiptarë, mbrëmjeve letrare, ekspozitave të librit shqip e të aktiviteteve të tjera, me qëllim të afirmimit të librit shqip. Në Bibliotekë janë mbajtur edhe shumë tryeza të rrumbullakëta, seminare e punëtori të cilat kanë trajtuar tematika jo vetëm lidhur me kulturën apo letërsinë, por edhe me problemet aktuale në shoqërinë tonë.

Natyrisht, shumë nga aktivitetet e saj Biblioteka i zhvillon në bashkëpunim me shoqata e institucione të tjera nga vendi dhe rajoni, si dhe me individë intelektualë të shquar. Në një nivel të lartë profesional është bashkëpunimi me bibliotekat e tjera në territor të Malit të Zi, si dhe me disa biblioteka e institucione jashtë, në mesin e të cilave do të përmendi BKUK, Institutin Albanologjik të Prishtinës, bibliotekën „Hivzi Sulejmani“ të Prishtinës, bibliotekën „Marin Barleti“ të qytetit të Shkodrës, Institutin e Goethes në Beograd etj.

Edhe vështirësitë janë të shumta. Një prej problemeve më të mëdha është pasurimi i fondit bibliotekar. Viteve të fundit Bibliotekës nuk i është kushtuar kujdesi i duhur, duke e harruar rëndësinë e saj si institucion i kulturës për zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. Pa kurrfarë mjetesh financiare për blerjen e botimeve të reja, e vetmja mënyrë e pasurimit të fondit janë donacionet nga individë apo shoqata e institucione të ndryshme. Posaçërisht fondi i librave në gjuhën shqipe nuk është përtërirë dhe është amortizuar mjaft.

Në anën tjetër, zhvillimi i shpejtë i teknologjive të telekomunikacionit, posaçërisht i internetit, ka bërë që bibliotekat në tërë botën të ballafaqohen me vështirësi bashkëkohore, në mbajtjen e lexuesve. Për të kthyer lexuesit, të cilët gjithnjë e më pak trokasin në dyert e bibliotekave për të kërkuar informacione, ato u detyruan të ndryshojnë mënyrën e ofrimit të informacionit. Dikur raftet e mbushura me libra, tash vendin po ia lëshojnë materialit jolibror. Edhe kompjuterët janë pjesë e domosdoshme e

inventarit të bibliotekës. Biblioteka si vend ku grumbullohen vetëm librat është botëkuptim i vjetruar, ato janë shndërruar në qendra të mirëfillta bibliotekaro-informative. Edhe bibliotekat në rajon, në mesin e të cilave edhe Biblioteka e Ulqinit, edhe pse me hap mjaft të ngadaltë, po bëhen pjesë e këtij transformimi radikal, por të nevojshëm për përparimin e individit dhe shoqërisë në tërësi.

Sa i përket bibliotekave shqipe, më lejoni t'i quaj kështu, është koha e fundit për vetëdijesim. Kufijtë na ndajnë, por jemi një komb, me një trashëgimi të përbashkët kulturore. Bibliotekat tona, si degë të një trungu të vetëm, duhet të gjejnë rrugë të ndryshme bashkëpunimi, ndërsa Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë do të duhej të ishte urë lidhëse apo nxitëse e këtij bashkëpunimi. Posaçërisht, në shqiptarët që jetojmë jashtë kufijve të shtetit tonë amë, kemi nevojë për përkrahje më të madhe institucionale, e kjo vlen edhe për Bibliotekën e Ulqinit.

Uroj që ky takim sot, si i pari i këtillë, të mos jetë i fundit. Vetëm me një punë të përbashkët mund të ruajmë e afirmojmë me sukses jo vetëm librin shqip, por mbarë kulturën tonë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të bëhemi pjesë e Evropës, e cila nuk është vetëm shoqëri e kapitalit, por edhe e dijes. Dhe atje identitetin tonë mund ta ruajmë vetëm atëherë, nëse atë më parë ia vëmë vetes në dispozicion, e pastaj të tjerëve.

Nikë GASHAJ

Kryeredaktor i revistës për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore "Malësia "

Në emër të Redaksisë së revistës "Malësia" ju përshëndes përzemërsisht dhe njëkohësisht i falënderoj organizatorët: Bibliotekën Kombëtare dhe Akademinë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave në Tiranë për organizimin e këtij promovimi të revistave kulturore- shkencore të shqiptarëve të Malit të Zi.Si themelues dhe kryeredaktor i revistës "Malësia", kam nderin dhe kënaqësinë që vëmendjes Suaj t'i afroj disa të dhëna për revistën në fjalë."Malësia" është revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore. Numri i parë i saj doli në janar të vitit 2005, në Podgoricë, Mali i Zi. Qëllimi parësor i revistës është që në faqet e saj të trajtohen çështje të rëndësishme nga thesari i vlerave kombëtare, historike dhe kulturore të popullit shqiptar. Gjithashtu,

synohet të afirmohet mendimi humanist, dija dhe idetë, të cilat do të kontribuojnë në përparimin e shqiptarëve në Mal të Zi dhe në Rajon, si dhe për ardhmërinë e tyre të lumtur. Revista "Malësia" vazhdon të jetë zëdhënëse e intelektualëve shqiptarë nga mbarë hapësira shqiptare, duke pasur si qëllim pasurimin e kulturës e të shkencës me njohje të reja dhe nxitjen e shpirtit krijues të të gjithë atyre që kanë ide të reja, vizione, mundësi dhe aftësi intelektuale.

Revista "Malësia" ka gjetur përkrahje të dukshme në opinionin profesional dhe shkencor. Këtë e dëshmon rritja e numrit të bashkëpunëtorëve nga mbarë hapësira shqiptare, si dhe nga vendet tjera të rajonit, të Europës dhe nga Amerika. Fakulteti Filologjik i Universitetit të Prishtinës e ka regjistruar tashmë në listën e revistave profesionale dhe shkencore.Në revistën "Malësia", krahas autorëve shqiptarë nga Mali i Zi, kanë botuar punimet e tyre edhe akademikë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës; profesorë dhe pedagogë nga Universiteti i Tiranës, Prishtinës, Shkupit, Shkodrës, Tetovës, Prizrenit, Durrësit, Vlorës, Korçës, Elbasanit dhe i Gjirokastrës.

Gjithashtu, në revistën "Malësia" janë botuar artikuj nga studiues të Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Tiranë; nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë.

Në revistën tonë janë botuar edhe punimet shkencore të profesorëve dhe pedagogëve nga Universiteti i Kalabrisë, i Zagrebit, i Sarajevës, i Beogradit, i Sofjes, i Kingstonit (Kanada), i Budapestit, i Oslos dhe nga ai i Podgoricës. Po ashtu edhe artikuj të politikanëve dhe diplomatëve të lartë nga Berlini dhe krahina Meklenburg në Gjermani, si dhe studiues të tjerë.Për numrin e radhës të revistës, ndër të tjerë, kanë dërguar punimet e tyre për botim edhe studiues të njohur nga Universiteti i Harvard-it dhe ai i Palermos, si dhe autorë nga Anglia dhe Suedia.Revista "Malësia", që me numrin e parë të saj ka pasur përshëndetje dhe fjalë miradije e inkurajuese nga figura të dalluara të botës studimore e shkencore shqiptare, si dhe ka gëzuar vlerësime përmes recensioneve të studiuesve seriozë. Përmendim: Gjovalin Shkurtaj, Shaban Sinani, Tomor Osmani, Rusana Bejleri, Shpresa Hoxha, Tefë Topalli, Mentor Quku, Murat Gecaj, Begzad Baliu, Rovena Vata, Sabina Osmanoviq, Edlira Troplini, Fatmir Minguli, Prend Buzhala etj. Për hapin e mbarë dhe ndimesat e

mirëprituara të kësaj reviste flasin edhe letrat uruese e përshëndetëse drejtuar kryedaktorit të revistës nga intelektualë të njohur të shkencës dhe kulturës shqiptare dhe më gjerë, si për shembull: Aleksandër Stipçeviq, Mateo Mandala, Emil Lafe, Zef Mirdita, Françesko Altimari, Shefkije Islamaj, Agim Vinca, Emine Bakalli, David Luka, Hamit Xhaferi, Drita Ivanaj, Ermira Babamusta, Liman Matoshi, Arjeta Ferlushkaj, Mustafa Spahiu etj. Revista "Malësia" ka arritur një fizionomi kulturore e shkencore të gjerë kombëtare shqiptare. Për këtë arsye redaksinë e revistës e përbëjnë një numër i njohur intelektualësh nga rajonet e ndryshme, jo vetëm shqiptare, por edhe ballkanike.Revista "Malësia" është periodike dhe del një herë në vit. Ajo është e renditur në sistemin ndërkombëtar të publikimeve. Deri më tani janë botuar tetë (8) numra të revistës me rreth 2500 faqe gjithsej. Në numrat e deritanishëm të "Malësisë" kanë publikuar punimet e tyre 190 autorë. Prej tyre, 135 doktorë shkencash, akademikë e profesorë universitetesh nga rajonet e shumta shqiptare dhe më gjerë. Autorët e tjerë janë specialistë dhe publicistë të njohur nga fushat e ndryshme shkencore. Revista "Malësia" ka qenë dhe do të jetë e hapur për të gjithë dijetarët e kulturës shqiptare; për njohjet e tjera shkencore që kanë rëndësi dhe interes për afirmimin e kulturës dhe qënies kombëtare shqiptare.

Ju falemnderit !

ZËRI I KRIJUESVE SHQIPTARË, NË MALIN E ZI

(Veprimtari përuruese, në Bibliotekën Kombëtare)

Nga: Prof. Murat Gecaj

Tashmë, është e njohur se Bashkësia Shqiptare në Republikën e Malit të Zi është mjaft aktive dhe zhvillon një jetë të pasur e të gjallë arsimore, kulturore e shkencore etj., duke ruajtur e zhvilluar më tej traditat atdhetare e liridashëse, si dhe në fushat, që përmendëm më lart. Janë të shumtë shkrimtarët e poetët, studiuesit e publicistët, të cilët gjurmojnë e mbledhin pasuritë shpirtërore të popullit tonë. Me përkushtim e pasion, ata ulen e shkruajnë tema studimore dhe i paraqesin në veprimtari të

ndryshme, ato i publikojnë në gazeta e revista që kanë çelur, por dhe në libra të veçantë.

Edhe nëqoftëse na kërkohet një gjë e tillë këtu, është e pamundur t'i përmendim të gjithë këta autorë, por as drejtuesit e gazetave e revistave të Bashkësisë Shqiptare të asaj treve. Megjithatë, ishte rast i veçantë dhe, ndoshta, shumë i rrallë, që disa prej tyre erdhën sot në kryeqytetin tonë. Nismëtarë ishin Biblioteka Kombëtare e Tiranës, Akademia e Arteve dheShkencave të Shqipërisë (ASHASH), në bashkëpunim me Bashkimin e Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi. Pra, me këtë rast, u organizua një veprimtari përuruese, për revistat dhe botimet kulturore-shkencore, të shqiptarëve në Malin e Zi.

Në sallën e leksioneve të Bibliotekës Kombëtare ishin të pranishëm: shkrimtarë, poetë e publicistë, mësues veteranë, studiues e botues dhe bibliotekare, nga organizatat shoqërore dhe fusha të ndyshme të jetës, në kryeqytet e në Shqipëri, nga media e shkruar dhe ajo elektronike e të ftuar tjerë.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Prof. A.Plasari. Ai ua uroi mirëserdhjen botuesve shqiptarë, nga Mali i Zi dhe nënvizoi se veprimtari të tilla, me bashkëkombësit tanë, i shërbejnë afrimit tonë të mëtejshëm, shpirtëror e kulturor. Pastaj foli kryetari i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Shqipërisë, prof.M.Spiro. Me interes u ndoq përshëndetja e dr.Gani Karamangës, në emër të Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë, në trevat e Malit të Zi dhe e prof. E.Lafes, në emër të organizatorëve të kësaj veprimtarie përuruese.

Pastaj, të pranishmit patën kënaqësinë të dëgjonin për punët e bëra dhe historikun e revistave, që publikohen nga krijuesit shqiptarë atje. Kështu, për redaksinë e revistës "Buzuku", foli dr.Simë Dobreci; për Qendrën Kulturore të Ulqinit dhe revistën "Lemba", dr. Nail Draga dhe për bibliotekën e këtij qyteti, Ardita Rama. Në vazhdim, të pranishmit ndoqën informacionin e paraqitur nga Ali Salaj, për "Art-Klubin" në Ulqin e gazetën "Koha javore" dhe Gazmend Çitaku, për revistën "Dija", organ i krijuesve shqiptarë në Malin e Zi. Në pamundësi ardhjeje, u lexuan të dhënat e dërguara nga Nikë Gashaj, kryeredaktor i revistës së njohur kulturore, shkencore e shoqërore,"Malësia".

Pjesëmarrësit në këtë veprimtari mbresëlënëse vizituan një ekspozitë, që ishte çelur në mjediset e Bibliotekës Kombëtare, me

revista e botime tjera të autorëve shqiptarë, të cilët punojnë dhe jetojnë në Malin e Zi ose e kanë origjinën nga ato vise.

Mendimi i përgjithshëm ishte se kjo veprimtari e parë, që u organizua në Tiranë, është mirë të pasohet me të tjera, në të ardhmen dhe në mënyrë të ndërsjelltë. Është e udhës që edhe organet e larta shtetërore përgjegjëse t'i vlerësojnë më shumë ato, jo si në rastin e sotëm. Në këtë mënyrë, do t'i shërbejmë më mirë edhe njohjes nga afër të krijuesve e botuesve tanë, që jetojnë, punojnë e botojnë jashtë kufinjëve të Republikës së Shqipërisë. Sigurisht, me bashkimin tonë shpirtëror, arsimor e kulturor etj., do të arrijmë në integrimin e plotë të shqiptarëve, në Europën e Bashkuar.

Tiranë, 8 prill 2014

Mirela Kumbaro – Furxhi
Ministria e Kulturës së Shqipërisë

Pershendetje,
Ju lutem po ju nis me poshte nje tekst per revisten tuaj.
Ju uroj gjithe te mirat

Në takim e 13 shkurtit në Tiranë, mes institucioneve kulturore të Kosovës dhe Shqipërisë, ku ndërtohej kalendari i përbashkët kulturor mes dy vendeve pata deklaruar: "Takohemi këtu në Tiranë, në Galerinë e Arteve, në një hapësirë të përbashkët kulture, që mund të ishte e njëjtë në Tiranë, në Prishtinë, në Vlorë apo në Prizren, madje edhe përtej qyteteve e krahinave tona". Dhe sigurisht që kjo hapësirë e përbashkët kulturore përfshin shqiptarët kudo ku janë dhe padyshim dhe ata në Mal të Zi.

Ky kalendar mes Kosovës dhe Shqipërisë, nuk është vetëm i dy vendeve por i gjithë rajonit sepse kultura është e të gjithëve. Është elementi nëpërmjet të cilit më lehtë reflektohen realitetet e reja në rajon dhe nëpërmjet të cilit krijohen jo vetëm ura mes shqiptarëve por edhe përtej tyre.

Prandaj ai takim mund të ishte zhvilluar edhe në Ulqin, Plavë, Tuz, etj. sepse pikërisht këto ura mes nesh dhe përtej i

ndërtojnë edhe shqiptarët e Malit të zi, me gjithë atë trashëgimi që bartin.

Historia është ajo që është dhe nuk e ndryshojmë dot, por së bashku sidomos në frymën evropiane mund të ndërtojmë një të ardhme tjetër, pjesë e të cilës do të jemi të gjithë, ku tashmë shqiptarët e Malit të Zi nuk do të duhet të jenë më aq larg edhe pse shumë afër. Në të kaluarën roli dhe ndikimi i shqiptarëve të Malit të zi në disa momente ka qenë jetik në ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave kombëtare, e njëjta gjë ka ndodhur edhe në historinë e cila është edhe pjesë e memories tonë kolektive, që nga rënia e monizmit e deri tek lufta e Kosovës, por sot ky kontribut, nën një realitet të ri, do të duhet të dominohet nga arti, kultura dhe komunikimet.

Këtë mision Ministria e Kulturës e reflekton me disa politika që ka ndërmarrë për herë të parë, si kalendari i përbashkët kulturor me Kosovën, apo mundësia për mbështetje për organizata dhe artistë shqiptarë jashtë kufijve me kusht bashkëpunimin me ata në Shqipëri, duke bërë një hap më përpara në njohjen tonë të ndërsjelltë, në lidhjet tona.

Si një person që vjen nga shoqëria civile, nga bota e librit, nga komunikimet për mua dhe për këtë Ministri të Kulturës është me rëndësi vizioni dhe aksioni ynë, është i rëndësishëm publiku kudo ku është, janë të rëndësishëm artistët dhe gjithë ata që kontribuojnë që nga folklori e deri tek trashëgimia dhe sidomos është i rëndësishëm krijimi i hapësirave për prezantimin e tyre.

Nuk jam për patetizëm patriotik, do të mbështes skena të hapura për të gjithë ata që sjellin vlera të mirëfillta, për hapësira komunikimi që na ndihmojnë për një njohje gjithëpërfshirëse ku shqiptarët e Malit të Zi janë pjesë e natyrshme. Pa nacionalizma dhe me frymën e një brezi që ecën bashkë drejt Evropës, ku kultura është hapësirë e përbashkët, të cilën askush s'e mbyll dhe askush s'e kufizon dot, diçka që shqiptarët e dinë prej vitesh, por që tashmë së bashku do ta bëjmë me mbështetje institucionale, të lirë dhe pa komplekset e të kaluarës.

Këtë rubrikë e përgatiti:
Prim. Dr. Gani Karamanga

Në bibliotekën kombëtare të Tiranës, u hap ekspozita e shtypit shqiptar nga trojet e Mal të Zi, ekspozita do te jetë e hapur nga data 8-15 Prill!

Fotografitë nga Fisnik Dobreci

© fisnik DOBRECI

© fisnik DOBRECI

© fisnik DOBRECI

© fisnik DOBRECI

Në Kabinetin e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë dr Aurel Plasari

Në kabinetin e Ministres së Kulturës zonjës Mirela Kumbaro - Furxhi

Një fotografi e përbashkët e delegacionit nga Mali i Zi me Ministren e kulturës së Shqipërisë

Fotografi e përbashkët para hyrjes së Bibliotekës kombëtare në Tiranë, nga e majta: Gazmend Çitaku, Dr Gani Karamanaga, Ardita Rama, Dr Simë Dobreci dhe Anton Lulgjuraj

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 12/2014, viti XII, Ulqin

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi
Kryetar: prim. dr. Gani Karamanaga

Redaktor teknik: Gazmend Çitaku

Kontakti
E-mail: **ganik@t-com.me**
Bashkëpunëtorëve u jemi mirënjohës për ndihmesa.
Artikujt duhet të jenë të regjistruar në WORD dokument.
Duhet të jenë të lektoruar dhe të korrektuar.
Nuk duhet të jenë të faqosur e as të dizajnuar.

Shtypi
PRESS STUDIO
ULQIN, 2014

Tirazhi
300 copë

CIP - Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

001+7+82

DIJA / kryeredaktor Hajro Ulqinaku - God. 1, br, 1 (2003)- . - Ulqin (Ul. Majke Tereze bb) : Bashkimi i krijuesve shqiptarë në Mal të Zi, 2013.
- 25 cm

Godišnje.
ISSN 2336-9310 = Dija
COBISS.CG-ID 22278416